



Hasan M. Petrela

LUGINAT

roman

BJA-51
P 56

Hasan
M.
Petrela



LUGINAT

roman

LIBRERIA TIRANA
IP-TIRANA 1970

SH-1000 : 1970

SH-1000 : 1970

SH-1000 : 1970

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

10 - AL 2
324

H.M.
M
Petrela

Petrela, H.M.
Luginat. Roman. T., «Naim
Frashëri», 1979.

... f.

B-ka të mëdha dhe
B-ka të vogla: 891.983-31.

P 56

Tirazhi 18.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re Tiranë, 1979

shofer Kola vullnetarë që ishte ulur në sediljen e djathtë. Ky ishte i ri, rreth
pasagjerë. Dy ishin vullnetarë që shkonin në një kooperativë të thellë malore, tjetri ishte një fshatar.
I.

Në kabinën e kamionit «skoda» kishin zënë vend tre pasagjerë. Dy ishin vullnetarë që shkonin në një kooperativë të thellë malore, tjetri ishte një fshatar.

Shofer Kola, një burrë me trup pak të vogël, i hollë e imët, me një fytyrë në ngjyrë të grurit të pjekur, me një kokë me flokë të rënë, lëvizte krahët, duke rrrotulluar timonin herë djathtas, herë majtas, nëpër ato rrugë malore, gjithë kthesa të forta.

Një copë udhë pasagjerët dhe shoferi nuk folën fare. Prapa, në karroceri, udhëtonin edhe disa fshatarë e fshatare, nja dy ushtarë, dhe një vullnetar tjetër, që s'kishte mundur të zinte vend përpara, për shkak se e kishte zënë ai fshatari.

— Po ju, për ku kështu? — pyeti shofer Kola vullnetarin që ishte ulur në sediljen e djathtë. Ky ishte i ri, rreth

njëzet e pesë vjeç, me një trup të bukur prej sportisti. E quanin Petrit Skënderi.

— Për në Kapercyll, — u përgjigj Petriti.

— E di, se ju pyeta te agjencia. Po ku konkretisht?

— Për në Arrë, — u përgjigj vullnetari tjetër, Elmaz Fuga.

— Ekip?

— Jo, vullnetarë.

Kola i hodhi një vështrim të matur Petritit, buzëqeshi dhe i tha si me shaka:

— Paskeni për t'u mërzitur me këta! — dhe bëri me gisht në drejtë të fshatarit.

— Mos e dëgjoni Kolën ju, o shokë, kështu e ka zakon ky, ka qejf t'i pickojë njerëzit.

Vullnetar Petriti po ndiqte më nge bisedën e tyre me buzë në gaz.

Në shumë vende rruga ishte «supermalore», prandaj Kola ishte i detyruar të ndërronte marshet herë pas here. Dy vullnetarët udhëtonin për herë të parë në këtë zonë të largët e të thellë. Ishte fillim janari. Një puhizë e bardhë dëbore zbardhët majat e maleve. Ata vështronin me vëmendje atë det të pafund bardhësie, me një bukuri të rrallë, që u zgjonte gjësim e hare në zemër.

— Sidoqoftë, përpinquni t'ua shtrëngoni rripat një çikë këtyre, — iu drejtua përsëri Kola vullnetar Petritit,

— Ne shkojmë edhe për të ndihmuar, por edhe për të mësuar, — u hodh e foli Elmaz Fuga.

— Eja na i shtrëngó ti rripat, or Kolë, — ia priti Nazimi me atë zérin e vet të hollë që të gërvishët veshët, — më placin këta sy, po s'të nxorëm me këpucë të kuqe, — dhe qeshi me gjithë shpirt.

— E di, sa për atë jam i bindur. Prandaj po u them këtyre shokëve që t'ju mbledhin, se edhe kjo ndihmë është,

— dhe qeshi duke zbuluar dhëmbët e vegjël.

Heshtën një copë herë.

— Pse ishe në qytet dje? Shite gjë? — e ktheu kokën nga ai shofer Kola.

— Edhe shes, po të dua, edhe blej; në shitsha, mallin

tim shes, po tē blej, me paref e mia blej, — tha ai buzagaz.

— Po, po, pesëdhjetë lekë një kile qershi, njëqind lekë një kile fasule. E, shoku Petrit, ç'thua?

— Lëre Petritin ti, — tha Nazimi, — s'ke punë me tē. Nuk ka mendjen tênde ky. Sa pér fasule, unë nuk shes, se më duhen pér vete.

— Në mos shitsh fasule, shet arra, shet gjalpë me...

— Llogaritë e tē tjerëve i bën shumë mire ti, — tha Nazimi.

— A ka zot që hahet me ju? — qeshi Kola dhe tundi përsëri atë kokën e tij me flokë tē rënë.

Skoda kaloi malin e Arrës. Në tē djathtë një mal tjetër — Selshta plot me pyje. Gjithë pylli, sidomos shkoza, ishte mbuluar nga bardhësia e dëborës.

Në qafë tē malit, pasagjerët zbritën. Nga larg u dëgjuan krisma minash. «Miniera», — mendoi vullnetar Petriti. Acar. Era, brisk e ftohtë, tē mpinte fytyrën. Vullnetarët ngritën jakat e palltove, dikush tē xhupit.

— Hajde, tund lekët ti, — i tha Kola Nazimit. — Kurse ju tē tjerët shkon! — iu drejtua ai vullnetarëve.

Vullnetarët u ndanë me përzemërsi dhe, pasi hodhën në sup nga një deng me rroba, tē mbështjellë me batanije, u nisën teposhtë, në një rrugë gjithë gurë tē vegjël, që u rrokulliseshin nëpër këmbë.

— Këtej do tē ngordhim nga tē ftohtët, — foli vullnetar Elmaz Fuga.

— Pisk do ta kemi, — tha Petrit Skënderi.

— Unë do ta kem marrë plevitin qysh sot! — ia priti vullnetar Sulë Metani, ai që kishte ndenjur në karroceri.

— Hundén dhe veshët më duket sikur nuk i kam tē miat.

— Pse do ta kemi pisk, o Petrit? — pyeti Elmaz Fuga.

— Ti e dëgjoje ç'bisedë u zhvillua në makinë në mes tē Kolës dhe tē Nazimit.

— E pastaj?

— Kjo do tē thotë se do tē kemi ndeshje tē forta në fshat.

— Ajo dihet.

— Është ndryshe ta dish teorikisht, ndryshe konkre-

tisht, — tha me ton të prerë Petriti dhe hodhi dengun nga një krah në tjetrin.

Kur dolën prapa një kodre, përpara tyre u shfaq një hapësirë e madhe. Kudo bardhësi. Përballë një mal, djath-tas një tjetër. Poshtë shtriheshin lugina të tëra. Tutje, fshatra. Ca re të holla ose më mirë një mjegull e bardhë po ngrihej nga lugina e po ngjitej me shpejtësi drejt faqes së malit. Dielli shkëlqente. Gjithçka shndriste. Në thellësi të një lugine gjarpëronte lumi. Ai farfurinte si sedef.

— Natyrë e egër, — tha Elmaz Fuga.

— Si nëpër filma, — shtoi Sulë Metani, duke vështruar gjithçka si me habi.

— Megjithatë, diçka e bukur sikur fshihet këtyre grykave e luginave, — plotësoi Petrit Skënderi me dorën si strehë, për të penguar diellin dhe bardhësinë e déborës, që i verbonte sytë.

2.

Ata u ndalën para zyrate të kryesisë. Ishin ca ndërtesa që kooperativa ua kishte blerë nga dy fshatarëve që ishin larguar përgjithmonë nga fshati.

Rreth e rrotull, qetësi. Toka ishte bërë llucë. Përballë ndodhej furra. Një çunak rrinte te dera e furrës dhe diç shihte. Te mensa erdhi një grua e bëshme, vuri dorën si strehë dhe vështroi me kureshtje vullnetarët. Një qen iu afrua dhe filloi t'i lëpihej e t'i fërkohej me përkëdhelje te këmbët. Ajo e shtyu me shkelm, dhe kafsha u largua me një butësi të habitshme. Njëri nga vullnetarët, Sulë Metani, tek e pa atë skenë, mendoi me vete se, sikur të të vërsulej, ai qen i madh të shqyente pa një pa dy.

Petrit Skënderi bëri në drejtim të furrës dhe, duke e mbështetur njérën dorë në shpatullën e atij çunakut, zgjati

kokën dhe përshëndeti furrxhiun, që e dalloi me zor për shkak se brenda në furre është errët.

— Sekretarin e byrosë së partisë, mos jua ka zënë syri, o shok?

— Jo, nuk e kam parë.

— Po kryetarin e kooperativës?

— Ka vajtur në Selishtë. Ç'e deshët?

— Jemi vullnetarë, — tha Petriti, — deshëm të bisedonim me ndonjërin prej tyre.

— Hyni brenda, hyni! — tha furrxhiu me mirësi. — Ejanë i merrni nga një avull, se paskeni mërdhirë.

Petriti thirri shokët dhe të tre hynë brenda.

Dikush erdhi dhe qëndroi në prag të derës. Brenda në furre u bë më shumë errësirë. — Mirë se rrini, burra! — tha i porsaardhuri me një zë të lartë, por pak të ngjitur. Merrte frymë me zhurmë.

— Ky është brigadier i Arrës, — u hodh e foli furrxhiu. — Me këtë do ta keni punën ju.

— Ashtu? — pyeti Sulë Metani dhe e kundroi me ata sytë e tij të vegjël, si të pulës.

— Po këta shokët nga kanë ardhur? — u dëgjua përsëri zëri i ngjirur i brigadierit dhe hyri brenda në furre me vrull.

— Këta janë vullnetarë, — sqaroi furrxhiu.

— Shumë mirë! — tha brigadieri dhe u zgjati dorën të treve.

— Ju kemi pritur qysh dje... Kështu na pati thënë sekretari i byrosë.

— Ashtu është, — ndërhyri me të shpejtë Petriti. — Dje e kishim për të ardhur, por patëm përsëri një takim në Komitetin e Partisë.

— Për çështjen e lidhjes së partisë?

— Jo. Na dhanë ca udhëzime të reja.

— Shumë mirë! — pëshpëriti si nëpër dhëmbë brigadieri dhe zuri të mendohej.

Brenda në furre bënte ngrohtë. Ca dengje me miell ishin vendosur stivë aty afër një rafti. Pak më tej dukej

peshorja e madhe. Në një kthinë tjetër, majtas, magjeja, ku furrxhiu zinte brumët. Nga afér, vetullat e furxhiut dukeshin si, të pudrosura.

— Sikur do të vinin edhe nja dy shoqe, — tha brigadieri pas pak.

— Ashtu është, — u përgjigj Petriti. — Ato vijnë nesër ose pasnesër.

— Rrobat e fjetjes i sollët?

— Po. Nga dy batanije dhe çarçafë, — tha përsëri Petriti, që për nga mosha dhe nga mënyra se si fliste dukej që ishte përgjegjësi i atij grupi.

— Me nga dy batanije nuk kalohet dimri këtej! Prandaj përpikuni të merrni edhe nga një jorgan. E dyta, keq e kemi për fjetjen tuaj! — dhe brigadieri u ngrys në fytyrë.

— Pse?

— Nuk kemi vend. Sekretari i byrosë dhe kryetari i kooperativës kanë dhënë urdhër që të lirohet një dhomë, por nuk pranon magazinieri, se e ka të mbushur me grurë.

— Po si do t'ia bëjmë? — pyeti Sulë Metani.

— Hëpërhë do t'ju vendos në një dhomë të shkollës tetëvjeçare. Është pak larg, por s'kemi q'të bëjmë. Këto janë kushtet tona. Ju e kuptoni, fshat hesapi...

— E kuptojmë, e kuptojmë, por që të mos kemi vend dhe kushte për të fjetur, këtë unë nuk e kuptoj, — ia priti Sulë Metani si i mërzitur.

— Ju vini turistë apo vullnetarë? — iu drejtua brigadieri dhe e ndëri atë fytyrën e tij zeshkane me një nishan në mes të faqes së majtë.

— Dëgjo ti, shoku brigadier, — u hodh Elmaz Fuga. — Me ne mos përdor fjalë të tillë. Ne vijnë si vullnetarë dhe këtë ti e di mirë, prandaj turistik fute në xhep nga e nxore. Kështu! Tani të vijnë te fjetja, — dhe ai e shtroi pak zërin.

— Për këtë ju duhej, të ishit merakosur më shumë. Neve nuk është se na bie ari në ujë sepse po flemë në shkollë, por për hesapin tim kjo nuk më duket serioze!

— Jua thashë, këto janë kushtet tona, në daç rrini, në daç...

Brigadieri s'e mbaroi gjithë frazën. Petriti e vështroi nё sy. U mat t'i vërsulej, por ndërroi mendim.

— Takimi i parë, i shkëlqyer! — ia priti si me shaka Sulë Metani. — Shoku brigadier qenka artist i vërtetë! — dhe buzëqeshi. Brigadieri e ndjeu veten ca si ngushtë, po ai përdrohhi buzët e murme dhe vazhdoi nё të tijën: — S'kam nevojë tё ma shpjegosh ti, shok, jam apo s'jam artist! Po e përsërit edhe një herë, shqip, këto janë kushtet tona!

— Mirë, — ndërhyri Petriti si i fyer. — Tani pёr tani jemi dakord me ju. Vërejtjet kemi vend se ku t'i bëjmë. Krevatet ku janë?

— Nё magazinë, ejani me mua! — dhe doli me vrull.

Ata morën nga një sustë krevati, po u doli përsëri çësh-tja e transportit.

— Edhe me kafshët jemi keq, — tha brigadier si i pez-matuar.

— E qartë, — ia priti si me rrëmbim Petriti dhe hodhi dengun e tij mbi sup. — Sustat vijmë e i marrim më vonë, — dhe u nis.

Brigadieri qëndroi një copë herë brenda nё furre. Dukej i shqetësuar. E kishte ngulur vështrimin nё një pikë dhe rrinte ashtu, pa folur dhe pa lëvizur, si i kredhur nё mendime.

— More ti, Mexhit! — nuk u përbajt më furrxhiu. — Po ti dërgo ndonjë fëmijë, që t'u tregojë udhëni deri te shkolla!

Brigadieri sikur erdhi nё vete.

— Po i shoqëroj vetë, — tha dhe mori frymë thellë. — Ata kanë të drejtë, po unë i shkreti si t'ia bëj... — dhe u nis me hap të madh pas tyre.

3.

Arra përbëhet nga katër lagje. Tri ndodhen sipër, larg njëra-tjetrës. Ato ndahen nga ca kodra e lugina të thella, të krijuara nga gërryerjet dhe derdhja e përrrenjve malorë. Buzë atyre grykave dhe luginave, ngrihen pyje të tëra me gështenja që kanë formën e çadrave të mëdha. Në verë ato lëshojnë hije të dendura, kurse gjatë dimrit ngarkohen nga dëbora, dhe degët e tyre të kristalta tékurren nën peshën e saj. Mbi ato degë, dimër, verë, hidhen e përdridhen mullënjat, fugat, qukapikët, sqaeptrashët, ketrat.

Lagjja tjetër ndodhet fare poshtë, në luginën që ndan dy malet, atë të Arrës dhe të Selishtës. Shtëpitë e kësaj lagjeje ngrihen në një faqe pak të pjerrët, dhe poshtë tyre gurgullon si kristal uji i përrrenjve malorë, që, duke u bashkuar me përrenj të tjerë, të vegjël, formojnë lumin Shpalc, një lumë i vogël, që ndoshta as në hartë nuk figuron, me zajet e bardha, që vezullojnë nën rrezet e arta të diellit.

Kushdo që vjen për herë të parë në Arrë, kur sheh tërë atë panoramë me kontraste të mëdha, do të mendojë me vete: «Çudi! Çfarë i ka shtyrë këta njerëz të vendosen në thellësi të këtyre maleve, buzë humnerave dhe luginave të thella?»

Gojëdhënët thonë që malësorët e parë të kësaj zone u vendosën në këto male e gryka fill pas vdekjes së Skënderbeut. Ata erdhën s'dihet nga c'anë e vendit, erdhën të lodhur e të rraskapitur, me vraga e plagë nëpër trup, zbatthur e të uritur, nënët me fëmijët në gji e burrat me armë e sfurqe nëpër duar, erdhën të ndjekur këmba këmbës nga osmanllinjtë e tërbuar. Thonë se njerëzit e asaj kohe patën jetuar pa strehë, herë nëpër shpella, herë nëpër kasolle, që i ngrinin sa për të mbrojtur foshnjat nga era, dëbora dhe acari... Më vonë filluan të ndërtonin shtëpitë e para prej guri. Për tjegulla përdornim rrasha të holla, që i sillte zalli, pastaj patën mbjellë mana e gështenja, arra e qershi, mollë dhe pjergulla. Ka gojëdhëna edhe për brezat e mëvonshëm

të Arrës. Ato të gjitha flasin për vuajtje, për lot e gjak. Tani në fshat ka disa pleq e plaka që mbajnë mend çfarë u kanë thënë gjyshërit dhe baballarët e tyre, por tanimë ato u duken si gjëra të vjetruara, që tregohen si përralla, me gjithëse u shkaktojnë emocione të mëdha. Kjo ndodh sepse brezave të mëvonshëm u ranë mbi kokë hallet dhe dertet e veta. Në fund të lagjes së zallit, në një si grykë që mbrohet mirë nga erërat dhe tufani, ndodhet shtëpia e Bregasve. Ali Bregu, kryetar i kësaj familjeje, është një burrë pak i shkurtër, me trup të ngjeshur, me krahë gjithë muskuj dhe me gjoks të gjerë, që i është rreshkur nga thëllimi dhe erërat e ftohta. Ka nofulla të gjera, flet ngadalë, dhe, kur flet, herë-herë i merret goja e fjalët sikur i dalin me zor.

Ali Bregun e ëma e la në djep dhe ai nuk arriti të mbante mend as edhe një përkëdhelje të vetme të saj. Kurse nga i ati Aliu u nda sapo kishte mbushur tetë vjeç. Kjo ndodhi në kohën e Luftës Ballkanike. Atëherë ishte vjeshtë. Malet gjelbëronin. Qielli vende-vende ishte me re të bardha. Pylli fëshférinte. Mbi zall mjegulla shtrihej si një tyl i hollë, i hirtë. Befas u hap lajmi, që gjëmoi si bumbullimë pranvere: «Po vjen një ushtri e madhe, e huaj». U myllën dyer e dritare, u myllën bagëtia nëpër burgje... Ja, u duk tymi e flaka e atyre shtëpive anës udhës nga kaloj ajo ushtri ogurzezë. Sefer Bregu, i ati i Ali Bregut, vështroi me dhembje të thellë në zemër nga dritarja e vogël si frëngji. Ushtria e huaj po largohej në njëshkolonë. Syri i zuri një ushtar që ecte me zor. Ishte ushtari që dogji i fundit mullarin me bar. Seferi ndjeu gëzim në shpirt. Ai ushtar kishte mbetur prapa kolonës. Seferi u ngrit dhe mori sfurkun. — Ti rri këtu, — i tha Aliut ai.

— Po ti ku do të shkosh?

— Kthehen shpejt, — dhe Seferi doli me vrull. Iu qep pas atij ushtarit që çapitej prapa kolonës. E ndoqi me kujdes të madh, derisa ushtari armik qëndroi për një çast në një të përpjetë gjithë shkurre të dendura. Merrte frymë si një kalë i lodhur jashtë mase. Aty Seferi gjeti rastin dhe e goditi me sfurkun mu në kokë. E goditi disa herë. «Pse, vetëm ju dini të digjni e të vrissni?» — thoshte me vete

ai dhe e goditi përsëri. Ai po shfrynte kështu kündër gjithë atyre që kishin ardhur nëpër tokën e tij, kundër atyre që digjnin shtëpi e bagëti. Pastaj e mori në krahë dhe e hodhi në një hendek. Armiku kishte rënë përbys, me nofullën që i kishte ngecur diku në ca rrënje dhe, ashtu, kishte marrë një pamje të ngërdheshur. Seferi i hodhi përsipër ca degë dushku, i mori pushkën dhe u nis pér në shtëpi. Ekte me hapa të lehtë e të mëdhenj. Sa s'fluturonte nga gjëzimi! Qëndroi pranë një lëndine të vogël. Rreth e rrrotull bari gjelbëronte. Mullënjet, me sqepin e verdhë si pishë, hidheshin nga ferra në ferrë. Një dhëlpër shkau me shpejtësi nëpër pyllin me dushk. Seferi po qetësohej dalngadalë. Pushkën e të huajt e kishte vënë aty pranë dhe herë pas here e vështronte me një kënaqësi të thellë prej fëmije. E përkëdhelte me dorë. Tërë jetën kishte endërruar pér një pushkë. Ja, tani kishte një pushkë të re, të bukur. Ai e mori përsëri në dorë. E puthi. Mori nishan. Sa bukur puqej thepi me shinjestren! Tani do ta kishin zili shumë njerëz. Nuk do ta lëshonte kurrë nga dora, deri në vdekje. «Ku do të ketë shkuar gjithë ajo ushtri e madhe?» — pyeti veten dhe hodhi vështrimin në pafundësi. U përgjigj po vetë: «Mamerr mendja drejt pér në kasaba. Ndoshta kanë dalë në Bubrec ose në Kapërcyll. Do të kenë djegur shumë shtëpi atë do të kenë vrarë njerëz...»

Nuërsa ai mendonte kështu, kishte ndodhur diçka e papritur, pothuajse e pabesueshme: ai ushtari armik që kishte goditur Seferi ishte ngritur dhe ashtu, si i dehur dhe me mundime të mëdha, ishte nisur përsëri, përpjetë, pas gjurmëve të ushtrisë së tij. Mu te kthesa, në Kapërcyll, ishte takuar me shokët. Reparti i tij po pushonte. Ai u tre-goi oficerëve q'i kishte ndodhur në udhë e sipër. Komandantri shqeu sytë si i tërbuar. Përgatiti me nxitim tri kompani ndëshkimi dhe i udhëhoqi vetë. Ai qëndronte gjithë nervozizëm mbi kalin e tij të bardhë, kalë race, që ia kishte dhuruar një gjeneral kroat, i plagosur pér vdekje në Gjakovë.

Tri kompanitë rrëthuan Arrën. Skuadra të veçanta u futën pothuajse shtëpi më shtëpi. Çburra gjetën, i lidhën

dhe shtëpive u vunë zjarrin. Tymi e flaka në kupë të qiellit. Ulërima grash e qarje fëmijësh. Sefer Bregu vrau katër a pesë armiq, por më në fund e zunë të gjallë. Tok me të arrestuarit e tjerë e lidhën me litar dhe, ashtu siç ishin, kush zbathur, kush me këmishë, i nisën varg, të shoqëruar nga ushtarët. Një re e zezë u duk në kokë të malit Arrë. Ca vetëtima çanë qiellin dhe pastaj krisi një bubullimë, që gjëmoi një copë herë me zhurmë. Filluan pikat e para të rralla të shiut. Të arrestuarit i shpunë mbi majën e një shkëmbi, që quhej Shkëmbi i Ariut. Aty komandanti i ushtrisë së huaj dha disa urdhra me një zë të çjerrë e gjithë klithma, sa damarët e fytit iu nxinë. Shqiptarët, të lidhur, nuk kuptuan gjë se ç'tha ai oficeri i xhindosur. Pas pak ata panë të parin, Sefer Bregun, që e mbërtheu për zverku dora e një xhelati, kurse një i dytë ia nguli bajonetën mu në gjoks dhe e shtyu me vrull nga maja e shkëmbit, poshtë në humnerë. Kështu u masakruan të gjithë ata dhe fshatin e plakosi mjerimi. Këtë skenë e pa me sytë e tij edhe Ali Bregu, që, ndonëse i vogël, i kishte vajtur pas t'et dhe me zemrën e njomë, që i dridhej si fugë, priste gjithë frikë se ç'do të ndodhte me babanë, të vëtmen dorë që kujdesej për jetën e tij. Vogëlushi zbriti ngadalë, si një kaproll i vogël, dhe u gjend pranë të masakruarve. I njihte gati të gjithë. U thirri me emër, i përkëdheli në faqe, kurse të atin e puthi në gushë, e puthi edhe te balli dhe qau me dënesë, qau aq shumë, sa e kishte zënë gjumi mbi trupin e tij. Vonë, kur dielli po perëndonte, erdhën dhe e morën gratë e fshatit...

Pas ca kohësh pati pëshpëritje se Sefer Bregu, me veprimin e vet të pamatur, mori më qafë gjithë fshatin, por këto pëshpëritje u dënuan nga gratë dhe nënët e Arrës. Sot portreti i tij, vizatuar nga dora e një piktori jo aq të mirë (ndoshta mund të ketë qenë ndonjë mësues vizatimi) qëndron në muzeumin e thjeshtë të Arrës, krahas fotografive dhe portreteve të njerëzve më të dëgjuar të asaj zone. Aty ndodhet edhe fotografia e Ali Bregut. Si dhe përsë, këtë do ta shpjegojmë kur të vijë radha...

4.

Tre vullnetarët u ngritën shumë herët, pothuajse pa zbardhur. Gjithë natën kishin mërdhirë nga të ftohtët. Bora s'pushoi. Nga dritarja, nga hynte thëllimi nëpër plasat e saj, Petrit Skënderi shihte dëborën që binte fllucka-fllucka.

— Ti nuk duhej të silleshe aq paqësor me atë brigadierin, — i tha Sulë Metani.

— Ne nuk kemi ardhur për t'u grindur, — foli me ton të prerë Petriti dhe u largua nga dritarja.

— Na bëri edhe turistë! — u ankua Elmaz Fuga. — Edhe ky, ashtu si Petriti, ishte i gjatë, me shpatulla të gjera, por me një fytyrë çuditërisht të imët, si të një fëmije pesëmbëdhjetëvjeçar.

— Jo, Petrit, — ia priti përsëri si i pakënaqur Sulë Metani, — ne nuk duhet të lejojmë që të na marrin nëpër këmbë.

— Ndoshta kanë të drejtë, — tha Petriti. — Këto janë kushtet e tyre. Ne duhet t'i kuuptojmë. Nuk duhet të kemi asnjë pretendim. Derisa pranuam të vijmë, të qëndrojmë e të përballojmë çdo vështirësi.

— Rri, o Petrit, mos na mbaj leksione tani! — kundërshtoi përsëri Sulë Metani, ndërsa po paloste batanjen. — Na përplasën këtu si deng pa markë. Punë është kjo?

— Ç'deng pa markë se! — murmuriti edhe Elmazi, duke qeshur.

— Njëqind herë mu lut nëna e shkretë: «Merre jorganin, merre se do të mërdhish, janë vende të ftohta ato!» — vazhdonte të fliste Sula, duke tundur kokën, tek merrej me rregullimin e teshave të tij. — Kurse unë i thosha: «Ku po shkoj, moj nënë, në kozmos?! Po fundi i fundit do të na çojnë nëpër familjet e fshatarëve». Rri tani e dridhu, po të duash!...

— Të kisha një kafe tani! — ia priti Elmazi, duke u shtriquar, dhe gogësiu me një rënkim të lehtë.

— Kérkuake qiqra në hell ti! — tha Sulë Metani.
— Ndoshta ka klub, — u dëgjua zëri i Petritit.
— Akoma me éndrra ju? — Jua tregon brigadier Mexhitin juve, — dhe përsëri Sula e holloi zërin. Në buzët i vizatohej një nënqeshje e émbël. Petriti qeshi dhe e përkëdheli Sulën te koka, ku i ngërtheheheshin flokët e zinj, kaçurrela-kaçurrela. E donte Sulën ai. Përpala pesë vjetësh ata kishin punuar bashkë, në një uzinë. Më vonë Petriti kaloi në një uzinë tjetër. Ai e donte, se Sula ishte punëtor i mirë dhe shakaxhi. E kishte parë kushedi sa herë të luante role të ndryshme në estradën e uzinës dhe me shkathtësinë dhe me humorin e tij i bënte spektatorët të vinin duart në ije. Edhe fytyrën e kishte tamam si fytyrë komiku, Sula. Një fytyrë pak ezmere, me ca sy të vegjël laramanë, me një hundë pak të kthyer, dhe, kur fliste, përdorte shpesh një gjuhë të émbël që e shoqëronte me lëvizje. Ishte i pakët, me ca shpatulla të ngushta dhe me këmbë të holla.

— Mirë ne, do të bëjmë si do të bëjmë, se fundja jemi burra, — tha si i menduar Elmazi, — po dy shoqeve si do t'u vejë halli?

— Do të mësohen, — foli me zë të kthjellët Petriti.


— Lindita të përballojë këtë gjendje? — i hoqi fjalët zvarrë Elmazi.

— Qan hallin e saj ti! — u hodh Sula me ato buzët e holla. — Ajo është si pelë, kurse unë i shkreti peshoj sa një keç!

— Nisemi, shokë! — tha Petriti, duke vështruar përsëri nga dritarja.

— Për boks? — tingëlloi zëri metalik i Sulës dhe filloj të bënte ca lëvizje, sikur po stërvitej në ring. Elmazi ia plasi gazit. — Me cilin do të ndeshesh? — e pyeti gjithnjë duke qeshur.

— Me brigadier Mexhitin. Ia tregoj unë turistlikun atij, — dhe bëri sikur gjuajti me forcë. Pastaj filloj të numëronte si arbitër: një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë Foriuzo! — bërtiti e u hodh përpjetë me krahët lart, në ajër. Petriti dhe Elmazi u shkulën së qeshuri. Pastaj Sula hapi pak derën. Një erë o shkatërr dhe e fortë iu



përplas në fytyrë. Ai e tërroqi kokën shpejt brenda, si breshkë, dhe shtyu derën me vrull. — Ç'qenkérka sot! — tha dhe mori frymë thellë me hundë.

Elmazi e kishte nisur me të qeshura atë mëngjes dhe, kur dëgjoi ato fjalë dhe pa mimikën komike të Sulës, qeshi përsëri.

— Na kënaqe, Sulë! — tha dhe sytë i shkëlqyen nga të gajasurit.

— Dalim? — pyeti Petriti dhe hapi derën. Një bardhësi e mrekullueshme kishte mbuluar kodrat përballë. — Shinkoni ç'bukuri! — tha dhe me tërë mushkëritë thithi ajrin e ngrirë.

— Vërtet bukuri e rrallë! — murmuriti Elmazi.

Dolën njëri pas tjetrit. Dëbora kërciste nën këmbët e tyre. Era dhe dëbora e lagët u binte në qafë dhe u shkak-pudrosura nga dëbora dhe vështroi atë det të pafund bar-luginave, ku çlodhej dhe reflektohej tërë ajo dëborë e virgjër, e magjepsën dhe ai ndjeu një kënaqësi të thellë që po njihite më mirë vendin e tij. Shtëpitë nuk dukeshin; edhe pyjet nuk dalloheshin. Bardhësi, kudo bardhësi.

— E, shokë, si u gdhitë?! — u dëgjua befas zëri i brigadier Mexhshitit dhe ai u shfaq i plotë përpara vullnetarëve, dñe atë trupin e tij mesatar. Kishte veshur një xhaketë kafe dhe poshtë saj, një fanellë leshi ngjyrë kafe.

— Mirë, shumë mirë, — u përgjigj Petriti dhe i zgjati dorën. Sulë Metani deshi të bënte një shaka të vogël, por heshti dhe i dha dorën serioz.

— Gjumi s'më ka zënë sonte! — tha brigadieri me zërin që i dridhej pak.

— Pse, nga dëbora? — pyeti si nën buzë Sula.

— Jo nga dëbora, more vëlla, se ajo ka punën e vet dhe ne tonën. Por më vinte keq për ju! Do të keni mërdhirë kiamet, ë?

— Pak, — sa me zor u dëgjua zëri i Petritit.

— E mallkova veten që nuk ju mora në shtëpinë time,

— vijoi brigadieri dhe i mbuloi të tre me vështrimin e tij të çiltër.

— S'ka gjë, s'ka gjë, — tha Elmazi ngadalë.

— Nuk do të kishe bërë keq, — foli Sula, duke zvogëluar plot djallëzi atë syrin e tij të majtë.

— Sulë! — dhe Petriti e vështroi vëngër.

— Ka të drejtë shoku, — ia priti brigadier Mexhiti, tek merrte frysme me gjoksin, që i férshëllente lehtë. — Ka plotësish të drejtë. Mirëpo unë shtëpinë e kam larg, atje në zall. Përveç kësaj, e dija që do të kthehesha shumë vonë, sepse do të fusja ca thasë me patate në një si magazinë, që e kemi atje poshtë. Njerëz nuk kisha dhe...

— I futnim ne fët e fët patatet, — ia priti përsëri Sula me sytë e tij të vegjël që i shndrisnin.

E bëra atë gabim dhe jam penduar si qeni! Nejse, iku kjo. Vegla pune a keni?

— Unë kam ca vegla mekanike, — pëshpëriti Petriti.

— Pse? Edhe vegla prisni nga ne? — pyeti serioz Elmazi dhe puliti sytë, i habitur.

— Ne jemi keq për to, — vijoi brigadieri, duke i dhënë zërit një ton të hapët përzemërsie dhe sinqueriteti. — Gjendjen do ta njihni vetë. Brigadën tonë kryesia e kooperativës sikur e shikon me sytë e njerkës.

— Ne vegla s'kemi, — ndeu duart në hapësirë Elmazi dhe vështroi Petritin në sy.

— Ta kishim ditur, do të kishim bërë në uzinë nga një bel ose nga një kazmë, — tha Petriti si i menduar.

— Të tre tornitorë jeni?

— Petriti merr vesh nga të gjitha, Elmazi është tornitor, kurse unë më shumë kam punuar si axhustator, — sqarroi Sula.

— Nejse, — tha brigadieri me zërin që e uli pak. Po ju rregulloj unë nga një bel, pastaj shohim.

— Çdo të bëjmë sot?

— Qilizmë.

— Shumë mirë, — pëshpëriti Petriti.

— Po bora nuq pengon? — pyeti pas pak me zë të ulët Sula.

— Bora këtu s'pushon deri në të hyrë të prillit, or vëlla, — ia pati brigadier Mexhiti me dorën që e shpuri deri afër fytyrës së Sulës. Sula u tërroq me kast. Elmazi s'e përbajti dot të qeshurën.

— Lëri shakatë tanë, Sulë! — i tha Petriti dhe i hodhi një vështrim të mprehtë.

Filluan të vijnë edhe kooperativistë të tjerë.

— Mirëmëngjesi!

— Mirëmëngjesi!

— Si u gdhitë?

— Mirë, po ju?

Përvëshendetjet shkëmbëheshin njëra pas tjetrës në mes të vullnetarëve dhe të fshatarëve. Këta të fundit i shihnin vullnetarët me kujdes dhe shpesh me bishtin e syrit.

— Ju prisni këtu, se unë po shkoj te magazinieri, që t'ju siguroj veglat e punës, — tha brigadier Mexhiti dhe pothuajse me vrap u ngjit në një kodër të vogël, mbi të cilën vareshin, nga pesha e dëborës, degët e një ftoi.

— Nuk qenka njeri i keq, — tha me zë fare të ulët Elmazi.

— Qenka i shkëlqyer! C'paskemi qenë duke u palluar mbrëmë në shtëpi të tij! — tha me zë të ulët Sula, për të mos dëgjuar të tjerët, dhe qeshi me gjithë shpirt.

Me një çantë të zezë nën sqetull, po vinte në drejtim të tyre sekretari i byrosë së partisë të kooperativës. Besnik Sala ishte një burrë mesatar, flokëverdhë, me një kokë pak të madhe e me një të ecur të shkujdesur. Supet i ishin zbardhur nga dëbora dhe me atë shapkën në kokë dukej si ndonjë ushtarë që do të ndërmerrte beteja të mëdha. Si u takua me vullnetarët, shkëmbue nja dy fjalë me ta në këmbë, pastaj i ftoi në zyrën e partisë, një zyrë kjo e vogël, aq sa Petriti u detyrua të ulte kokën, kur hyri brenë. Po zyra ishte e pastër.

— Borë e madhe, ë? — tha Sulë Metani, duke shkundur këmbët.

— Kjo vlen shumë për gështenjat, — foli sekretari.

— Bora në përgjithësi për bujqësinë është shumë e dobish-

me. Ku fjetët mbrëmë? — dhe sekretari, ulur mbi krevatin e vet që kërciti, i vështroi një e nga një në fytyrë.

— Në shkollë, — tha Petriti.

— Në shkollë?!

— Kemi bërë qejf, shoku sekretar, — ia priti Sula dhe shpuri dorën te shpatulla e djathtë.

Sekretari s'foli. Asnjë muskul i fytyrës nuk i lëvizi. Nuk i erdhi mirë që nuk ishte zbatuar një porosi e tij. — Nejse, — tha pas pak, do t'ju rregullojmë këtu afër. Po një gjë duhet ta keni të qartë, — shtoi duke i vështruar përséri një nga një: — Kushtet në përgjithësi këtu nuk janë aq të mira. Ka vështirësi të mëdha. A e shihni ç'zyrë kam unë? Zyrë i thënçin! Ne jemi kooperativa më e prapambeetur në gjithë këtë zonë malore. Partia është e shqetësuar. Paga mesatare na ka dalë rrëth nëntë lekë për ditë pune. Pak, shumë pak! — dhe vuri buzën e poshtme mbi të si-përmen, i kredhur në mendime.

— Sa për ne, jemi gati të bëjmë ç'të na kërkohet, — pëshpëriti si nën buzë Petriti, kurse Elmazi pohoi me kokë.

— Është e qartë që ju nuk do ta ndryshoni gjithë gjendjen e këtushme, — ia priti si përgjigje sekretari. — Ndryshimi i gjendjes varet nga një sërë faktorësh të shumtë që ne, si parti dhe kryesi kooperative, po i shqyrtojmë me kujdes të madh. Për shembull, rritja e rendimentit të punës është një nga kyçet më të rëndësishme. Mirëpo brigada juaj paraqitet dobët. Pjesëmarrja në punë nuk është e kënaqshme...

Ai heshti një copë herë, diç lexoi në formularët e tij dhe vazhdoi:

— Ju do të punoni në brigadë. Jetën e partisë hëpër-hë do ta bëni këtu, ndoshta më vonë ndonjërin mund ta dërgojmë në ndonjë organizatë tjeter. Unë, për shembull, jetën e partisë e bëj në Selishtë.

— Pse jo këtu në Arrë?

— Sepse atje kishte më shumë nevojë.

Ra një heshtje e shkurtër.

— Keni ndonjë pyetje? — tha pas pak sekretari, duke i vështruar përsëri një nga një, siç kishte bërë në fillim.

— Ne do t'i kemi parasysh këto porosi, — foli Petriti me një ton që linte të nënkuptonte se fliste në emër të të treve. — Por disa pretendime minimale ne do t'i kemi patjetër, — shtoi me zë të shtruar.

— Për shembull?

— Dhoma e fjetjes, pavarësisht si do të jetë, e shtruar me dërrasa ose jo, na duhet. Kjo një. E dyta: një herë në javë, të shtunave, do të kthehem i nëpër familjet tonë, sepse, helbete, njerëz jemi!

— Patjetër, — miratoi me kokë sekretari dhe shpuri, buzën në gaz. — Ju jeni që të tre të martuar, apo jo? — dhe iu zbuluan dhëmbët e bardhë, të rregullt.

— Me përjashtimin tim, — shpuri gishtin tregues në gjoksin e vet Elmaz Fuga.

— Atëherë ju të dy do të shkoni çdo javë, kurse ti, shoku begar, një herë në muaj, — ia priti sekretari plot çiltërsi. — Tjetër? — pyeti përsëri.

Elmazi mbeti si i shtangur, sepse nuk e kuptoi nëse sekretari e kishte seriozisht apo me shaka.

— Tjetër keni? — sekretari ia mbërtheu sytë Petritit, sikur po e shqyrtonte.

— Tani për tani këto janë, më vonë nuk dihet se ç'nevoja na dalin. Sidoqoftë, këtu jemi. Ne besoj do të takohemi shpesh.

— Patjetër.

— A jeni gati, shokë vullnetarë? — u dëgjua zëri i ngjirur i brigadier Mexhitit, që hapi derën pa trokitur.

— Gati, — tha Petriti.

— Shkojmë, pra, se u vonova unë. Veglat e punës juajjeta.

— Ku do të punojë sot brigada, o shoku brigadier? — e pyeti sekretari me një ton të afërt, shoqëror.

— Te Kodrat e Lajthive, shoku Besnik.

Vullnetarët u ngriten. Bashkë me ta doli edhe sekretari...

5.

Kooperativa bujqësore e Arrës u krijuar më shtatë janar të vitit 1958. Si kudo gjetkë, edhe në Arrë, pati nga ata që domin të jetonin me pronën e tyre të vogël, të zhvillonin ekonominë private, të vinin në jetë planet dheën drat e veta. Por më në fund shumica dërrmuese u bind se e vetmja rrugë që e shpëton fshatarin nga vuajtjet dhe i përgatit të ardhmen e lumtur është kolektivizimi. Kooperativat bujqësore të zonave fushore e kodrinore kishin shërbyer si një shembull i shkëlqyer. Dy net e dy ditë u bë festë e madhe në Arrë. Islam Kamberi shtiu me pushkë, dhe dega e punëve të brendshme ia hoqi të drejtën e armës. Kryetari i ri i kooperativës, Bedri Gjuzi, u martua atë të diel, dhe dasma, siç u shpreh dikush «shkoi deri në shalë të kalit». Liman Driza, për shkak se kishte pirë shumë, u gremis në një hendek të thellë dhe theu këmbën. Eh, ç'u bë atëherë nëpër ato gryka e nëpër ato lugina!.. Qysh atëherë në Arrëjeta bënte përpëra vazhdimisht. Fshatarët mbledheshin shpesh pér të shpjeguar rregullat e reja të punës, flisnin pér disiplinën, pér organizimin më mirë të skuadrave dhe të vetë brigadave. Kryetari i kooperativës, Bedri Gjuzi, kishte aq punë, sa vendi vend s'e zinte. Ai dukej i qetë në vete, por përbrenda ziente si një kazan. Merakosej shumë që kolektivizimi të çante përpëra dhe atij si komunist, t'i zbardhej faqja.

Qysh vitin e parë, anëtarët e kooperativës morën prodhime të mira. Pati familje që arritën të merrnin edhe tre kuintalë fasule, përveç të ardhurave të tjera. Prandaj, në fund të vitit nxituan dhe bënë lutjet pér t'u pranuar edhe dy familjet e fundit të Arrës, që deri atëherë kishin qëndruar jashtë kooperativës, gjoja se s'kishin pasur krahë pune të mjaftueshme, por shkaku i vërtetë kishte qenë se ata s'kishin pasur besim te kolektivizimi.

Shembulli i kooperativistëve të Arrës frymëzoi edhe fshatrat e tjera fqinjë. Me arrën u bashkua edhe Selishta,

Bubreci, Derdomi dhe Sherra. U krijua kështu kooperativa bujqësore e bashkuar «Çlirimi» e Arrës. Kjo ndodhi në vitin 1966. Toka dhe krahët e punës u shtuan. Ajo u bë një ekonomi e madhe. Bedri Gjuzi shfaqi dëshirën të mos ishte më kryetar i kooperativës. Nuk e ndiente veten të aftë për të drejtuar gjithë atë ekonomi.

— Rri, Bedri, se na ke ne, — iu lutën shokët.

— Aha, nuk e bëj dot! Më mirë të vijë një shok tjetër! Do shkollë dhe tru kjo punë.

Atëherë sollën një kryetar të ri, Meto Demon, një ish-oficer i çmobilizuar, lab me origjinë, luftëtar i vjetër i ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ai ishte një burrë me trup të bëshëm, me një fytyrë zeshkane e me ca sy të qeshur që të bënин për vete. Në mbledhjen e parë me kooperativistët, kur po prezantohej me ta dhe kur po u fliste për detyrat e mëdha, plaka Xhevrie Vishnja, një grua cipëplasur, u tha ca grave që ishin mbledhur grigjë pranë njëra-tjetrës:

— Ky qenka si mëzati i Lik Sulës...

Nifja, një grua e hollë dhe e gjatë, nuk qe në gjendje të mbante të qeshurën, aq sa kryetari u detyrua t'u drejtohej grave:

— Po ju, moj shoqeni, si e keni hallin?

Atëherë të gjitha gratë shpërthyen në gaz. Plaka Xhevrie rrinte në këmbë dhe kafshonte cepat e buzëvë me ata dy dhëmbët që i kishin mbetur qosheve.

— Mirë, mirë bëtë, duhet edhe të qeshim, por jo vend e pa vend, — tha Meto Demoja. Shumë shpejt ky njeri u bë i dashur dhe i afërt për fshatarët. Metoja dikur kish te shërbyer si argat te një fshatar i pasur. Po me të fillouar lufta partizane, ai u lidh me Partinë dhe nga urrejtja që kishte për pronarin, pasi i dogji mullarët e barit, doli partizan. Me çetën e tij, ai luftoi dhe u shqua për trimëri. Kur u krijua brigada, atë e caktuan komandant batalioni. Pas dy vjetësh, u kthye në labëri me gradën e kapitenit të parë. Të gjithë u mahnitën kur e panë. Ishte rritur e zbuluar si një qiparis. Pastaj e nisën përsëri për në Veri dhe ai luftoi deri në Vishegrad...

Në kooperativë shkriu tërë energjitet e tij, që ajo të mëkëmbej. Rriti tufën e bagëtisë, dha urdhër për ngritjen e dy stallave, njëren në Bubrec, tjetrën në Selishtë. Ai ishte burrë babaxhan e mbante fjalën dhe dinte të sillej me njerëzit.

Dalngadalë në kooperativë zunë të vinin edhe kuadro të tjerë, të mesëm e të lartë, specialistë bujqësie e blegtorie. U hap edhe ambulanca me një ndihmësmjek e me një infermier. Kurse nëpër fshatra filluan nga puna mamitë e para. Një revolucion i tërë, i thellë e i madh, po vazhdon-te me vrull në jetën e kësaj krahine.

Meto Demoja, ndonëse me moshë të thyer, u vinte qark punëve. Me një shkop çobenjsh në dorë, tërë ditën, ai brindhte brigadë më brigadë dhe parcelë më parcelë. Dhe një herë në muaj, medoemos, do të shkonte të shihte me sytë e tij tufën e bagëtisë. E njihte mirë bagëtinë Meto Demoja, e kishte pasur zanat qysh në vogëli, madje ai ishte në gjendje të hahej edhe me veterinerin përsa i përket blegtorisë dhe jo rrallë specialisti detyrohej të përulej përra argumenteve bindëse të Metos. — Dëgjomë mua ti, djalosh i dashur, — i thoshte ai veterinerit me dorën të mbështetur në supin e tij, si të ishin të një moshe, — dhitë janë shumë delikate. Ato nuk e pranojnë pisllékun, prandaj t'u kërkosh llogari barinjve. Po t'i gjeta kështu pis herën tjetër stallat, do ta kemi keq bashkë...

Por ajo që mbeti e paharruar në mendjen e kooperativistëve nga puna e palodhur e këtij njeriu të mirë ishte përpjekja e madhe që bëri për krijimin e një rezervuari të madh uji, që do të shërbente për vaditjen e tokave. Të rrallë ishin ata që besonin se mund të bëhej një gjë e tillë. Lugina ku do të krijohej rezervuari grumbullonte ca përrenj të vegjël malorë, ca rrëkera dhe dëborën që shkrinte në pranverë. Mirëpo, në fund të luginës ishte krijuar një e çarë e thellë, që e thithte dhe e zhdukte gjithë ujin e grumbulluar. Duhej shumë punë për të mënjanuar këtë difekt. Meto Demoja solli nja dy inxhinierë hidraulikë dhe ata shfaqën mendimin se gropat që thithte dhe zhdukte ujin mund të vulosej vetëm duke hedhur zhavorr,

gurë e argjilë. Meto Demoja iu përvesh vetë kësaj pune. Ai kishte shumë të njohur në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe ata nuk vonuan t'i vinin në ndihmë kooperativës bujqësore. Punimet filluan me vrull. Mbi qafën e malit, poshtë të cilit shtrihej lugina e thellë, erdhën dy traktorë dhe një eskavator i kuq, i madh, përveç kamionëve, që shkarkonin në humnerë materialt inerte.

Pas tre muajsh pllakosi përsëri qetësia e dikurshme, ajo qetësia monotone që të ngjall një farë trishtimi, sidomos kur je fillikat vetëm e kur nuk sheh gjë tjetër veçse hapësirë, lugina e vargje malesh të pafund...

Rezervuari mbaroi. Ajo gropë që thithë ujin u vulos aq mirë, sa dalngadalë u grumbullua ujë i bollshëm me një ngjyrë të gjelbër, që farfurinte nën rrezet e arta të diellit, dhe dallgët e blerta shtynin njëra-tjetër më nge e si me përkëdhelje.

Meto Demoja po mendonte tanë për kanalin vaditës që do të hapej e që do të vadiste tokat e Arrës, të Selishtës dhe të Bubrecit. Ai mendonte i shqetësuar për të nesërmen. Kishte keq sa të hapte kanalin, pa pastaj ndryshe do të ecnin punët. Ai përgatiti skicën e kanalit, llogariti sa forca pune duheshin, kur ja, një urdhër nga Komiteti Ekzekutiv i rrëthit e hodhi në një front tjetër pune: duhej që në bashkëpunim me ndërmarrjen e elektrikut të fillohej menjëherë puna për elektrifikimin e të gjitha fshatrave të kooperativës së bashkuar «Çlirim». Meto Demoja ishte i dëshiruar t'i shihte ato fshatra me dritë elektrike, t'i shihte njerëzit e Arrës, të Selishtës, Bubrecit, Derdomit etj. duke dëgjuar lajmet e Radio Tiranës, fëmijët e tyre duke bërë detyrat e shkollës jo më nën dritën e zbehtë të kandilit ose të llambës me vajguri, por nën shkëlqimin e dritës elektrike. Eh, ç'ngjarje e madhe do të ishte ardhja e asaj dite të shënuar!...

Lajmi u përhap si veriu shtëpi më shtëpi, gojë më gojë e vesh më vesh. Por që drita elektrike do të arrinte deri në Arrë ose në Derdom, kjo u dukej e pabesueshme mjaft njerëzve.

— Po qysh do të kalojnë drushtat deri në malin e Selishtës? — pyesnin shumë veta.

— Pse, pak shtylla dushku kemi ne nëpër pyjet tonë?
— Mirë thua ti!

— More, po do të duhet dynjaja e telit...

— Ç'hall që qan! Shteti i ka bërë hesapet vetë. Ashtu thoshim edhe për rezervuarin ne...

— Ke të drejtë. Ç'nuk bën kjo Parti, or vëllezër!...

I pari që dha lajmin se erdhën «njérëzit e dritave» ishte rojtari i kooperativës, xha Isufi. Ai u takua me ta te oborri i shkollës dhe i shoqëroi me qejf për në zyrat e kë-shillit të fshatit të bashkuar. Ishin një inxhinier, një brigadier dhe një teknik i mesém. Ky ishte grupi i punës që do të hartonte planin konkret nga do të fillonte elektrifikimi. Dhe ata u morën vesh pothuajse pa asnje kundërshtim. I pari do të elektrifikohej fshati Arrë. Aty do të ngríhej nëncentrali elektrik që do të furnizonte me dritë fshatrat e tjera. U vendos gjithashtu që brigada e montimit, e përbërë kryesisht nga punëtorë të zgjedhur të ndërmarrjeve të qytetit, të vinte javën e ardhshme, ditën e hënë. Mirëpo tamam në këtë kohë ndodhi një e papritur: kryetari i kooperativës, Meto Demoja pësoni një infarkt në zemër dhe gati qe duke dhënë shpirt. Në fillim kjo shkaktoi një farë hutimi te shokët e kooperativës, por shpejt çdo gjë u normalizua: përkohësisht kryeagronomi mori frenat në duar, dhe puna vazhdoi si më parë. Edhe brigada e montimit mbërriti në datën dhe orën e caktuar. Punëtorët shkarkuan nga kamioni një sasi të madhe materiali elektrik. Brigadieri i kësaj brigade, një burrë energjik, me tëntha të thinjur e me një ballë të gjerë, dukej tepër nevrik, sepse pothuajse për çdo gjë thërriste me zë të lartë. Ai kishte shkrirë shumë energji për elektrifikimin dhe kjo punë i kishte thithur shumë mund. Megjithatë, ai vazhdonte të ishte ende i fortë, plot autoritet dhe burrë i zoti. Brigada punonte nga mëngjesi deri në muzgun e mbrëmjes.

— Po te Ali Bregu do ta çoni dritën? — e pyesnin shpeshherë fshatarët brigadierin e montimit.

- Si jo, në çdo familje.
- Po ai e ka vec, në majë të asaj kodrës.
- Edhe në majë të malit sikur ta ketë, edhe atje do t'ia çojmë.
- Ju lumtë, or vëllezër! Hallall ju qoftë buka e kësaj Partie!

Ali Bregu asnjëherë nuk kishte pyetur njeri se si do t'i bëhej hallit, që shtëpinë e kishte në atë pozicion ters, që me siguri do t'i nxirrte telashe të mëdha gjithë brigadës elektrike. Ai nuk dyshonte se, në një mënyrë apo në një tjetër, edhe atë nuk do ta linin pa dritë elektrike.

Një ditë në Arrë erdhi një gazetar i «Zërit të popullit» për një reportazh. Ai u njoh me Pashone Krepin dhe me shokë të tjerë, mori mjaft të dhëna për këtë kooperativë, por përfundimisht shokët e këshillit vendosën ta dërgonin te Ali Bregu, se, helbete, Aliu kishte ç'ti tregonte gazetarit. Udhës për në zall, gazetarin dhe shoqërueshin e tij i zuri një shi i mirë që i lagu dhe i bëri quill.

Ali Bregu u gjëzua pa masë, kur pa në oborr Halilin, bashkëfshatarin e tij, dhe një mysafir të panjohur, një burrë ky rrëth tridhjetë vjeç, i hollë e i gjatë, me ca buzë të vogla, sikur mbanin një të fshehtë brenda.

— A doni miq, or Ali Bregu?

— Bujrum e paskeni bërë si burrat, më gjenuat shumë, — dhe i përqafoi. Hynë brenda, dhe gazetari, pa u ulur akoma mirë, pyeti për të birin, Bilal Bregun.

— Pse, e njeh ti Bilalin?

— Jo, personalisht nuk e njoh, por më kanë folur për tē.

— Në arë është, bën qilizmë.

— Mban larg që këtej?

— Jo dhe shumë. Sa të pish një cigare duhan, — dhe Aliu shpuri buzën në gaz.

Erdhi e shoqja e Aliut, Lulja, një grua kjo e vjetër në moshë, por shumë hokatare, gjë që i bëri përshtypje gazetarit, sepse, me sa dintë ai, zakonisht gratë e këtyre zonave nuk e kishin fort zanat muhabetin me burrat, sidomos me burra që u hynin për herë të parë në shtëpi.

— Silli atë setrën e Bilalit dhe ndiz zjarrin! — i tha Aliu Lules. Ajo doli pa u vénë re dhe veç kur erdhi përséri me një dorë karthije dhe me një xhaketë të palosur, fare të re. — Vishe! — i tha ajo gazetarit. Vishe se do të ftohesh!

Ai mori xhaketën, që binte erë naftalinë. I erdhi keq që ajo nënë e mirë i sillte xhaketën e re të djalit, por s'pati ç'të bënte. Tanimë ishte vonë pér të kundërshtuar.

— Besoj se kjo éshtë xhaketa e dhëndërisë, — tha gazetari, duke e përkëdhelur me dorë atë stof të bukur blu.

— Jo, — foli me një buzëqeshje të ciltër Aliu. — Kur e martova, nuk i bëra xhaketë. Këtë ia bleva kur u fut në parti.

Gazetari sikur u mahnit nga përgjegjja që i ra si papritur dhe ndjeu gëzim dhe respekt pér këtë njeri të thjeshtë. Aliu ndezi zjarrin e pas pak në mes të tyre filloj një bisedë e ngrohtë dhe e gjallë. Ata folën pér shumë gjëra, por gazetari, që kishte dëgjuar fragmente jete nga familja e Bregasve, bëri si bëri, me marifet e cyti Aliun që tē fliste me hollësi pér të kaluarën e vet.

* * *

Pas asaj ngjarjes te «Shkëmbi i Ariut», Aliun e vogël e mori nën kujdesje një komshia e tij. Leme Dushku quhej ajo, një grua brisk nga goja, me një bukuri të përenduar dhe me një vështrim të egër që tē shponte si turjelë. Kjo egërsi kishte shkaqet e veta. Përveç tē shoqit, asaj i kishin vdekur edhe dy fëmijët, njëri pas tjetrit, brenda një viti. Dhe, ndonëse e re, ajo vendosi ta ngryste jetën me djalin e vetëm që i mbeti, me Ahmetin, një djalë ky çapkën rreth 8 vjeç.

Me kalimin e kohës, dashuria e Aliut pér nënë Lemen rritej e bëhej gjithnjë më e madhe. Ai e donte tamam si nënën e tij. Madje, nuk mund ta përfytyronte ndryshe atë që e kishte lindur dhe nxjerrë në këtë jetë. Të atin çoku e sillte ndër mend, i therte në zemër, kur kujtonte skenën e vrasjes, po, sidoqoftë, dalngadalë koha bënte tē vetën. Pu-

na, lufta pér bukën e gojës, e huionin dhe e bënин tē harronte shumë gjëra.

Aliu dhe Ahmeti jetuan bashkë rrith tre vjet. S'nda-heshin nga njëri-tjetri. Bashkë hanin, bashkë flinin, bashkë luanin. Pas tre vjetësh Aliun erdhi dhe e mori një mbesë e s'ëmës dhe e shpuri hyzmeqar në një fshat, në fushë. Aliu bënte punëra tē ndryshme, po më shumë merrej me këllotjen e një kali buzë brigjeve gjithë moçale ku fluturonin trumba rósash tē egra. Pas njëzet muajsh e dëbuani nga puna pér shkak se kali u gjend i ngordhur në haur me bark tē fryrë, thuase do tē pillte nga çasti në çast. Po atë javë ai e ujdisi me disa ustallarë që tē punonte përkohësisht me ta pér hapje pusesh.

— Të pëlqen tē punosh me ne përherë? — e pyeti një ditë ustai më i vjetër, një gollobordas azgan, me ca mustaqe tē vogla mbi buzën e sipërme.

— Me gjithë qejf, — tha Aliu, i kënaqur.

— Kushedi mund tē tē marrim, — dhe ustai fshiu me bërryl mustaqet që kishin filluar t'i thinjeshin.

Kështu, pér afro katër vjet, Aliu brodhi nëpér fshatra si pusaxhi. Mirëpo gollobordasve u plasi sherri pér punë parash dhe gripi u prish. Aty nga fundi i prillit, pasi u bleu ca dhurata tē vogla Lames dhe Ahmetit, Aliu u kthyte në Arrë. Ishte shtatëmbëdhjetë vjeç. U kthyte me sy më tē ndritur dhe me mendje më tē kthjellët...

Në fshat flisnin shumë mirë pér Aliun, flisnin aq mi-rë, sa shumë vajza e ëndërronin pér ta pasur bashkëshort në jetë. Një ditë, në mars, ditë ngrice, kur kopshtiet dhe drurët ishin veshur e zbuluar me fije kristali, në derën e Leme Dushkut trokiti dikush dhe hyri brenda.

— Kam ardhur pér shkes, pér Aliun, — tha i porsa-ardhuri pa e zgjatur muhabetin. Lemja, e inatosur nga ky propozim, e vështroi me ata sytë e egër, që sikur lëshuan zjarr e flakë.

— S'kam djalë pér tē martuar, është hala i vogël Aliu; — u përgjigj ajo vrazhdë.

— Tetëmbëdhjetë vjeç dhe i vogël?

— Lemja gati u tèrbua.

— Jo, — i mëshoi zërit ajo. — Nuk kam djalë pér të martuar!

— Është gjynah, moj Leme!

— Po pate ardhur vetëm pér këtë punë, m'u largo nga shtëpia! — dhe me gisht i tregoi derën. Shkesit sikur i ra pika. U ngrit. — Q'të të bëj, je grua... — dhe doli.

— Pas disa muajsh ia behu një tjetër.

— Gjithë fshati e di që unë s'kam djalë pér të martuar, -- ia priti me sokëllimë Lemja.

— Ah, ȝrua e keqe! — tha shkesi, duke skërmitur dhëmbët nga inati. — Ti hallin e ke gjetiu.

— Lërmë rehat, s'dua ta martojo!

— Ii s'do ta martosh, se ke ndër mend ta mjelësh gjithë jetën.

— Thyej zverkun! — iu gufua ajo dhe i mbylli derën me vrull.

Aliu as që dinte gjë pér ato që thuheshin pér të. Ai merrej me punë. I shpinte dhitë nëpër gryka e zabele, madje herë-herë gati mu në zemër të malit, atje ku dushku dhe panja ishin me bollëk.

— Merre gocën e Qerimit, Lulen, — erdhi e i tha një ditë Aliut njëri nga lagjja e sipërme e Arrës.

— Është e vogël, u përgjigj Aliu. — Ajo është kalama.

— Jo, tamam është, nguli këmbë shkesi. — Ajo i mbushi pesëmbëdhjetë vjetët.

— Është e vogël, murmuriti pér të dytën herë Aliu.

— Po Qerimi ka nevojë t'i japësh ca para borxh, — tha pas pak me gjysmë zëri shkesi.

— Sa?

— Një napolon.

— Mirë, ia jap, — por pas dy muajsh dua paratë. Vëtëm atë napolon kam.

Pas dy muajsh shkesi erdhi dhe e lajmëroi Aliun se Qerimi s'kishte para dhe as që do të kishte.

— Po deshe, merr Lulen! — e mbylli bisedën ai. Aliu u bë prush në fytyrë. E ndjeu veten ngushtë. S'kishte ç'të bënte. Pranoi. Por në familje plasi grindja. Lemja u tërbua fare. E shau e s'la gjë pa i thënë Aliut, madje e goditi

edhe me shkarpë të thatë dushku mu në sup. Aliu s'tha gjysmë fjalë. Heshitte kokulur.

— Përse nuk e lë Aliun të martohet me gocën e Qerimit t'i Leme? — e pyetën disa pleq të Arrës.

— S'është për Aliun ajo.

— Pse?

— E njoh unë atë, ajo s'bën për Aliun.

— Ti kërkon ta rrjepësh Aliun, — u nxeh njëri nga pleqtë. — Ti ke kushedi sa vjet që po i ha mundin dhe djersën këtij jetimi. Por dije se ka një zot që të vret...

— Le të më vrashë, ajo nuk është për Aliun.

— Mirë, pra, — u hodh një plak tjetër i mençur. — Atëherë po e lëmë gocën e Qerimit dhe po i gjejmë një gocë tjetër.

— Çkeni me Aliun ju, more burrat e dheut? — klithi Lemja me inat dhe nga goja sikur i doli shkumë e bardhë.

— Na dhimbset ai djalë. Prindërit e lanë të vogël, me zor u rrit, si ai zogu i pyllit degë më degë dhe gjeth më gjeth. Ti mjaft e kë mjetur të varfrin, lëre të krijojë edhe ky familjen e vet.

— Aliu e ka familjen.

— Jo. Ai s'ka familje. Ai po mundohet e po rrapoat për ju. Ai don të marrë Lulen e Qerimit. Ti, Leme, mos u bëj shkaktare që të prishet kjo punë.

— Po mori atë, Aliu ska më punë me mua, — tha ajo, e vendosur, me fjalët që i hoqi zvarrë. Atëherë dërguan dhe thirrën Aliun. Ai erdhi pak i zyrtë dhe me hap të pasigurt. Nuk dinte si ishte puna.

— Po të pyesim, or ti, Ali Bregu, a do ta marrësh Lulen e Qerimit apo jo?

— Do ta marr, — tha pa e zgjatur Aliu, — por jo tanë, se kemi ca telashe.

— Po more atë, ngri leckat e mos ti pafsha më sytë! — iu vërsul me egërsi Lemja.

— Po pse, moj nënë? Ne bashkë do të jetojmë derisa të jemi gjallë në këtë tokë. — Zëri i tij ishte si i përgjëruar.

— Jo, jo! — bërtiti përsëri si e xhindosur ajo. — As mos t'i pafsha më sytë, as mos m'i pafsh.

Ahmeti deri atëherë kishte qëndruar si mënjanë dhe nuk i ishte dëgjuar zëri. Mirëpo ato fjalët e fundit të s'ëmës e mallëngjyen tepër, prandaj tha, duke e vështruar Aliun mu në sy, me inat:

— Deri tani të kam pasur vëlla, or ti, Ali. Tani e tutje të mos më thuash më as merhaba.

— Ashtu?! — pyeti si i habitur Aliu.

— Kështu! — I mëshoi zërit Ahmeti. — Të dolën puplat dhe na dhe shkelmin!

— Mos, or Ahmet! — iu lut Aliu. — Mos fol kështu, se ti e di se si jemi rritur ne. Baltë e gjak kemi ngrënë.

— Po ti tani ecën me mendjen e të tjerëve. Neve na e vure kazmën.

— Bashkë do të jemi, or Ahmet, për atë zot që na i di zemrat si i kemi! — u betua Aliu dhe vështroi qiellin ngjyrë çeliku.

— Ik, lanet, prej nesh! — iu vërsul Lemja. — Bojën mos ta pafsha më! Si bëfsh gjeg!

E kotë ta zgjaste. Po atë ditë Aliu mori ato pak rrage që kishte dhe u vendos në pjesën që i takonte te shtëpia e tij e dikurshme, që deri atëherë e kishin përdorur si burg për gjënë e gjallë.

Pas gjashtë muajsh u martua. Nuk bëri fare dasmë.

— Do të heqësh zor me mua, — i tha Lules po atë ditë. — Jam i varfër e pak si abdall. Po deshe rri, po deshe ik!

Ajo s'foli.

— Shih, gjë prej gjëje s'kemi në shtëpi. Dy krerë dhi kam. Duhet të punojmë shumë, që të hamë një kafshatë bukë.

Ajo dëgjonte e s'liste.

Aliu vazhdoi:

— Dy dynym tokë kemi gjithsej. Do të mbjell misër. Nga nëna e vëllai s'kam asnje shpresë. Tani, në këtë jetë, të kam vetëm ty!

Lulja kishte qenë punëtore e gjallë. Minutën nuk e linte t'i shkonte dëm. Herë me gështenja, herë duke rrëmuar tokën nga mëngjesi deri në darkë, herë me dhittë, i ngrysnin netët e gjata e të ftohta të dimrit.

Pas një viti u martua edhe Ahmeti. Në krye të vitit i lindi një djalë, por fëmija i vdiq. E shoqja kishte lindur jashtë dje, nga të ftohtët, foshnja dha shpirt. Një muaj më vonë i vdiq edhe e shoqja. Kurse pas tre muajsh edhe e ëma, Lemja. Ajo shkoi gjithë helm e brengë nga kjo jetë.

Ahmeti priste se mos ndoshta shokët e miqtë do t'i gjenin ndonjë nuse tjeter, por askush s'iu afroa. Një natë ai u sëmur rëndë. Lajmëroi Aliun. Kishtë kohë që ai s'fiste me të.

— Më fal, or Ali, se faji ka qenë imi! Të kam rënë kot më qafë, — i tha më gulçim, i mbytur në djersë.

— S'ka gjë, Ahmet! Të kam falur. Ne jemi si të një barku e të një zemre.

— Jam keq, or Ali. Të shkosh te hoxhë Demiri, në Derdom, e lutju të më bëjë një nuskë! Më dalin para syve gruaja, nëna dhe djali. Dridhem. Shih si jam larë nga djersa!

— Po është natë! — murmuriti me një fill zë Aliu.

— Ta bësh këtë punë për hatrin tim, — rënkoj tjetri.

— S'ma mban të shkoj kaq vonë në Derdom! Do të më shqyejnë ujqrit.

— Aman, Ali, bëma këtë të mirë! Jeta ime varet në dorën tënde!

Pranoi. S'kishte rrugë tjetër. Iu dhimbis Ahmeti. U nis. Ekte me guxim, por herë-herë e pushtonte edhe frika. Shndërrrohej shpesh në ca si rënkim, pshëretima, qeshje, kuitje, angullima, kërcënime. Po Aliu, me nofullat e shtrënguara fort, me sépatën që e kishte mbërthyer në dorën e djathëtë, çante përparrë e i ngjitej së përpjetës thikë të Derdomit.

Trokiti disa herë me radhë në derën e shtëpisë së hoxhë Demirit. Vetëm pasi u sigurua se ishte Ali Bregu, hoxha ia hapi derën dhe u gudit që kishte ndërmarrë një rrugë të tillë për një punë që mund të bëhej fare mirë ditën me diell.

— Është shumë i sëmurë, hoxhë efendi. E mbytën djer-sët dhe sheh èndrra të këqija.

— S'ka gjë, — tha hoxha, tek shkruante diçka nën dritën e venitur të një kandili. — Do të ketë hyrë në gjynah! — shtoi dhe palosi nuskën.

Aliu pagoi dhe iku. Tek kthehej, u duk se po zbardhëllonte. Qielli kishte marrë një ngjyrë të çeliktë, kurse yjet nuk shkëlqenin e nuk ndriçonin si më parë. Po shuheshin e po veniteshin si ai kandili i hoxhë Demirit...

* * *

Gjashtë muaj pas kësaj ngjarjeje, vendin e pushtoi Italia fashiste. Ali Bregu shau e mallkoi ata që ishin futur me topa e me aeroplanë, që kishin vrarë njerëz e kishin djegur shtëpi. I urrente shumë ushtritë e huaja armike ai. Një ushtri e tillë ia kishte nxirrë jetën, e kishte bërë fat-keq...

Në fshat zunë të dukeshin ushtarët fashistë, me pupël në kapelë. Madje ata zunë të kërkonin herë ujë, herë vezë, herë «sinjorina». Aliut po i grumbullohej pikë-pikë urrejtja e viteve. I përfytyrohej masakra të «Shkëmbi i Ariut» dhe i ati me gjoksin të çarë nga bajoneta.

— Dëgjo këtu ti, grua, — e porositi Lulen ai, — dua që ata turiderra të mos të ta shohin as majën e thoit.

Qepallat e zeza të Lules rrahën si krahë fluture.

Një ditë Aliu i tha birit të Zyber Ramës:

— Ama, yt atë ia ka shtruar mirë me italianët e Duçes!...

— Pse të mos ia shtrojmë, kur na léverdis? — ia ktheu tjetri me fodullëk.

— Mirë, por dardha e ka bishtin prapa!

I vrenjtur në fytyrë, i biri i Zyberit u largua dhe po atë natë i tregoi t'et q'i kishte thënë Ali Bregu.

Ditën e parë të bajramit të madh, lopët e Zyberit u gjendën të djegura brenda në haur. Aliu dhe Lulja po rrëmonin tokën me këzmë. Kur ja, karabinierët erdhën e i

vunë prangat në duar Ali Bregut. Zyber Rama e kishte vënë në listën e të dyshimtëve për djegien e haurit.

Natën e parë Aliun e mbajtën në një postë karabinierie. Të nesërmen e quan në burg. Burgu ishte i ndarë më dysh. Lart ishin të burgosurit për krimë ordinere, poshtë të burgosurit politikë. Aliun e përplasën si deng atje sipër, tok me hajdutë, me vrasës, me kumarxhinj.

— Në burg ka edhe shumë komunistë, — i tha Aliut një fshatar nga Selita, që e kishin burgosur për shkak se kishte rrahur djalin e një beu.

— Ashtu? Komunistë? — Aliu kishte dëgjuar për komunistët, por që tani ndodhej tok me ta në burg, kjo e habiti dhe e trembi.

S'shkoi shumë kohë dhe Aliu zuri shoqëri të ngushtë pikërisht me një komunist. E quanin Luigj. Ishte i ri, jo më shumë se njëzet e pesë vjeç. Kishte një trup të drejtë dhe një fytyrë shumë të bûkur, zheshkane. E kishin dënuar me burgim të përjetshëm për shkak se e akuzonin për vrasjen e një spiuni. Që ditën e parë të njoftues, Luigji i foli gjatë e gjerë për Partinë Komuniste Shqiptare dhe për qëllimet e Luftës Nacionalçirimi. Aliu u mahnit nga ato që dëgjoi dhe e pëlqeu shumë këtë rrugë.

— Të gjitha të këqijat i kemi nga fashizmi e tradhitaret e vendit, — i thoshte Luigji.

— Po si i bëhet hallit?

— Fashizmi po na mashtron, po na merr nderin në- për këmbë.

— E di, por të pyes si i bëhet hallit!

— Hallit? Luftë me ç'të mundim, edhe me sfurqe,

Aliut iu përfytyrua i ati. Me sfurk kishte luftuar ai dikur.

— Ku ta gjesh luftën! — tha ai, duke pshëritë. — Po ti dhe unë, këtu brenda në burg, jemi si ata kalamajtë e vegjël në djepe.

— Jo, jo! — kundërshtoi me vrull Luigji. — Nuk jemi kalamaj, por luanë.

Aliu dëgjonte me qejf të madh. Sa shumë po i hynte në zemër ky Luigji i mirë!

— Ne jo vetëm do ta nxjerrim jashtë fashizmin, do të shpartallojmë edhe tradhtarët e vendit, por edhe shtetin e ardhshëm do ta ketë vetë populli. Atëherë të gjithë, edhe ju fshatarët, do të bëjmë një jetë tjetër, të ndershme, të drejtë...

Ndërkohe në burg përgatitej një demonstratë e madhe. Komunistët kishin marrë masa që kjo demonstratë të kombinohej edhe me demonstratën e popullit jashtë burgut. Aliu shihte lëvizje të mëdha brenda Luigji kryente në heshtje detyrat që i kishte caktuar celula e partisë. Aliu e vuri re shqetësimin e tij.

— Si i ke hallet, Luigj? — e pyeti.

— Sot, — ia ktheu Luigji, — këtu do të shpërthejë një demonstratë kundër fashizmit dhe veglave të tyre. Të gjithë simpatizantët e Partisë, pra edhe ti, Ali, duhet të bashkoheni me ne, me qëllim që kjo demonstratë t'u trajtojë atyri derravë se shqiptari më mirë pranon të vdesë sesa të rrojë skllav dhe i turpëruar.

— Fjalë me vend, — e ndërpren Aliu.

— Sot do të shohësh se ne nuk jemi kalamaj, por luanë të vërtetë. Aliut i shndritën sytë.

— Ki mendjen dhe mos bisedo me njerëz të dyshimtë. Këtu ka edhe shumë provokatorë.

— C'janë këta? — pyeti duke picërruar sytë Aliu.

— Hiqen si të burgosur, por janë spiunë të fashizmit. Prandaj ki mendjen!

— Mos u bëj merak fare!

Lëvizjet po shtoheshin vazhdimisht brenda në burg. Fashistët dhe gardianët ishin shumë të shqetësuar. Zhurmali të mëdha vinin edhe nga jashtë. Ajo filloj jashtë dhe, si një llavë e zjarrtë, hyri brenda dhe ngriti peshë gjithë të burgosurit.

— Poshtë fashizmi! Asnjë i burgosur në burgjet e Italisë! — kumboi një zë i fuqishëm. Ishte zëri i Luigjit. Aliut iu drodh zemra. Ishte një gjë me të vërtetë e madhërishtë! Brenda në burg, mu në sytë e fashistëve dhe të gardianëve, të therrisje: «Poshtë fashizmi!» Si e pabesuesh-

me për Aliun! «Ç'bëhet kështu!» — mendoi. Ai ende nuk e kishte kuptuar fjalën «demonstratë».

Filloi rrëmuja. Një gardian iu turr Luigjit.

— Mos më prek! — iu drejtua Luigji atij. — Mos më prek, se ndryshe ta marr shpirtin, këlysh i fashizmit! — dhe Luigji e shtyu me vrull.

Aliu ishte si i hutuar. Mu brenda në burg të godisje gardianin!

Refat Çela, ai fshatari nga Selita, që e kishin burgosur për shkak se kishte rrahur djalin e beut, i tha Aliut:

— Sot, or vëlla, edhe sikur të vdesim, hallalljeta jona!...

Pas pak erdhën ca qeveritarë të mëdhenj. Dikush tha se kishte ardhur vetë prefekti. Pas tij rrinte një suitë e tërë fashistësh. Luigji thirri përsëri me tërë forcën e kraharorit:

— Asnjë i burgosur në brigjet e Italisë! Poshtë fashizmi! Poshtë terrori!...

Këtyre parullave iu bashkuan si një kor i madh zërat gati-gati të të gjithë të burgosurve. Prefekti u tërbua. Vështroi andej nga kishte ardhur zëri i parë dhe dikush qëlloi me automatik drejt Luigjit. Aliu pa se një plumb goditi hekurin, prapa të cilit ndodhej trupi i bëshëm i Luigjit. Iu duk sikur Luigji mbeti i vrarë, prandaj vrapoi drejt tij si i tmerruar.

— Rroftë Partia Komuniste Shqiptare! — thirri Luigji.

Demonstrata përfundoi me sukses. Aliu dhe të burgosurit e tjerë mësuan se edhe jashtë populli ishte përedhe shoqja Mine Peza. Këtë emër Aliu e dëgjonte për herë të parë. Dhe nuk do ta harronte tërë jetën...

* * *

Me Luigjin u takua përsëri në nëntor të vitit 1943. Aliu ishte liruar nga burgu kohë më parë, për mungesë

faktesh, kurse Luigji ishte arratisur dhe tani bënte jetën e luftëtarit ilegal.

Ishte koha kur Luigji dhe shokët e tij po zbatonin porosinë e Partisë për krijimin e një shtypshkronje në zonat e thella malore. Makina e shtypit ishte marrë me mençuri dhe ishte transportuar me një mijë e një mundime në një bazë të largët, në Gur të Muzaqit. Mirëpo, përvèç makinës, duheshin shkronja, bojë, letër dhe gjithë ai material tjetër i nevojshëm për të shtypur komunikatat. Tërë ky material duhej të transportohej me kafshë, jo një ditë, por shumë ditë. Ishte një punë e vështirë kjo dhe tepër sekrete.

Lidhjet me nja dy fshatarë Luigji i mbante nëpërmjet një furrxhiu atje sipër, afër varrezave. Atje takohej ai dhe ngarkonte mushkat. Njëri nga këta fshatarë ishte Rifati Çela nga Selita. Me të dalë nga burgu, ai e kishte lidhur jetën e tij me shokët e Partisë Komuniste. Iшин ata që, kur Rifati doli nga burgu, i dhanë një kuintal misër për fëmijët e uritur dhe i blenë me fondin e ndihmave edhe një kalë. Qysh atëherë Rifati ishte vënë plotësisht në shërbim të luftës. Dhe pikërisht Rifati e tërroqi në këtë punë edhe Ali Bregun. Sapo i thanë Aliut se Rifati e Luigji i bënин të fala dhe se kishin nevojë për ndihmën e tij, Aliu vajti menjëherë te furra tok me një mushkë që ia mori hua një mikut të tij nga Bubreci.

Luigji ishte veshur tamam si fshatar. Mbante breku-she, një xhokë me thekë e pak të rrjepur, një palë ëpinga që i vishte pa çorape, dhe rrreth e rrotull qeleshes kishte vënë një shami të kuqe. Një palë mustaqe, pis të zeza, i qëndronin poshtë hundës dhe i shkonin shumë fytyrës së tij pakëz të gjerë, muskuloze, zeshkane.

— A je burrë i fortë, o Ali Bregu? — i tha pikërisht ky njeri Aliut dhe i zgjati dorën. Aliu e vështroi në sy, vështroi koburen që i shkëlgente në anën e majtë të brezit dhe një hop mbeti si i shtangur. E njohu vetëm kur Luigji buzëqeshi. Ai kishte një buzëqeshje krejt karakteristike.

— Allahalla, ti, Luigj, je?

— Mos më thirr me emër, më quajnë «Brahim».

— Brahim katundari, — shtoi Aliu, duke shpënë buzën në gaz, dhe filloi të ngarkonte thasët që i dha Luigji. Pas pak ata u nisën përpjetë. Brenda ditës ia behën në Kapercyli dhe pas një ore në Arrë. Qyshtatëherë Luigji u bë si njeri i shtëpisë në familjen e Ali Bregut. Lulja e donte si ta kishte vëllanë e saj këtë «kaur» të urtë e të besës, siç shprehej ajo për Luigjin.

6.

Sekretarja e organizatës bazë të partisë të fshatit Arrë, Pashonë Krepi, erdhi nga «Kodrat e Lajthive» me kamionin e kooperativës. Ajo zbriti nga makina dhe rregulloi shaminë që ia kishte hallakatur era atje prapa, në karroceri. Ishte ndaj të ngrysur. Qielli kishte marrë një ngjyrë të kúqërrëmtë. Pashonia e ndiente veten të lodhur atë ditë. Kishte punuar në atë thëllim, majë atyre kodrave, ku frynte shumë erë dhe të ftohtët të mpinte duart dhe fytyrën.

Pashonia u gëzua kur pa vogëlushen e saj katërvjëçare, Mirën, që i doli përpëra dhe iu hodh në qafë, thua Pashonia e kishte një çikë në merak vajzën, sidomos kur largohej nga shtëpia. Zákonisht ajo e linte te komshinjtë. Mirëpo Mira ishte shumë e lëvizshme dhe me marifet u largohej atyre dhe ec e gjeje pastaj!

Pashonia ishte martuar me Xhemal Krepin rrëth pësë vjet më parë. Ajo ishte bijë nga Balajt, në lagjen e siperme të Arrës. Ishte rritur edhe ajo në varfëri, si shumica e arrzjanëve. Ndonëse e re në moshë, ajo mbante mend shumë, sidomos nga tregimet e t'et e të xhaxhallarëve,

me tē cilët kishte bashkëjetuar derisa u bë nuse. Sa ishte gocë, ajo u bë sì mollë sherri pér disa familje në fshat. Shumë shtëpi dërguan pér ta kërkuar nuse Pashonen, por prindët e saj vendosën ta jepnin përfundimisht te Krepajt, pikërisht djalit tē tretë tē tyre, Xhemalit, një djalë shumë i urtë, me një trup tē zhvilluar, tamam prej maledorë.

Një nga ata që kishte dërguar pér Pashonen ishte edhe Hamit Vishnja, një djalë atëherë rrëthtridhjetë vjeç, jo aq i pashëm, me një fytyrë pak tē hequr e më sy tē bardhë. Mirëpo i ati i Pashones nuk ia dha këtij pér arsyese e éma e tij Xhevria, ishte grua serte dhe ngatërrrestare. Hamiti u tërbua nga inati. Dy net e dy ditë s'e zuri gjumi. Nuk ia kishte prerë kurrë mendja se nuk do t'ia jepnin Pashonen. E éma, Xhevria, filloi ta përfliste poshtë e përpjetë Pashonen. Madje arriti tē thoshtë se goca vuante nga sëmundja e tokës, tē cilën prindërit e saj e kishin mbajtur me kast tē fshehtë. Por Xan Krep, vjezhwi i ardhshëm i Pashones, burrë i fjalës dhe i zakonit, as që ua vuri veshin këtyre fjaleve...

Pashonia, si i dha Mirës një copë bukë, që ia ngjenu me vaj, shkoi tē merrete lopën, por befas dëgjoi një zë që e thirri nga larg.

— Kur tē mbarosh punë, eja, se po tē pres te zyra e Islamit,

— Mirë, mirë, — përsëriti ajo me zë tē lartë e tē zgjatur, duke e njohur nga zëri Bedri Abazin, kryetarin e këshillit popullor tē fshatit.

Pashonia vazhdoi udhën pér ku ishte nisur. Ajo solli ndër mend udhëtimin me kamion dhe ujkun që u kishte dalë përpara në udhë. Ajo ishte grua e shkathët dhë per punë s'iа hante qeni shkopin. Gjithë ditën në këmbë, nga mëngjesi deri natën vonë. Kishte një trup, tē bukur. Me atë fytyrën me një parnjë gati-gati fëminore, me trupin e mbushur, me një palë pantallona tē gjera, sipër tē cilave i dukej një fustan basmajë dalëboje, me opinga që i ishin zgjeruar nga përdorimi i tepërt, me një shami tē verdhë në kokë, ku mblidhë flokët e dendur, tē kuq, si tē lyer

me këna, ajo, Pashone Krepi, ngjante më shumë me një vajzë gjashtëmbëdhjetëvjeçare, sesa me një grua që i kishte kaluar të njëzetipesat.

Pashonia mori lopën, e shpuri në haur dhe zuri ta milte. Pranë i erdhi Mira, që s'pushonte së foluri.

— Ka mërdhirë lopa, oj nënë! — i thoshte ajo me dorën e vogël të hedhur në supin e saj. E ëma vazhdonte të milte, pa i kthyer përgjigje.

— Do të ha përshest me qumësht, — vijonte Mira dhe zgjaste kokën pér të parë në sy nënën.

— Largohu, Mira, se po më derdh qumështin! — i thoshte ajo dhe e shtynte lehtë me bërryl.

— Duan edhe vullnetarët qumësht, — tha përsëri Mira.

— E ku janë vullnetarët? — ktheu kokën nga ajo Pashonia dhe e vështroi të bijën në sy. Fytyra e vogëlushes ishte skuqur nga të ftohtët. Edhe duart, pak të fryra, i kishin marrë një ngjyrë trëndafili.

— Atje kanë ikur, me Mexhitin.

— Ku e di ti? — bënte muhabet më nge Pashonia.

— I pashë unë. Tek oda jonë do të flenë ata? A t'ua tregoj tutat e reja?

— Vullnetarët nuk vijnë te shtëpia jonë, se ti i mërzit me llafe.

— Jo, nuk i mërzit, i kam xhan.

— Edhe ata të kanë xhan ty, — dhe Pashonia u ngrit, largoi kusinë me qumësht dhe futi lopën brenda në haur.

— A ta çoj kusinë te shtëpia?

— Jo, se e derdh.

— E mbaj, e mbaj unë, jam e fortë, — dhe Mira, si ndonjë kukull e madhe, bëri sikur po e ngrinte kusinë, por Pashonia ia mori dhe vajtën në qilar. Derdh qumështin në mëti dhe mori një krah me shkarpa të thata pér të ndezur zjarrin.

— Ti mos dil më jashtë, se është ftohtë, — e këshilloi Mirën dhe u nis pér të zyrat e këshillit të bashkuar.

— Do të vij edhe unë, — iu qep pas vogëlushja, me dorën që kishte kapur fundin e fustanit dhe s'ia lëshonte.

Pashonia têrroqi derën dhe i vuri kycin. Tek ecte, mendonte. Kishte shumë probleme pér tê zgjidhur ajo. Raporti i organizatës bazë, që do tê mbledhej nga mesi i javës, akoma nuk ishte bërë, dy karakteristika që kishte kërkuar Komiteti i Partisë ende nuk ishin përfunduar, dhe mbledhja me popullin, që kishte qenë në plan pér t'u bërë javën e kaluar, ishte shtyrë me sot me nesër. Zakonisht Pashonia ishte e kujdeshme, por ja që shpesh koha i shkiste nëpër duar dhe tanë i ishin mbledhur shumë gjëra që kërkonin zgjidhje. Ishte viti i dytë që ajo kryente funksionin e sekretares së organizatës bazë. Pashonia nuk kishte dashur tê zgjidhej sekretare, u ishte latur shokëve që tê mos votonin pér tê, se ishte me fëmijë tê vogël dhe e zënë me shumë punë, por e zgjodhën. Pati njerëz në fshat që e priten si me habi këtë lajm. Madje ndonjëri tha se «Kot ia varën atë kumborë në qafë një copë gruaje». «Nuk ka takat Pashonia tê rregullojë gjithë punët e katusdit». Më shumë nga tê tjerët foli Xhevrie Vishnja dhe i biri, Hamiti. Xhevria kishte thënë plot gjëra dhe kishte shprehur bindjen se Pashonia jo që nuk do t'ia dilte në krye kësaj pune, por do ta bënte lesh e li gjithë fshatin. Kur i dëgjoi këto fjalë, Pashonia shpuri buzën në gaz dhe iu kujtua se si dikur dhe dikush, apo më mirë disa, kur ajo u pranua kandidate partie, i bënë një letër anonime Komitetit të Partisë, ku thuhej se Pashone Krepi nuk duhej pranuar fare në parti, sepse i shoqi i saj, Xhemal Krepi, kishte një xhaxha tê dënuar si armik, bir kulaku. Atëherë erdhën në fshat dy tê dërguar tê Komitetit të Partisë pér tê bërë verifikimet në vend. Punët u acaruan. Kishte ndonjë që vinte në dyshim edhe tê kaluarën e vjehrrit tê saj, Xan Krepit, e që thoshte se ai vërtet kishte qenë përkrahës i luftës, se në shtëpi tê tij vërtet kishin hyrë e kishin dalë partizanët, por pas Çlirimtës thuhej se kishte strehuar një bandit. Ku? Si? Qysh? Asnjë nuk guxonte ta thoshte hapur këtë. Më në fund u bë mbledhja e gjithë popullit. Xan Krepi foli pér jetën e vet. Edhe ai kishte mbutur jetim qysh në fëmimi. Edhe atij ia kishin vrarë tê atin

në masakrën e «Shkëmbit të Ariut», madje edhe xhaxhanë. I kishin djegur edhe shtepinë! Xan Krepi u tregoi se ishte rritur nëpër dyert e botës, pastaj u levoi disa deklarata lëshuar nga persona të ndryshëm. Dy nga këta ishin shokë që kishin pasur përgjegjësi në radhët e Ushtrisë Nacionale rimtare dhe shpreheshin me fjalët më të mira për Xan Krepin dhe familjen e tij. Tani çështja ishte e qartë. Autorët e letrës anonime nuk guxuan të dilnin hapur, por qëndruan të struktur, si pula të lagura.

— Ta imbyllim! E vërteta doli në dritë, — thanë disa.

— Ta imbyllim!

— Mjافت më këto shpifje!

Befas u dëgjuat zëri i hollë e i emocionuar i Pashonës. Plakosi tijë heshtje e thellë. Ajo ishte skuqur flakë në fytyrë.

— Unë them që të mos mbyllet me kaq. Unë dua që të kullohen mirë pünët. Flisni për ato që dini për mua dhë për njerëzit e mi. Kullomëni sa më shumë!

Qysh atëherë kishin kaluar disa vjet. Në parti, përvenc saj, u fut një vit më vonë edhe i shoqit, Xhemal Krepi. Burrë e grua anëtarë partit. Ndoshta ishte rasti i parë në tërë atë krahinë të thellë malore...

— Erdhe, Pashone? — e pyeti Bedri Abazi dhe i bëri vend që të ulej. Pashonia ndenji.

— Po Islami ku qenka? — pyeti ajo.

— E kërkuan në telefon, tani vjen, — tha Bedriu. Ai ishte një burrë rrëth të dyzetave, i gjatë e i hollë, me një shkollë. Ishte tamam ai Bedri Gjuzi, që dikur kishte qenë kryetari i kooperativës bujqësore të Arrës.

— E kemi keq me bërinjtë, Pashone. Mbrëmë erdhi i ati i Sefës dhe u ankua se i biri do ta linte tufën e dhive, sepse u mungojnë shumë gjëra.

— Çfarë, për shembull? — e ndërpren Pashonia me zë të ulët.

— Cizme nuk u kanë dhënë, pelerina jo. Me fjetjen qenkan keq, bile as kripë nuk paskan për dhitë.

— Po ne i kemi porositur edhe brigadier Mexhitin,

edhe agronom Dautin, — foli Pashonia dhe iu kujtua bise-
da që kishte bërë me ta.

— Nuk e kuptoj përse këta shokë sillen kështu me
barinjtë! — u ankua Bedriu. — Unë mendoj se Mexhiti du-
het të japë llogari në mbledhjen e organizatës bazë, kurse
agronom Dautin ta thërrresim në raport dhe të na shpjegojë
shkaqet e kësaj gjendjeje.

Në zyrë hyri me vrull, Islam Sula, kryetar i këshillit
të bashkuar. Ai fërkonte duart, ngaqë kishte mërdhira.

— Si është puna? — pyeti dhe u ul në karrigen pranë
tavolinës.

— Po i shpjegoj Pashones çështjen e barinjve, — tha
Bedriu me fjalë të shkoqura mirë.

— Aha! — tundi kokën Islami, si për të thënë se ishte
në dijeni pér atë çështje. — Veçse, — shtoi ai si me rrëm-
bim, — edhe barinjtë kanë kusuret e tyre. Kryetari i koo-
perativës ishte përpara tri a katër ditësh dhe më tha se
stallat i kishte gjetur keq, bile edhe keçë kishin ngordhur
nga pakujdesia e barinjve...

— Po as kripë nuk u kanë dhënë shokët e kryesisë, —
tha Bedriu me sytë pak të hapur.

Pashonia dëgjonte e s'fliste. Atë e shqetësonte gjendja
e blegtorisë. Më në fund tha:

— Të mos kapemi vetëm te kripa.

— Jo, Pashone, — e kundërshtoi Bedriu. — Bariu i do
të gjitha. I ati i Sefës më tha: «E kam dërguar djalin pér
të dimëruar me dhi e s'më ka sjellë asnje lek qysh nga
muaji i kaluar!»

— Kjo është një çështje tjeter, — ia priti Islami. — Sa
pér dijeni, barinjve nuk u takon më dietë, ja tek e kam
shkresën e Komitetit Ekzekutiv, këtu në dosje.

— Ne u kemi dhënë kur ata dilnin nga territori i koo-
perativës, — tha Bedriu me ton të sigurt.

— Është bërë, q'është bërë më parë, tani nuk u jepet
më, — tha në formë të prerë Islami. — Dashkeni të ushqej-
më fëmijët e Sefës! Po ne e dimë fare mirë, se nga ky
fshat jemi edhe ne, e dimë që barinjve veç buka u mun-
gon. Qumështin e kanë, bile edhe nga një keç e futin në

hell dhe thonë se ngordhi, ose se e hëngri ujku! Lëri hilëtë e tyre ti!

— Mund të jetë një bari i tillë, por jo të gjithë, — kundërshtoi qetë Bedriu dhe zuri të dridhëtë një cigare nga kutilia e tij prej fakfuni.

— Për mua janë shumica...

— Jo, jo, se atëherë do ta kishte marrë lumi gjithë kooperativën tonë, — tha me zë tingallues Pashonia. — Megjithatë, unë mendoj që raportit t'i shtojmë edhe pikën e blegtorisë.

— Kështu mendoj edhe unë.

— S'kam kundërshtim, — tha i fundit Islam Sula.

Heshtën një copë herë. Bedriu ndezi cigaren, dhe fjoillat e tymit të duhanit zunë të përhapeshin nëpër dhomë. Islami diç nisi të bururonte nëpër dosjet e tij. Pashonia kishte hallin e vullnetarëve. Ajo ishte informuar se të tre vullnetarët akoma vazhdonin të flinin në shkollë.

— Po me vullnetarët si do t'i bëhet halli? — pyeti Bedriu, — duke vështruar Pashonen në sy.

— Ma more fjalën nga goja, — tha ajo, duke buzëqeshur giltër. — Aty e kisha edhe unë mendjen. Mexhiti s'ka bérë hiç mirë që i ka çuar në shkollë. Tani në dimër mërdhin shumë. Pa zjarr, pa mbulesa...

— Hajt, se ashtu kaliten më shumë, — ia priti si me shaka Islami, dhe mbylli dosjen që kishte në dorë.

— Ata të kalitur janë, se vijnë nga klasa punëtore, — tha me një ton të qetë Pashonia, ku shquheshin edhe nota këshille për Islamin, që, ndonëse me shaka, nuk duhej të shprehej ashtu.

— Mexhiti na ka turpëruar, — tha Islam Sula dhe mori frymë me hundë.

— Po pse nuk polirohet ajo magazina? — pyeti Pashonia.

— S'dëgjon magazinieri, — tha Bedriu.

— Zaten kështu shkojnë punët, kur duan të bëhen të gjithë gjela! Kush urdhëron këtu, xhanëm, magazinieri apo kryesia e kooperativës, këshilli popullor?... — Islami s'e

mbaroi të gjithë frazën, ngaqë foli me rrëmbim. Pashonia u ngrit.

— Që nesër magazinierit t'i thuhet që të zbatojë urdhrin e kryesisë, — tha ajo.

— Kështu ta lëmë atëherë, — e mbylli Islami dhe u ngrit edhe ai pér të ikur.

— Natën e mirë!

— Natën e mirë!

Mira e vogël ia behu te Pashonia.

— Ka biskota te Cani, — i tha s'ëmës dhe e preku me dorë te kindi i fustanit.

Përballë Pashones doli Xhelal Vishnja, djali i pestë i Xhevrie Vishnjës, një djalë ky azgan e i shkathët.

— Si u ngryse, Pashone?

— Mirë, po ti?

— Jam i pakënaqu! nga ju, — ia priti Xhelali me zë tingëllues.

— Pse? — dhe Pashonia e vështroi me kujdes me sytë e saj të qeshur.

— Po afron koha e hapjes së kursit pér normist dhe ju akoma nuk më keni dhënë asnje përgjigje.

— Këto ditë do të mblidhet Organizata e partisë dhe do të vendosë.

— Agronom Dauti është dakord që unë të shkoj në kurs, — tha si nëpër buzë Xhelali.

— Shumë mirë që qenka dakord edhe ai, — tha Pashonia me zë pak si të lodhur.

Xhelali heshti një copë herë.

— Po shkoj, Xhelal, se ma preu gocën të ftohtët.

— Ti duhet të më përkrahësh, Pashone, sepse jo vetëm që jam i aftë pér ta bërë punën e normistikës, por s'ma merr mendja që të kesh ndonjë tjetër që të më afrohet mua sadopak.

— Këtë çështje e vendos organizata e partisë, — ia preu ajo.

— Po ti si sekretare ke shumë në dorë, — e ngriti pak zérin ai me një ton miklues.

Pashonia zuri të ecte. Xhelali i shkonte përkrah dhe

niuk e ndërpren bisedën. Ai i foli se kishte mbaruar shkollën tetëvjeçare, se kishte kryer ushtrinë dhe kishte marrë një fletëlavdërimi nga komanda e repartit dhe plot gjëra të tjera që Pashonia i kishte dëgjuar edhe më parë. Tani që këto gjëra përsëriteshin vend e pa vend, të shoqëruara me lloj-lloj mburrjesh, Pashonen e bezdisnin deri në atë shkallë, sa me zor e përbante veten.

— Kështu, Xhelal, si të vendosë organizata, — i tha më në fund ajo, kur iu afroa shtëpisë.

— Sidoqoftë, unë do ta marr vesh se ç'qëndrim do të mbash ti, Pashone! Kam edhe unë shokët e mi aty në organizatë, — dhe fytyra e tij e gjatë u mbush me rrudha, si fytyrë plaku.

— E di, — ia priti Pashonia, duke u lëkundur me ato këmbët pak të shkurtra. — E di që je shejtan i madh ti, Xhelal, — dhe hyri në oborrin e saj.

Xhelali qeshi me zë të lartë dhe shtoi që përtej gardhit:

— Ta thotë Xhelali ty që unë me siguri do ta marr vesh pikë për pikë se ç'do të thuash ti për mu! — dhe u zhduk në muzgun, që kishte filluar të merrte formën e një nape të errët.

— C'mjeri i besdiss'hëm ky djale! — mendoi me vete Pashonia dhe shkoi në kuzhinë të bënte darkën.

7.

Bilal Bregu ishte komunisti më i ri i fshatit Arrë. Ndonëse i ri në moshë, ishte pak i shëndoshë, i gjatë e me një qafë të trashë. Fytyrën e kishte shumë tërheqëse. Me sytë pakëz të mëdhenj, shumë të zinx e të qeshur, me atë gjakun e ëmbël e të gjiltër, Bilali të bënte për vete. Kishte mba-

ruar shkollen tetëvjeçare të Arrës dhe arsimin e kishte dashur shumë. Ai do ta kishte vazhduar edhe të mesmen, por kishte qenë i detyruar ta mbyllte me aq për shkak se prindërit i kishte të moshuar dhe vetë kishte mbetur si direku kryesor i familjes. Ishte edhe i gojës, edhe i punës. Nëpër mbledhje fliste dhe shfaqte mendime. Ndoshta për këtë i kishte dalë nami si «parimor» dhe që e «tepron». E vërteta ishte se Bilali nuk pajtohej me të metat e me dobësitë. Kishte një shpirt të zjarrtë ai dhe nuk e duronte dot indiferentizmin. Kritikonte pa druajtje, por, ama, kishte edhe një të mirë të madhe, se ishte gati të bënte autokritikë për çdo gabim që bindej se e kishte bërë vetë.

Ata që i kishin nxjerrë namin si «njeri që e tepron» nuk kishin aspak të drejtë. Ata ende nuk ia kishin njohur shpirtin e zjarrtë që i vlonë brenda në kraharor. Ai mera-kosej shumë për punët dhe për fshatin. Mendonte edhe për të nesërmën Bilali. Shkurt, ishte tamam nga ata të rintjtë që duan ta shndërrojnë me vrull gjithçka, nga ata që duan kapercime të mëdha e të shpejta. Ai i njihte ata që orvateshin të bënin ndonjë shaka ca si të tepruar me të, por nuk para ua varte dhe shpesh i vështronë si me keqardhje. Pikërisht kjo i tèrbonte ata. Por njëkohësisht brenda për brenda Bilali ndiente një farë dëshpërimi që nuk ia kuptionin ndjenjat e mendimet.

— Atje ku hanë e s'të japid dhe atje ku flet e s'të dëgjojnë, s'ka gjë më të keqe! — përdorte shpesh këtë shprehje popullore Bilali.

Pashonen e donte dhe e qmonte shumë. Mbi të gjitha, qmonte ndershmërinë dhe drejtësinë e shpirtit të saj. Edhe atëherë, kur u diskutua çështja e letrës anonime, edhe më vonë, kur ajo u propozua për sekretare, Bilali, foli me zjarr dhe e mbrojti me këmbëngulje.

— Unë për hesapin tim, — kishte thënë ai për çështjen e parë, duke shpënë dorën në anën e zemrës, — i quaj frikacakë ata që i drejtojnë letra pa emër Partisë dhe që mërrën me shpifje e thashetheme. Burri është burrë! Ngrihet e thotë mendimin e tij si t'ia presë, mirë ose keq, por e thotë hapur, përpara të gjithëve dhe jo tinëz, si hajdut. Baballa-

rët tanë e njohin fare mirë edhe të kaluarën, edhe të tashmen e Xan Krepit. Ai është plak, dhe ata që shkruajnë letra tinëz, si hoxhallarët e dikurshëm nuskat, bëjnë krim! Turp të mërzitësh në një moshë të tillë një njeri të mirë siç është xha Xani!...

Bilali kishte qejf të përmendte, kur diskutonte, fjalë pak a shumë të reja, që zakonisht në fshat paq i përdorin dhe jo të gjithë ua dinë mirë kuptimin. Por ruhej, se nuk donte t'u jepte material atyre që i kishin nxjerrë namin si «njeri që e tepron».

— Bjeri shkurt, Bilal! — dëgjohej ndonjë pëshpëritje, kur ngrihej pér të folur.

— Shkurt, more vëlla. E di unë se të dhimbset koha ty, — ia kthente Bilali me romuze dhe vazhdonte të fliste po pér ato çështje që mendonte.

Njëherë ai u grind me Islam Sulën, kryetarin e këshillit të bashkuar. Po zhvillohej mbledhja e këshillit të frontit pér të hartuar planin vjetor të punës. Doli edhe çështja se nëpër mbledhje bëheshin shumë mungesa. Islam Sula tha se atyre që mungonim t'u jepnin dru.

— Jo, dru, — e ndërpren Bilali.

— Dru që ç'ke me të! — vazhdoi Islami dhe ndjeu se po zemërohej gjithnjë e më shumë.

— Jo, shoku Islam, e ke gabim. Ti vërtet sot je i dele-guar në këtë mbledhje, por më duket se po na mëson keq.

— Unë them që dru do edhe ti, — iu hodh Islami me një ton tepër të ashpër. Bilali buzëqeshi, tundi kokën, si i habitur, dhe e vështroi në sy.

— Hajt, — vazhdoi Islami, — përgjigju pér mungesat në mbledhje.

— Ti s'më detyron të flas.

— Të detyroj që ç'ke me të. Ti je aniëtar i këshillit të frontit.

— Jo, s'më detyron!

— Shikoni, shokë, — iu drejtua Islami të tjerëve, — këtë njeri ju nuk e keni fare në rregull.

— Më përpana të shohim këshillat tua ja, pastaj çështjen time. Ju thatë që njerëzve t'u japim dru. Pa ma shpje-

go një çikë këtë kuptim! C'do të thuash ti me këto fjalë, shoku Islam Sula?

Islami e pa pisk. Në vështrimin e disave, në bebet e syve të tyre, ai shihte se shumica ishte me Bilalin.

— Tuaf njeri që bëhesh! — shfryu Islami pas pak. — Kur them t'u japim dru, e kam fjalën që të bëjmë çmos që ata të vijnë në mbledhje, t'i kritikojmë përpara të gjithëve, shkurt ky është druri që propozoj unë.

— Kështu po, — tha Bilali. — Këtë lloj druri e meritoj edhe unë, — dhe me fjalë të prera tregoi se për dy çështje që kishin të bënin me mosplotësimin e detyrave përgjegjësia i takonte atij.

Bilali përpinqej të lexonte sa më shumë. I pëlqenin sidomos romanet me temë nga puna dhe lufta e sigurimit të shtetit. I ati Ali Bregu, i kishte treguar se fill pas Çlirimt, në malet e zonës së tyre, ishin strehuar kriminelë që ishin organizuar në banda të rrezikshme. Aliu kishte bashkëpunuar me shokët e sigurimit për shfarosjen e tyre. Madje ai edhe kishte luajtur një rol të bukur që i kishte dalë me sukses. Bilali përgjërohej për këto gjëra. Kur i rastiste të ndodhej nëpër gryka dhe shkëmbinj të thepisur, ai kishte caste kur e përfytyronte veten të rrethuar nga armiqëtë dhe në fantazinë e tij sajoheshin skena me plot kombinacione të bukura...

Por ai lexonte edhe literaturë politike. Gazetën po se po, por edhe butelinet e Komitetit Qendror të Partisë dhe veprat e shokut Enver i studjonte me laps në dorë dhe shpesh i nënvizonte. Në shtëpi, në odën e mirë, ai kishte bërë një si kënd të vogël në formë biblioteke, ku kishte vendosur libra të Leninit, të Stalinit dhe të shokut Enver. Kishte edhe një shtatë a tetë romane. Njëherë njëri nga sekretarët e Komitetit të Partisë, kur i kishte vajtur për vizitë, kishte shfletuar disa nga librat dhe kishte parë se vende-vende veprat ishin nënvizuar me laps.

— Ti i ke nënvizuar, shoku Bilal? — e pyeti sekretari.

— Si urdhëron. Përpinqem, por...

— Çfarë por?

— Natyrisht, nuk e kemi atë kulturën tuaj ne, fshata-
rët. Megjithatë, përpjekjet i bëjmë edhe ne.

— Kjo ka rëndësi. Po u përpoqe, patjetër do të mësosh.

— Lexon, lexon dreqi! — kishte folur Aliu, i kënaqur.

— Ka raste kur tri edhe natën vonë.

— Shumë mirë. Kështu duhet. Parashikohet që pas di-
sa vjeteshi të ngrihet edhe një shkollë e mesme këtu në Arrë.

Në dërkë Bilali dëgjonte muzikë dhe lajmet e Tiranës.
Ai i shpjegonte t'et, s'ëmës dhe së shoqes këtë apo atë çë-
shtje. Sidomos shumë u fliste për gjendjen ndërkombëtare,
për vrasjet e presjet që bënin kapitalistët nëpër botë, pér
popujt që luftonin dhe përllesheshin me shfrytëzuesit. Aliu
e shihte me kujdes dhe i bëhej qejfi që i biri dinte aq
shumi dhe jetonte me kohën.

— Një vít e ca më pârë, Bilali u martua dhe pothuajse që
i pari në Arrë që theu zakonin e vjetër, sipas të cilit djali
ose vajza ishin të detyruar të prisnin shkesin pér të hapur
udhët e mëtejshme të jetës së tyre. Bilalit i pëlgente Gjylja,
vajzë e Dikut; me të cilën ishte rritur. Bashkë kishin luaj-
tur kukafshëllithi, bashkë këshin kultetur dhitë, bashkë ki-
shin mbáruar shkollën, bashkë kishin mbledhur luleshtry-
dhë, dhe kur rastështë që i zinte shtrëngata në male e në py-
jë, kur buçisnën bubullimat dhe shkrëpimmat çanin retë;
ajo, Gjylja, nga frika, gati-gati rigjeshej pas trupit të Bila-
lit... Mirépo, kur ajo mbushi tetëmbëdhjetë vjec, takimet i
rralluan dhe bisedat nuk i bënin më si dikur. Megjithatë,
vështrimi i të dyve ishte rrufitës dhe fliste shumë.

— Si thua ti, Gjyle, ta përfundojmë edhe ne atë hesa-
pin tonë, — guxoi e i tha një ditë, kur e takoi vajzën mu te
ata e saj.

— Ç'hesap? — pyeti Gjylja me një buzëqeshje plot-
jetë dhe drithë. Gjylja po qëndiste një shami të bardhë.
Tëmiriat e saj shkëlqenin si copatë florinjta, kur ajo lëviz-
te pak e kur mbi të derdhej një rreze e diellit që depërtö-
nte nëpër gjethet e arrës.

— E? — pëshpëriti me zë të ulët Bilali dhe ndjeu se pë-
shtyma i ngeci në grykë.

— Atë e di Lala, — u dëgjua zëri i saj i ëmbël. Ajo e

kishte kthyer kokën mënjanë, ndërsa qëndisma i kishte ngrirë mbi prehër.

— Unë dua fjalën tënde, me Lalën ka se kush bisedon. Gjylja s'foli. Po Bilali e shihte se ajo nuk kishte ndonjë kundërshtim. Shpatullat e saj lëviznin më me shpejtësi se herët e tjera. U dëgjua zëri i një fëmije që erdhi an-dej nga shtëpiat e fshatit, pastaj disa zëra së bashku kumbuan me potere kundër një hute, që, me sa dukej, përpiquej të rrëmbente ndonjë zog pule. Bilali ngriti kokën lart dhe dalloi hutën që po ngjitej e trembur, pa arritur të krye-në krimin. Edhe Gjylja zuri të vështron te atë shpend gra-bitqar që çante me vrull qellin e kaltër të asaj dite vere. **Disa fluracë të vegjël e ndiqnin nga pas.**

— Mirëmbeç, pra, — i tha ai dhe pa ditur si ia hodhi dorën në sup. Ajo nuk lëvizi. Uli sytë përdhe. Në fytyrë ish-te bërë si lulëkuqe. . .

Po Bilali ishte edhe punëtor i zoti. Punonte pa hile dhe zakonisht merrte njëqind e njëzet pikë në ditë. Atij i qante shpirti ta shihte Arrën ashtu siç kishte parë disa koopera-tiva bujqësore të Fierit e të Beratit, kur kishte qenë ushtar, Akoma s'i shqiteshin nga kujtesa parcelat e atyre koo-perativave, ku çdo vit lulëzonte gruri, pambuku, misri dhe lulet e diellit, që, ca pjata të verdha, mbushnin plantacio-net e pafund, duke i dhënë fushës një bukuri të rrallë. «Eh, sikur edhe tokat tonë të ishin po kaq pjellore sa këto! — pshëretinte plot afsh ai. Ai éndërronte që luginat e ngas-trat e tokave të Arrës, ku edhe traktori i vogël futej me vështirësi e me vështirësi bënte qilizmi, të ktheheteshin në toka pjellore, të jepnin rendimente sa më të larta. Rrinte e i vështron te Bilali dhe i përfytyronte ato plot e përplot me pemë frutore, me mollë, me dardhë, me ftonj, me qershi, me arra. Këto lloj frutash rritheshin për bukuri në këtë zo-në dhe arrzjotët ua kishin parë leverdinë pak a shumë. Por tani që ata jetonin në kooperativë, duhej ecur më përpara. Atij i vinte zor, madje edhe turp, që tregonte të vërtetën, kur e pyesnin se sa mërrnin për ditë pune. Vitin e kaluar dita e punës u kishte rënë tetë lekë. Pak, shumë pak. — Unë nuk kuptoj një gjë, — kishte thënë Bilali në një aktiv

partie dhe këtë e kishte thënë me një ton pak të ashpër. — Për të punuar po punojmë si derri, si i thonë fjalës, por si shpjegohet që tetë lekëshi s'na u nda që s'na u nda muaj pér muaj nga borderoja? Tokat i mbjellim vit pér vit, i mbjellim ashtu siç na thotë brigadieri dhe agro-nomi. Bimët rriten, punët ma duken fare mirë, i gëzohemi punës sonë, por kur vjen fundi, llogaria po aq të jep, meazzallah më shumë se tetë lekë pér ditë pune.

— Në kooperativën tuaj kâ shpërdorime, — u dëgjua zëri i të deleguarit, që ndërhyri nga presidiumi.

Bilali heshti. Këtë të vërtetë ai e dinte fare mirë dhe kjo thënie e të deleguarit ia çori zemrën si një thua çeliku. Kushedi sa herë ishte grindur Bilali me prindër fëmijësh që si pa të keq jo vetëm që hanin qershi nga të kooperativës, por i këputnin ato me gjithë degë, ose ai kishte bërë fjalë me ata që kullosnin bagëtitë personale në meranë e kooperativës dhe me të tjerë që silleshin me pronën e përbashkët si ajo-huta që rrekej të përlante zogun e pulës. Dhe, kur rastiste që dilte pa gjë, kjo vinte pér shkak të atyre të thirrurave të forta të fëmijëve e të grave që s'i ndaheshin derisa shpendi të zhdukej në thellësi të qiellit... Dhe pér të gjitha këto qëndrime, pér Bilalin dhe pér-ata që e përkrahnin thoshin se e «tépronin», «se donin të dukeshin e të shisnin mend». Bilali njihet shumë prej atyre që silleshin keq me pronën e kooperativës. Madje i kishte kritikuar me emra nëpér mbledhjet, por kishte vënë re se ndaj këtyre gjërat sikur mbahej një farë qëndrimi indiferent, gjë që atë e dëshpëronte shumë. Përparime ishin bërë shumë dhe po bëheshin gjithnjë, por një pjesë e mundit dhe e djersës së tyre shkonte dëm vetëm e vetëm nga shpërdorimet. Bilali dyshonte se ai Xhelal Vishnja, transportuesi i grurit në mulli dhe i miellit nga mulliri në furrë, përvetësonte miell nga të kooperativës. Këtë dyshim ia kishte shfaqur pér herë të parë vetë furrxhiu.

— More ti, Bilal, dua të të pyes, se s'po e zgjidh dot kë-të çështje.

— Pér çfarë?

— Ky Xhelali, Xhelal Vishnja, u bë dy muaj e kusur që s'blen bukë këtu në furrë. Ku ushqehet ky xhanëm?

— Ndoshta ha bukë misri. Mund të kenë pasur dy a tri qase me misër.

— Jo, ai nuk ha bukë misri. Kam informata.

— Po atëherë?

— Më duket se vjedh miell, miellin e kooperativës...

Bilali skërmiti dhëmbët nga inati. U bëtua me vete që do të bënte qëmos që ta zinte. Ta zinte më presh në duar dhe ta bënte qepaze mu në sy të të gjithëve, madje ta dërgonte në gjyq. Po hajde e kape se! Xhelali ishte skile, skile e rafinuar...

Bilali është vuri re atë mbrëmje, kur Xhelali diç i thoshte Pashones sa me gojë, me duar. E kuptoi Bilali se ai po përpjekj t'ia hidhte sekretares, prandaj, kur ajo u nda nga ai, Bilali i vajti në shtëpi dhe e pyeti lidhur me Xhelalin.

— Kërkonte ta dërgojmë për normisë, — i tha Pashonia.

— Ti a je dakord?

— Unë i thashë si ta vendosë organizata e partisë.

— Shumë mirë i ke thënë! Me sa duket, ai e ka qelbur me punën e miellit dhe kërkon të largohet përpara se të japë llogari.

— Mos dysho pa fakte, — pëshpëriti me buzë në gaz Pashonia.

— Më placin sytë, në mos ka vjedhur miell...

— Po pse nuk e zure as ti, as Bedriu?

— Këtu është e keqja. Ai kushëdi se me qmarifet e ka organizuar këtë punë.

— Sidoqoftë, ne nuk duhet të dyshojmë, nuk duhet t'ia nxjerrim namim e keq, sepse nuk kemi fakte. Kuir të kemi fakte, po.

Bilali është kishte pranuar këtë këshillë, por brenda përbreda ai ishte i bindur për këtë dhe kishte edhe bindjen tjetër se në mos sot, nesër, kjo gjë do të dilte si një e një bëjnë dy...

8.

— Mirëmbërëma!

— Mirëmbërëma!

— Si u ngrysët, shokë punëtorë?

— Mirë, po ju?

Fshatarët komunistë dhe punëtorët vullnetarë u shtrën-
gonin duart njëri-tjetrit. Petrit Skënderi e ndiente veten të
gëzuar, dhe një ngrohtësi e thellë e brendshme ia kishte
pushtuar zemrën. Ja anëtarët e partisë, komunistët fshatarë
të këtyre zonave malore! Me ta do të jetonin, do të lufto-
nin së bashku e mbasë, po ta lypte nevoja, edhe do të vdis-
nin së bashku.

— A mungon njeri? — pyeti Pashonia me shikimin e saj
të qetë e të paqtë.

— Vetëm dy veta, brigadieri dhe Qerimeja, — ia priti
shpejt e shpejt Sherif Arra, mbajtësi më i saktë i protoko-
lleve, të mbledhjeve. Ai kishte fytyrë të rrumbullakët, sy të
imprehite. Koka i vinte si me gunga.

— Po Dirin, përsë nuk e përmende ti? — u dëgjua zëri
metalik i Bilal Bregut.

— Atë e kam kushërirë, — tha duke qeshur Sherifi, —
pastaj do edhe tri minuta që ora të shkojë shtatë fiks, — dhe
ai tregoi orën e tij të dorës. — Deri atëherë ajo vjen, se
ja tek e ka shtëpinë, — shtoi gjithnjë me fytyrën e tij si të
ngërdheshur.

— Po edhe Qerimeja me brigadierin mund të vijnë, —
sekush foli.

— Aha, s'ma merr mendja, se ata janë në zall, — vazh-
doi përséri Sherif Arra dhe i vështroi me buzëqeshje të tre

Petri i shihte një e nga një, me vëmendje, shokët
e organizatës bazë. Aty ishin pesë komunistë fshatarë. Mu-
ngonin tre, pra organizata përbëhej gjithsej nga tetë veta.
Mu-Sulë Metani ishte kandidat partie.

— Këtë shokun kot e paskeni prurë deri këtu në Arrë,

— u hodh e foli Sherif Arra me shikimin në drejtëtim të Sulës.

— Pse? — pyeti Elmaz Fuga me një farë habie.

— Po më duket pak si i dobët nga trupi. Është punë e rëndë bujqësia! — Dhe ai tundi kokën, sikur kishte shumë gjëra për të thënë.

— Vërtet duket i dobët, por është i fortë, — i ra shkurt Petriti.

Sula e pa nja dy herë vetëm në fytyrë Sherifin dhe befas i shkau një buzëqeshje.

— Po ti me çfarë punësh merresh këtu? — e pyeti Sula si me druajtje.

— Unë punoj në administratën e kryesisë.

— Aha, paske gjetur një qoshe të rehatshme ti, o vëllai im! — ia priti Sula, duke i tërhequr fjalët zvarrë.

Plasën të qeshura. Sherifi përpëliti sytë dhe tha: — Këtu më ka caktuar Partia. Po kam punuar edhe në prodhim, bile edhe në blektori. — Tek fliste, ai u skuq në fytyrë.

— Partia thotë që komunistët të jenë në punët më të vështira të prodhimit, — ia priti Sula me vrull.

— Po këtë punën time kush ta bëjë? — Sherifi ishte bërë si plak në fytyrë.

— Ky të vika hakut ty, o Sherif Arra! — ia priti Bilal Bregu.

— A fillojmë, shokë? — u dëgjuva zëri i Pashones. — Ti, Sherif, shëno në protokoll ata shokë që mungojnë.

— Ja, erdhi Diri. Ajo ishte një grua e bëshme, me gjoks të fryrë dhe me fytyrën gjithë mish. Ishte kuzhiniere e menës.

— Ju thashë se vjen në orar Diri? — tha me ton të gëzueshëm e si me krenari Sherifi.

— Ulu, Diri, — tha Pashonia.

— Kanë kaluar pesë minuta, — ia priti Sula, — shoqja duhej të kishte ardhur në orar.

— S'janë gjë pesë minuta! — tha Sherifi me një zë gjithë qesëndi.

— Sherif! — i tërroqi vëmendjen Pashonia. — Mbledhjen e hapim. Pllakosi heshtja.

— Në mbledhje marrin pjesë edhe tre vullnetarët që na i ka dërguar Komiteti i Partisë. Tani këta shokët e rinj vullnetarë të thonë diçka nga biografia e tyre, por shkurt, — shtoi Pashonia me zërin që i dridhej lehtë.

Përsëri ra një heshtje e shkurtër.

— Atëherë po ngrihem unë, — theu heshtjen zëri i Sulë Metanit. Ai u ngrit në këmbë. — Ulu, ulu, — sekush i tha. Po Sula nuk u ul. Në dorë kishte një bllok shënimesh dhe një laps kopjativ. — Unë quhem Sulejman Metani, por për shkurt më thérresin Sulë, — filloj të fliste ai me një zë që i dilte si me dallgë. — Rrjedh nga një shtresë e varfër. Im atë ka qenë kovaç. Prindërit e mi e kanë simpatizuar Luftën Nacionalçlirimtare. Para Çlirimit kemi jetuar keq. Ç'të flasim për atë të kaluar! Vetëm pas Çlirimit filluam të jetojmë si njerëz. Unë kam mbaruar tetëvjeçaren dhe vazhdoj më korrespodencë vitin e tretë të politeknikumit. Jam më profesion axhustator. Jam i martuar dhe kam një djalë katër vjeç. Jam kandidat partie qysh vitin e kaluar. Tani erdha si vullnetar këtu të ju. Ë ndiej veten të gëzuar dhe, ç'të them, jam edhë optimist. Ai shoku, — dhe Sula shënoi me gisht Sherif Arrën, — ai tha qëparthi se kot më pas kan sjellë këtu, se jam me trup të imët, dhe me të vërtetë dukem i dobët. Dua t'i bëj një sqarim atij shokut, se mua nuk më ka sjellë njeri me zor në kooperativën tuaj, por kam ardhur vetë, vullnetarisht, për të ndihmuar me aq sa mundem në përparimin e fshatit tonë socialist dhe për të mësuar nga ju. Jam i dobët ose i fortë, këtë do ta tregojë koha, — dhe u ul.

— Të lumtë, — foli si nën buzë Islam Sula dhe vështroi me bishtin e syrit Sherifin, që pas fjalëve të Sulës përsëri u skuq në fytyrë.

— Unë quhem Petrit Skënderi, — kumboi zëri i qartë dhe i plotë i Petritit.

Të gjithë e vështruan në sy. Trupi i tij i bëshëm, fytyra me tipare têrheqëse, sytë e tij, ku fshihej gjithnjë një nënqeshje e ëmbël, u bënин përshtypje fshatarëve dhe ata e dëgjonin me vëmendje.

— Jam tornitor, anëtar partie. Një xhaxha e kam dësh-

mor të Luftës Nacionalçlirimtare. Babai im ka qenë partizan në Pezë.

Befas trokiti dera.

— Hyr!

Hyr i pari brigadier Mexhiti; pas tij dukej një grua që zgjati një fytyrë të imët.

— A mund të marrim pjesë? — pyeti Mexhiti më zërin e vet të ngjirur. Dukej i loddhur, ngaqë merrte fryshtë me mundim.

— Pse me vonesë, Mexhit? — pyeti Pashonia.

— Vijnë nga Zallë. Orë nuk kishim. Mua më dolën edhe disa ngatërresa të paparashikuara.

— Ulu, ulu! — sekush foli me zë të pakënaqur.

— Vazhdo, shok! — iu drejtua Pashonia Petritit.

— Në parti nuk kam asnjë vërejtje, — vijoi Petriti, — kam qenë anëtar i byrosë së organizatës bazë të uzinës dhe nënkyryetar i komitetit profesional të repartit. I premtoj organizatës bazë se do të vë të gjitha forcat e mia si punëtor e si komunist për të kryer mirë të gjitha detyrat që do të më ngarkohen.

— Haja, haja, se do të keni shumë punë ju, vullnetarët, — ndërhyri Sherifi, i mbështetur me të dy bërrylat në tavolinë.

— Ka kush ndonjë pyetje rreth meje? — dha Petriti i mbuloi të gjithë me vështrimin e vet.

— Jo, jo, nuk kemi.

— Uluni, shoku Petrit!

Elmaz Fuga u kollit lehtë, u ngrit në këmbë dhe filloj të flasë:

— Ardhja ime si vullnetar në kooperativën «Çlirimi» të Arrës është një ngjarje me rëndësi në biografinë time personale. Përpala një javë festova ditëlindjen. Mbusha njëzet e katër vjeç: Po e filloj kështu prezantimin, për arsyë se në familjen time është rasti i parë që festohet një ditëlindje. Përse po jua tregoj këtë gjë? Ndoshta ndonjërit mund t'i duket si e tepërt! Jua tregova për t'ju thënë se nga ç'shtresë rrjedh unë dhe, nga ana tjetër, për t'ju treguar se jo vetëm ju, fshatarët, keni hequr e keni vuajtur

shumë, por edhe më, qytetarët, se shtypësit e shfrytëzuesit ishin edhe në fshat, por edhe në qytet.

Pashonia pohoi me kokë dhe përpëliti sytë e saj që i shkëlqenin.

— Jam anëtar partie, beqar....

— Haje, se do të ta gjejmë këtu, në fshat, nusen ty, — ia priti Sherifi dhe ia shkrepit të qeshurit.

— Dakord, shoku Sherif, — tha si me shaka Elmazi dhe, vazhdoi:

— I lutem organizatës bazë të më caktojë në frontet më të vështira të punës, — dhe u ul ngadalë, duke kërkuar si me druarjtje kamrigen e tij.

— Vazhdojmë, — e mori fjalën Pashonia pa u ngritur në këmbë.

Përpëra kishte një letër dhe një stilograf ngjyrë vishnjë.

— Kemi një raport të shkurtër mbi disa porosi që na u dhanë nga Komiteti i Partisë për përgatitjet e fushatës së mbjelljeve të pranverës. Raportit i shtuam edhe një pikë të dyte përgjendjen e blegtorisë, se këtë sektor e kemi përtokë. A, të filloj ta lexoj raportin?

Petriti e shihte Pashonen me vëmendje dhe i vinte keq, kur ajo, tek lexonte, ngekte aty-këtu. Flokët gati-gati të kuq e me kaçurrelatë cullufet, i kishin rënë te faqet dhe fytyra i dukej edhe më e vogël. Një dritë gjëzimi vezullonte në sytë e saj.

— A keni pyetje? — tha ajo, kur mbaroi së lexuari.

Heshtje. Dikush gogësiu me një rënkim të vogël. Sulë Metani zgjati kokën për të parë.

— Po s'patët pyetje, fillojmë nga diskutimet.

Përsëri heshtje. Petriti kishte mbajtur disa shënimë të shkëputura nga raporti: «Morëm trembëdhjetë kuïntalë grurë për hektar». Pak. Pse? «Një pjesë të gështenjave na i vodhën dhe na i hëngren derrat». Pse? Kush përgjigjet për këto? «Stallat e dhive nuk kanë përfunduar. Dhité janë me zgjabe. Plani i qumështit është realizuar shtatëdhjetë përqind». Pse?

— Mos të humbasim shumë kohë, shokë, — tha Islami, që ishte ulur afër Pashones. — Probleme ka mjaft, shokët duhet të diskutojnë.

— Po ngrihem unë i pari, — tha Bilal Bregu. — Unë jam dakord me raportin, — vazhdoi ai me zërin e tij pak të trashë. — Kritika sigurisht duhej të kishte më shumë. Nejse! Për mendimin tim, shkaku që nuk u realizua rendimenti i grurit është fara meksikane. Kjo farë nuk i përshtatet as tokës, as klimës sonë. Këtu kanë faj edhe agronomët. Na e dhanë me zor dhe ne e mbollëm. Mexhiti ka faj që s'përdori farën e parvjetshme.

— Po s'dëgjonë agronom Dauti, sikur t'ia mbaje në lule të ballit! — ú ankua me zërin e vet të ngjirur brigadier Mexhiti.

— Kur isha unë zëvendësbrigadier, — vazhdoi Bilali, dhe, kur fliste, gjoksi i tij i bëshëm fryhej e shfryhej me shpejtësi, — unë nuk e zgjatja me ta, i bija shkurt unë, po ose jo, dhe vazhdoja punën. Nuk e njeh tōkën e Arrës Dauti. As kryetari i kooperativës. Prandaj me ta duhet bërrë luftë, o shoku Mexhit, dhe jo siç bën ti, që, për të mos i prishur qejfin kurrujti, njërit i thua «peqe», tjetrit «lepe». S'ka peqe e lepe këtu!

— Unë zbatoj urdhrat e agronomit dhe të kryesisë, — tha Mexhiti me fjalët që i shqiptoi si me protestë.

— Nuk them të mos i zbatosh urdhrat e tyre, sepse edhe ata Partia na i ka prurë këtu për të udhëhequr bujqësinë, po shiko, Mexhit, se ti je kandidat partie dhe unë anëtar, ne kemi përgjegjësi të madhe për çdo gjë që ndodh në brigadën tonë. Po të isha unë, meksikanin nuk e mbillja dhe bille do ta kisha bindur edhe agronom Dautin edhe kryetarin. Dauti është i ri në kooperativën tonë, ai thotë ato që ka mësuar nëpër libra. Mirëpo librat nuk flasin apostafat për Arrën. Ne kemi librin tonë, eksperiencën e të parëve dhe tonën. E dyta, e kam fjalën përsëri po për grurin. Ti, Mexhit, e vonove mbjelljen. Gruri mbiu i dobët, vonove edhe hedhjen e nitratit dhe grurin e mbuluan barërat e këqia. A ju kujtohet, shokë, se si filloj të zverdhej gruri? U bë që s'shihej me sy...

— Unë s'jam fabrikë që të prodhoj nitrat, — kundërshtoi përsëri me vrull brigadier Mexhit. — Kur ma sollën, e hodha në arë.

— Jo, jo, se nitrati ndenji një javë në magazinë, — ia priti Bilal Bregu me ton të qetë. Kështu fliste ai ngahera, pa u ndezur, fiste si babaxhan, por shpesh kishte logjikën e fakteve.

— Me se tă merrja? Ju e dini se dy kuaj ka gjithsej brigada jonë!

— Prit, Mexhit! Tani po i ngatërron hesapet, — ndërhyri Islam Sula. — Pse s'kërkove ndihmën e organizatës bazë-ti, Mexhit? Pse s'm'u drejtave mua si kryetar i këshillit të bashkuar? Brigada vërtet ka vetëm dy kuaj, po mos harro se fshati i ka një pesëmbëdhjetë gomarë. I ngarkoje një ditë ose dy dhe ja tek e solle nitratin.

— Nuk mund të shpenzoj ditë të tepërtë pune unë, — iu drejtua përsëri Mexhit Islamit si me mospërfillje.

— Mbaje, pra, mbi kurrizin tënd mosrealizimin e planit të grurit! — ia priti Bilal Bregu.

— Ta mbajë kryesia e kooperativës, — tha Mexhit me zërin e vet të ngjirur e si të lodhur dhe lidhi duart te gjunjët.

— Dëgjoji vërejtjet e shokëve ti, shoku Mexhit, se ato janë të vlefshme, — ndërhyri Pashonia me fjalë të shkoqura mirë.

— Kam edhë një çështje tjeter, — vazhdoi Bilali, duke marrë frymë thellë me atë gjoksin e tij të gjerë. — Ne mbo llëm fasule plaqi, por morëm aq pak prodhim, sa ma merr mendja që nuk nxorët as shpenzimet e ditëve të punës dhe të hunjve që bëmë!

Mexhit u ngrit i papërmabjatur.

— Pse ndodhi kjo? — pyeti dhe vetullat iu bashkuan.

— Hë, pra, pse? — pyeti si me qesëndi Bilali.

— Sepse fasulja donte ujë! Kryetari na pati thënë mbi llemi, se uji do t'ju vijë, por uji s'na erdhi.

— Po, po, or Mexhit, është kollaj t'ia veshësh kryetarit, kur ai s'është këtu! — tha Bilali me zë të pakënaqur dhe u ul.

— Po një pjesë e gështenjave përse u dëmtuan? — pyeti Petriti pas një heshtjeje të shkurtër me vështrimin të ngulitur në drejtim të Pashones.

— Përgjigju, Mexhit! — tha Pashonia.

Mexhiti u ngrit si me përtesë. Ishte i parruar dhe nga kjo dukej më plak nga ç'ishte. Kiske veshur një xhaketë kadife dalëboje dhe poshtë saj i dukej fanella e trashë prëj leshi ngjyrë kafe. Sytë i kiske si të kunadhes, flokët pak rebelë, të ndarë me një vijë anash.

— Për gështenjat puna qëndron kështu, — tha ai ngadalë me një ton pak të shtuar, si të lodhur. — Një pjesë të gështenjave ne i kemi sipër, afër udhës automobilistike, dhe na i dëmtojnë kalimtarët. Kurse një pjesë na i dëmtojnë derrat.

— Përse nuk i vrisni? — pyeti Sulë Metani, duke i hedhur një vështrim të mprehtë.

— S'kemi armë gjuetie, shokë, kurse me armë lufte është e ndaluar gjuetia e derrit.

— Mirë, mor Mexhit, më fal, se po të ndërpres, — u dëgjua zëri i pakënaqur i Islam Sulës, — unë, për he-sapin tim, po ty të bëj fajtor. Ti nuk po e organizon mirë brigadën. Përse nuk fillove të vilje pikërisht atë zonë që bie afër rrugës automobilistike, po fillove këtej? Ky nuk është viti i parë që po na dëmtohen gështenjat. Çdo vit kështu po na ndodh neve...

Mexhiti s'diti ç'të thoshte. Fytyra i mori një pamje të vrazhdë.

— Vlerësoji mirë vërejtjet e shokëve, — e këshilloi Bedri Gjuzi. — Edhe kritikat që të bëri Bilali janë me vend.

— Sa rrënje gështenja kemi ne? — pyeti përsëri Petriti.

— Se mos i kemi numëruar! — ia priti Mexhiti, duke ngritur supet.

— Pse? Po mbushen 25 vjet nga dita e Çlirimt dhe ju thoni...

— Po nuk numërohet pylli, more vëlla! — ia priti Mexhiti me sy si të hutuar.

— Jo, shoku Mexhit, numërohet që ç'ke me të, — tha Petriti dhe sytë i shkëlqyen. — Ju edhe planim e gështë-

njave nuk e keni real, derisa nuk dihet sa rrënëtë kemi. Ju thoni se do të marrim dyqind kuintalë gështenja. Mbi ç'ba-zë? Kush më siguron mua se nuk mund të marrim katërqind kuintalë? Prandaj duhet patjetër të bëjmë inventarin e gështenjave. Socializmi është llogari, na mëson Lenini.

— Shumë drejt e ke, — u hodh Sherif Arra, dhe vuri mbi bllokun e shënimve lapsin e tij. — Edhe katërqind kuintalë, edhe pesëqind kuintalë gështenja mund të mbledhim ne. Më kujtohet se, kur ishim privatë, ngriheshim natën, me fenerë në dorë, dhe gjithë familja, me gra, e me kalamaj, shkonim e mbledhnik gështenja. Zaten me gështenja e me mollë jetonim ne, se shtëpia më e mirë këtu, në Arrë, bënte a s'bënte tre muaj bukë. Pleqtë tanë gjithë dimrit shis-nin gështenja dhe blinin misër. Kurse sot, që shteti na e ka siguruar bukën, ne i biem së mirës me këmbë, na ikën mali dëm. Pastaj qahemi se marrim tetë-nëntë lekë në ditë! Shumë janë bile! Kështu nuk e kemi në terezi punën. Buka është në tokë, paret janë në tokë, çdo gjë është në tokë, prandaj odo gjë varet nga duart toma. Unë jam dakord me vullnetarët që ta bëjmë inventarin e gështenjave në bashkë-punim me ndërmarrjen e pyjeve.

Jashtë kishtë rënë errësira. Në qìell shkëlqenin yje të panumërtë. Petriti mbërtheu kopsat e xhupit. Ajri i ftohtë i digjte gurmazin. Por e ndiente të nevojshme atë ajér, të lehtë, të ftohtë. Ai bëri disa hapa, i kredhur në mendime. Mendonte ai për mbledhjen, për psikologjinë e komunistëve fshatarë, për problemet e mëdha. Vërtet fshati paskësh halle, dhe telashe! Ai nuk e kishtë ditur kaq qartë sa tani. E shih-te se duhej punë, luftë, përpjekje në shumë drejtime. Rreth e rrötull qetësi. Malet flinin. Tutje nuk shihej asgjë, veçse yje që vezullonin pranë e pranë.

— E kape mirë gështjen e inventarit të gështenjave ti,
— dëgjoi ai zérin e një shoku. Ishte Sherif Arra. — E kape shumë mirë, — shtoi përsëri ai.

Petriti s'foli.

— Ishe dreq i madh ti, — qeshi pas pak Sherifi si me tallje.

— Pse?

— Të merrje arrat ti! I shtrove shumë mirë problemet, por megjithatë do kujdes.

— S'po të kuptoj, — pëshpëriti si i mërzitur Petriti.

— Ne, katundarët, i themi një fjale: druri nuk pritet me një sépatë.

— Edhe ne kështu i themi.

— E thoni, e thoni, po kuptimin nuk ia dini mirë.

Petriti qëndroi si i habitur.

— S'po të marr vesh, — foli pa e ngritur zërin.

Ta jepin karakteristikën të zezë në fund, po vazhdoive kështu, — e nxori gjuhën jashtë, si breshkë, Sherifi.

Petriti vuri buzën në gaz me ironi.

— As që pyes fare për këto gjëra, — tha.

— Ta thashë këtë për të mirë, mos ma merr ters muhabetin, ti po më pëlqen, se qenke i gjallë dhe i drejtë.

Petritit qyshi në fillim Sherifi i ishte dukur nga ata që e mbajnë veten për «kapo», që medoëmos duan të dukën e të dalin mbi të tjerët.

— Për parimet e Partisë unë nuk trembem dhe nuk lëshoj as kaq, — i ra shkurt Petriti dhe i afroi te sytë dorën e tij, ku kishte bashkuar thonjtë e dy gishtërinjve:

9.

Xhelal Vishnja, si hëngri një tas me kos, që e bëri përshest aty afër dritares, u nis të dilte. E ëma, Xhevria, po mëkonte nipçen e vet të vogël. Dëgjohej zëri i saj ledhatues, që i bënte nina-nana vogëlushit. Ishte mëngjes. Një pulë kakariste në oborr. Bora kishte shkrirë, por vende-vende ajo formonte ca vraga të bardha, sidomos nëpër lugina, nëpër të çarat e maleve dhe thellë në pyje.

— Na mbush nja dy gjyma me ujë, — e porositi eëma Xhelalin, kur tërroqi derën pas. Xhelali nuk u përgjigj. Vijo udhën e tij. Kur doli te gardhi, aty ku vendi ishte si kodër, hodhi sytë andej nga zyrat e kryesisë. I shihte ato si në pëllëmbë të dorës. Pastaj rrotulloi kokën djathtas dhe dalloi Pashonen, që po tërhiqte lopën. «Sot do të kemi lajme», — mendoi me vete ai dhe u shtriq. Ishte i hollë e i gjatë, me një fytyrë vezake e me flokë që i binin mbi ballë. Ai mendoi të shkonte te Pashonia, por ndërrroi mendim. Ishte akoma shumë herët. Nuk duhej të epej kaq lehtë para saj. Duhej të priste edhe pak. Zyrat nuk ishin hapur ende. S'kishte njeri përvëç rojes, xha Isufit, me pushkë në sup, dhe qenit të Sherifit, i madh sa një ujk, që vinte rrrotull, duke nuhatur qosheve të mensës. Pastaj Xhelali u kthyte përsëri te shtëpi, mori dy gjymat dhe zbriti për nga çezma e fshatit. Aty gjeti furrxhiun që po vinte tubin e gjatë prej gome, që uji të arrinte deri në furre.

— Hiqe një cikë atë zorrë sa të mbush gjymat, — i tha Xhelali.

— Hajde, shpejt, se do të zë brumët unë.

— E di, vallahi, të këputën punët ty.

— Ke të drejtë ti, se ty dy mbëdhjetë të bie.

Xhelali buzëqeshi, hoqi gjymin e parë dhe vuri të dytin, pastaj tha:

— Dhe nja dy a tri ditë do të jemi bashkë, pastaj do të kesh të bësh me tjetër njeri.

— Me cilin?

Ndoshta me Selimin ose me Bilalin, nuk e di cilin do të caktojë Mexhiti.

— Po ti ku do të shkosh?

— Në kurs, për normist.

— S'ma merr mendja!

— Ajo ka marrë fund, — tha me ton të sigurt Xhelali. — Mbrëmë është bërë mbledhja e organizatës së partisë dhe ka vendosur edhe për çështjen time.

— Ti s'shkon për në kurs, — kundërshtoi përsëri furrxhi gjithnjë me ton të qetë.

— Pse? Të gjitha kushtet i kam.

— Për mua nuk i ke.

— Ashtu?! Ja, pra, ku po ta them hapur: mbrëmë ajo ka marrë fund. Deri në ora njëmbëdhjetë i prita, por ata e vazhduan mbledhjen edhe më vonë, — vijoi Xhelali me fytërën e tij akoma të përgjumur.

— Shih, po s'doli fjala ime, — e kundërshtoi me qesëndi furrxhiu. — Ti ke në punë të shtetit edhe tre vëllezër të tjerë. Vetëm për veten tuaj luftoni ju, për të tjerët as që e çani kokën.

— Po shati te këmbët e veta tërheq, — dhe Xhelali u zgërdhi.

— Partia i sheh këto, or Xhelal. Shati duhet të punojë me drejtësi, se ndryshë e bëjnë lopatë; — ia priti furrxhiu me sytë e tij të-embël, si sy gruaje.

Xha Isufi, me pushkën hedhur në sup, pak i kërrusur nga vitet që i rëndonin mbi kurriz, u afrua ngadalë.

— Ndize shpejt atë furrë, or qun, se na preu të ftohtët, — i tha ai furrxhiut.

— Rojet nuk duhet të ngrohen, ia priti Xhelali, tek po hiqte gjymin e dytë. Furrxhiu i vuri çezmës tubin. Xha Isufi tundi kokën e tij gjithë thinja.

— A di gjë kur mbaroi mbledhja mbrëmë? — e pyeti Xhelali dhe ngriti gjymin.

— Shumë vonë, aty nga ora një e natës.

— More vesh ndonjë fjalë?

— Jo, Secilli iku në hesap të vet, se, helbete, sharruan për gjumë.

Xhelali po i ngjitej së përpjetës me gjymat në dorë. Përballë tij po vinte Sherif Arra. Ai zbriste për në zyrat. Xhelalit i rrahu zemra me vrull.

— E, Sherif? — e pyeti me një zë që iu duk sikur s'ish-te i tij:

— Nuk u bë gjë, o Xhelal.

— E pse? — Xhelali u bë si plak në fytyrë.

— Nuk duan, vunë tjetër njeri.

— Cilin?

— Selim Qarrin.

— Po përmua çfarë thanë? — Zeri i Xhelalit fshihte nuanca të theksuara zemërimi.

— Thanë se Xhelali i ka tre vellezër në punë të shtetit.

Xhelali me zor po ngopej me frymë. Me buzët e tij të holla, ai diç pëshpëriti më vete. Sherifi e kuptoi se ai dikë shau.

— Po Pashonia ç'tha pér mua? — pyeti pas pak, duke marrë frymë me gurmazin që i fërshëllente lehtë.

— Pashonia! E ç'të thoshte ajo!...

Xhelali vuri buzën e poshtme mbi të sipërmen. E ndiente veten të fuqishëm dhe azgan, por...

— Nejse, — tha si i lodhur dhe i vrarë. — Këtu jemi, — dhe zuri të ngjitej ngadalë drejt së përpjetës që e konte në shtëpi. Futi gjymat në kuzhinë dhe hodhi sytë si kusar rrëth e rrötull. Ishte bërë tym.

Ai dëgjoi se prapa oborrit eëma po grindëj me kuniten e tij. Xhelali u nis drejt tyre.

— Po ju ç'keni që bëni si kulkuvajkat? — iu drejtua ai më shumë së kunate sesa s'ëmës.

— Më thotë që të mjel lopën, pastaj të dal në punë, kurse mua më pret Mexhiti atje te magazina! — u ankua e kunita.

— Mile, imile lopën, se Mexhittit hala s'i ka dalë gjumi! — i tha Xhelali, si të ishte ndonjë burrë dyzetvjeçar.

— Më bëhet vonë, mofe Xhelal, sa të nxjerrë gomarin, sa t'i vë samarin, më iku dita mua! — u ankua përsëri Fatimeja, e kunita, një grua me fytyrë të gjerë e me barkun që i rritej nga dita në ditë pér shikak të barrës.

— Bëj ashtu si të thotë kjo! — shënoi me gisht t'ëmën Xhelali dhe lëshoi një pshëretimë të thellë.

— Do të më bërtasë Mexhiti, — murmuriti nën buzë Fatimeja.

— Ai le t'i bërtasë së shoqes dhe jo ty!, — i mëshoi zërit Xhelali.

— Xhada! — nëmi Xhevria, eëma e Xhelalit, një grua mbi të shtatëdhjetat, e njohur në të gjithë fshatrat e kooperativës si grua që s'linte njeri pa përfolur dhe pa i vënë një bisht.

— Më dogjën edhe kësaj radhe, — murmuriti Xhelali me fytyrë të njomur ca nga dëshpërimi, ca nga fraqi.

— Kush tē tha? — pyeti pas pak si e ngrirë Xhevria.
— Sherifi, Sherif Arra.

Heshtje.

— A ka rënë katundi nē dorë tē një copë gruaje? — ia priti thekshëm Xhevria, dhe ai syri i majtë, i çapëlyer, sikur i doli kokërdhok.

— Ma punuan keq!

Xhevria po fryhej brenda pér brenda. Ajo bëri sikur po shkonte nē haur, por mendjen e kishte gjetkë. Hapi derën e haurit dhe pa dhitë e saj. Kishte dymbëdhjetë krerë, pastaj mori një krah dushk nga mullari dhe ua hodhi bagëtive te këmbët. Derën e mbylli me reze. Ajo i ra anash oborrit dhe doli te gardhi, aty ku pak më parë kishte qëndruar edhe i biri, Xhelali. Dielli sapo shkrepi rrezet e tij tē arta. Malet sikur u veshën me një ngjyrë tē émbël trëndafili, kurse zalli poshtë mbulohej nga tisi i hirtë i mjegullës. Xhevria qëndroi një copë herë ashtu, nē këmbë, e zhytur nē mendime. Ishte grua e prapë ajo! As i shoqi, Arifi, ndjesë pastë, nuk e kishte bërë dot zap Xhevrien. — Ku m'u shpife ti pér grua mua! — i thoshte Arifi, kur zemërohej.

— Ti s'më ke pasur hak mua, more derdimen! — ia ktheonte ajo me vrull. — Ç'kérkon më shumë nga unë ti? Pesë djem t'i bëra, shtëpinë ta mëkëmba, ç'do më nga unë!

— Pusho, pusho, se tē njoh mirë unë, — dhe Arifi i varfër largohej gjoja sikur po bënte diçka, se e dinte që Xhevria do t'i vërsulej ashtu siç dinte tē vërsulej ajo...

Ajo vazhdonte tē qëndronte nē këmbë. Ishte veshur me brekushe, me jelek tē zi, shenjë e zisë që mbante pér Arifin e vdekur vite më parë. Vetëm nē kokë kishte hedhur një rizë tē bardhë që i mbulonte edhe një pjesë tē shpatullave dhe mbaronte me një nyje nē fund tē gushës gjithë rrudha.

Xhevria ndenji sa ndenji aty te gardhi, pastaj zuri tē zbriste ngadalë, me hap tē kontrolluar mirë, drejt shtëpisë së Pashones. Kishte dëshirë tē ndeshej me tē. Ajo nuk mund tē rrinte pa i thënë nja dy fjalë asaj sekretares, që ishte bërë shkaktare që i biri tē mos shkonte pér normist.

Pashonia diç i thoshte të shoqit aty te dera. Xhevria u kollit lehtë pér t'u treguar se ndodhej aty dhe se kishte ardhur apostafat pér të biseduar.

— E, si u gdhitë ju Krepajt? — pyeti ajo me zë në dukje dashamirës, por që Pashonia e kuptoi se plaka Xhevrie me zor e përbante veten.

— Mirë shqyr, po ti si u gdhive? — ia ktheu Pashonia. I shoqi i saj, Xhemal Krepi, u largua.

— Më mirë të mos më kishte zënë dita! — foli Xhevria si me rënkim e më një zë të lodhur e të ashpër.

— Pse? Mos je sëmurë?

— E sëmurë. çdo ditë jam unë, moj Pashone, por ju po më varrosni pér së gjalli! — dhe fytyra e madhe e Xhevries u nder, mori një formë të çuditshme. Syri i majtë, i çapëlyer, një herë iu zgogëlua, pastaj iu hap jashtë mase, kurse syri tjetër, i egër, i ra rrötull fytyrës së Pashones me kërcënëm.

— Jo, moj Xhevrie, se ne të duam ty.

— Punoni me hile, oj Pashone, po mbani hatërlliqe!

— Partia nuk merret me hatërlliqe e me hile, por me drejtësi, — tha Pashonia dhe ndeu nja dy ndërresa të Mirës mbi një fill tel, që e kishte lidhur te trarët, në hajat.

— Partia nuk bën hatërlliqe, por disa nga ju po punoni si jua do qejfi e zemra, — u mëshoi fjalëve Xhevria dhe e nxori gjuhën si thimth gjarpri.

Pashonia e vështroi nga këmbët gjer te koka, si me qortim.

— Jo, Xhevrie, ne nuk punojmë si na e do qejfi, por me drejtësi, — përsëriti Pashonia.

— Pse s'ma dërguat djalin në kurs, pra?

— Duan të hanë edhe të tjerët, moj Xhevrie, kurse ti vec pér fëmijët e tu përpinqesh.

— Po i kam jetimë, moj Pashone! — dhe sytë e saj, edhe i çapëlyeri, i ranë rrötull përsëri plot nakar fytyrës së Pashones.

— Ata u rritën e u bënë burra tanë, s'janë më jetimë, — foli pas pak Pashonia me zë të butë. — Njërin djalë Partia

ta bëri ndihmësmjek, dy të tjerët i ke po në punë të shtetit me nga gjashtëqind lekë në muaj. Mirë do të ishte ta kishit edhe Xhelalin në kurs, por ka edhe të rinj të tjerë që kanë bërë lutje. Ne kemi vendosur me drejtësi, kemi dërguar një djalë tjetër, që nuk ka asnijë njeri në punë të shtetit.

Xhevria kishte ulur sytë përdhe dhe dëgjonte pa folur, me nofullat që i lëviznin.

— Ty s'të vë faj unë, — foli ajo gjithë smirë dhe psherëtiu me brengë, — një copë grua je ti! E q'mund të bëjë një grua mes dhjetë burrash? Ata të sjellin rrrotull ty. Ti helbete do të firmosësh ç'të të japid ata! S'ke faj, por.... — Xhevria psherëtiu thellë.

E kuqtonte mirë Pashonia domethënien e atyre fjalëve gjithë romuze të plakës Xhevrie. E dinte ajo se ku i rrithët çekani asaj, por Pashonia kishte vendosur të mos binte në çark e të mos jepej, se helbete Xhevria aq donte, një shlkak që të ndizej e të shpërthente me furi...

— Megjithatë, Partia është e madhe, ka se kush na e gjen të drejtën edhe neve, — i tërhoqi fjalët zvarrë Xhevria me fytyrën të shëmtuar nga inati.

— Kërkoje të drejtën, Xhevrie, rrugët i ke të hapura, kurrikush nuk të pengon, por përmendimin tim...

— Mendimin tënd e di unë, edhe mendimin e të tjerëve, e di, — e ndërpren plaka me gjuhën që i lëvizte gjithë përtim. — Por më vjen keq që po na i ngatërroni litarët në-për këmbë! E do hapur fjalën time ti, Pashone? — e ngriti zérin ajo me një vështrim të shëmtuar. — Katundi po vuani përmes sebepin tuaj, se ju u jepni të drejtë atyre që therin keçë e që shtrojnë darka e dreka, kurse — ajo e holloj shumë zérin, — Xhevria e shkretë nuk ka as keçë, as...

Pashonia qeshi.

— Rrofshin keçat, oj Pashone! — vazhdoi Xhevria me një zë si e lehura e një koneje.

— Po edhe ti ke keçë, — ia priti Pashonia me qesëndi, — edhe ti ke shtruar darka e dreka. Përsëri mund të shtrosh, askush nuk të ndalon. Sa përmua, kur të shtrohet çështja

imë në popull, ti ngrihu e thuaj që Pashonen nuk e duam për sekretarë partie dhe aty m'i numëro të gjitha, një përnjë, mbi në sy të popullit.

Xhevria s'foli. Qëndroi një copë herë më këmbë, tundi kokën nga dy a tri herë, pshëritiu dhe u nis drejt zyrave të kooperativës. Kishte ndër mend të bisedonte me kryetarin...

10.

Nga qyteti po vinin njëri pas tjetrit, si varg rosash, nëpunësit e kooperativës. Në krye printe doktor Kristoja, një burrë me fytyrë të fryrë e me faqe gjithë mish, të rëna si të atyre qeve të vjetër, ndonëse ai nuk ishte më shumë se dyzet vjeç. Ishte pak i shkurtër, i shëndoshë dhe me barkun pothuajse si grua shtatzënë. Sytë i kishte të mëdhenj, vetullat të trasha, të zeza dhe ballin të ngushtë. Kur fliste, përdorte atë dialektin e bregut të detit, dhe shpesh kishte raste kur fshatarët, sidomos të kaluarit nga mosha, me zor e kuptionin. Pinte cigare me filter, vishej mirë e pastër dimër verë dhe ndonjë që s'e njihet mirë do të kujtonte se ai kishte para të depozituara në arkën e kursimit. Doktor Kristoja për të punuar punonte, por kishte një zakon që lëvdohej pak si shumë. Megjithatë, ua kishte fituar zemrën fshatarëve, se shpesh u vente në shtëpi të sëmurëve edhe deri në Derdôm, edhe natën, pa pyetur fare përrugët e vështira, gjithë baltë dhe me të përpjeta e të tatëpjeta. Fshatarët e donin dhe e çmonin, se, përpëra se të vinte ai në Arrë, njerëzit, sidomos fëmijët, kishte raste që vdisnin edhe nga një grip, kurse tanë mortaliteti i fëmijëve kishte rënë shumë.

Pas doktorit vinte infermier Sefedini, por shokët e

thërrisnin Sefë. Ky ishte një numër më vete, si i thonë fjalës. Kishte trup të bëshëm, kokë të gjatë, si vezë pate, dhe çà sy të kërcyer e të skuqur anash. Njihej nga të gjithë si njjeri shakaxhi, por shpesh shakatë i kishte fare pa kripë, banale. Me cilindo që takohej, kishte për borxh të hynte menjëherë në muhabet, merrte përsipër detyra të ndryshme ndaj njërit ose tjetrit dhe pastaj përpiquej që nga këto mafifete të nxirrte ndonjë përfitim për vete. Edhe me vullnetarët ai u njoh fët e fët, bile një ditë, gjatë pushimit të drekës, zuri të tregonte në ambulancë pothuajse gjithë biografinë e vet.

I treti që po vinte me këtë grup, ishte shefi i llogarisë, njjeri serioz, i shtruar në muhabet dhe i aftë për punën e tij. Fshatarët e nderonin dhe e çmonin, madje e çmonte edhe vetë kryetari i kooperativës, për arsyen se ai, shefi i llogarisë, kohët e fundit kishte bërë një studim me leverdi të madhe për ekonominë, sipas të cilit shkurtoheshin pothuajse fare normistët. Studimi i tij kishte bërë bujë edhe në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit, ai kishte ngjallur shumë diskutime në mjaft specialistë të rangjeve të larta. Disa financierë ishin orvatur ta hidhmin poshtë si diçka fantastike e të papranueshme për kooperativat e tjera, por ai kishte ngulur këmbë dhe nuk ishte tërhequr, derisa më në fund i kishte bindur edhe ata që e kundërshtonin.

Pas shefit të llogarisë ecte me hap të vogël e të shpejtë ekonomistja e kooperativës, Liriq, një vajzë me trup të imët, me flokë të zinj, të lëmuar, që herë pas here i binin mbi ballë dhe ajo i largonte vazhdimisht me dorë. Kishte një fytyrë shumë të pastër, me lëkurë të hollë si cipë qepe, dhëmbët i kishte pak të mëdhenj dhe sytë si të lodhur, por që i shndrisnin si fosfor. Vishej me pantallona stofi të mirë dhe, në vend të palltos së madhe, mbante një fëshfëshe najloni njyrrë blu të errët. Nën fëshfëshe i dukej një triko prej leshi deve, që e ruante shumë se mos i ndotëj ose mos ia gërvishitte ndonjë ferrë me gjemba.

I fundit, me çantën të fryrë plot me ilaçe, vinte vetrineri i kooperativës, Afrim Qosja, një djali i hollë e i gjatë, me një fytyrë të vockël, me hundën me majë e me një të folur me zë të lartë. E mbante veten për «asin» e kooperati-

vës, grindej pothuajse me të gjithë, madje edhe kryetarit të kooperativës nuk përtonte t'ia prishte. Kur të gjithë këta mbërritën te mensa, sheshi i vogël pëmpara zyrave filloj të bugiste nga zërat e njerëzve, nga bisedat e shakatë. Të gjithë flisnin me zë të lartë, madje edhe për ndonjë çështje fare të rëndomtë.

— Tani vihat në punë? — ia këputi Sherif Arra veterinerit dëhe doktor Kristos.

— Pusho aty ti, tullac! — ia ktheu doktor Kristoja dhe ndezi cigaren me filtër.

— Nuk sheh sa ma ka gojën? — ia priti veteriner Afriimi dhe i dha çantën një fëmije për t'ia shpënë në zyrë.

— Po bëni pallë ju në këtë kooperativën tonë! — vijoi Sherifi pa e prishur terezinë. — Vini në orën tetë, punoni nja tri a katër orë dhe, o burra, kush të zërë i pari Kapërcyellin.

— Shko, shko në brigadë ti, se atje e ke vendin, — i tha Kristoja, dhe gusha e trashë i dridhej tek fliste. — Gjynah, i kë zënë vendin një gruaje.

— Lëre brigadën time ti, shih më mirë mamitë, që po të ikin qdo natë në qytet, kurse atij tjetrit po i ngordhin dhitë.

Veteriner Afriimin sikur e pickoi një mizë e keqe dhe u kthye me vrull nga Sherifi:

— Ke gojë e filet, tullac i dreqit! Ti me ca shokë të tu jeni dembelë, ju s'keni siguruar bazën ushqimore dhe tani bagëtia s'ka q'të hajë. E shihni ju se një kë peshon gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë kilogram? Turp për ju, dhe guxoni të hapni edhe gojë!...

Sherifi sikur u thartua në fytyrë. Ia priti gjithë nakar:

— Edhe për bazën ushqimore ju, veterinerët, jeni fajtorë. Përse nuk mbollët hasëll ju?

— Shko e merru vesh me kryetarin për çështjen e hasëllit ti.

— Pse me kryetarin, kur të kam ty këtu? Ti duhet të luftosh për bazën ushqimore dhe jo né! Brigadës ti i ke kërkuar, fjala vjen, njëqind bigë dushk. A t'i bëri brigada njëqind bigët?

Doktor Kristoja, tek po hante një pjatë kos në mensë,

kënaqej kur shihte Afrimin, që e kishte vënë përpara Sherifin dhe tinëz i shkelte syrin, që të vazhdonte ta thumbonte.

— Rrini nja dy a tri orë në fshat dhe, o burra, te gratastë në qytet! — fliste Sherifi, mbështetur në pragun e derës së mensës. Afrimi, për t'iu shmangur bisedës me Sherifin, u drejtua nga Liria, që mori fshesën për të pastruar zyrën e kryetarit të kooperativës. Bënte shumë shakara veteriner Afrimi me këtë vajzë të urtë në dukje, por shpuzë në të vërtetë.

— Dje jam takuar me tët shoqe mu te mapoja e madhe, — u kthyte Liria nga ai. — I thashë nja dy fjalë në vesh, — dhe vajza qeshi me gjithë shpirt.

— Për mua?

— Po, po, për ty. Për cilin tjetër?

— Aha!, — ia priti Afrimi. — Ajo ka besim të plotë tek unë.

— Shih se si do të të presë sonte! — Dhe Liria doli duke buzëqeshur me fshesën e lagur në dorë.

Te depot rrinte plaka Xhevrie. Në të djathëtë të saj, xha Isufi me pushkë në sup. Ai tymoste dhe rrallë fliste me Xhevrien.

Xhelal Vishnja kishte marrë kalin dhe kishte ardhur në magazinë. Nxori nga një thes disa grushte me hime dhe ia hodhi kafshës në një helmetë gjermane. Kali hapi vrimat e hundës, përplasi njérën këmbë në tokë dhe zhyti turinjtë në helmetë.

— E ke parë sot kryetarin, or Afrim? — u dëgjua zëri i Xhevries.

— Kaq shumë të paska marrë malli për kryetarin? — ia priti Afrimi dhe i hodhi një vështrim të kujdeshshëm.

— Epo, helbete, derisa e kemi zgjedhur kryetar!... — foli ajo me zërin e saj gjithë sqimë.

— Jo, nuk e kam parë, — tha ai dhe u largua. — Por do të vijë se kemi mbledhje sot, — shtoi tek mori kthesën pas dyqanit.

Xhevria hyri në kuzhinën e vogël të mensës. Xhelal Vishnja goditi me shkëm buzet e kalit, që nuk donte të lagohej nga helmeta. Kafsha u tremb dhe u drodh sikur ta

kishte zënë korenti. Xhelali i këputi një të sharë vendje dhe pastaj filloi të ngarkonte dengjet me grurë.

— Sa rrugë do të bëni sot? — e pyeti magazinieri dhe i zgjati bllokun me fletëdalje pér ta firmuar.

— Një rrugë, — tha Xhelali me zë të pakënaqur.

— Pse kaq pak?

— Kam edhe unë hallet e mia!

— Pó njerëzit duanbulkë, or ti çun, — foli magazinieri me ton palk të ashper.

— Po punët e mia kush m'i zgjidh mua?! As që po e çaj fare kokën pér bukën e njerëzve! — tha ai me ata sytë e zymtë e të thellë.

— Bisedo me Mexhit Drizën që të tē zëvendësojë, se ndryshe do tē na nxjerrësh ngatërresa tē kota, — e ngriti zërim magazinieri.

Në derë u duk agronom Dauti. Në dorë kishte ushqimin, e mëngjesit tē mbledihur me gazetë që i ishte ndotur vende-vendë me lyrë. Xhelalit i qeshi nuri. E kishte mik pér kokë Dautin ai.

— Silkur je vonë një cikë, Xhelal, — i tha agronomi, dhe hunda e tij e madhe, më samar, i lëvizti përpjetë.

Xhelali e tèrroqi jashtë dhe i tha:

— E more vesh së sì ma punuan?

— Më tha diçka Xhevria, — pohoi Dauti me ballin që iu rrudh.

— Po si i bëhet hallit?

— Mos u mérzit! Cdo gjë do tē rregullohet pér bukuri. Tjetër njeri nuk shkon pér normist! — i mëshoi zërit ai.

— Këtë dua edhe unë! — murmuriti Xhelali me sytë që i shkëlqyen nga gëzimi.

— S'ka rrugë tjetër, ose ti, ose askush tjetër! — përfundoi agronom Dauti.

Xhelali e përkëdheli me dorë të supi i djathjtë.

— Rrofsh! — i tha dhe pshëreti thellë, gjithë kënaqësi..

Pas mbledhjes me kuadrot, kryetari i kooperativës, Petro Doraci, një burrë rrëth të pesëdhjetave, me trup të mbajtur mirë, me flokë të rënë e të thinjur te tëmthat, me një fytyrë të rrumbullakët e me ca sy quditërisht të bardhë, po bisedonte me kolegët e vet të punës. Ata ishin ulur nëpër karrige portative rrëth sobës prej teneqeje të skuqur nga zjarri që bubulonte brenda saj.

— Po atë teknikum e kadastrës, atë Mihal Andonin, e ke njohur ti, shoku kryetar? — sekush e pyeti.

— Si jo! — tha Petroja, duke lépirë buzët. — Sa qyfyre kam më të unë! Ja t'ju tregoj diçka, — dhe Petroja u mbësh-tet më mirë me bërrylin mbi tavolinë. — Ishte viti 1948 a fillimi i dyzetenëntës. Atëherë po bënim korrigjimet e reformës agrare, sepse ishin vërtetuar sabotime. Nëpër komisionet e fishatarëve të varfër, aty-këtu ishin futur kontrabandë edhe elementë dallaveraxhinj, bile edhe kulakë dhe e kishin ndarë tokën jo në bazë të udhëzimeve të dhëna nga qeveria. Mihalin, mua dhë një teknik tjetër, një Agim Mete, na rastisi të shkonim andej nga zona e Vlorës. Bukur. Tek ishte centrali elektrik, në rrugën e Durrësit, po prisnim ndonjë makinë. Pas pak përpara nesh po vinte një burrë bu-lafiq, me barkun sa një kosh. «A e njihni Xim Agën ju?» — na pyeti. — Jo, — i thamë në. «Mos u mërzitni së do ta ngas një cikë, — na tha Mihali. — Ka qenë tregtar ky, tregtar manifaturash». — Tregtari kishte një fytyrë të gjërë e të madhe dhe ishte me dy gusha. S'më kujtohet mirë, ka qenë korrik apo gusht, po fytyrën e atij Ximit sikur e kam para-sysh edhe tani. E kishte nxjerrë gjuhën pak jashtë, si një gen i lodhur, duart i mbante te ijet dhe xhaketën e kishte hedhur krahëve. «Nga paske qenë kështu, or Xim Aga?» — e pyeti Mihali me zë të lartë, me një ton shumë të përzemërt. Ximi ngadalësoi hapin, picërrroi sytë, vuri dörën si strehë për të njohur njeriun që i foli dhe u përgjigji si i lo-dhur: «Isha te një mik në Kashar, por më doli për hundësh,

ta hajë dreqi ta hajë! «Pse o Xim aga?» — e pyeti Mihali. «Prit se po gjej ndonjë makinë, s'ka! Ec e ec, kthe kokën prapa, derisa mbërrita. Jam bërë telef, eshydibilah!» «E ç'tu desh Kashari ty, or Xim Aga!» — e thumboi Mihali. «Hë pra! — ia priti Ximi, — pse thonë se qeni, po s'përmori në derë të xhamisë, nuk tërbohet! Edhe unë, me ç'duket, jam tërbuar! Po, ti i kujt je, or çun se vallahi s'po të njoh!» «Unë jam çuni i Kilit, o Xim Aga, i atij mejhanexhiut, në pazar të vjetër. A e mban mend kur ta mbushja faqoren?» «Si, more, çuni i Kilit qenke ti?! Marshallah, qenke bërë burrë! Eh, Kili i shkretë, ka qenë burrë i mirë! E kam pasur mik të vjetër, qysh në luftën e Shkodrës». «Na, dridhe një cigare,» — i tha Mihali dhe i zgjati kutinë e duhanit. Ximi kishte ca duar të mëdha, si putër ariu, dhe e drodhë si me zor cigaren, me gishtërinjtë e trashë. «Te kush ishe në Kashar, o Xim aga?» — e pyeti Mihali. «Te Li Shaqiri,» — u përgjigj ai. «O bubu, — qeshi Mihali dhe sytë i dolën kokaerdhok, — paske qenë te kulaku, o Xim Aga! E ç'tu desh ty të shkoje te Li Shaqiri? Nuk e di ti se të shikojnë pesë-qind palë sy! Me siguri do të thonë se ke shkuar për propagandë!» Ximi u prish në fytyrë. «Mirë thua ti, — foli ngadalë ai, — edhe unë e qava atë hall, po ashtu e kisha punën dhe më duhej të shkoja me domosdo». Mihali po e tallte aq bukur, sa ne me zor po e mbamim gazin. «Me punë si ia çon, or Xim Aga?» «E kush më jep punë mua, or çuni i Kilit! Më thonë shko në kazmë në kanal, po unë s'kam fuqi për kazmë.» «Nejse, ti, fundi i fundit, ke bërë qejf në këtë jetë,» — ia ktheu Mihali. «Të gjitha u harruakan, or çuni i Kilit, e fundit u mbaka mend!» «Më kujtohet, or Xim Aga, kur uleshe aty përpëra dyqanit, në ramazan, me një portokall në dorë mbushur plot me rrënje karafili dhe prisje të binte topi i ramazanit». «Ika, or çun i Kilit, ju rrofshin ç'keni për zemër! E ç'm'i kujton ato kohë të shkreta? Atëherë punoja sa një çerr dhe haja sa një derr,» — dhe iku me xhaketën krahëve. Ne u shkulëm së qeshuri. Kështu puna e Mihalit...

Agronom Dauti e kishte dëgjuar pjesë-pjesë këtë ngjarje, sepse mendjen e kishte pasur gjetkë: te Xhelal Vishnja, që nuk e kishin pranuar për në kursin e normistëve. Për Xhelalin dhe familjen e tij agronom Dauti kishte detyrime. Kushedi sa herë kishte ngrënë e kishte pirë në shtëpinë e tij, kushedi sa muhabete të ëmbla kishte bërë me të, me Xhevrien, me Fatimen dhe me të shoqin e saj, Hamit Vishnjën, e me vëllezërit e tjerë të Xhelalit.

Agronom Dauti erdhi në kooperativën «Çlirimi» të Arrës tre vjet më parë. Fill pas mbarimit të studimeve në Institutin e Lartë Bujqësor të Kamzës, ai shërbeu dy vjet si agronom në Skrapar, po atje nuk i vajti puna mbarë, për shkak se, sipas tij, «e kufizonin ata të kryesisë së kooperativës.» Pastaj e transferuan në Lushnjë, mirëpo edhe atje karakteristikën ia kishin dhënë me shënim se «nuk jep maksimumin e aftësive të tij, merret me thashetheme dhe ka shfaqje prej ambiciozi». Kjo karakteristikë i ishte lexuar mu në sy, përpara gjithë sektorit, dhe, ndonëse ai kishte protestuar, myzeqarët nuk i kishin hequr asnje presje.

Në Arrë Dauti u paraqit me një letërrekomandimi nga një shok i tij i ngushtë për kryetarin e këshillit populor të fshatit Arrë, Bedri Gjuzin. Ky, pasi e lexoi letrën, i vuri dorën në sup dhe i tha:

— Për çdo hall ose nevojë personale që do të kesh të vish tek unë, si te vëllai yt. A e shikon atë shtëpinë atje? Ajo është shtëpia ime. Derën e saj e ke të hapur ditë e natë. Edhe në rastistë që të mos jem unë, ti futu brenda si në shtëpinë tënde, dëgjove?

— Të falemnderit shumë, — i kishte murmuritur agronom Dauti dhe i kishte shtrënguar dorën me respekt...

Por punët rrodhën ndryshe. Agronom Dauti zuri miq të tjerë në Arrë, Selishtë, Bubrec, Derdom. Në shtëpinë e Bedri Gjuzit ai nuk vajti asnjëherë, se nuk pati nevojë. Zuri shoqëri të ngushtë me Xhelal Vishnjën dhe atje e ngriti bazën. Hynte e dilte pa teklif, ia shtronte për shtatë palë qejse, madje, jo rrallë edhe me raki.

— Erdhe, Daut? — i thoshte Xhevria. — Për zotin, të dua si djemtë e mi!

— E di, e di, falemnderit! Po edhe unë i dua djemtë e tu si t'i kisha tamam vëllezër.

Xhevria kënaqej. Helbete, veç të mira mund të kishte ajo nga agronomi i sektorit. Njëherë u bë regjistrimi i gjësë së gjallë dhe tri dhitë e tepërtë të saj ai nuk i regjistroi. Njëherë tjetër, Hamiti, për të vaditur bostanet e tij personale, preu me sëpatë tubin e çezmës dhe fshati mbeti rrëth dymbëdhjetë orë pa asnjë pikë ujë. Bedri Gjuzi deshi ta procedonte Hamitin, por ndërhyri agronom Dauti dhe e garantoi Bedriun se tubin duhej ta kishte prerë ndonjë njeri tjetër.

— Kush, pra? — kishte pyetur Bedri Gjuzi me këmbëngulje.

— Atë gjejeni ju, sepse ju jeni këshill, — ishte përgjigjur agronom Dauti me gjaknxehtësi.

— Ja, pra, ne po themi se e ka prerë Hamiti, — këmbënguli Bedriu.

— Thoni ju, por kjo nuk qëndron. Përse nuk thoni se e preu Islami, Xhemali apo Sherifi! Uji i çezmës nuk ka vaditur vetëm bostanet e Hamitit, por edhe të Shaqirit, të Demës, të Kadriut e shumë të tjerëve... Kështu u mbyll kjo çështje. Hamiti, Xhelali dhe Xhevria, ndonëse në heshtje, i dhanë të kuptonte agronom Dautit se i ishin shumë mirënjosës. Pastaj doli puna për kursin e normistëve. Xhevria nuk iu nda agronom Dautit.

— Aman, Daut, aman, edhe hallin e Xhelalit kam unë, po rregullove edhe këtë, vdes e qetë.

— Ç'ke ti, Xhevrie, ajo ka marrë fund.

— Kam frikën e kryetarit...

— Me kryetarin kam biseduar unë.

— E ç'të ka thënë?

— S'ka asnjë kundërshtim, në rast se e aprovon organizata bazë e partisë.

— Po kaq hyqëm të madh paska kjo organizata, more djali i nënës?

— Partia mbi të gjitha, Xhevrie, ajo vendos për çdo gjë.

Mirëpo nga çasti që Xhelali nuk u miratua për në kur-sin e normistëve, agronom Dauti, i cili teorikisht e dinte se Partia qëndron mbi të gjitha, praktikisht filloi të mendonte ndryshe. Ai ishte i bindur se këtë e kishte bërë Bedri Gjuzi, Pashone Krepi, Islam Sula dhe dikush tjetër që nuk e përcaktonte dot. Brenda përbrenda e ndjeu veten të fyter, ndjeu se tani nuk kishte më sy e faqe t'u dilte përpara as Xhelalit, as edhe pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij. Pranëndaj duhej bërë diçka, duhej turbulluar uji, duhej t'i shkonte fjala medoemos. Ishte inatçi i madh ai. Me këto mendime në kokë, vajti e u takua me vullnetarët. Në dhomën e tyre ishin edhe dy vajzat, vullnetaret nga radhët e rinisë, që ishin sistemuar në një dhomë të vogël, ngjitur me të djemve. Sulë Metani po bënte shakara me Linditën, që qeshite me zë të lartë; Elmaz Fuga po qepet një kopsë të xhaketës së vet, kurse Petrit Skënderi po lexonte «Epopenë e Ballit Kombëtar» të shkrimtarit Shefqet Musarai.

— Si u ngrysët, o shokë vullnetarë?

— Mirë, shoku agronom, urdhëro brenda!

— Jo, jo, nuk do të rri. C'thotë Lindita?

— Lindita? — pyeti Sulë Metani. — E ka mendjen te festivali i këngëve dhe i valleve.

— Aha, i harroni festivalet për nja dy a tri vjet! Këtu kemi vetëm probleme bujqësie: mbjellje, korrije, plehërim, vaditje, ja, këto.

— Po edhe çështje blegtorie, — shtoi Sula. Lindita qeshi me gjithë shpirt me sytë e saj të vegjël, si të ngulitur në atë fyttyrën e saj të madhe.

— Pse qesh vend e pa vend, Linditë? — foli si me shaka, por edhe si me qortim agronom Dauti.

— Pse, e ndaluar është të qeshësh? — ia priti Lindita me zërin e vet të gëzuar e tingëllues.

Dauti bëri nja dy lëvizje nëpër dhomë dhe vazhdoi:

— Kujtova se ju do të sillnit frymën e klasës punëtore, po... — ai s'e përfundoi frazën. Sulë Metani ndërhyn me të shpejtë.

— Pse, qfarë sollëm tjetër? — Petriti e kishte ndërprenë leximin dhe po ndiqte me vëmendje bisedën e tyre.

— Ku e di unë, mbase gapoj, por më duket se nuk po e luani rolin e duhur si vullnetarë të klasës punëtore.

— Shprehu më konkretisht një çikë, shoku Daut. Ne i duam gjërat troc dhe jo rrotull e rrrotull, — u dëgjua zëri i Elmaz Fugës, i cili atë qast po këpuste me dhëmbë fijen e perit të zi.

— Troc di të flas edhe unë, — e ngriti pak zërin agrom Dauti dhe ia qepi sytë Petritit.

— Ja, për shembull, përsë nuk aprouat për normist Xhelal Vishnjën, por ia dhatë atij ngordhalaqit që s'di të ruaj as pulat e jo më të merret me normat!...

— Çështjet e organizatës së partisë të mos i diskutojmë në këtë formë, — ndërhyri Sulë Metani dhe i lidhi duart te gjunjët. Petriti pohoi me kokë,

— Aty ka tarafe, prandaj kini mendjen! — vijoi Dauti.

— Ne nuk jemi daçkord me atë mendim.

— Kush ne? — pyeti Petriti.

— Unë konkretisht, unë si agronom i sektorit. Merret apo jo parasysh edhe mendimi i specialistëve në këto raste?

— Merret, po, në fund të fundit, vendos organizata bazë.

— Mirë, more shpirt i vëllait, — tha duke marrë frysë thelli agronom Dauti e me një zë më të përzemërt, — por në rastin konkret mendimi ynë ra përtokë.

— Ne e kemi shqyrtuar me kujdesin më të madh këtë çështje, — tha Petriti, duke mbushur me frysë gjoksin e tij të gjerë. — E gjithë organizata bazë ishte e mendimit që të mos dërgohej Xhelali, por Selim Qarri.

— Selimi është djallë i shkëlqyer, — ia priti me vrull Sulë Metani. — E shoh në brigadë unë, punon si traktor. Apo jo, Linditë, — dhe me mijmikën e tij e bëri të qeshte përsëri atë vajzë të mirë e të çiltër. Agronom Dauti ndjeu se iu skuqën pakëz veshët. Iu duk sikur Sulë Metani po e vinte në lojë me marifet.

— Nejse, — tha si i mërzitur ai. — Mua më duket se dikush e ka dredhur aty. Unë kam mendimin tim për këtë punë.

Ra një heshtje e një si ftohtësi. Sulë Metani e vuri re këtë dhe me vështrimin e tij u mundua t'i jepte të kupton-te agronom Dautit se e kishte gabim.

— Sidoqoftë, duhet pasur kujdes, bile kujdes i madh, — theu heshtjen pas pak zëri i agronom Dautit. — Arra nuk është në terezi. Njerëzit nuk dalin në punë me pretekste të ndryshme. Kurse edhe ata që dalin, dalin me vonësë dhe pa bereqet, si i thonë fjalës.

— Organizata e partisë e diskutoi dhe këto çështje. Ti, shoku agronom, do të shohësh se janë marrë e do të merren vendime me shumë rëndësi. Ne besojmë se gjendja do të ndryshojë.

— Rri, or shoku Petrit, se ti s'ke vëçse pa kohë këtu, kurse unë mbusha vitin e tretë, — vijoi me zë si të lodhur agronom Dauti. — Na ra bretiku hendeqeve e luginave, dhe, kur vjen fundi, kurrikush s'ta var!

— Ti ke shumë në dorë përsa i pënket brigadës, ndërhyri Sulë Metani, tek i futi sobës disa copa druri. U ngrit dhe një copë herë qëndroi ballë për ballë Dautit.

— Kam edhe s'kam, — tha Dauti si me mëdyshje. — Kur vjen puna që nuk realizohet rendimenti në një kulturnë, fajet i ka agronom Dauti. Kur agronom Dauti bën një propozim, propozimi i tij hidhet poshtë, — dhe ai u bë si plak në fytyrë.

Në derë u duk Xhelal Vishnja. Agronom Dauti doli bashkë me të.

— Erdha të të marr, — i tha Xhelali.

— Për çështjen tënde po bisedoja me ta.

— E kush ua var vullmetarëve, more shoku Daut? — dhe Xhelali nxori majën e gjuhës jashtë.

— Jo, jo, i dëgjojnë që ç'ke me të.

— Nejse. Hallin e kam gjetikë. Kur mori vesh Hamiti im se nuk më pranuan për në kurs, u bë spec nga inati. Ai ka ndër mend të merret me këtë punë, vëçse nga ti duam që Selim Qarri të mos shkojë në kurs.

— Do të shkojë kur të shohë veshët pa pasqyrë! — tingëlloi zëri i pakënaqur i agronom Dautit.

— Të tjerat i dimë ne, — dhe Xhelali i ra gjoksit me gishtin tregues.

Ata ecnin krah njëri-tjetrit. Agronom Dautit iu bë qejfi që Xhelal Vishnja me Hamitin diç do të kurdisnin, por edhe vetë ai kishte në kokë planet e tij, sidomos kundër Islam Sulës, Bedri Gjuzit dhe deri diku edhe kundër Pashone Krepit... Ishin këta që nuk kishin pranuar kërkesën e një dikasteri qendror, në Tiranë, i cili kishte menduar që Dautin ta emëronin në një detyrë tjeterë më me përgjegjësi. Në karakteristikën e organizatës bazë, ndër të tjera, ishte shënuar:

... Në përgjithësi ai (është fjala për agronom Dautin) ka cilësi të mira dhe është i aftë, por këtu në kooperativën tonë ka manifestuar mungesë të shpirtit luftarak dhe këmbëngulje të pamjaftueshme për të shkrirë të gjitha energjitetë e tij për ngritjen e rendimenteve bujqësore, prandaj mendojmë se është akoma shpejt për ta graduar. Ai duhet të japë më shumë prova për ta merituar atë vend të ri pune...

12.

Besnik Sala kudo që të ishte, në fshat ose në shtëpi, e kishte mendjen te problemet e kooperativës. «More, po kemi tërë këta kuadro në kooperativën tonë! Si nuk na kanë dhënë asnjë studim shkencor dhe të na thonë troç se kjo ekonomi ka këtë apo atë perspektivë?» — mendonte me vete, i shqetësuar. Tani po mendonte dhe po punonte me ngulm për të mbledhur një aktiv partie që do të analizonte pikërisht rrugët për të çarë përpëra, me hapa më të shpejtë. Këtë mendim ia përkrahën edhe në Rreth. Madje njëri nga sekretarët e Komitetit të Partisë u ngarkua që të ndihmonte konkretisht. Në dispozicion të byrosë së partisë, që drejtonte Besnik Sala, u vunë edhe disa specialistë të tjere,

të cilët filluan menjëherë nga puna. Gati një muaj rrresht shokët e ekipit vazhduan të bridhnin brigadë më brigadë, grumbullonin të dhëna të sakta për të gjitha çështjet Në përgjithësi, të të gjithë pjesëtarët e ekipit po formohej mendimi se pak përpjekje ishin bërë për të shfrytëzuar mirë dhe me mençuri mundësitetë reale ekzistuese. U vërtetua se gjendja e blektorisë nuk paraqitej e mirë, se asaj i mungonte si baza ushqimore, ashtu edhe strehimi në kushte të përshtatshme. Dobët, madje shumë dobët, në krahasim me kooperativat e tjera malore, paraqitej edhe prodhimi i drithrave të bukës. Rendimentet ishin të ulëta. Gruri, mesatarisht — katërmëbëdhjetë kuintalë për hektar, misri — njëzet e dy kuintalë. Mbi shtatëdhjetë përqind e tokës së punueshme ishte e pavaditshme. Mbase ishte e vetmja ekonomi në Rreth që kishte një përgindje kaq të vogël vaditjeje.

Në të gjitha fshatrat e kooperativës, ato ditë flitej vetëm rrëth punës, veprimeve, takimeve, bisedave dhe vizitave të anëtarëve të ekipit. Thuheshin edhe thashetheme: se ishin zbuluar abuzime të mëdha, se shefin e llogarisë ose e kishin futur në burg, ose do ta futmin së shpejti, se brigadier Mexhit Drizën do ta përjashtonin nga Partia, se magazinieri i Bubrecit ishte zënë me presh në duar si falsifikator faturash, se furrrxhiu i Derdomit kishte ngrënë në kandar njëzet e pësë gramë përgjdo copë bukë e plot gjëra të tjera. E éma e Xhëlal Vishnjës, Xhevria, shtoi edhe ajo disa nga vetja: hapi fjalë se dikush i kishte ngrënë ryshfet Selim Qarrit dhe përkëtë arsyet atë e pranuan për ta dërguar në kursin e normistëve në vend të djalit të saj, që «ma hoqën me të padrejtë». Ajo nxitoi dhe kërkoi takimin edhe me sekretarin e Komitetit të Partisë dhe i qau hallin, akuzoi Pashomen, Islam Sulën, Bedri Gjuzin e të tjerë se po mbani hatërlleqe dhe se po merrnin më qafë fshatin. Sekretari dëgjonte, bënte ndonjë pyetje dhe mbante shënimë në një blok të zi, të bukur. Ai ishte mbi të dyzetat, me një fytyrë, të pastër e zakonisht të rruar, me ca sy që i lëviznin me shpejtësi poshtë ballit të gjerë. Ishte shumë i shqetësuar. Byroja e Komitetit të Partisë e kishte porositur

që me masat që do të merreshin. të shënohej një kthesë e thellë në të gjithë veprimtarinë e kësaj kooperative.

Anëtarët e ekipit ishin ulur mirë, këmbëkryq, për të njojur thellë e më thellë gjendjen, hallet e njerëzve dhe të ekonomisë. Ata merrnin kontakt me njerëz të ndryshëm, me sekretarë të organizatave bazë, me barinj, me punonjës të administratës, më specialistë e me popull. Ata thirrën edhe Bilal Bregun, si komunist dhe si punonjës i dalluar në sektorin e bujqësisë. Bilali foli qetë-qetë, u tregoi ato që dinte, shfaqi mendimin se mund të punohej më mirë, sidomos në sektorin e blegtorisë e të frutikulturës, dhe solli shembuj se toka dhe klima e Arrës ishin shumë të përshtatshme për mollët, arrat, për dardhë e për pemë të tjera. Të nxitur nga këto të dhëna, dy anëtarë të ekipit, së bashku me agronomët e sektorëve dhe me kryeagronomin, vajtën parcelë më parcelë dhe bënë disa piketime paraprake se ku mund të ngrihej një plantacion i ri frutikulture. Vullnetarët, nga ana e tyre, ngritën çështjen e ruajtjes së pronës dhe të hapjes së kanalit vaditës, për të cilin ishin bërë plane e stërplane, ishim thënë shumë fjalë e dhënë premtimet, kurse në të vërtetë rezervuari që ishte hapur me aq mund e përpjekje vazhdonte të mos shfrytëzohej.

— Kur erdhëm në fillim, ndonjëri nga ne mori me vete edhe vegla pune, sepse kujtonim se do të kishim të bënim me çështjet e mekanizimit bujqësor, kurse këtu, or vëllezër, na rrasën në qilizmë dhe në mbledhje gështenjash! — u tha atyre Sulë Metani.

— Edhe qilizmë duhet të bëni, edhe gështenja duhet të mblidhni, — e ndërpren një shok i ekipit të Komitetit të Partisë. — Por kooperativës i leverdis të ngrini dhe një oficinë, të ndreqni vegla të ndryshme, të mos lejoni që makinat e shkoqjes së misrit të kalben në shi atje përparramagazinës.

— Ne gati jemi, — kishte thënë Elmaz Fuga.

— Sidoqoftë, ju duhej të kishit vepruar edhe me iniciativë, — kishte ndërhyrë një shok tjetër i ekipit...

Sherif Arra ato ditë ishte bërë si një «agjenci» e vogël lajmësh. Ai dinte pothuajse me hollësi të gjitha lëvizjet e

ekipit, ku kishin ngrënë, ku kishin fjetur, madje deri në ç'orë kishin ndenjur e ç'kishin biseduar. Një natë ai ftoi dy anëtarë të ekipit për darkë, por ata vajtën te Pashonia. Sherifi u bë helm.

Njëri nga anëtarët e ekipit thirri në raport veteriner Afrim Qosen sidomos për gjendjen shëndetësore të bagëtisë. Një pjesë e dhive ishin me zgjebë, dhe veterinerët, me disa masa që kishin marrë, e quanin të kryer punën e tyre. — Ne ato që patëm për të bërë, i bëmë, — fliste me zë të lartë Afrimi, që kryente edhe funksionin e kryeveterinerit. Me sjelljen e tij, ai linte të kuptonte se s'para e çante kokën për ato që i kishin ndodhur me gjënë e gjallë.

— Kur e kuptuat se dhitë ishin me zgjebë? — pyeti një brigadier blegtorie që bënte pjesë në ekip.

— S'më kujtohet si datë.

— Po si kohë sa mund të ketë afërsisht?

— Besoj se para nja dy-tre muajsh.

— Domethënë jeni njofuar gati qysh në shkurt, kurse neve na kanë thënë sësa barinj se ju kanë lajmëruar qysh në dhjetor.

— Për barinj që kemi ne! — dhe Afrimi nxori gjuhën jashtë. —

— Pse?

— Kanë grumbulluar disa gjytrymë që s'kanë idenë e dhisë ose të lopës dhe hajde merru vesh me ta! E ku janë komunistët? Edhe ju të Komitetit mbani përgjegjësi që i keni lënë të veprojnë si të duan! Mua më vajti goja prapa me sekretarët e organizatave bazë, po askush s'ma var.

U thirr për ballafaqim sekretari i byros së kooperativës, Besnik Sala, dhe kryetari i kooperativës, Petro Dordaci. Kur pa këta, Afrim Qosja filloi ta ulte zërin dhe u përpoq ta kalonte hendekun, duke i rënë problemit rrotull e rrrotull. Besniku tha pa e zgjatur:

— Ty, shoku Afrim, të kemi thirrur në byronë e partisë, të kemi kritikuar për bazën ushqimore, për stallat dhe për sëmundjen e dhive. Ti ke marrë angazhime, por gjendja ka vazhduar të mos përmirësohet.

— Ne kemi bërë çmos, shoku Besnik, por shoku Petro, ja tek eshtë, e di gjendjen më mirë, bile e di edhe më mirë nga unë, dhe e ka të qartë se barinjtë kanë pretendime, se ata nuk çajnë kokën, se e nxjerrin bagëtinë pér kullotje në orën dhjetë paradite, se...

— Tamam këto vërtetojnë dobësitë e punës suaj, — ndërhyri me vrull, një shok i ekipit.

— S'jam aspak dakord me këto konkluzione! — e ngriti zérin Afrimi dhe fytyra e tij e vockël, e kuqe prej natyre, me ata sytë e kërcyer, gati-gati iu nxi.

— Ruaj gjakftohtësinë! — e këshilloi shoku i ekipit.

— Po rendimenti i qumështit, përsë eshtë aq i paktë? — ndërhyri Besniku.

— Ti e di mirë, shoku Besnik, qumështin e pinë barinjtë...

— More, pse flet si fëmijë? — ia priti i zemëruar kryetar Petroja.

— Po ti, more kryetar, nuk u ke dhënë barinjve as ehët e nevojshme pér ta shpënë qumështin në baxho e tani më flet sikur nuk je kryetar i kësaj kooperative, po sikur na vjen nga anë e anës:

— Dëgjo ti, djale i mbarë, me këtë qëndrimin tënd po vërteton ato që thuhen poshtë e përpjetë pér ty. Mua më duket se të mungon serioziteti dhe ndjenja e përgjegjësisë në detyrë!

Afrimit filluan t'i dilnin qjersë...

— Pse? Çfarë eshtë thënë pér mua? — pyeti duke u ngërdheshur.

— Po, po, pikërisht pér ju, — tundi kokën shoku i ekipit. Afrimi u bë flakë në fytyrë. Zemërimi shquhej në bebet e zmadhuara të syje të tij. Besnikut qe duke i plasur gazi. Ai ia njihte huqet Afrimit. Afrimi nxori paketen e cigareve, dhe u përpooq një copë herë të merrte cigaren me gishtërinjtë që i dridheshin.

— A bëhet stan me lepuj? — tha ai me një lloj fodullëku. — Në majë të hundës më, ka ardhuri! — Mjekra e tij me majë i dridhej.

Sherif Arra e kishte dëgjuar pak bisedën e zhvilluar

në zyrën e Partisë dhe, kur doli veteriner Afrimi, ai e mblodhi dorën grusht, si për të thënë «ta mblodhën». Afrimi i këputi një të sharë vendçë dhe iku pa e parë mirë rrugën, ngaqë ishte fare i hutuar...

Llogari iu kënkua edhe doktor Kristos. Kristoja mendoi se kishte të bënte me nidonjë shok që s'para merrte erë thellë nga problemet e shëndetësisë, po, kur ai shoku i ekipit filloj nga pyetjet, atëherë imjeku e ndjeu veten të lirshëm. I tregoi përsuljen e mortalitetit të fëmijëve, por i foli singrisht se nuk ishin ende aq mirë me masat profilaktike për parandalimin e sëmundjeve.

— Ne, në krahasim me kooperativat e tjera të zonave malore, nuk jemi keq në këto çështje, — i tha Kristoja. Po përsëri s'jemi mirë. Dhe, sigurisht, faji bie mbi mua, megjithëse puriës i qëndroj mbi kokë.

— Në Selishtë përparrë tre muajsh ju vdiq një fëmijë. Si ndodhi kjo? — pyeti me ton të qetë anëtarë i ekipit.

— Jo për fajin tonë, — ë ndërpren me vrull doktor Kristoja dhe ndjeu se filloj të zverdhej në fytyrë.

— Po si ndodhi?

— Faji ka qenë i s'ëmës. E la fëmijën të sëmurë deri në gradën e fundit, pastaj fajin ua hodhi infermierit, mami, mua.

— Po prindët ju kanë lajmëruar mbi gjendjen e rëndëtë foshnjës; kurse ju, në ambulancë, s'keni pasur as i dezhurn atë ditë.

Doktor Kristoja u mendua pak:

— Lajmëruan me vonesë, — tha me dëshpërim! — Po edhe unë s'jam pa faj. Më ther nië zëmiér!

— Ne, si ekip, kemi konstatuar se propaganda sanitare është e dobët, ka papastërti, ka aty-këtu rastë kur familjet jetojnë bashkë me bagëtinë.

— Konstatimet janë të drejta, — u përgjigj Kristoja me pezmatim të madh.

— Asnjieri nuk jua mohon sukseset, por nia duket sikur keni rënë në vetëkënaqësi.

Doktor Kristoja pëshpëriti duke tundur kokën e tij të madhe.

— Edhe kjo nuk përjashtohet.

— Ne mendojmë se ju, shokët e shëndetësisë, duhet të hartoni një plan konkret për propagandën sanitare. Të shpallet, për shembull, një herë në muaj, më kupton, të paqtën një herë në muaj, «Dita e pastërtisë».

— Ide e mirë. Mund ta bëjmë...

— Të përfshihet këtu pastrimi i oborreve dhe i ambienteve, të shpallet një shtëpi model për pastërti, më kupton, shoku Kristo? Në këtë shtëpi të dërgojmë gra e vajza për eksperiencë etj. etj. Të krijohen evidencat e atyre shtëpive që s'janë lyer, të merren masa për largimin e bagëtive nga burgjet që janë brenda shtëpive, të rregullohen WC-të. Ndoshëta këto juve ju duken shumë të vogla, të parëndësishme, por...

— Jo! — e ndërpree doktor Kristoja, i zemëruar me vetveten. — Ato janë pasqyrë e punës sonë. Mund të punosh mirë sa të duash, po, kur tjetri të sheh një WC me derdhje nga jashtë, vate e fluturoi tërë puna...

* * *

Tamam në këtë kohë, drejt së përpjetës thikë të Kapercellit, po ngjitej një burrë rrëth të gjashtëdhjetave. Ishte ndaj të ngrysur. Mbrëmja kishte shtrirë krahët e vet mbi malet dhe kodrat rrëth e rrotull.

Ai kapérceu lëmin e lagjes së sipërme të Arrës dhe doli afër shtëpisë së Hamit Vishnjës. Ekte me hap të kujdesshëm dhe dukej që vendin e njihët mirë. Trokiti tri herë me çok dhe pas pak derën ia hapi Xhevria.

— Mirë se erdihe, Zeqir! Përmend qenin, bëj hazër shkopin! — i tha ajo dhe i zgjati dorën.

— Përmend mikun dhe bëj hazër pulën! — e korrigoi i porsaardhuri, duke qeshur, dhe hyri brenda.

— Na ra goja, si s'erdhi Zeqiri?!

— Ashtu më doli një punë dhe s'erdha dot mbrëmë.

Xhevria e futi mikun në odën e mirë dhe ndezi driten. Mysafiri ndenji këmbëkryq pranë oxhakut, por u detyrua të ngrihej përsëri pér shkak se erdhi Hamiti. U përqafuan me dashuri.

— Kemi kaq kohë që po të presim! — tha Hamiti me buzëqeshje.

— E di. Më tha edhe Xhevria.

Xhevria mori xhezven, pastaj kutitë e vogla prej tenqeje të sheqerit e të kafesë dhe u ul përballë mysafirit. Tek shihte atë fytyrën e tij të gjerë, me nofulla si të kalit, me ato buzët e përveshura, me atë kokën si pjepër, Xhevries iu kujtuan shumë gjëra. Ky njeri, që e quanin Zeqir Trushi, ishte mik i vjetër i shtëpisë së tyre. Ai kishte lindur e ishte rritur në Derdom, por prej shumë vjetësh banonte në qytet. Deri pas Çlirimtit kishte pasur dy furga dhe një hotel. Në vitin 1949 hotelin dhe furrat ia konfis-koi shteti. Policia i gjeti gjithashtu një qyp me florinj të fshehur me kujdes nën tokë. Tërë atë pasuri ata e kishin vénë me lloj-lloj dallaveresh. I ati i Zeqirit kishte qenë i hurat dhe i litarit, grabitës dhe vrasës. I shoqi i Xhevries, Arif Vishnja, e kishte pasur mik të ngushtë. Xhevries i kujtohej babai i këtij Zeqirit, veshur me një jelek të zi, të leshtë, me brekushe të zeza. E me një qeleshe të bardhë në kokë. Kishte qenë burrë i pashëm, por sert i madh. Xhevries i kujtohej mirë si e përfundoi jetën ai njeri. Ishte viti 1937. E rethuan xhandarët në qytet pér arsyen se kishte bërë disa vrasje dhe plaçkitje. Një oficer, mik i tij, e lajmëroi dhe i tregoi se nga mund të ikte. Ai çau me vrap, avlli më avlli, rrugicë më rrugicë e bahçë më bahçë. Mirépo, sapo doli në kodrat e qytetit, i ra të fikët. Iu shtrembërua hem goja, hem syri i majtë. E kapën, por pas ca kohësh e lanë të lirë. Ishte shëmtuar sa s'shihej me sy. Por me kohë filloi ta merrte veten. Ekte çalë-çalë, me atë nofullën të varur poshtë, sikur përqeshte njeri. Njëherë, tok me të shoqin e Xhevries, vajtën te ca miq, në Lajthizë. Po kalonin nëpër fshatin Shënkoll. Në këtë fshat, i ndihmuar nga i shoqi i Xhevries, ai kishte bërë tri vrasje. Përballë, atje në faqe të kodrës, dukej një shtëpi e bardhë.

— Të kujtohet ajo shtëpi? — e pyeti Arif Vishnjën.

— Si jo! Eshtë shtëpia e Latif Hoxhës.

— A i pimë një kafe?

— Si të duash. Hasmë e kemi pasur, por ka qenë trim. Eshtë i vetmi njeri që më ka dalë ballë për ballë dhe ma ka shtënë plumbin në mish.

Trokitën në derë. I zoti i shtëpisë i priti mirë dhe i mbajti me zor për drekë.

— Ti je i vetmi që më ke plagosur si burrat, — i tha plaku i Trushajve të zotit të shtëpisë.

— Ashtu erdhën punët atëherë. U gjakosëm kot fare! — iu përgjigj Latif Hoxha, pa u mburrur.

Pasdreke ai i përcollë miqtë deri poshtë, në xhade. U ndanë përzemërsisht. Mirëpo, ndërsa ata u larguan, te Latif Hoxha erdhi me ngut një fshatar, me pushkë në dorë.

— O Latif! — i tha ai fshatari, që merrte frymë me zor. — Ti vrasim! Ti e di që ata më kanë vrarë vëllanë!

— Shko, more, e këput zverkun matanë! Ata sapo më hëngren bukën, kurse unë t'i vras!...

Fshatari bëri sikur u bind, por u zuri pritë tek po kthëheshin. Shtiu dhe plagosë rëndë të shoqin e Xhevries. Atëherë, plaku i Trushajve e ndoqi fshatarin çalë-çalë, po s'e arriti dot. Po atë ditë e ngarkoi të plagosurin mbi një mushkë dhe e shpuri në shtëpi. Pas disa muajsh i shoqi i Xhevries vdiq nga plaga që kishte marrë. Po plaku i Trushajve, bëri si bëri, pagoi para dhe, më në fund, e zhduku nga faqja e dheut njeriun që plagosë të shoqin e Xhevries. Qysh atëherë në mes të tyre ishte forcuar miqësia...

Rrugën e t'et ndoqi në një farë mënyre edhe i biri, Zeqir Trushi. Ky, për të vrarë nuk vrau njeri, por u bë vegël e të tjerëve. Gjatë Luftës Nacionalecimtare u bashkua me forcat e Bazit të Canit dhe punoi për Legalitetin. E arrestuan në vitin 1946 dhe gjyqi e dënoi me tre vjet burg...

Xhevria u shkëput nga kujtimet dhe i shpuri kafenë mikut. Zeqir Trushi zuri ta rrufiste me buzët e përveshura, që i fërshëllën lehtë. Ai pyeste për njerëzit, për hallet, për gjithçka. I njihte të gjithë ai, një për një.

— Jemi mirë, shumë mirë, — përgjigjej Hamiti.

— Po synetillékun ku e mësove ti, o Zeqir? — e pyeti Xhevria me një buzëqeshje të ngrirë në' cepat e búzëve të vyshkura si eshkë. — Tashmë këtë vaj!

— Ohu! E kam mësuar qysh kur isha në burg. Atje u njoha me një berber...

— Aferim të qoftë! Ti edhe nga guri nxjerr vaj! — dhe syri i çapëlyer i Xhevries, gjysmë i hapur, nga i bar dhë që ishte, ubë si ujë kënete.

— Synetillékun unë më tepér e përdor pér seyap sesa pér fitim, — tha Zeqir Trushi dhe mbylli me kujdes paketën e cigareve, që kishte përparrë.

— E-di, — pohoi Hamiti. — Shumë shpejt!

— Po Sherif Arra ç'bën? — pyeti ai pas pak.

— Sherif Arra? — përsëriti Hamiti me pëbzët që i shpuri në gaz, si ai njeriu që di digka, por që s'e thotë doti.

— Sherif Arra e ka grûrë.

— Ç'pyet pér Sherifin ti, shtro peta e hidhi telyn! — plotësoi Xhevria dhe fshiu hundët me mëngën e mintanit.

— Di ta dredhë mirë qerratai! — dhe Zeqir Trushi shpuri buzën në gaz.

— Më duket se po fut në parti edhe të bijën, — tha Hamiti.

— Shumë bukur! — ia priti me kënaqësi Zeqiri. — Në parti të kem të futem edhe unë!

— Ç'punon ky Zeqiri! — thirri si e habitur Xhevria.

— Jo, e thashë me gjithë mend; vecse të mira ke, — dhe qeshi përsëri. — Djalin gati e keni?

— Edhe pak, — tha Hamiti, — po i jep zëmër e ëma, atje mëtanë.

— Pas pak erdhë edhe Xhelali.

— Kështu i prët miqtë ti, Xhelal? — Zëri i Zeqir Trushit ishte i ngrohtë, dëshamirës.

— Ke të drejtë, — pranoi Xhelali. — Po rrinim aty te mensa dhe po bisedonim pér punët e ekipit.

— Ç'thotë ekipi? — pyeti me një farë gjallërie Zeqiri.

— S'po marrim vesh gjë, megjithëse pér të thënë thuhen shumë gjera.

— Ashtu?!

- Thuhet sikur do të bëjnë ndryshime të mëdha. Dëgjova sikur Besnikun mund ta heqin.
- Atë sekretarin? — pyeti me interesim Zeqir Trushi.
- Amani, ta shporrin një sahat e më parë! — murmuri si nën buzë Xhevria.
- Mos u mërzit, — se të sjellin një Besnik tjetër, më të keq se ky, — tha Hamiti dhe u zgërdhi.
- Sidoqoftë, nuk është keq që ta heqin, — e mylli mysafiri, duke i shkelur syrin Xhelalit. Ai zgjati këmbët e tij me çorape të reja najloni drejt oxhakut me tulla të ngrohta. I pëlqente t'i thekronte këmbët pranë zjarrit, se ashtu e ndiente veten më mirë e më me humor. — Thuhet se në disa zona qeveria po ua shton oborret fshatarëve, — filloj ai me zë të ngrohtë e të shtruar. — Po këtej ç'thuhet?
- S'dimë gjë, — rrudhi supet Hamiti.
- Vërtet thua, Zeqir? — pyeti Xhevria.
- Po, po. Kam ca miq andej nga Mirdita unë. Më thanë se ua shtuan oborret në disa dynymë.
- O zot, ishallah edhe neve! — ofshani Xhevria.
- Me siguri edhe juve, — tha me bindje të plotë Zeviri. — Arra është zonë më e vështirë se Mirdita.
- Arra? Këtu te ne ha pula gurë, — dhe fytyra e Xhevries u gjallërua.
- Po t'ju zgjerojnë oborret, atëherë mund të jetohet...
- Më ndryshe është. Ke ç'të mbjellësh e ç'të marrësh. Po kështu, me një hasër vend!... — zgjati duart në hapësirë Xhevria.
- Duhet t'i luani gurët një çekë. Kam dëgjuar se u japid vetëm atyre që ankohen me lutje në qeveri. Se kjo qeveri nuk të shton asnjë metër tokë, mirëpo, kur ka ankesa të forta, ajo e pranon pa bërë bujë, se nuk do ta ketë keq me popullin.
- Sigurisht, — pohoi Xhelali dhe shkoi të shihte ç'bëhej andej matanë, në kthinën tjetër.
- Ua thuaj edhe të tjerëve që të bëjnë lutje.
- Unë për vete, nuk i futem kësaj pune, — tha Hamiti si i menduar. — Të futin në lloj-lloj kallëpesh politike...

— Ashtu është. Do pasur kujdes. Po ka edhe forma të tjera që të mos biesh në sy. Ka letra anonime.

— E di, ka. Po unë nuk dua të ngatërrohem. Jam mirë...

— Gëzohem, — tha me zemërim të brendshëm, të përmbjajtur, Zeqiri. — Po Arra është në kushte më të këqija se Mirdita, apo jo?

— S'kam qenë në Mirditë, vetëm kam dëgjuar. Thonë se edhe atje është zonë e keqe malore.

— Po përsë atyre t'u japid e neve të r.a i pakësojnë?

— pyeti me mllef Xhevria.

— Edhe unë jam me mendjen e Hamitit, — tha Zeqir Trushi, duke përplasur qepallat e syve të tij bojë hiri. — Më mirë këtë ankesë ta bëjnë disa të tjerë sesa ky. Por që duhet bërë, kjo s'ka dyshim, është e domosdoshme.

Hyri përsëri Xhelali dhe, si mbylli me kujdes derën, vajti u ul te vendi i tij i mëparshëm.

— A bën shumë synetllëqe ti, Zeqir? — e pyeti me buzëqeshje Xhelali.

— Jo! Shkoj vetëm nëpër miq, kur më thérresin. Dhe ju thashë se e bëj vetëm pér sevap. Do të vdesim, toka do të na kalbë, baltë do të bëhem. Të paktën, shpirti të na ruhet i pastër...

— Ishallah! — ia priti Xhevria, — Të lumtë ajo gojë, Zeqir! Synetllëku është sevap i madh.

— Po kanë ardhur kohë të këqija, Xhevrie! Sot spiu-non vëllai vëllanë. Po megjithatë, ka shumë njerëz në këtë tokë që nuk i kanë lënë ligjet e fesë; njoh shumë njerëz që hem zotit i luten, hem ramazanllékun e mbajnë, shkurt, i bëjnë të gjitha. Të themi atë që është pér të thënë; pa një besim, njeriu nuk mund të rrojë! Pa një besim, njeriu është si bagëtia!

E shoqja e Hamitit, Fatime ja, atë çast solli djalin. E kishte veshur me një dolloma të gjatë. E kishte nxirë në ballë me bojë të zezë, marrë nga fundi i tiganit.

— E, more trim! — ia priti Zeqiri. — Një cikë lëkurë do të të heq, prandaj mos u tremb!

Djali dhjetëvjeçar rrinte në këmbë dyllë i verdhë.

— As ciu, as miu, me gojë, se, po na e morën vesh, na gjeti belaja! — tha Xhevria si e përgjeraur.

Zeqiri po përgatitej për «operacionin». Përpinqej t'i jep-te vetes rëndësi, duke hapur me tangërrlëk atë çantën e ze-zë, ku kishte jodio; alkool, fasho, leukoplast, pambuk, gér-shërë, nga dy brisqe të mëdhenj rroje, nga ato të berberëve; shap dhe ca pluhura të tjerë, që shërbën për ndalimin e gjakut. Si i rregulloi këto, e shtriu djalin në një shilte të re, i ngriti dollomanë, i kapi një copë lëkurë me ato duart e tij akull të ftohta, i bëri shenjë Hamitit dhe Xhelalit që ta mbanin djalin, njëri nga krahët, tjetri nga këmbët, dhe vetë, me një kujdes të madh, që u bëri përshtypje të mirë të gjithëve, ia ktheu djathtas kokën djalit, që vogëlushi të mos shihte se c'do të bënte ai kasap. Befas një klithmë e furishme buçiti nga goja gjithë jargë e vogëlushit.

— Keshë, keshë, keshë! — thirri Zeqir Trushi dhe sa-kaq ia zuri gojën me pëllëmbën e dorës. Ulërima e mytur e klithmave të djalit ia ngriu gjakun hem atij, hem Xhevries, që rrinte si e shushatur.

— Mos, se na fike! Na more më qafë! — i thoshte ajo si me lutje djalit, por edhe si me kërcënëm.

— S'ka gjë, mori fund! — tha Zeqiri dhe kërkoi t'i sillnin legenin. Gishterinjtë e dorës së tij të djathët ishin përgjakur, sikur të kishte therur një zog pule.

— Të lumtë, Zeqir, shkoi shumë bukur! — tha me një ton gjithë kënaqësi Hamiti.

— Ejvallah! — ia ktheu Zeqiri, tek lante gjakun më ujë të ngrohtë. Pastaj, tek fshinte duarët me një peshqir të ri, iu afroa dritates, dhe hodhi vështrimin e tij përtëj, si kusar. Në qielin e zi ndriste hëna...

13.

Pa zbardhur ende mirë, brigadier Mexhitit i doli gjumi nga një éndërr e keqe. Iu duk sikur një kope ujqish bëri kérdinë në tufën e dhive. Shpuri dorën te balli dhe vuri re se i kishin dalë djersë nga ankthi. Nuk donte ta sillte ndër mend atë éndërr të llahtarshme. Akoma i dukej sikur shihte bagëtinë e gjakosur mu në mes të pyllit, ca të tje- ra duke u gremisur nëpër gryka e nëpër lugina. Tha me vete se këtë éndërr të keqe do ta kishte parë ngaqë mbrëmë kishte fjetur shumë vonë. Ishte marrë me hartimin e listave të ditës së punës. Nxjerrja e tyre përfundimtare ishte gjëja më e lodhshme dhe më e bezdisshme për të. Kujt t'ia prishtë e kujt t'ia ndreqë! Kishte njerëz që kërkonin më tepër nga ç'kishin dhënë. E keqja vinte edhe për shkak të vetë Mexhitit. Shpesh ai nuk arrinte t'ua mas- te të gjithëve normën ditore dhe, kështu, i rrumbullakos- te gjërat me hamendje. Dikujt i jepte tetëdhjetë pikë në ditë, një tjetri nëntëdhjetë, ca të tjerëve njëqind. Kishte raste që jepte edhe njëqind e njëzet, njëqind e tridhjetë pikë, sidomos Asllan Berit dhe Bilal Bregut, që punonin si buaj. Kishte edhe një hall tjetër Mexhiti, që nuk e le- jonte ta kryente si duhej këtë punë. Banorët e Zallit i kishte të tijtë, farefis, ndarë nga një oxhak. Ua dinte hal- let të gjithëve, u dinte sa lugë kishin në raft, ç'hanin në darkë dhe ç'merrnin me vete, kur shkonin në punë. Mi- rëpo numrin e ditëve të punës ai e kishte planifikuar për gjithë vitin dhe të ndarë në tremujorë. E nga t'i nxirrte tepricat? Sigurisht, shpesh nga të tjerët nga banorët e dy lagjeve të sipërme, nga vajzat, që zakonisht nuk e ngrinin zërin, edhe kur u hahej ndonjë e drejtë e vogël. Kishte edhe një burim tjetër ai, vullnetarët, me të cilët mund të manovronte me lehtë. Kështu kishte vepruar disa herë brigadier Mexhit Driza. Por me vullnetarët e këtij vi- ti e ndiente se e kishte pisk. Ata punonin shumë, punonin pa fjalë, plotësonin e tejkalonin normat, madje linin pra- pa edhe ndonjë bujk nga më të mirët...

Mexhiti u ngrit dhe hapi dritaren. Lugina ishte e qetë.

Aty pranë rridhte uji i lumit. Mali kundrejt sillte ajrin e pyjeve. Tek mbushi mushkëritë me ajrin e stohtë, ndjeu brenda përbrenda se pranvera nuk ishte larg. Eh, sa punë e sa telashe të mëdha do të sillte ajo pranverë për brigadier Mexhitin! Atë ditë forcat do t'i ndante më dysh: një pjesë do të mbillnin fidanët e mollëve sipër, në ato luginat e ashpra, që deri vonë kishin shërbyer si kullotë për bagëtinë; pjesa tjeter, kryesisht të rinjtë e të rejet, do të shkxonin në aksion, te Kodrat e Thëllëzave, për të hapur tokë të ne.

Ishte afër të dyzetave Mexhiti, por tregonte më i ri. E kishin mbajtur të freskët e të gjallë puna, malet dhe luginat. Dikur kishte qenë bari dhish e këtë zanat Mexhiti e njihte mirë. Edhe kur u zgjodh brigadier, ai nuk e humbi gjallërinë dhe shkathtesinë, që mund të barazoheshin me gjallërinë dhe shkathtesinë e një të riu. Gjithë ditën e ditës në këmbë, gjithë ditën e ditës parcelë më parcelë, skuadër më skuadër, kodër më kodër e luginë më luginë.

Pranë tij flinte Liman Driza, vëllai i madh i Mexhittit. Kishte edhe katër vëllezër të tjerë, por Limani kishte mbetur si kryetar i familjes, pas vdekjes së t'et. Ishte shumë hokatar Limani dhe njeri me përvojë të madhe për bujqësinë dhe blegtorinë. Ai e çmonte sa peshonte sqapi vetëm me një të parë, dinte të përcaktonte me saktësi ku e kur duhej mbjellë gruri ose misri, sa farë duhej hedhur, sa bagëti mund të kullosnin në malin e Arrës, sa lesh mund të jepte një dele.

— A u ngritën gratë, o Mexhit? — pyeti Limani dhe nxori krahët e tij të fuqishëm, muskulozë sipër jorganit.

— Jo, hala, s'dëgjoj asnjë zë.

— C'presin më ato gjumashet e dreqit! — dhe një të shtyrë jorganin me këmbë. U ngrit me vrull, gjeti pantalonat ushtarake dhe i veshi. Ishte burrë i fortë, por që nga koha kur ishte gremisur në hendek dhe kishte thyer këmbën e djathë, që tanë nuk e përdorte dot lirshëm, ai nuk ishte më i dikurshmi. Ndiente një dhembje të fortë, sikur një turjelë ia shponte gjithë kockën e këmbës. Doktor Kristoja, për t'i bërë qejfin, e kishte siguruar se do ta shëronte, i kishte bërë disa kura me lloj-lloj vitaminash,

por pa dobi. Për shkak të këmbës, Limani nuk dilte më në brigadë. Nuk ecte dot nëpër udhë të largëta. Nuk ngjitej më si dikur nëpër gryka dhe kodra. Tani ai merrej me bostanet e tij, mbillte grurë dhe misër, kullandriste dhitë e lopën, priste dushk dhe ngrinte disa biga vit për vit, me të cilat ushqente bagëtitë gjatë gjithë dimrit...

U dëgjuaj qarja e një fëmije. Diçka kërciti tutje, u hap një derë. Njerëzit e familjes po ngriheshin kush e kush më parë. I priste puna ata, punët e shtëpisë dhe të kooperativës. Ishte familje e madhe ajo e Drizajve, bëhej rrëth njëzet e pesë veta, nga të cilët pesë gra e pesë burra, kusuri kalamaj, çuna e goca.

Atë ditë edhe Limani kishte ndër mend të mbillte disa rrënje mollë, aty poshtë, në breg të lumit. Rriteshin bukur fort mollët, qershítë, fiqtë dhe rrushi aty në zall. Gjatë dimrit zalli ishte zona më e paprekshme nga erërat, dëbora dhe ngricat. Rritej ç'të doje atje, mjافت që të kujdeseshë për bimën, t'i rrije mbi kokë, t'i bëje shërbime. Kishte krijuar një parcelë shumë të bukur Limani, me lloj-lloj pemësh. Gjithçka e kishte bërë vetë, me duart e tij. Edhe gardhin me thupra të dendura, që qarkonte gjithë parcelën e tij, e kishte thurur me duart e veta ai. Flisnin shumë për Limanin, disa e lëvdonin, disa e quanin hileqar. Kishte edhe nga ata që pëshpërisnin se ai s'ishte hiç i sémurë, por shtihej si i tillë për të ndenjur në shtëpi, për t'u marrë me punët personale, se ashtu i leverdiste më shumë. Këto pëshpëritje kishin arritur deri në organizatën bazë të partisë, madje deri në vesh të kryetarit. Brigadier Mexhítit i kishin thënë që Limani duhej të dilte në brigadë, por Mexhiti u kishte treguar një raport mjekësor, që e këshillonte Liman Drizën të bënte punë të lehta bujqësore.

— E duam nga ambulanca reportin dhe jo nga doktor Kristoja, — i kishte thënë Islam Sula, kryetari i këshillit të fshatit të bashkuar.

— Ne Kriston njohim në kooperativën tonë, — i ishte përgjigjur Mexhiti dhe kishte ikur duke mos e zgjatur më. Doktor Kristoja i kishte dëgjuar të gjitha këto pëshpërit-

je dhe njëherë ishte detyruar t'i thoshte edhe Pashone Krepit se kot i binin më qafë Liman Drizës.

— Është i sëmurë ai, shoqja Pashone. Unë e kam shpënë edhe te mjeku specialist dhe ai e ka nxjerrë me frakturë. Ju bëni ç'të doni...

Sidoqoftë, Limani nuk merakosej shumë. Ai kishte në xhep raportin mjekësor dhe me këtë ua mbyllte gojen të gjithëve. Pastaj, kishte edhe njerëz që e mbronin Limanin. Ai ishte njeri që dinte të priste e të përcillte miq, njojur e panjohur, ishte gjithë muhabet dhe me këtë tregonte se kishte një zemër bujare. E, ç'muhabet të ëmbël që bënte Liman Driza! Apo s'fliste bukur, me figura që të mah-nishnin...

— Mexhit, — i tha të vëllait. — Bëj nga bëj, duku një çikë këtej sot, që të më ndihmosh në mbjelljen e mollëve.

— Po pata mundësi, do të vij, ndryshe përpiku vetë, se sot kam shumë punë.

Limani vajti e mori kusinë e madhe për të mjelë dhittë. Atë ditë këmba e sëmurë po e ngacmonte më shumë se herët e tjera. Ia kishte frikën ndonjë paralize Limani. Kjo do të ishte vdekje për së gjalli për të! Ai ishte mësuar me punë, me punë të rënda qysh në fëmijëri. Dikur i ati e ngrinte që me natë dhe i thoshte të bënte këtë dhe atë. Limani kryente qdo gjë pa fjalë. Pas vdekjes së t'et, ai u bë një Abdi i dytë. E zëvendësoi plotësisht të atin, Abduin, e zëvendësoi me huqe, me tonin e zërit, me mënyrën se si u jepte urdhrat dhe porositë njerëzve të shtëpisë. Edhe zakonin e mikpritjes së t'et diti ta ruante shumë mire Limani.

— Një shtëpie që s'i hahet buka, ajo kurrë nuk bën prokopi! — kishte dëgjuar shpesh nga goja e t'et Limani.

Dhitë i milte vetë. Duart e tij ishin mësuar t'i kapnin me butësi gjintjtë e bagëtive dhe ato as që lëviznin fare në kohën e mjeljes. Ishte merakci i madh Limani, i përkëdhelte dhittë një nga një, madje shpesh fliste me to. Kurrë dhittë e Liman Drizës nuk e kishin njohur zgjeben ose sémundjen e gjinjve.

E mbushi deri në gjysmë kusinë e madhe dhe vajti të hidhte qumështin në mëti. Bënte gjizë e gjal-pë Liman Driza si askush tjetër në Arrë. Pastaj vajti e mori fidanët e mollëve. I kishte futur në një kthini, në një si qoshe të ngrrohtë, që të mos ia dëmtonte të ftohtët. Ishin gjithsej nëntë rrënë. Ai i pa një e nga një me sytë si në hi, që kishin një vështrim të ashpër. Ishte burrë rrëth të pesëdhjetave, por dukej më i madh në moshë. Fytyrën e kishte plot rrudha dhe në mjekrën, që zakonisht e rruante dy herë në javë, i shkëlqenin plot qime të thinjura.

Ai doli me fidanët në duar dhe me belin në krah. Duke ecur çalë-çalë, i hidhte sytë rrëth e rrötull që nga parcela ku kishte mbjellë grurin deri te gardhi i puthitur me kujdes në çdo pjesë të tij. Edhe ai, si Mexhiti, e ndjeu afshin e pranverës, sido që bënte ftohtë dhe mjegulla po ngjitej nga zalli përpjetë fases së malit.

Gropat përfidanët e mollëve i kishte bërë gati. Do të hapte dy gropë të tjera, që të plotësohej numri nëntë. Për këtë ai i thë Mexhilit që të vinte e ta ndihmonte. Por, kur u bind që Mexhiti ishte në mëdyshje, vendosi t'i përfundonte me krahët e tij. Nuk ia përtonte punës Limani, veçse atë ditë ndiente të therura të forta në këmbën e sëmurë. Hodhi xhaketën prej kadifeje aty mbi buzën e një hendeku, mori belin dhe filloi nga puna. Toka ishte e butë dhe dheu nixirrte avull. Me krahë, ai kishte sjellë dhjetë vjet më parë tokë të shkrifët, që e merrte në brigjet e lumenit dhe e hidhte në ngastrat e tij. Ajo tokë, bërë si humus nga vitet e nga grumbullimi i lloj-lloj mbeturinave që sillte lumi, ishte si një pleh i shkëlqyer. Si e mbuloi pothuajse gjithë sipërfaqen e ngastrave, e punoi dhe e ngopi me pleh bagëtish. Vitin e parë Limani mori në gjysmëdynymi tokë rrëth tre kuintalë grurë, i binte, pra, mesatarisht rrëth gjashtëdhjetë kuintalë për hektar. Dhe, kur këtë ua tregonte udhëheqësve të kooperativës, agronom Dauti ose ndonjë tjetër ia priste:

«— Nuk është ndonjë zor i madh, Liman, të marrë njeriu tre kuintalë në një gjysmëdynimi. Marifeti është të rritet prodhimi në të gjithë sipërfaqen, e kjo si-përfaqe në kooperativën tonë nuk është e paktë, por janë qindra e qindra hektarë.

— Limani buzëqeshë si me mosbesim për ato që i thoshin ata. Ai kishte tjetër mendim.

— Gabimi juaj qëndron në dy pika, — u thoshte ai. — E para, se ju nuk dini të zgjidhni tokën më të mirë për grurë e për misër. E dyta, se me afatet e mbjelljeve nuk jeni në rregull.

— Po cila është tokë më e mirë për misër e për grurë, sipas teje, o Liman? — e pyeste agronom Dauti me zë ku fshihej një notë ironie.

— Toka më e mirë është ç'kap gjithë zalli, — dha Limani ngrinte krahun në ajër, thua se në atë mënyrë kishte në dorë gjithë hapësirën për të cilën po fliste. — Zalli është hambari i Arrës. Këtu e ke të siguruar në daç bukën, në daç pemën, në daç kullotën, ç'të duash.

Mirëpo Dauti kishte mendimet e veta dhe pothuajse s'iavarte fare Limanit. Dhe Limanit aq i bënte! Letë vepronin si të donin! Po kur erdhën shokët e ekipit, ai u shtrua këmbëkryq me ta dhe bisedoi shtruar, gjatë e gjerë. E falënderuan Limanin dhe i thanë se kishte mendime shumë të sakta.

Edhe mollët që po mbillte do të rritheshin të shëndetshme. Gjithçka varej nga duart e njeriut. Shpesh ishte grindur me të vëllanë, me Mexhitin, për cilësinë e punës. S'kishte bërë akoma as gjysmën e gropës së parë, kur dalloi anëtarët e kooperativës që ia nisen punës me vrull e me hare për mbjelljen e mollëve. Ndjeu gjësim të thelli në shpirt ai. Po mbilleshin qindra e qindra rrënje të reja, do të zbulurohej vendi, do të kishin më shumë të ardhura edhe pjesëtarët e familjes së tij. Vetëm një hall e shqetësonte atë: fidanët e rinj duhej të ruheshin, të ruheshin sidomos nga bagëtia dhe kalamajtë, që për hic gjë i këputnin dhe i përdornin për shkopinj për të trembur e rrahuar keçat ose qen-

gjat, në behar. Edhe lepujt, thoshte Limani, mund ta dëmtojnë fidanin. E dëmtojnë kur fidani fillon e lëshon sythe e kur lëkura fillon e njomet nga rrezet e diellit pranveror. Shumë porosira i kishte dhënë Mexhibitit për këtë punë, madje i kishte thënë se nuk do të ishte keq që çdo fidan të vishej me kashtë, për të mos e vrarë erërat dhe ngrica.

Limani e mbuloi gropën e parafundit. Tani i kishte mbetur edhe një. Ai dëgjoi zërin e fëmijëve që po shkonin në shkollë. Edhe Zalli tani kishte shkollën e vet. Deri dy vjet më parë fëmijët e kësaj lagjeje bënin një orë e ca udhë me këmbë, duke ngjitur e zbritur tërë ato të përpjeta thikë, që të zinin frymën e të këpusnën gjunjët. Limani kishte qenë ndër më këmbëngulësit që edhe Zalli të kishte shkollën e vet fillore, se fëmijët nuk shkonin dot deri sipër në lagjet e largëta të Arrës, sidomos gjatë dimrit, kur binte borë e madhe, kur fryshtave tufani dhe kur ujqit bridhnin qark me kope. Askush nuk kishte ndonjë kundërshtim, veçse ishte çështja e godinës. Zalli nuk kishte godinë të përshtatshme për ta përdorur si shkollë. Po Limani e zgjidhi këtë problem.

— Për sivjet po ju lëshoj unë dhomën e madhe të miqve. Aty të mësojnë kalamajtë e Zallit. Mot rregulllojmë një ndërtësë të re, — u tha ai dhe ashtu u bë.

Një vit fëmijët mësuan në shtëpinë e Drizajve, në atë dhomë të madhe e plot dritë. Vitin tjetër filloj ndërtimi i shkollës. Limani punoi si usta. I vinte çdo gjë përdoresh këtij njeriu. Gurë e rërë kishte Zalli sa të duash. Trarët i bënë me drunj të shëndoshë dushku e lisi. Shkolla mbaroi si pa e kuptuar...

Ai dalloi nga larg, në zall, Xhelal Vishnjën me kalin të ngarkuar me dy dengje miell që i kishte marrë në mulli e po i shpinte në furrë. Xhelali ishte me një tjetër që Limani nuk e njohu dot. Ata të dy diç bisendonin në këmbë. Xhelali i fliste atij, duke i shoqëruar fjalët me lëvizjen e duarve e të kokës. Tjetri dëgjonte me vështrimin poshtë, në zhurët e zallit. Pas pak aty

vajti edhe Mexhiti. Limani dëgjoi zérin e ngritur të Mexhilit. Ai po hahej me Xhelalin, por herë-herë i kthehej edhe atij tjetrit. «C'dreqin do të kenë? — pyeti vreten Limani. — Ky Mexhiti im mbeti gjithnjë gjë e egër;» — shtoi si i dëshpëruar dhe psherëtiu.

Mexhiti kapi kalin nga kapistri, me forcë. Xhelali u hodh t'ia merrete, po Mexhiti e shtyu. U dëgjua një sharje, pastaj pllakosi heshtja. Limani u mat të shkon te për të parë q'ndodhë me ta. Pastaj Xhelali goditi me një thupër vithet e kalit dhe u nis duke kaluar përmes ca shelgjeve e rraveve me trup shumë të trashë që ishin mbjellë mu në breg të lumenit. Pas e ndoqi ai tjetri, kurse Mexhiti po vinte në drejtëm të Limanit.

— C'pate me Xhelalin ti? — e pyeti Limani, kur Mexhiti akoma nuk i ishte afruar pranë.

— Mistreci, sorrollatet kot rrugë më rrugë! — shfryu Mexhiti gjithë zemërim.

— Po me kalin c'pate ashtu?

— I thashë të dorëzonte punën. Kalin, i thashë, ma jep mua, se me këtë punë do të caktoj tjetër njeri. Ke parë ti? Më bën mua fajtor që nuk e dërguan në kursin e normistëve.

— Po ai tjetri kush ishte?

— Nuriu, djali i Dervish Lokut. Edhe ai s'po më duket në terezi. Diç duan të kurdisin të dy, se rrinë e bisedojnë kokë më kokë me njëri-tjetrin. Kam dëgjuar edhe ca fjalë jo të mira për të.

— C'fjalë? — pyeti Limani me gjysmë zëri.

— Sikur ai çuni i Dervishit i paska dalë përpëra në rrugë gocës së Asllanit dhe i ka thënë ca fjalë...

— Kush të tha ty?

— Semihaja.

— Ai Xhelali më duket si bakabond djalë! — foli nëpër dhëmbë dhe i kredhur në mendime, Limani.

— Lëmsh m'i ka bërë punët! — vazhdoi Mexhiti me zérin e tij të ngjirur e të pakënaqur.

— Lajmëro Pashonen dhe Islamin! — e porositi Limani me ton të prerë.

— Do të mbledh brigadën e do ta bëj për një lek!
— tha Mexhiti me fytyrën të ngrysur dhe me sytë e zymtë dhe të thellë.

Limani hodhi tej edhe një lopatë me dhë dhe përgatiti gropën për të vendosur fidanin.

— Edhe neve na ka ecur mirë sot, — tha pas pak Mexhiti dhe iu afrua gropës.

— Sa rrënëjë keni mbjellë deri tanë?

— Nja treqind e tridhjetë ose edhe katërqind...

— Kontrolloji mirë gropat! — i tha përsëri në formë porosie Limani. — Gropa duhet të jetë, ja, kaq, sa kjo, edhe e thellë, edhe e gjerë. Po i bëtë më të cekëta e më të ngushta, dije se bima nuk zë.

— I kemi bërë edhe më të mira se të tuat, — tha Mexhiti me buzën në gaz e si me mburrje.

Limani e shikoi në sy me gjëzim.

— Të kam sjellë një rrënëjë mollë «starking». Thonë se është mollë e shkëlqyer, e prodhua ka Korça.

Limani e mori dhe e pa me vëmendje. Fidani nuk ndryshonte nga të tijtë, veçse vinte pak më i trashë e si më i shëndetshëm.

— Me bereqet, pra! — tha Limani dhe dora sikur iu drodh, tek e vendoste fidanin në gropë. Hodhi nja dy grushtë pleh kafshësh dhe filloj ta mbulonte me dhe.

— Këtë fidan ta ka dërguar një shoku im. Ai vullnetari që të kam folur.

— Petriti? — pyeti Limani dhe e pa në sy të vëllanë.

— Po, Petriti. E kam ftuar për drekë sot.

— Shumë bukur! Kam qejf ta njoh atë djalë, se më kanë folur mirë edhe të tjerë për të.

— E dua shumë dreqin, se më duket njeri i drejtë. Kur erdhi në fillim, e patëm një ngatërrsesë të vogël...

Limani ngjeshi me duar dheun.

— Shko e i thuaj Dipes të na bëjë diçka më shumë sot, meqë paskemi miq për drekë, — e porositi ai Mexhitin.

Mexhiti iku pa folur. Limani, pasi mbaroi punët e

veta, vajti të ndihmonte skuadrën e kooperativës. Nuk i shkohej në shtëpi pa punuar në ato parcela të mëdha e të bukura.

— Çdo ditë do të dal në punë me juve, — u tha atyre ai me tonin hokatar. — Nuk po pyes më as për këmbën, as për ditët e punës. Kooperativa është rrënja e jetës sonë, — dhe filloi të mbillte fidanët e mollëve me duart që i dridheshin nga një kënaqësi e thellë, e papërmabjatur, që ndiente brenda përbrenda gjoksit të tij...

14.

Xhelal Vishnja, i shoqëruar nga djali i Dervish Lomut, Nuriu, po ngjitej përpjetë, për në Arrë. Ata ecnin njëri pas tjetrit, ngaqë rruga ishte e ngushtë. Përpara ecte kali i bardhë, me vithe të gjera e me bisht të gjata. Kafsha ecte pa u ndier. Ajo e dinte mirë rrugën. Vettë i merrte kthesat dhe vetë printe përpara, pa qenë nevoja ta drejtonte Xhelali. Vetëm në ndonjë vend, ku vareshin degë dushku, kali ndalej dhe zgjaste turirin e gjatë me dhëmbët e mëdhenj të dalë jashtë e me flegurat e hundës që i nxirrin shtëllunga avulli, dhe përpiquej të kapte degën e dushkut ose të panjës. Atëherë Xhelali i bërtiste dhe e godiste me thupër në bark.

Ajo e përpjetë thikë, nga Zalli në Arrë, ia kishte prurë në majë të hundës Xhelal Vishnjës. Ai ngjitej ngadalë, shpësh me duar në ije, duke marrë frymë me hundë. Por atë ditë ai nuk e ndiente veten mirë. Prapa kishte Nuriu, moshatarin e tij, të cilin qysh prej disa ditësh e kishte futur në një lojë të ngatërruar e të rrezikshme.

— A nuk ishin Islam Sula dhe Pashone Krepi ata që të nxorën nga puna e shtetit ty? — ia përsëriti përtë dhjetën herë Xhelali.

— Ata, sidomos Islami.

— Po pse, Pashonia jo? — e ngacmoi Xhelali.

— Edhe ajo.

Xhelali qëndroi një copë herë. Aty pranë ishte një trung qarri i tharë, i shembur përtokë. Xhelali u ul mbi të.

— Kape një çikë kalin dhe lidhe aty! — i tha Nuriut. Nuriu mori kafshën dhe e lidhi. — Pushojmë një gjikë, se na u mor fryma.

Nuriu vajti e ndenji pranë tij. Aty vendi vinte si pllajë dhe nuk frynte shumë. Një qukapik çukiste mbi një qarr. Xhelali e qëlloi me gur. Zogu i egër iku poshtë zallit, duke lëshuar ca tinguj të çjerrë. Lart, ku përmes drurëve të gjatë dukej një pjesë e qillit, kish-te nderë krahët një shqiponjë dhe po bënte një hark me krahët që nuk i lëvizte fare.

— Këtu prite Xhejen ti, — i foli Xhelali dhe shpuri buzët në gaz.

— Jo, do ta pres pak më lart. Këtu mund të më shohin.

— Thuaja copë! — Xhelali hapi pëllëmbën e dorës.

— Nuk ke rrugë tjetër, i thuaj, ose do të bëhesh gruaja ime, ose të hëngri dreqi, i thuaj. Mblidhja mirë dhe do të shohësh po nuk u bë pulë. Ajo të do. Edhe e ëma e saj është dakord të ta japë; ia ka thënë vetë ajo, me gojën e saj, nënës sime. Eja dhe pyete, po të duash, Xhevrien time.

— Islam Sula ngul këmbë që jo, — pëshpëriti Nuriu me një fill zëri.

— Sa i trashë që bëhesh! Të kam thënë se këtë punë e di mirë Hamiti im. Vetë i ati i gocës ia ka thënë Hamitit tim që në këtë punë po e ngatërronte kot së koti Islami. Kështu si të them unë, Islam Sula nuk do që ti t'i marrësh kushërirën. Shkakun se përse ai nuk do, ti e di mirë.

Nuriu dëgjonte e s'fiste. Ai ishte rrëth njëzet e pësë vjeç. Kishte trup mesatar dhe një kokë pak të shtrembër. Ishte qimekuq edhe te flokët, edhe te mjekra, edhe te vetullat. Sytë i kishte ngjyrëjeshil, po një jeshil të turbullt. Ishte i urtë dhe i sjellshëm, po kohët e fundit kishte filluar të hutohej e të turbullohej. Sidomos që nga koha kur e hoqën nga puna e shtetit dhe e sollën për të punuar në kooperativë, ai e ndiente veten si të vrarë e të dërrmuar. Dhe fajtor për këtë, ai dhe familja e tij, bënin Islam Sulën, sepse shkresa që ta sillnin në koperativë ishte firmuar nga ai, si kryetar i këshillit të fshatit të bashkuar. Në të vërtetë, vendimi për ta hequr nga puna e shtetit, ishte marrë nga byroja e partisë së kooperativës, dhe jo vëtëm për Nuriun, por edhe për disa punëtorë të tjera që me lloj-lloj marifetesh ishin larguar nga kooperativa dhe punonin nëpër ndërmarrje të ndryshme, larg fshatit dhe familjes, mjafton të siguronin një rrogë fikse.

— Po fute në dorë Xhejen ti, me siguri rregullo-hesh edhe me Islam Sulën dhe atëherë kthehet përsëri në punën që ishe. Hamiti im ka folur me drejtorin e ndërmarrjes dhe ai është dakord të të marrë, mjafton që të të lejojnë këta të kooperativës.

— I kam bërë një letër asaj, — foli si me druatjtë pas pak Nuriu.

— Kujt?

— Xhejes.

— Dale ta shoh?

Nuriu ngurroi ta nxirrte. Se si i erdhi ashtu, si turp, ndonëse Xhelalin e kishte shok të ngushtë. Bashkë e kishin kryer ushtrimë, dhe për Xhelalin ai ruante kujtimet më të mira.

— Nxirre, pra! — iu lut Xhelali.

— Nuk e kam këtu.

— Edhe nga unë ruhesh ti? — dhe Xhelali e vësh-troi në sy si i pezmatuar. Atëherë Nuriu nxori letrën. E mbajti një copë herë në dorë. Përsëri nuk kishte qejf t'ia jepte Xhelalit. Ndoshta ai mund t'ia tregonte

dikujt tjetër atë sekret dhe fjala do të merrte dhenë. Do të fillonin e do të talleshin me të, do ta telendisnin dhe kjo nuk ishte mirë pér një djalë, sidomos pér një beqar.

— Nëma, pra! — iu lut Xhelali dhe zgjati dorën pér t'ia marrë. Nuriu nuk lëvizi fare. Xhelali ia mori dhe filloj ta lexonte. Mirépo shkrimi ishte pothuaj i palexu-eshëm. Vetëm emri «Xheje» mund të lexohej. E kishte shkruar me emocione të mëdha atë letër, Nuriu. I ishte dridhur dora, thuase po bënte një gjë të ndaluar.

— Shqip ke shkruar apo turçe? — e pyeti Xhelali me dhëmbët pak të mëdhenj që i dolën jashtë.

— Fillove të tallesh ti? — u zemërua Nuriu dhe përpëliti sytë. Vetullat me qime të kuqe iu drodhën.

— Kur të qaj nënën, nuk tallem! — u betua me ton serioz Xhelali, po ajo buzëqeshja e tij që i buronte nga brenda, nuk i shqitej nga fytyra.

— Unë kam hallin se ajo nuk do ta kuptojë se ç'ke shkruar, — shtoi me fjalë të shkoqura Xhelali, që i mbërtheu sytë përsëri te letra dhe sa s'po e përpinte.

— Po kjo fjala këtu, ç'është? — e pyeti ai, duke e parë Nuriun me bisht të syrit.

— «Mos», i shpjegoi Nuriu.

— «Mos dëgjo», — plotësoi Xhelali dhe ngeci përsëri.

— «Se ç'thotë bota», — shtoi tjetri pa e lexuar fare.

— Aha, — ia priti si i habitur Xhelali dhe shtoi me zë pak më të ngritur: «Xheje, mos dëgjo se ç'thotë bota, unë...të...dua... më shumë se.... jetën. Po nuk... u bëre... gruaja ime... do të... hendohesh...

— Pendohesh! — korrigjoi shpejt Nuriu me vrull dhe si i fyter. **Xhelali diç nisi të mendonte. Letra nuk i pël-queu.** Ajo nuk të prekte. Me siguri që Xheja do të qeshte kur ta lexonte. Duheshin fjalë më të shumta e më të forta. Duheshin fjalë të tillë që ta hutonin, bile ta linin pa gjumë Xhejen. Xhelali kishte lexuar disa romane. Ai kishte vënë re se nëpër libra letrat e dashurisë ishin shumë të forta, që të trondisnin, që të bënin të derdhje lot. Një letër e tillë duhej dhe jo si kjo që kishte bërë shoku i tij, Nuriu.

— Sikur diçka mungon në këtë letër, më mirë mos ia jep, foli me gojë, foli shumë, hutoje dhe bile kërcënije, i thuaj se kjo mesele veçse me gjak do të mbyllët! — Tek fliste, Xhelali lëvizte buzët e holla.

— I kam thënë, pra, se do të pendohesh, — foli Nuriu, duke e vështruar shokun si me trishtim.

— Tjetër kuptim ka do të pendohesh, tjetër t'i thash se do të mbyllët me gjak, — dhe sytë i shkëlqyen si xham nga ky krahasim.

— Çohemi? — ia priti Nuriu, ngaqë e ndjeu veten si të hutuar dhe sikur po i fillonte dhembja e kokës.

Xhelali u ngrit. Tjetri e mori letrën dhe zgjidhi kalin.

— Më mirë foli me gojë, — tha përsëri pas pak Xhelali. — Po të jetë nevoja, po i shkruajmë bashkë një letrë tjetër.

Nuriu po fryhej nga mënyra se si po i fliste ai. Ishin gjëra këto që nuk duheshin biseduar, nuk duhej t'i dinte tjetëkush, veçse ai vetë. Po ja që Xhelali ishte futur tanimë në hallet e tij të brendshme, ia njihët bregët, ia dinte të fshehtën, që i vlonët në gjoks, në shpirt, në trup.

— Mos kujton ajo se po i lutem shumë?! Pak goca ka Arra? — tha befas Nuriu si i pakënaqur e me zë aspak të dhimbsur.

— Hajvan! — e qortoi me ton dashamirës Xhelali.

— Gocë si Xheja ti nuk ke për të gjetur as për njëqind vjet dhe jo vetëm në Arrë, por në të gjithë botën.

— Po derisa nuk do, unë nuk do t'i bie në gjunjë, sikur edhe nga qelli të ketë zbritur! — vazhdoi Nuriu me zërin që herë i ulej, herë i ngrihej.

— Ajo të do, e ëma e saj është me ty, kurse i ati lëkundet, dhe kjo për shkak të Islam Sulës. E pse të heqësh dorë kot së koti ti? Pér mua t'i s'vleke një dysh! Të isha unë në vendin tënd, namin do të bëja, mu brenda në shtëpi u kisha hyrë dhe ua kisha marrë me forcë.

Fytyra e Xhelalit u bë e ashpër dhe e skuqur, ngaqë foli me zjarr. Kali qëndroi befas dhe u përpoq të kafshon-

te një degë thane, po Xhelali i ra me shkelm në bark dhe e shtyu me forcë.

— Këtu po e pres, — tha Nuriu me gjysmë zëri dhe si me turp.

— Shumë mirë, — miratoi me gjithë shpirt Xhelali.

— Për prita qenke i fortë ti! Tregohu i tillë edhe me fjalë e me letra.

Nuriu vuri buzën në gaz dhe një dritë lumturie shkrepri në sytë e tij larushë.

— Si të thashë, ë? Po qe se është vetë e dytë, ndaje veç dhe foli, por foli që t'ia mbledhësh! — e porositi Xhelali pér t'i dhënë zemër e kurajë.

— Po sikur të jetë bashkë me vullnetarët? — pyeti Nuriu me zë të pasigurt.

— Vullnetarët nuk janë aty, kanë ikur në «Çajret e Thëllézave». Aty është vetëm Petriti, ai krapi i gjatë. Po, me ç'mora vesh unë, Petriti sot është pér drekë te Mexhit Driza, se, helbete, Drizajt gati janë pér t'i bërë njerëzit pér vete. Eh, sa u di... atyre! Kurse në darkë më prit në shtëpi pér t'i çuar atij mikut peshqeshin! — dhe u zgërdhi, duke zbuluar dhëmbët e tij pak të dalë.

Nuriu buzëqeshi ciltër pér nëntekstin e atyre fjalëve të Xhelalit. Ishte qerrata i madh ky Xhelali. Nuriu ndaj e donte, e gmonte dhe i besonte. Dinte shumë gjëra Xhelali, kurse vetë ai, Nuriu, nuk ishte aq i hollë dhe i rafinuar sa shoku i tij.

— Kështu si të them unë të bësh ti! A e kupton se në këtë mes unë s'kam asnjë interes, përkundrazi, unë mund të digjemi pér hatrin tënd! Mirëpo me dhimbsh, se të kam shok e të dua, — dhe u largua me sytë që i shkëlqenin nga mburrja. Nuriu e shoqëroi me sy dhe pastaj vajti e u fsheh prapa një qarri të madh, i kredhur në mendime e me zemrën që i fërgellonte lehtë...

15.

Petrit Skënderi ishte ulur pranë oxhakut, në dhomën e pritjes së Liman Drizës. Mexhiti kishte sjellë një krah me karthje, u kishte vënë zjarrin dhe sipër flakës së dendur kishte hedhur nja dy kërcunj të mëdhenj. Kërcunjëtë ishin ndezur, e një zjarr i madh, bubulak, që përhapte flakë e ngrohtësi, i jepte një bukuri të rrallë gjithë dhomës.

Përballë Petritit rrinte Liman Driza, ulur mbi një postiqe të madhe prej lëkurë dashi. Aty pranë, brenda në murin prej guri, në të djathtë të oxhakut, dukej një si raft i vogël, që Limani e përdorte pér nevojat e veta. Aty ai mbante kafenë, shëqerin, xhezvet prej teneqeje, gotat e vogla të rakisë dhe vogëlsira të tjera, që Limani nuk kishte qejf t'ia prekte njeri.

Petriti, pas gjithë asaj punë që kishte bërë pér mbjelljen e mollëve, e ndiente veten mirë dhe rehat në atë dhomë të ngrohtë. Mbi të gjitha, i kishte pëlqyer mikpritja e Drizajve, sidomos muhabeti i ëmbël i Limanit. Ata të dy kishin nga një gotë raki përparrë dhe pér meze brigadier Mexhiti u kishte sjellë, në pjata të veçantë, pak gjizë, nga një kokërr qepë, vezë të ziera e specia turshi.

— Ulu, pra, edhe ti, Mexhit, — i tha Petriti, se Mexhiti hynte e dilte nëpër dhomë.

— Ju bëni qejfin tuaj, se unë kam punë, — thoshte Mexhiti me zë të gjuar.

— Kur na vijnë miq, Mexhiti shërben, si kamerierët nëpër restorante, — tha Limani me buzë në gaz. Petriti e kishte vënë re që më fillim se kishte të bënte me një malësor të zgjuar dhe sqimatar.

— Përparrë se të më thyhej këmba, — vijoi Limani, — një herë në dy javë zbrisja më qytet, se i kam ca miq andej, e përpinqesha t'i kujtoja, por që kur m'u thye kjo e shkretë, — dhe ai shtrëngoi me dorë këm-

bën e djathtë, — po bëj vite e vite që s'e kam parë me sy më qytetin.

— Hudhra a doni? — erdhi Mexhiti dhe u hodhi përpara një grusht me thelbinj të qëruar, të mëdhenj e të bardhë si gurë të vegjël zalli.

— Tani rri, Mexhit, — iu lut përsëri Petriti.

Mexhiti tërhoqi një shilte me mbulesë basmeje me ngjyrë trëndafili dhe ndenji në mes të Petritit dhe të Limanit, natyrisht, i tërhequr pakëz prapa, për të formuar kështu një rrëth, që të shiheshin mirë njëri me tjetrin.

— Miku në shtëpi është punë e madhe, — thoshte Limani, duke shpërndarë prushin me mashë. — Kur më vdiq 'babai, një hall qaja dhe gjumi nuk më zinte: a do të isha në gjendje dhe a do të dija të prisja e të përcillja miq si babai, rahmet pastë?! Kemi qenë të varfér, o shoku Petrit, por mikun ne jemi munduar ta presim me gjithë shpirt. Rrallë ndodh që këtu, në këtë shtëpinë time, të mos kemi një ose dy miq. Kur jam vetëm e kur shoh që s'po duket të vijë njeri, dal në oborr dhe hap sytë se mos po shoh ndonjë udhëtar që t'i them: «Eja, or mik, eja, e grimë sonte, se të zuri nata udhës!» Kështu, o shoku Petrit, kështu e kam zakon unë, përpinqemi me atë taikatin tonë, se njeriu në këtë jetë veçse kujtime të mira duhet të lërë, mjafton që familja t'i nderohet.

Petriti dëgjonte pa folur dhe shpesh miratonte me kokë ato që thoshte Limani.

— Jeta po bëhet e bukur, — ndërhyri Limani, — sidomos tani në këto kohëra të mira. Sepse jetë mund të bëjë edhe qeni, po përsëri është qen, e rrahin, e lënenë prapa derës, nuk i japin për të ngrënë. Apo jo? Kështu kemi qenë edhe ne dikur, përpara se të vinte Partia. Kishim ca dhen e ca dhi, por ishim kallaballëk e nuk ngopeshim as me bukë. Shtëpia më e mirë këtu nuk bënte as dy a tre muaj bukë. Dëgjo këtu, shoku Petrit, — mori zjarr. Limani me vështrimin e mprehtë, të ngulur në fytyrën e mikut, — kemi vuajtur e kemi hequr aq shumë, sa s'ka avokat në botë ta tregojë! A

më sheh mua? Jam dyzet e nëntë vjeç, por dukem sa për gjashtëdhjetë. Na vrau ajo jetë! Kemi qenë shtatë vëllezër e pesë motra, tre vëllezër e tri motra na vdiqën, me zor shpëtuam në të tjerët. Unë nuk mbaj mend të kem fjetur ndonjëherë i mbuluar me jorgan, siç mbulohemi sot. Këto shtëpi nuk i kemi pasur, i kemi ngritur vonë; atëherë banonim në një si qur të madh, plot blozë e me të çara nga të katër anët. Aty ndiznim zjar dhe shtriheshim si bagëtia me kurrizin prapa zjarrit. Kështu na zinte gjumi. Siç binim, ngriheshim, po me ato plaçka që kishim në trup. S'mbaj mend unë t'i kem larë këmbët me ujë të ngrrohtë. Edhe tani po me ujë të ftohtë i Jaj, se më ka mbetur si zakon. Kurse tani kalamajtë tanë, veshur e mbathur përbukuri, barkut i futin ç'të duan, hanë e pinë ç't'u dojë e bardha zemër, e përsëri ankohen jo dua këtë, jo dua atë, shpesh u bërtas dhe i mallkoj: «Mos i bini së mirës me këmbë, he ju marrtë dreqi, ju marrtë!» — u them.

Mexhiti qeshi me zë; buzëqeshi edhe Petriti, kurse Limani duke marrë frymë si me zhurmë, vazhdoi:

— Më duket se njeriut i ka mbetur diçka e keqe. Sapo rregullohet në një anë, kërkon gjëra të tjera, ke parë ti? Një sene isha në Llixhat e Elbasanit. Më kishin thënë se më bënin mirë përkëmbën. Hera e parë në jetën time që shkoja atje! Hotele që të dhimbte kokë kur i shihje, restorante, dhoma me krevate, me dyshkë e me batanije të reja. Na jepnin për të ngrënë tri-katër herë në ditë! Qejf o qejf! Po kishte njerëz që ankoheshin, jo ushqimi i sotëm nuk qenka gatuar mirë, jo çarçafët nuk na i ndërruan. Më vinte t'u bija me grusht surratit.

— Do të kenë qenë borgjezë! — tha Mexhiti dhe ia shkrepit të qeshurit.

— Më keq, lapangjozë! — i mëshoi zërit Limani. — Por fjalën e kisha te disa njerëz. Shteti të bën gjithë ato nderime e të jep gjithë ato të mira, kurse ti po duke u qarë, po duke kërkuar, po duke zgjatur dorën për

të përlarë atë që s'të takon. Jo, jo, shoku Petrit, nuk
është mirë kështu, njeriu duhet ta çmojë të mirën.
Këtij Mexhitit tim i bërtas shpeshherë: «Punëtorëve
jepu atë që u takon, as më shumë, as më pak, se më-
sohen keq. Atij që punon më shumë, jepi hakun, atij
që punon më pak, jepi më pak, se atëherë ai që s'pu-
non òse që punon më pak se unë, mësohet keq».

— Shumë drejt, — pohoi Petriti dhe lidhi duart te
gjunjet, sepse ndjeu që po i mpiheshin këmbët, ngaqë
nuk ishte mësuar të qëndronte këmbëkryq një kohë të
gjatë.

— Mbështetu të jastëku, — foli Mexhiti dhe ia solli
aty pranë jastëkum me lesh.

— Shtriji këmbët, mos ki turp, rri si në shtëpinë të-
nde, — i tha edhe Limani me zë të përzémërt. — Unë
e kam zakon që mikun e mbaj me muhabet, i tregoj
lloj-lloj përrallash, se më duket sikur s'ka lezet që të
rrish me mikun e ta shikosh në sy pa folur. Apo e kam
gabim, o shoku Petrit?

— E ke shumë drejt, shoku Liman, — dhe Petriti
drejtoi atë trupin e tij të drejtë e të bëshëm.

— Kam pasur një xhaxha unë, — vazhdoi Limani.

— Njëqind e njëzet vjeç jetoi ai. Ishte, ja, si ti, goxha
burrë. Mustaqet te veshi. Vëç me gjueti merrej, me
gjueti derrash dhe sklesh. Për punë nuk e kishe. Mu-
habet s'dinte të bënte më mikun. Ishte çudi njeri! Ka
vdekur vonë, sepse, të thashë, ai jetoi njëqind e njëzet
vjeç. «More, Tut, i thoshtë im atë, se Tut e quanin
xhaxhanë, — po mos u rri miqve hundë e buzë, se po
ma bëri mua njeri kështu, unë një dekik nuk rri me
të, sikur të ma shtrojë me florinj». Tuti i thoshte:
«Mikut, po pate, jep të hajë e të pijë dhe lëre në me-
ndimet e veta. Kushedi nuk ka qejf t'i dëgjojë muha-
betet e tua ai, përse ta mërzitësh kot së koti me pall-
vra?» Kurse unë, — shtoi Limani, duke marrë frymë
thellë, mikut i jap muhabet, e pëlqe, s'ë pëlqe, punë
për të. Tuti jo. Çudi njeri ka qenë ai! Dy gjëra na ka
lënë si kujtim. Kemi një arrë të madhe ne, një arrë që e

quajnë «Arra e Tudit». Atë arrë e mbolli me dorën e tij dhe s'ka vit që ajo të mos na japë dy-tre kuintalë arra, Shko e na sill një sahan nga ato arra, — iu drejtua ai Mexhitit. — Cahen me dorë, aq të hollë e kanë lëvozh-gën...

— Na ka lënë edhe një qershi, — tha Mexhiti, tek u ngrit, dhe vazhdoi të fliste në këmbë. E bën kokrrën të zezë, na, sa një kumbull, por është pikëmjalti e ëmbël. Ne e përdorim për pekmez atë qershi, — dhe shkoi të sillte arrat, duke u lëkundur me ato këmbët e tij të drejta.

Limani dhe Petriti ngritën nga një shëndet. Petriti shikoi orën më dorë.

— Edhe gjysmë ore kohë kam, pastaj do të më falësh, se jam më aksion.

— Do të dalim bashkë, — foli me gjithë shpirt Limani. — Mollët do t'i mbjellim bashkë dhe me këmbë rriten që ç'ke me të. Çdo gjë rritet këtej, vegce duhet punë. Mirëpo shoh se më brigadë dalin vetëm disa gra nës. Edhe për mua thonë se i bëj bisht! Po unë i shkredhe edhe kryetarit të kooperativës, edhe agronomëve që, e bëj, se trupin e kam më gjendje për punë, ndryshe që më pengon këmba për të ecur, mirëpo shoh se sikur nuk duan, më duket se kanë hallin që të mos flasin të tjerët. Ka nga ata që mund të thonë: «Pse Liman Drizën e lejoni të punojë ku t'i teket, apo pse është vëllai i brigadierit? Normën kush ia mat atij, apo t'i vërë Mexhiti njëqindpi-këshin kot së koti? «Jemi një çikë hasetçinj ne, katundarët, o shoku Petrit, dhe kjo nuk na lë të bëjmë prokopi. Prandaj unë vendosa të dal vetë, s'po pyes as për pikët, as për gjë tjetër. Kam qejf t'ua mbyll gojën disave.

— Ne kemi hartuar listat e atyre që s'dalin rregullishët më punë dhe po marrim të gjitha masat që këtë problem ta zgjidhim sa më parë, — tha Petriti me zërin e vet të

kthjellët. — Të gjitha organizatat e partisë po mendojnë seriozisht për një punë më të madhe në kooperativën tonë. Do të bëhet çmos që të ngrihen në këmbë të gjithë, i madh e i vogël. Atdheu sot pret shumë nga ne, nga të gjithë. Në jetojmë të rrethuar nga armiqjtë e egër e barbarë imperialistë e revizionistë, prandaj duhet të shqetësohem i thellë, gjumi të mos na zërë si të punojmë më mirë, si të prodhojmë më shumë; si të çajmë përparrë.

— Shumë bukur, — foli Limani, i kënaqur. — Po u vu në vijë puna e daljes në rregull e gjithë krahëve të punës, kjo është gjë shumë e madhe!

— Shokët e ekipit të partisë dhe komunistët e Arrës po mendojnë që, pasi të përfundohet mbjellja e mollëve, të hapet një kanal i madh, që të vaditim gjithë tokat e sipërme të Arrës, të Selishtës dhe të Bubrecit.

Limani e vështroi si me habi. E kishte dëgjuar edhe nga Mexhiti këtë. Ai plan i ishte dûkur si i parakohshëmi! Po nuk dëshi t'i prishë ndrrat këtij vullnetari që kishte lënë familjen e tij dhe kishte ardhur deri tek ata për t'i ndihmuar.

Mexhiti i solli arrat! dhe një tas me fasule.

— Provoni arrat e Tuit, ër shoku Petrit! — i tha dhe u ul pranë tyre, duke e vështruar me sytë e vegjël bojë hiri. — Une të besoj që këto luginat tonë mund të bëhen ashtu siç thua ti, por ana puna do zot. Mexhiti, ünë vëllate kam, nuk mund t'i dalë në krye kësaj punë. Njëri i thotë Mexhit këtu, tjetri Mexhit atje.

— Ku e keni fjalën? — pyeti Mexhiti pa e ngritur zërin.

— Po bisedojmë për punët e kooperativës, — i ra shkurt Limani, dhe shtoi si me vrull: — Ër shok i dashur, or vëlla, a i ke vënë re ato prita në formë muri, pritat prej guri, që fillojnë nga lart atje, afër zyrave të kooperativës, dhe zbresin deri këtu, në zall? Kush i bëri ato prita? Të parët tanë i bënë. E pse? Që luginat të mos gjerryheshin, që të mos shembeshin nga ujërat, nga shirat e nga tufanet, që derrat të mos i kapërcenin dot e të mos futeshin aty ku mbillej misri ose gruri! E kush i bëri ato, pra? Baballarët dhe gjyshërit tanë i bënë.

— Mos do të thuash ti se atëherë njerëzit kanë punuar më shumë e më mirë sesa sot? — e ndërpreu Mexhiti dhe buzëqeshi me kaft, një buzëqeshje që Limanit iu duk ngacmuese.

— Kuptoje mirë muhabetin dhe mos fol përpara koh! — ia priti Limani dhe i hodhi një vështrim të rrepëtë. — Unë nuk po them se njerëzit punojnë më keq se sa dje! Këtë e di edhe bufi, por po them se edhe dje njerëzit kanë luftuar me thonj e me dhëmbë, që të bëjnë diçka të mirë, dhe, për hesapin tim, nuk kanë punuar keq, diçka na kanë lënë, kurse ne që kemi Partinë mund të punojmë edhe më mirë, edhe më shumë. Këtu e kam unë muhabetin dhe jo atje ku do të më hedhësh ti! — i tërroqi fjalët zvarrë ai me një theks të pakë-naqur.

— Kështu po, — pohoi Mexhiti gjithnjë me atë buzëqeshjen e mëparshme.

— Vëri re mirë muhabetit, pastaj futu në muhabet! — tingëlloi zëri i Limanit, duke e vështruar të vëllanë me një vështrim gërvishëtës.

— Këtu ke të drejtë, — foli në formë autokritike Mexhiti. — Edhe për të metat e mia ke të drejtë.

— Ju akoma s'keni stalla ku të futni bagëtinë. Je brigadier, ti duhet të bërtasësh i pari për bagëtinë. Apo thua, bagëti është ajo, lëre jashtë po të duash ose mos i jep të hajë, s'ka gojë ajo, po kështu nuk lejohet, sidomos nuk të lejohet ty si brigadier.

— Është parimor Limani, — i tha Petriti Mexhitiit, duke e shikuar me sytë e tij, ku i shndriste një nënqeshje e mprehtë.

— Sa për atë, s'ta përton ky, — ia priti Mexhiti me zë përkëdhelës.

Limani kishte rënë në mendime. Petriti kënaqej pa masë, kur shihte që njerëzit ishin të shqetësuar për problemet. Petriti ishte gjithë pasion për punën. Ai e ndiente veten të lumtur që bashkë me komunistët e tjerë, duke zërthyer direktivat e Partisë, po punonte e po luftonte për t'i vënë në jetë ato.

— Tani po ngrihem, — tha Petriti, i pushtuar i téri nga pasioni pér të vazhduar më me vrull punën pér mbjelljen e mollëve.

— Merr ca arra dhe jepua shokëve të tjerë, — i tha Limani dhe i zgjati pjatën pérpara.

Limani doli me të çalë-çalë.

— Dalim këtej, më shkurt, — i tha ai Petritit dhe prenë nëpër një monopat të thepisur, pastaj kapërcyen ujet e një përroi të vogël dhe dolën atje ku po bëhej mbjellja e mollëve. Puna apo kishte filluar. Vajzat e gratë punonin si gjeraqina. Mollët po mbilleshin në kushte të mira. Kishte ardhur edhe agronom Dauti pér të parë në vend se si po shkonte puna. Disa gropë ai i kishte nxjerrë si të pavlefshme, sepse nuk ishin hapur sipas positive të dhëna.

— Të lumtë, shoku Daut, ke të drejtë, — i tha Limani dhe bashkë me tre punëtorë të tjerë zuri të ndreqte gabimin. Dikush vajti dhe i tha diçka në vesh. Pastaj Mexhiti vështroi një nga një anëtarët e brigadës dhe vështrimin e ndali në fund te Xheja. Ajo po mbante në krah disa rrënje mollë. Dukej si e tronditur.

— Kur kështu? — pyeti si i habitur Mexhiti vajzën që i kishte thënë diçka në vesh.

— S'ka as një orë. Nuriu na doli pérpara dhe u pérpoq që ta shkëpuste Xhejen nga unë. Po as ajo, as unë nuk u ndamë nga njëra-tjetra. Mua ai më shau, kurse Xhejes i dha një letër në dorë. Xheja nuk e mori, po ai e kërcënoi.

— Na qenkerka bërë trim i madh! — pëshpëriti me një zë të mbytur e gjithë inat Mexhiti. — Po ty ç'të tha? — e pyeti vajzën, tek merrte frymë me hundë, me zhurmë.

Mexhit! u dëgjuia zëri pak i lartë i agronom Dautit.

— Urdhëro, shoku agronom!

— Hë, more vëlla, se na mbetën mollët!

— Po bisedoj diçka, — dhe Mexhiti ktheu kokën nga ajo. — Çfarë të tha? Ke turp të më tregosh mua?

— Ti do ta pësosh si Dilja, — më tha.

Mexhiti tundi kokën dhe zvogëloi atë syrin e tij të majtë.

— Mirë, mirë, do ta shoh unë këtë punë. Ju mos e bisedoni me njeri këtë çështje, — tha ai dhe u largua. Vajti për të parë a ishin ndrequr gropat, pastaj tërroqi mënjanë agronom Dautin dhe i tregoi me hollësi gjithë veprimet e Nuri Lokut. Agronom Dauti zuri ta vështronë Mexhitin me sytë e tij pak të fryrë dhe, si u mendua një hop, tha si i pakënaqur:

— S'kanë ç'të duhen ty këto, o Xhit!

— Jo, shoku Daut, — e kundërshtoi Mexhiti dhe fytura iu skuq. — Këtu, në brigadë, unë jam si babai i të gjithëve, prindërit e tyre më kanë besuar mua.

— Ku je, o Xhit, ku je! — dhe i ra krahëve si me përkëdhelje — Babai i vegjëlisë!

— Si kujtovë ti? Të lëmë horrat që të prishin rregullat dhe qetësinë e brigadës? — dhe sytë e Mexhshit shkëlqyen plot shqetësim.

Dauti e kishte zakon që, kur fliste me dikë, sytë i mbante ulur, si ndonjë shenjtor. Edhe kësaj here ai e dëgjoi Mexhitin me sytë të ulur përdhe.

— Ku je, Xhit! — ia priti përsëri agronomi me pamjen e një njeriu të habitur. — Nuk e kam ditur që ti je kaq i rreptë, — shtoi duke tundur kokën e tij me flokë që vazhdonin t'i binin gjithnjë.

— Unë të vura në dijeni si shok e si agronom i sektorit.

— Kurse unë po ta përsërit e po të them se nuk merrem me çështje të tillë dhe të këshilloj që edhe ti të merresh me punët e brigadës e jo me thashetheme, — ia ktheu Dauti. — Shko atje dhe mos e humb kohën kot.

Mexhiti e ndjeu veten pak të fyter. Fytura dhe qafa iu skuqën, po e përbajti veten. E ndoqi me sy Dautin tek ecte me ato këmbët e tij të holla e të kthyera, si të atyre kalorësve, dhe diç nisi të mendonte me vete....

Natë. Fshati bën gjumin e parë. Njerëzit po çlo-dhen pas tërë asaj pune që kanë bërë gjithë ditën e ditës. Një dritë elektrike feks diku në një dritare të shtëpisë së Xhevrie Vishnjës. Hëna, si drapër, ka formuar një rrëth të hollë si prej tyli transparent, me ngjyra si të ylberit.

Xhelal Vishnja vesh çizmet prej gome dhe del si kusar nga shtëpia. Ai ecën me kujdes nëpër rrugën e ngushtë të kaldrëmtë. Çapet e tij s'para dëgjohen qartë në atë natë të errët e të qetë. Ai éshtë nisur për te shtëpia e Nuri Lokut, që po e priste me padurim. Ata e kishin biseduar me hollësi planin e këtij takimi.

— Erdhe?

— Po. Nisemi?

— Gati jam.

Ata morën udhën në heshtje me dy dhi të lidhura me litar. Udhëhiqte Nuri Luku. Pas, Xhelal Vishnja shtynte herë pas here me duar dhitë. Nëpër dushqet këndonin zogjtë e natës. Si bënë nga dhjetë minuta udhë, Nuriu qëndroi në një si udhëkryq.

— Ç'pate?

— S'di nga t'ia mbaj.

— Vazhdo drejt!

— Më mirë i biem këtu, nëpër kopsht.

— Pse?

— Këtej dalim drejt e te hauri i tij.

— Mirë, nisu!

Nuriu preu majtas, shtypi me këmbë një grumbull ferrash që shërbenin si gardh dhe çizmet e tij të llastikta u ngjeshën në tokën e butë të kopshtit të mbjellë me perime. Xhelali përpiquej të shkelte mbi çapet e shokut. Të dy ishin të frikësuar. Xhelali shpuri dorën te balli dhe dora iu njom nga djersa, kurse Nuriu, pa ditur si, lëshoi një pshërëtimë. Sa më shumë që i afroheshin shtëpisë së Islam Sulës, aq më shumë u dridheshin lejet e këmbëve.

Hauri i Islam Sulës ishte më të djathëtë, nja dhjetë

metra larg dhomës ku flinte eëma e Islamit, nënë Qerimeja, siç e thërrisinin fëmijët e lagjes.

— Ja tekështë hauri, — pëshpëriti Nuriu.

— Pusho! — ia preu fjalën Xhelali dhe i ra me bërryl.

— Prit pak, — dhe Nuriu zuri të vështronë me kujdes rreth e rrötull. Ai dhe Xhelali e dinin se as Islam Sula, as fqinji i tij, Din Luga, nuk mbanin qen. Po megjithatë, duhej kujdes. E kishin bërë me fjalë qysh më parë se, edhe po t'i pikaste dikush, ata do të thoshin se gjithë natën kishin qenë duke kërkuar rrötull nëpër fshat dy dhitë e humbura të Nuri Lokut.

— Nisemi, të mos e zgjatim, — i tha Xhelali në vesh dhe Nuriu bëri përpara. Kapërcyen edhe një gardh tjetër të vogël, hapën një trinë, ecën edhe pak dhe ja, hauri. Diku u dëgjua zëri i një këndesi. Atyre u rrihte zemra me vrull. Xhelali hoqi rezen e derës dhe hapi haurin. Era e athët e plehut të ngrohtë të dhive iu përplas në fytyrë, iu fut në hundë dhe i zuri grykën. Nuriu, nga ana e tij, shtyu me duar dhinë e parë, pastaj të dytën. Ai largoi dorën nga vithet e ngrohta të dhisë, që u përzie me të tjerat. Pastaj Xhelali tërroi derën përsëri. Menteshat e ndryshkura kërcitën; ai shau me vete, pastaj që të dy u larguan me hapa të mëdhenj, përmes kopshtit, andej nga kishin ardhur. Kur e panë veten jashtë çdo rreziku, u dëgjua zëri i Xhelalit:

— Tani le ta shohë ai qen e bir qeni se si do ta pësojë!

Nuriu kishte shpënë dorën në anën e zemrës dhe ndiente se si ajo i rrihte me një shpejtësi të çuditshme. Por ishte edhe shumë i kënaqur që nuk e kishin diktuar. Hëna u fsheh pas një reje, dhe errësira u bë më e thellë. Luginat, atje tej, oshëtinin. Hëna doli përsëri dhe, si një drapër shndriste e rrethuar nga re të holla. Rreth e rrötull qelli dukej sterrë i zi. Edhe pak e ndoshta do të zbardhë. Ata u ndanë pa fjalë, sepse gjithçka ishte parashikuar dhe e planifikuar.

Xhelali mbërriti më parë në shtëpinë e vet, se e

kishte më afër, u zhvesh, ndezi një cigare dhe, ashtu siç rrinte i shtrirë me kurriz, po e thithte i pushtuar nga lloj-lloj mendimesh; kurse Nuri Loku, me të vajtur, zgjoi të atin dhe i tregoi me hollësi se si kishin vepruar atë natë.

— Litarin duhej ta kishit marrë! — e qortoi i ati me fytyrën të prishur nga gjumi.

— Harruum!

— Jeni trembur, prandaj keni harruar.

— Jo, nuk u trembëm.

— Lëri lloget! Jeni trembur që ç'ke me të, ndryshe s'kishit përsë të harronit litarin. Çohu tanj, ndiz zjarrin dhe vërv xhezven! — i tha ai dhe u ngrit. Plaku qëndroi një hop në këmbë, ngriti brekët e gjata, të bardha dhe, duke e lëkundur, vajti në kthinen tjetër.

Nuriu ndezi zjarrin. Pas pak u kthyje i ati, që ndejni pranë vatrës, duke ndezur njérën cigare pas tjetrës...

... Në orën gjashtë fiks, plaku Dervish Loku trokiti në derën e Pashone Krepit. Ajo ishte ngritur me sy pak të buhavitur dhe po i jepte ujë lopës në një kusi të vjetër me gunga anash.

— Më kanë vjedhur dhitë, oj Pashone! — tha ai me zë të ngritur e si duke vajtuar.

— Si? — pyeti e shqetësuar Pashonia.

— Më fikën, Pashone, më dogjën fare! Ti e di gjendjen time?

— Si është e mundur?! Kur kështu?

— Mbrëmë, natën. Kanë hapur haurin dhe më kanë marrë dy krerë dhi.

— Çudi! Sidoqoftë, shko lajmëro edhe Bedri Gjuzin.

— Po, do t'i lajmëroj të gjithë. Mos më lini në baltë, oj Pashone! — dhe iku duke ecur si i shastisur, me ato këmbët e holla e të shtrembëruara nga pleqëria. Bëri përpjekje nga lagjja e sipërme, por iu zu fryma dhe kraharoni filloi t'i vërvhellente. «Ta tregoj unë qejfin, jezit!» — thoshte me vete, duke gulçuar si kalë i lodhur. Kishin hasmëri të vjetër këto dy familje në Arrë.

Bedri Gjuzin e gjeti pranë zgjoit të bletëve.

— Si u gdhive, o Bedri?

— Mirë, po ti, xha Dervish?

— Më ka gjetur e zeza, është djali im, më ka zënë gjarpëri me shtatë kërë.

— Po ti thuaje një herë se çfarë të ka ndodhur, pastaj fillo e ankuohu! — foli me atë tonin e tij të që-të Bedri Gjuzi.

— Ah, ç'më ka gjetur mua të zinë, more Bedri Gjuzi, më kanë vjedhur, more djalë, më kanë hapur burgun e gjësë së gjallë dhe më kanë grabitur dy kërë dhi!

— Nuk është e mundur! Në fshatin tonë ka shumë vite që s'kemi pasur gjëra të tillë.

Ja, pra, tek më gjetën mua të varférin.

Bedri Gjuzi diç zuri të mendonte: «Ndoshta mos kanë ardhur nga ndonjë fshat tjetër?» — pyeti ai veten.

— Po tani si t'ia bëj unë? — pyeti plaku, duke përpëlitur qepallat.

— Ti vetë me dorën tënde i mbylle mbrëmë dhitë?

— Jo, djali.

— Mos i kanë humbur gjë djalit në pyll? Apo kushti mos janë bashkuar me ndonjë tufë të kooperativës?

— Jo, more Bedri, jo, as i kanë humbur djalit, as janë bashkuar me të kooperativës. Njeriu që i vodhi, ka hapur burgun po të them, — i mëshoi zërit ai. — Unë Pashonen e lajmërova, edhe ty të lajmërova, tani po shkoj tek Islam Sula dhe te Habibja, si kryetare Fronti që e kemi. Hajduti është i brendshëm, këtë unë e di si buka që ha, — dhe u largua. Me cilindo që takohej, Dervish Loku i thoshte me fjalë alarmante se e kishin vjedhur dhe plaçkitur. Disave ua tregonte se çfarë, disave jo. Kur vajti te Islam Sula, aty ndjeu se gjunjët filluan t'i dridheshin. Nuk ishte shaka. Kishte të bënte me kryetarin e këshillit të bashkuar. Islami sapo ishte rruar dhe po fshinte fytyrën me një peshqir ngjyrë blu. — Hajde, xha Dervish, hajde, mirë se erdhe! — i tha Islami me buzë në gaz. — Tuajat paskan qenë ato dy dhi?

— Të miat, të miat, pse ku janë?! — zgurdulloi sytë Dervishi.

— Unë u habita kur më tha plaka se kishte gjetur në haur dy dhi të huaja, aty i ke, prit se t'i nxjerr unë.

— Jo, jo, unë nuk i marr pa qenë edhe Bedri Gjuzi, edhe Pashone Krepin.

— Pse? — dhe Islami u prish në fytyrë.

— Sepse unë dua të di kush m'i mori, dua se di si erdhën dhitë aty brenda në haurin tënd, erdhën vetë apo i futi dikush. S'do mend se një dorë i ka futur, apo jo?

— E ç'do të thuash ti me këtë? — e ngriti zërim Islam Sula me një pamje tepër serioze.

— Dua të them se... — ai u përtyp pak, — ti e sheh vetë shoku Islam, ty po të gjenden dhitë e huaja në burgun tënd! Se qfarë i thonë kësaj, ti, je i mençur vetë, e kuption më mirë nga unë...

— Do të thuash se i thonë vjedhje?

— Mua ashtu më duket, mirë që e the edhe vetë, me gojën tënde.

Islam Sula ia plasi gazit. Plaku Dervish Loku iku pothuajse me vrapi. «Matuf»! — murmuriti me vete Islami, pështyu anash dhe hyri në dhomë.

Plaku u kthye pas pak tok me Bedri Gjuzin, me Pashone Krepin dhe menjë dy a tre fshatarë, të tjerë, të cilët, të habitur nga lajmi që kishin dëgjuar, ishin kthyer nga udha dhe kishin ardhur për të parë si qëndronte e vërteta. Doli Islam Sula dhe menjë buzëqeshje nervozë që i endej nëpër fytyrën pak të hequr u zgjati dorën, në fillim Pashones, pastaj, të tjerëve.

— Dhitë e mia i ka brenda, — u dëgjua zëri i mprehtë i Dervish Lokut.

Bedri Gjuzi e vështroi mu në ninëzat.

— Aty janë, me të vërtetë, — pohoi Islami gjithnjë me buzën në gaz, por që kuptohej lehtë se ai zien te përbrenda.

— Po si është e mundur? — pyeti me një fill zë Bedri Gjuzi.

— Edhe mua më guditit plaka nja një orë më parë. Ajo kishte vajtur, të milte dhitë, kur ç'të shohë? Dy

krerë të huaja lidhur me litar. Ajo erdhi e më tregoi dhe unë zura të qeshja. E pyeta se mos kishte parë ëndërr, por ajo më tha: «Eja shihi vetë, po të duash.» Vajta dhe i pashë. Nuk i njoha të kujt ishin. Tani po e marr vesh që paskan qenë të xha Dervishit! Mirëpo ky... — Islami shtrembëroi buzët dhe nga turpi gati-gati s'i mbeti gjak në fytyrë.

— Nuk dua të di si e qysh unë, dhitë a i ke brenدا, kjo më duhet mua, tha plaku me gjuhën që i kë-vizte si thimth gjarpri.

Pas një bisedimi me zë të ulët, Bedri Gjuzi, Pahone Krepi dhe Habibe Lisi u nisën nga stalla dhe që të tre hynë brenda. Eëma e Islamit sapo kishte mbaruar së mjeli dhitë. Në grazhd kishte pak bar dhe ca degë dashku. Brenda ishin dhjetë krerë dhi dhe një lopë race vendi, me trup të vogël, po me gjinj të mëdhenj, gjysmë të murmë, gjysmë në ngjyrë kafe të çelët, të mbushura plot me qumësht. Dy dhitë e Dervish Lokut rrinin veç të tjera. Bedri Gjuzi doli i pari nga hauri, me buzë të varura nga mërzitja. Ai ishte i bindur se gjithçka duhej të ishte zhvilluar ashtu siç e kishte shpjeguar Islami Sula dhe eëma e tij, nënë Qerimeja. Mirëpo, ja që dhitë u gjendën brenda në haurin e tij! Ky ishte një fakt. Ai përpiquej të merrte me mend, ashtu turbull, një lidhje që duhej të ekzistonte në mes këtij veprimi enigmatik dhe qëllimeve që mund të fshiheshin pas këtij veprimi.

— Mirë, xha Dervish, ti merr dhitë dhe shko në shtëpi! — i tha Bedriu plakut.

— Pa procesverbal? — pyeti plaku, dhe ajo mje-kra me qime të thinjura iu bë më e mprehtë.

— Jo, jo, ky ka të drejtë, — u hodh dhe foli Islam Sula dylli i verdhë në fytyrë. — Ju duhet të mbanë procesverbalin përkatës. Dhitë mua m'u gjendën në vathën time, pavarësisht si e qysh, tjetër hesap se në ç'rrethana. Kësaj pune duhet t'i shkosh deri në fund. Unë jam i bindur se e drejta do të dalë në shesh. Fundi i fundit, mendoj se duhet të lajmëroni

organet kompetente. Ju duhet të mbani procesverbal të rregullt. Urdhëroni brenda në dhomë! — dhe ai hapi derën me vrull. Ata të pestë, Islami, Dervishi, Loku, Pashonia, Habibja dhe Bedri Gjuzi, hynë njëri pas tjetrit, me përjashtim të plakut Dervish, sikur po hynin në një dhomë ku ishte vendosur një xhenaze...

16.

Të dielën u mblodh aktivi i partisë. Përveç anëtarëve dhe kandidatëve të partisë, ishin ftuar edhe disa shokë e shoqe pa parti, sekretarë të organizatave të rinisë, kryetarë të frontit, aktivistë dhe punonjës të rendimenteve të larta. Koha atë ditë ishte me shi. Malet dhe zalli poshtë s'dukeshin, nga që retë dhe mijegulla e bërdhë i kishin mbuluar nga poshtë lart.

Mbledhja e aktivit do të fillonte në orën nëntë. Në mençë ishin grumbulluar shumë fshatarë e fshatave. Bisedohëj me zë të lartë. Dukej që ishte një ngjarje e jashtëzakonshme.

Zyra e partisë gumëzhinte. Hynin e dilnin sekretarë të organizatave bazë e komunistë. Besnik Sala, sekretari i byrosë, u jepte ca broshura mbi luftën e klassave si dhe ca formularë për t'i plotësuar me të dhënat që kërkoheshin.

Pas pak shiu pushoi. Retë po shpërndaheshin. Dilelli shkëlqeu. Malet dhe qelli dukeshin si të larë nga shiu. Një aromë e këndshme, aroma e pyjeve dhe e fushave të lagura, përhapej anë e kënd.

Vullnetarët e Arrës u takuan me vullnetarët e Selishtës dhe të Bubrecit. Ata njiheshin që në qytet dhe,

sapo u takuan, filluan nga pyetjet dhe bisedat e ngrohta. Gjithgka qeshte dhe gëzonte. Njerëzit ishin veshur si për ditë festë. Të gëzuar ishin edhe ata që nuk do të merrnin pjesë në mbledhje, gjithë fshati, madje edhe fëmijët. Një grup çamarrokësh, ishin përgatitur pér të dhënë një koncert të shkurtër. E kishin bërë si zakon ata të drejtorisë së shkollës tetëvjeçare që ngjarjet e rëndësishme politike t'i kthenin në ditë hareje e gëzimi edhe pér nxënësit. Petrit Skënderi po bisedonte me Bilal Bregun e me dy vullnetarë të tjerë të Selishtës. Pashone Krepi, apo doli nga zyra e partisë, iu drejtua Petritit:

- Sot do të diskutosh, — i tha ajo.
- Cakto ndonjë tjeter, — iu lut Petriti.
- Jo, jo, do të diskutosh ti. Kështu më porositi edhe shoku Besnik
- C'mërzitesh, moj Pashone? — ia priti Bilal Bre-gu me zërin e vet të ngritur. — Sot gjithsecili nga ne do ta thotë ndonjë fjalë.
- Sidoqoftë, është mirë kur e di me kohë, — tha Pashonia.

Në kodrën përballë u dukën edhe komunistët e komunistët e Derdomit. Ata ecnë njëri pas tjetrit, si një tufë patash të egra. Petritit i gufoi kraharori. Sa bukur! Tamam si në kohë të luftës partizane...

Salla e vatrës së kulturës u mbush plot e përplot. Në presidium zunë vend kryetari i ekipit, pas tij sekretari i byrosë, Besnik Sala, kryetari i kooperativës, Petro Doraci, Pashone Krepi, një vullnetare nga Bubreci dhe bariu i dalluar i Selishtës, Ali Seferi.

Përparrë se të fillonte mbledhja, sekretarët e organizatave bazë raportuan pér pjesëmarrjen e komunistëve. Mungomin dy shokë e një shoqe. Njëri ishte i shtruar në spital, tjetri ndodhej larg me bagëtinë dhe nuk kishte pasur mundësi që ta zëvendësonin, kurse ajo shoqja ishte më lejen e lindjes. Kryetari i ekipit u ngrit befas dhe kritikoi sekretarin e organizatës së

Bubrecit që nuk kishte marrë masa me kohë për të bërë çmos që komunisti bari të ndodhej medoemos në mblédhje. Në fund, pasi nuk pranoi asnjë justifikim, porositi që kjo çështje të shtrohej për diskutim në organizatën bazë të partisë.

Sekretari i byrosë, Besnik Sala, ia dha fjalën kryetarit të ekipit, i cili do të mbante raportin. Ai filloi me një ton të shtruar e me një zë të plotë. Fjalët e tij të para nuk u dëgjuan mirë. Qetësia e plotë është vendos vetëm atëherë kur Besnik Sala i râ tavolinës me çok dhe tha:

— Mbani qetësi, shokë!

Atëherë vëmendja u përqëndrua e plotë te kryetari i ekipit. Raporti ishte analistik dhe me plot kritika. Qysh në kapitullin e parë, ku flitej mbi punën politike dhe ideologjike të zhvilluar nga organizatat bazë dhe komunistët, viheshin në dukje të meta e dobësi. Sipas raportit, këto të meta e dobësi buronin nga fakti se puna politike e ideologjike me njerëzit nuk ishte zhvilluar mbi bazën e një plani konkret dhe në mënyrë sistematike, por shpesh me hope. Përmendeshin me emra disa sekretarë organizatash bazë si dhe sekretari i byrosë së kooperativës, Besnik Sala. Ky, ndonëse e kishte lexuar më parë raportin, kur dëgjoi emrin e tij, ndjeu se u drodh dhe iu shtua frymëmarrja. Nuk ishte shaka, kritikohej përpëra njëqind e ca komunistëve!

Në fund ekipi dilte me një sërë detyrash e propozimesh. Ai kërkonte që rendimenti i grurit të rrитеj nga katërbëdhjetë kuintalë për hektar, në njëzet e një kuintalë, i misrit nga njëzet e shtatë kuintalë për hektar, në tridhjetë e gjashtë kuintalë, propozohet të mibilleshin dhjetë hektarë me fruta — kryesisht me mollë — të hapeshin pesëdhjetë hektarë tokë e re, të hapej brenda vitit të ardhshëm kanali vaditës Arrë-Selishtë-Bubrec, që do të rriste përqindjen e tokës së vaditshme të kooperativës nga 35%, që ishe, në 72%. Për rritjen e rendimentit të drithrave, aktivë porosiste që të bëhen në çdo vit plugimet e thella, të

zhvillohej luftë e vazhdueshme kundër sëmundjeve dhe barërave të këqija, të shtohej sasia e plehërimit të tokës me pleh kimik e organik, të forcohej lufta kundër lagëشتirës dhe gjerryerjes, të hapeshin vija kulluese, me qëllim që rrrëketë dhe ujërat e përrenjve malorë të mos e dëmtonin tokën, të mirëmbaheshin kanalet, të mbilleshin farëra të zgjedhura dhe të përdorej sasia e duhur, duke hedhur dy kuintalë grurë përiktar dhe jo siç kishin vepruar disa brigadierë të kësaj kooperative, që kishin hedhur tinëz rreth tetëdhjetë-nëntëdhjetë kilogramë për ha. Pika e fundit e raportit mbyllej me rekomandimin që i bënte aktivë, kryesisë së kooperativës dhe disa organizatave bazë që t'u kërkohej llogari e të merreshin masa ndëshkimore ndaj kryetarit të kooperativës, kryeveterinerit, Afrim Qosës, kryeagronomit, agronomit të sektorit të tretë, Daut Mersinit, dhe shefit të llogarisë. Përsa i përket sekretarit të byrosë, Besnik Salës, kryetari i ekipit e shpjetgoi edhe me fjalë se nuk propozohet përmasë, përsaryse se ai kishte pak kohë si sekretar byroje, afro një vit, dhe nuk i takonte të përgjigjej përgjithçka.

Filluan pëshpëritjet vesh më vesh. Salla gumëzhitë si koshere bletësh.

- Na u zu fryma, — i tha Bilal Bregu Petritit.
- Është e vogël kjo sallë për një mbledhje kaq të gjerë.
- Kjo ka qenë xhami deri vjet.
- Kam dëgjuar, — tha Petriti.
- C'kemi hequr për ta prishur! Unë atëherë po përgatitesha për t'u bërë anëtar partie. Ma caktuan si detyrë që bashkë me dy shokë të tjérë të merrja pjesë në prishjen e xhamisë. Ishin hapur lloj-lloj fjalësh. Thuhet se të gjithë ata që do të vinin dorë kundër saj do ta pësonin keq. I pari u fut Islam Sula. Ai përpiquej të mos e jepte veten. Pas tij isha unë. Të them të drejtën ndjeva një farë frike të çuditshme, sidomos në çastin kur tërroqa qilimin. Tamam atë çast kërcitën tjegullat. Ai dreq Sherif Arra, për t'u tallur me ne, kishte he-

dhur një gur në çati. Islami një të përlarë u bëri dy postiqeve, unë tërroqë zvarrë qilimin e fishek përashta.

Petrit Skënderi mbante shënime. Ishte hëra e parë që ai merrte pjesë në një aktiv partie fshati. I pëlgente të ndiqte çdo gjë me vëmendje, të shihte njerëzit që bënин pyetje, të dinte përsë preokupoheshin atë dhe si i shtronin çështjet. Ai ishte ulur mbi një stol të gjatë mbushur plot e përplot me grë e me burra. Në të djath-të kishte një grua të veshur me pantallona, me fustanin të nxjerrë sipër pantallonave, me një pulovër të re, ngjyrë vishnjë. Nën pulovrën kishte një bluzë të bardhë, të pastër, me ca tentena te gryka. Në kokë mbante një shami gjithashtu të bardhë, që ia nxirrte në pah fytyrën pak të imët, sytë larushë, buzet e vogla dhe hundën pak me majë, si bisht rosaku. Pranë saj rrinte një grua tjetër, krejt si ajo, thua se ishin motronë, madje ngjanin aq shumë me njëra-tjetrën, sa mund t'i merrje për binjake. Por kjo e dyta dallonte ngaqë ishte më e re dhe si e tillë dukej edhe më e freskët, edhe më e bukur. Pak më tej ishte Rabia, grua e bëshme, me fytyrë të madhe, me një gërshtet të gjatë, që e kishte nxjerrë poshtë shamisë, me duar të mëdha si të ridonjë burri të fuqishëm, me gjoks të mbushur dhe me një fytyrë me mollëza të kërcyera. Ngjitur me të rrinte një vullnetare, një vajzë e re kjo, me një fytyrë të rrumbullakët, me flokët si cjad, mu përparraballit, me ca sytë mëdhenj, me hundë të vockël dhe me gushë të gjerët e të bardhë. Dukej vajzë shumë e përzemërt. Më tej ishte ulur Bimi, i biri i rojës, një djalë kuqalosh, me fytyrën me pikë në ngjyrën e kafesë së hapur, me kokët të madhe e si me gunga anash, me vetulla të kuqërrëmta, me veshë të rënë. Ai mbante një fanellë të verdhë tip golf, me plot rrudha. Në të djathë të Petritit ishte Bilal Bregu, pastaj vinte Asllan Beri, pranë tij Murat Dushku nga Selishta, të cilin Petriti e njihtë dhe kishte dëgjuar shumë për të. Murati i kishte sytë të brishët, flokët i krihte me kujdes dhe i ndante anash. Tek e vështroi në profil, Petritit iu kujtua një histori që i ki-

shin treguar për të. Murati i kishte propozuar «dashuri serioze» një ndihmësmjekeje që kishte shkuar në Selishë me një ekip shëndetësor, mirëpo ndihmësmjekja ishte skandalizuar dhe i kishte thënë ca fjalë aq të rënda, saqë Murati s'e kishte parë rrugën nga kishte vajtur... Pranë Muratit rinte mësuesi nga Derdomi, Shaban Derdomi, me kokë pak të madhe, me flokë krejt të thinjur, që i shkëlqenin si platin, me një fytyrë të kuqe ku sapo kishin filluar t'i vizatoheshin rrudhat e para.

- I pari që e mori fjalën ishte Besnik Sala.

- E quaj me vend kritikën e rëndë që më bëri ekipi i partisë dhe i premtoj aktivit se do të luftoj me të gjitha forcat e mia që të eliminoj të metat dhe të ndihmoj, më shumë në mbarëvajtjen e punës, — tha ai me zérin e tij pak të ngadaltë dhe vazhdoi: — Përsa i përket fârkimeve të mia me kryetarin e kooperativës dhe disa mosmarrëveshje që kam pasur me të për disa probleme, unë jam dakord me propozimin e ekipit që këto ti analizojmë në një mbledhje të veçantë të organizatës bazë dhe të mos bëhen objekt diskutimi këtu, sepse do ti hante shumë kohë aktivit.

Pas këtyre fjalëve, salla gumëzhiu përsëri nga pëshpëritjet Besniku u detyrua të heshtte. Nuk po e dëgjonte më njeri, Shihej qartë se ikureshtarët donin që këto mosmarrëveshje të shtroheshin patjetër aty, madje njëri u ngrit dhe tha se ata duhej të jepnin llogari përsë déri më sot e kishin mbajtur të fshehur një gjendje të tillë. Një komunist tjetër tha se edhe ekipi gabonte që kishte dalë me një propozim të tillë. Pas disa diskutimesh, u vendos që, po të ishte nevoja, do të jepeshin ca sqarime plotësuese, përpëra se të mbaronte mbledhja. Atëherë Besnik Sala vazhdoi të fliste përsëri. Ai ishte përqëndruar në pasqyrimin e punës së komunistëve dhe të rolit pararojë të tyre.

- Ne e kemi laydëruar punën e rinisë, që nën drejtimin e komunistëve është hedhur në aksione konkrete. Me aksion ata hapën rrugën automobilistike të

Derdomit, me aksion mbollën patatet dhe mposhtën shumë vështirësi të natyrës dhe, para së gjithash, të ftohtin e madh, me aksion vazhdojnë hapjen e tokave të reja. Tani ne ndodhemi përpara disa detyrash shumë më të mëdha se deri më sot. Mendoni mirë, duhet të marrim 21 kuintalë grurë për hektar në vend të 14-ve që kemi marrë, ose duhet të marrim tridhjetë e tre kuintalë misër për hektar në vend të 27 kv-ve.

- Jo 33, por 37 për hektar, — e korrigjoi dikush.
- Më fal, pse sa thashë?
- The 33.

— Më falni, gabim, duhet të marrim 37 kuintalë. Po mos harroni se janë po ata njerëz dhe është po ajo tokë. Asgjë nuk do të na bjerë nga qelli, si peshqesh. Gjithçka varet nga duart tonë, nga lufta jonë, nga djerëtë jonë. Prandaj sot e tutje lipset një punë më e madhe, një disiplinë më e çeliktë, një organizim më i shëndoshë. Këtu bashkohem me vërejtjen që bëri ekipi se organizatat bazë të partisë nuk kanë ditur ta përdorin si duhet punën politike dhe ideologjike si armën më të mprehtë për të kapërcyer vështirësitë dhe për të shkuar përpara. Duhet t'i bëhet e qartë çdo personi, çdo kooperativisti, edhe fëmijëve, se ai që dëmton pasurinë e përbashkët, ai brigadier që jep ditë pune të tepërtë, ai shok ose shoqe që nuk realizon normën dhe nuk i bën shërbimet e duhura bimës, qysh nga çasti që e mbjell, deri kur e korr dhe e fut në hambar, ai dashje ose padashje shpie ujë në mullirin e armikut. Raporti me të drejtë kritikon. Brigadieri i Selishtës doli dhjetë kuintalë grurë deficít. Në aktiv pati edhe pyetje se ç'do të bëhet me këtë njeri. Ne si parti jemi marrë shumë me këtë çështje. Brigadier Selmani pretendon se ka hedhur më shumë farë gruri nga ç'është porosia. Kemi bërë disa verifikime. Bile llogaritëm se, edhe sikur të kishte hedhur tre kuintalë grurë për hektar, përsëri deficiti del i madh. Pse? Ka dy gjëra: ose ia kanë vjedhur në depo grurin, ose e ka humbur kur e ka transportuar me kafshë. Unë personalisht jam i bindur se shoku Selman

vetë nuk ka dorë në këtë punë. Mirëpo ai lejoi keqbë-
sësít që ta përvetësonin e ta dëmtonin mallin e popu-
llit, prandaj ai duhet të përgjigjet, të përgjigjet rëndë,
qoftë edhe penalisht!

Në sallë u dëgjuan përsëri pëshpëritje:

— Penalisht? Për në burg?

Besniku vazhdoi:

— Lidhur me shembullin personal të komunistëve, ne kemi ç'të themi, qoftë për të mirë, qoftë për të keq. Marrim për shembull dy brigadat e Bubrecit. Të dyja janë në kushte të barabarta, me krah pune, me mjete pune, me tokë e me të gjitha të tjerat. Po si shpjegohet fakti që brigada e dytë arriti të merrte mesatarisht njëzet e katër kuintalë grurë për hektar, bile pati parcela të veçanta që arriten të jepnin deri në njëzet e shtatë kuintalë grurë për hektar? Kurse brigada e parë me zor kapi gjashtëmbëdhjetë kuintalë! Çfarë i thoni ju kësaj? C'emer t'i vëmë? Ku qëndron sekreti i fitores për brigadën e dytë dhe ai i humbjes për të parën? Sipas mendimit tim, këtu kemi të bëjmë kryesisht me çështje ideologjike. Është e tepërt të theksoj se komunistët e brigadës së dytë, duke qëndruar në krye të punës, duke paraprirë me shembullin e tyre personal, kanë mobilizuar gjithë masën pa parti dhe kanë zbatuar me ndërgjegje të lartë të gjitha kushtet agroteknike. Ishin të rinjtë e asaj brigade që, kur panë se nuk u mjaftonte plehu organik, shpalllen aksion që të grumbullonin e të nxirrin nëpër ara plehon e tyre personal. Ata arriten të bindnin edhe prindërit e tyre dhe ne u themi ju lumtë, se kështu thyhen konceptet dhe shkohet përpara.

Shpërthyen duartrokitje. Besniku merrte frymë me hundë, me zhurmë. Kishte folur me gjithë shpirt dhe me zë të lartë. Ai vazhdoi edhe disa minuta, po me atë ton, po me atë mënyrë, duke bërë krahasime në mes të shembullit pozitiv dhe negativ. Në fund tha:

— Unë nuk jam dakord me vërejtjen që propozohet për shokun Petro Doraci. Këtë ia kam thënë personalisht edhe kryetarit të ekipit. Shoku Petro Doraci është një i

vetëm. Pse u dashkërka të përgjigjet pér gjithçka vetëm ky? Këtu ka kryesi, ka byro, ka organizata bazë dhe brigadierë që udhëheqin. Prandaj nuk jam dakord. — Dhe vajti e u ul në vendin e tij, pranë Pashones.

Petro Doraci lëvizi instinktivisht nga karrigia. Nuk e kishte menduar një veprim të tillë nga ana e Besnikut. Iu rrit shumë respekti pér atë njeri, jo sepse propozoi të mos i jepej vërejtje, ai ishte i bindur se organizata-bazë do të miratonte propozimin e ekipit, por sepse Besnik Sala tregoi se ishte njeri i ciltër i pastër, komunist.

Pas pak Petro Doraci u ngrit, pér të folur. Ai vuri gjyzlykët dhe filloi të fliste duke mbajtur me të dyja duart blokun e shëнимeve.

— Unë bashkohem me mendimin dhe konkluzionin e ekipit si dhe të diskutantëve se kooperativa jonë i ka të gjitha mundësítë që të dalë nga prapambetja dhe të radhitet me më të mirat në rrëthim tonë. Por ka mungesë disipline dhe moszbativ urdhrrash. Secili kërkon të bëjë sipas kokës së vet! Sot aty në mensë po grindeshin agronom Dauti me brigadier Mexhitin. Pse grindeshin? Ja sepse: dje erdhi një traktor në Zall. Por pas disa orësh kryeagronomi me agronomin e sektorit dhanë urdhër që traktori të nisej pér në Bubrec. Mexhiti filloi të ulërinte: «Nuk punohet kështu», — bërtiste. — «Ju po na nxini faqen përpara popullit. Do të bisedoj me Besnikun dhe do të dorëzoj detyrën. Nuk mban më ujë pilafi...» Dhe, pér mendimin tim, fajin e kishte Mexhiti.

— Me leje, shoku kryetar? — e ndërpren befas Mexhit Driza.

— Ulu, ulu ti, Mexhit.

— Jo, jo, dua t'i bëj një pyetje kryetarit.

— Thuaje, ç'pyetje kërkon të më bësh? — dhe Petroja hoqi gjyzlykët.

— Ti kështu e ke zakon, shoku Petro, — kumboi zëri i ngjirur i brigadier Mexhitit. — Na sulmon ne pér hater të teknikëve.

— Vazhdo, Mexhit, se ke shumë të drejtë, — ia priti dikush nga salsa.

— Edhe për fasulen pllaqi ti na the mbilleni, se uji do t'ju vijë, por uji s'na erdhë.

— C'lidhje ka fasulja pllaqi dhe uji në këtë mes? — foli si i habitur Petro Doraci, — ne po flasim për tjetër gjë këtu.

— Ka, ka lidhje, o shoku Petro, — kundërshtoi pa e prishur gjakun Mexhiti. — Ti veç teknikët di të mbrosh. E pse nuk i kritikove ata që nisën traktorin nga Zalli në Bubrec? Ti e di mirë, shoku Petro, se ne jemi më prapa me punimin e tokave, e di gjithashu se traktori ishte planifikuar pér ne. Unë edhe tani ta përsërit se kështu nuk mund të punojmë!

Krisën bisedat. Disa thoshin:

— Ka të drejtë Mexhiti.

— Si të mos zbatojë urdhrat e specialistëve?

— Bjeri shkurt ti, shoku kryetar, — u ngrit pa pyetur njeri Bilal Bregu. — Për hesapin tim, gabimi është i tyre dhe yti. Gjithë ditën të flasësh për këtë çështje, ti nuk na e mbush mendjen. E di si e ke pësuar ti me Mexhitin? Si bualli me delen. E vunë me bast bualli me delen se kush mund të hante më shumë bar. Filloi bualli ha, ha, ha, derisa erdhë e u fry si mullar. Në fund plasi. Davanë e fitoi delja, që hante qetë-qetë dhe mengadalë...

Plasën shakatë.

— Të lumtë, Bilal!

— Ulu, more, aty ti e mos na e bëj kryetarin buall.

— Pse, ç'ka bualli? Është si traktor!

— Bile me shpirt.

— Që s'ka nevojë as për naftë.

— Hi, hi, hi, — qeshën nja dy gra.

Petro Doraci tha se Mexhiti nuk e kishte kuptuar qartë mendimin e tij, se urdhri për largimin e traktorit nga Zalli në Bubrec duhej zbatuar, natyrisht duke ruajtur të drejtën që Mexhiti të kritikonte veprimin e tyre.

— Po për fasulet pllaqi që s'nxorëm as shpenzimet tona? kush përgjigjet, shoku kryetar? — përsëriti pye-

tjen e tij brigadier Mexhiti, se e dinte që kjo çështje ishte ndër pikat e dobëta të kryetar Petros.

— Lëreni të vazhdojë shokun Petro, — u ngrit e foli kryetari i ekipit.

Petroja u kollit.

— Lidhur me shembullin personal të komunistëve, për të cilën bën fjalë edhe raporti dhe që u dhanë mjaft mendime edhe nga shokët parafolës, unë mendoj se kjo çështje duhet parë më me seriozitet, sidomos dalja e komunistëve në prodhim, dhe të mos ndodhë si me disa që kanë zënë ndonjë qoshe dhe kanë rënë në rehatllék.

— Duam emra, shembulla, or kryetar, — tha një i ri nga Derdomi.

— Shembulla sa të duash, edhe emra gjithashtu. Ja për shembull, kemi rastin e shoqes Sabrie Sula, anëtare e byrosë, që punon si magazinierë me njëzet ditë pune në muaj. Shoqja Sabrie është mirë të dalë në brigadë, sepse kështu do të jetë drejt përdrejt në prodhim dhe do të ketë mundësi të lidhet më ngushtë me masat.

— Po rasti i Sherif Arrës? — u dëgjua zëri i Bilal Bre-gut.

— Po Sherif Arra? — e ngriti zërin vullnetari Sulë Metani.

— Edhe rasti i tij, edhe ai për mendimin tim ka mundësi të zëvendësohet me një shoqe pa parti. Sepse në popull ka pëshpëritje për këto gjëra.

Ai hoqi gjyzlykët, shfletoi blokun dhe tha:

— Shumë na preokupon si kryesi çështja e shpërdomive të pronës kolektive. Rasti i deficítit të brigadier Selmanit është tipik. Po ka edhe raste të tjera. Në Arrë u vodh mullari me bar dhe sot e kësaj dite vjedhësit nuk janë gjetur. Më duket ka përpjekje për komprometime reciproke. Unë nuk jam në kundërshtim me propozimin e ekipit që të mbajmë rrëth 2000 pula. Ne mbanim pula edhe më parë, por kishim shpërdorime; pothuajse çdo natë do të na zhdukeshin katër-pesë pula. «Kush i merr xhanëm?» — pyesnim ne. «Skilja», — na përgjigjeshin. «Po a mundet që skilja ta thyejë tërë këtë dhogë?» Atë-

herë na hidhnin në ujëra të tjera, duke na thënë: «Duket se është njeri që vjen nga «Kodra e Pëllumbit» dhe na i merr.» E njëjtë gjë na ndodhte edhe në sektorë të tjerë. Përpara tre vjetësh na vodhën tri dele. Patëm disa dyshime. Shkuam dhe kontrolluam befasisht. Por s'gjetëm gjë. Atëherë u detyruam t'ia bënim ngarkim bariut. Mirëpo u bë zhurmë e madhe! Çështja vajti në gjyq, dhe kooperativa fitoi davanë, por ama pati edhe njerëz që na shanin ne dhe me pa të drejtë mbronin bariun.

— Jo, shoku kryetar, ti gjithmonë po barinjve ua vesh! — tha një zë që doli nga salla si një rënkim i thellë. Njerëzit zgjatën kokën për të parë cili ishte ai që foli:

— Kush foli? — pyeti Besnik Sala.

— Unë, unë, pse është e ndaluar? — dhe personi që kishte folur u ngrit përgjysmë. Ishte një burrë me ftyrë të parruar, me flokë të rralluar te balli dhe me ca sy që sikur të shponin tejpërtej. Ishte bariu i Derdomit, Alush Culli.

— Mos më ndërpren, — murmuriti Petro Doraci, duke lëvizur nëpër duar bllokun e shënimave.

— Të ndërpres, se të dua të mirën. Mos bëj fajtorë kot së koti barintjtë, se, po hyre në hakun e tyre, nuk del më nga balta. E keni gjetur lehtë shtegun që të nxjerr atje ku do ti, o kryetar. U vodh delja, paguan bariu, çau ujku dhinë, në ngarkim bariut. Po se ka fëmijë për të ushqyer ky bari apo nuk ka, ju as që e çani kokën. Disa barinjve nuk u keni dhënë as pushkë. E me se ta vrasë ujkun ai, me dajak?

— I kemi bërë kërkesë degës së punëve të brendshme për armë.

— Jo, shoku Petro, unë bari jam vetë, të rrimë shtrembër e të flasim drejt. Jo një çikë gjë e bjeri bariut! Dje, kushedi e keni marrë vesh, ujku hëngri lopën personale të Haxhiut nga Bubreci. Thoni ju se donte Haxhiu që t'i ndodhte kjo që i ndodhi?

— Ti e ke diskutim apo pyetje? — e ndërpren kryetari i ekipit dhe, ngaqë foli si me vrull, u skuq në ftyrë.

— Merre si të duash, — tha Alush Culli, — jo bjeri t'i biem bariut... — dhe u ul duke kruar me gishterinj ballin.

— Shoku Alush, — ndërhyri Petro Doraci, duke zgjatur dorën, thua se deshi ta prekte në sup. — Nuk jam dakord me ty. Ti diskuton në mënyrë sentimentaliste. Ty dhe shokëve të tu ju kanë ngordhur 24 keça. Pse s'flet për këtë ti, po më mbron barinjtë? Ti na flet nga pozitat e revolucionarit në dukje. Kurse ne na akuzon si të ishim ballistë!

— 24 keçat kanë ngordhur po për fajin tonë, — e ngriti zërin Alush Culli pa lëvizur nga stoli ku ishte ulur. — A futen në një stallë të vogël 134 dhi?

— Aferim, o Lush!

— Tetë me dy ia bëre kryetarit.

Pëshpëritje e romuze të tilla qarkullonin nga një cep i sallës te tjetri, me zë të ulët, me të qeshura nën buzë.

— Sa krerë dhi ju ngordhën, shoku Lush? Pse nuk e thua as këtë? — vazhdonte kryetar Petroja, sepse e shihte se një debat i tillë ishte i nevojshëm, madje i domosdoshëm për të luftuar konceptet dhe sentimentalizmat.

— Na ngordhën dymbëdhjetë krerë, — dhe Lushi u ngrit ngadalë në këmbë.

— Ngordhën apo dështuan?

— Kanë faj veterinerët, shoku kryetar. Dhitë kanë qenë me zgjebë gati-gati pesë muaj më parë. Lindte keçi, dhia s'kishte qumësht dhe keçi ngordhë, Gjumi nuk na zinte kur dëgjonim që qanin keçat si fëmijë, ngaqë s'kishin ç'të pinin! E tani fajtor po bariun bëni! Keni hak. Për të folur dini të flisni më mirë se ne, shkollë po shyqyr keni, kryetar jeni, pse të mos ju presë shpatë sa andej-këtej?!

Duket që këto fjalë e prekën kryetarin e ekipit, sepse ai u ngrit rrëmbimthi dhe tha:

— Shumë bukur, kështu duhet t'i shtrojmë çëshijet, hapur, pa frikë e pa doreza. Partia ka nevojë ta njohë

gjendjen ashtu siç është, pa zburime. Prandaj çdo gjë që të keni në adresë të kryesisë, të byrosë së partisë, apo edhe të Komitetit të Partisë, thuajeni pa druatje, na ndihmoni, sepse gabime kemi edhe ne.

— Ne gabime kemi, — pohoi Petro Doraci, duke vështruar me ata sytë e tij të bardhë, — por secili përgjigjet për të vetat.

Petrit Skënderin e kishte marrë etja për ujë. Pas pushimit, ai vajti te çezma dhe piu ujë me duar, që i bëri si kupë. Mbledhja i kishte pëlqyer. Njerëzit flisnin hapur dhe po ngrinin probleme. Edhe ai do të diskutonte. Do të fiste edhe për rendimentin në punë, edhe për zakonet prapanike. Ai kishte vënë re se vajzat, me të mbaruar shkollën tetëvjeçare, vinin shamira në kokë dhe, sa po bëheshin nuse, nuk i thërrisin më me emrat e tyre, por me emrin e burrit. Kjo ishte diçka qesharake dhe e pështirë! T'i humbiste emri njeriut për së gjalli, kjo nuk mund të durohej! Petriti do të fiste edhe për kremin fshehurazi që u bëhej aty-këtu festave fetare. Kishte edhe një dy raste konkrete: një djale epileptik dhe një nuse që nuk lindte i kishin shpënë deri në kishën e Shënkollit! Do t'i përmendte të gjitha këto raste dhe do të bënte thirrje që komunistët të rrisin më tej vigjilencën revolucionare. Pastaj do të zotohej për zbatimin e atyre propozimeve që bënte ekipi. Sa shumë i kishin pëlqyer atij vendimi për hapjen e kanalit vaditës, krijimi i plantacioneve të frutave, i pularisë, i vitikulturës dhe masat për blegtorianë! Petriti kishte bindje të plotë se këto masa do ta përmirësonin gjendjen, do të rrisin entuziazmin e njerëzve dhe do të krijonin kushte për të ardhura më të mira.

— E, shoku Petrit, si po të duket aktivitët ynë? — e pyeti Sherif Arra, duke qeshur.

— Më pëlqeu, shoku Sherif.

— Do të propozoj të të bëjmë bari, — dhe Sherifi i vuri dy duart në gjoks Petritit.

— Unë shkoj me gjithë qejf.

— Jo, bëj shaka, është e vështirë ajo punë për ty.

Kam qejf t'ia rras Bilal Bregut, — dhe qeshi e u bë si plak në fytyrë.

Dielli grisi me forcë një copë rë të zezë dhe në tokë u derdh plot drítë e shkëlqim. Sherifi vështrroi përpjetë, me dorën si strehë. Petriti vajti të vullnetarët e tjerë.

17.

Xheje Brahimi ishte njëzet e një vjeç, me një trup të plotë, me shpatulla të gjera. Fytyrën e kishte të pastër e në ngjyrë si të pjeshkës; kurse sytë e saj të zinj e gjithë drítë të rrufitnin. Ishte fjalëpакë dhe punonte si gjeraqinë. Shpirtin e kishte të ndjeshëm, si një lule delicatë që s'duhet të trazohet, se ndryshe pezmatohet dhe vyshtket. Ajo donte shumë prindërit, donte të vëllanë, Metin, por mbi gjyshen s'vinte njeri. Vetë ajo, Xheja, e lante dhe e shpëlante, i shtronte bukën dhe, kur koha ishte e mirë, e nxirri në divanhane. Atje gjyshja rrinte e sodiste me orë të tëra. E hidhët vështrimin tutje, nëpër ato male, nëpër ato lugina dhe gryka në ngjyrë të çelikut. Kridhej në lloj-lloj kujtimesh ajo grua e mirë dhe zakonisht rrinte pa folur me vështrimin andej larg. Kur ndonjëherë Xheja e pyeste për diçka, gjyshja, e zhystur në kujtimet e saj, vazhdonte të heshtte.

«E shkreta e ka nga pleqëria!» — thoshte me vete Xheja dhe e prekte me dorë gjyshen për ta përmendur. Por në fakt gjyshja, ajo grua rrëth të tetëdhjetave, e kishte mendjen dhe kujtesën qiqër dhe mbante mend shumë gjëra.

Përballë saj dukeshin pemët e kooperativës, dhe nga

e djathta, pranë përroit, që s'e ndërpriste ujin as në gusht, dukej si një çadër e blertë, një vodhë e madhe, që s'kishte vit të mos bënte fruta sa të ngopeshin fëmijët e gjithë lagjes.

— Pse s'përgjigjesh ti, gjyshe? — e pyeste Xheja, që rrinte pranë saj.

— Pse, the gjë ti?

— Të fola, po nuk e kishe mendjen aty.

— Po shihja atë kodrën e Lekajve. Atje ka qenë një qarr i madh, shumë i vjetër; aty usta Aliu, gjyshi yt, kishte gjetur një zgjua bletësh. Atëherë edhe unë ruaja nja dy a tre keca të vegjël. Ishte si tani, nuk bënte as ftohtë, as ngrohtë. Usta Aliu ishte azgan, por edhe sert i madh. Nuk begeniste t'u fliste e t'u jepte rëndësi vajzave. «Eja të të jep mjaltë», — më thotë mua një ditë. Unë u habita. Mjaltë atje, në kodër midis pyllit?! «Eja, pra», — përsëriti ai dhe ma bëri me kokë. Shkova. Po ama pak si me frikë. Isha e vogël, nja gjashtëmbëdhjetë vjeç. Kur q'të shoh! Bleta e dynjasë mu në zgavër të qarrit! Usta Aliu e zhyti dorën deri në bërryl dhe e nxori plot e përplot me mjaltë. Ta shihje si shkëlqente mjalti në krahun e tij, si flori, dhe i pikonte pikë-pikë mbi gjethet e rëna të dushkut! «Ha mjaltë!» — më tha dhe më afroi krahun. Unë zura të lëpija dorën e tij. Ai rrinte serioz e nuk fliste. Rrallë lëpinte dhe ai pak mjaltë. Mirëpo e kishin pickuar grerëzat dhe ai erdhi e u fry në fytyrë aq shumë, sa sytë me zor po i dukeshin. Unë zura të qeshja. S'ishte mirë, po s'e mbaja dot gazin.

— Pse qesh? — u ngrys ai.

— Je enjtur.

— Për ty e bëra. Unë mund të gjeja një thes e të mbrohesha nga grerëzat.

— Për mua? — dhe ndjeva sikur ngriva.

— Po, vetëm për ty. Kështu do të më kesh gjithë jetën, si mjaltë.

— Sa bukur, gjyshe, kështu u njohët ju me babagjyshin!

— Kështu.

Xheja i lutej shpesh gjyshes t'i tregonte historinë e bletëve te qarri në kodrat e Lekajve. Edhe Xheja jetonte tamam ato çaste që kishte jetuar gjyshja e saj e mirë. Edhe ajo ishte njohur nga afër me Selim Qarrin dhe ishin dashuruar. Ata i kishin dhënë fjalën njëri-tjetrit. E donte shumë atë djalë ajo, e donte ashtu fshehurazi, siç di të dojë vajza e malësisë.

Xheja ishte qëndistarja më e mirë e Arrës. Qëndiste herë një shami koke për nusë, herë një mbulesë tavoline. Dinte të zgjidhte edhe modele shumë të mira ajo. Shpesh ia sillte i ati nga qyteti dhe në të rrallë edhe xhaxhai nga Durrësi, që e kishte detar. Shoqet i venin në shtëpi Xhejes për të kopjuar ndonjë model nga punimet e saj të bukura.

Xheja gëzohej shumë, kur te gjyshja e saj vinte për vizitë një shoqe e gjyshes, Ahmetja, siç e thërrisinin të gjithë, një grua kjo shumë e shëndoshë, me një fytyrë të madhe, të kuqe. Ajo ulej rëndë-rëndë pranë gjyshes së Xhejes, pëershëndetej po me ato fjalët e zakonshme, pastaj ia shtronin muhabitetit me orë të tëra. Xheja u nxirrte nga një gotë me dhallë dhe zakonisht qëndiste pranë tyre.

— A të bëjnë ndonjë cikë yzmet nuset, oj Ahmet? — e pyeste gjyshja e Xhejes.

Ahmetja kishte ca sy të mëdhenj, po që i duke shin të vegjël, ngaqë ishte shumë e shëndoshë.

— Më mbajnë mirë, — përgjigjej ajo, e kënaqur, me fjalë të shkoqura. — I kam të mira nuset unë.

— Je vetë e mirë, prandaj të duan.

— Jo, moj, se s'jam aq e mirë, më do fort ti mua, prandaj dhe më lëvdon, — dhe shpinte buzën në gaz.

Xheja kishte dëgjuar nga ato lloj-lloj tregimesh dhe ngjarjesh, që e kishin rrëmbyer.

Një ditë, tek po bisedonin të dyja, Xheja dëgjoi me vëmendje këtë përrallë nga Ahmetja: «Ishte një ditë, ta zëmë si sot. Një bari ndezi një zjarr të madh, në formë sofre. Donte dhe të ngrohej, por edhe të tremble ujqit, se edhe në behar atje, në male, bën

ftohtë dhe ujqt bredhin qark. Një gjarpër paskësh qenë i fshehur aty, në mes të zjarrit, nën një shkurre. Nuk kishte se si të shpëtonte nga zjarri: «O njeri. — i tha gjarpri bariut, — më shpëto, po deshe, se jam në rrezik të madh». Bariut iu dhimbë, zgjati dorën dhe i tha: «Përdridhu këtu, në krahun tim». Gjarpri u përdrohd te krahun i tij. Bariu e largoi nga zjarri, por gjarpri, sa po shpëtoi, iu ngjit njeriut në sup dhe e zuri nga fytë. «Unë të shpëtova jetën, përsëti po më mbyt!» «Kështu e kam zakon unë, s'pyes pér nderin që më bëre, unë do të të ha kokën». Po vinte një dhelpër. «O dhelpër e mençur, — i thotë bariu, — shih se çmë bëri gjarpri, unë e shpëtova nga zjarri, kur sek më ka zënë fytin e po më mbyt». «U dashkërka bërrë gjyq, — tha dhelpra. — Patjetër çështja do të zgjidhet me gjyq», — tha përsëri ajo. Me mendimin e saj u bashkua edhe njeriu, edhe gjarpri. «Eja këtu në tokë», — i tha dhelpra gjarprit. — Dua të të bëj ca pyetje». Gjarpri zbri ti më tokë. Bariu po shihte si me habi. «Ç'pret më?» — i thotë dhelpra. «Çfarë të bëj?» — pyeti njeriu. — «Shtypi kokën, ký është gjyqi», — i thotë dhelpra. Njeriu kapi një gür dhe e goditi gjarprin, derisa e ngordhi fare. «O dhelpër e mirë», — i thotë ai asaj, — ti më shpëtovë jetën, unë do të të sjell një squkë me gjithë zogj. Të bëfshin mirë». «Falemnderit, o njeri». Ai bariu shkoi te e shoqja dhe i tregoi ç'i kishte ngjarë e i tha se do t'i dërgonte dhelpës si peshqesh një squkë me gjithë zogj. «Je në vete! — i bërtiti e shoqja. — Dhelpra na ka ngrënë kushedi sa pulë! Merr, ore, zagarin, fute në thes dhe, kur dhelpra të afrohet, lëshoje që ta kapë». «Po është gjynah, moj grua! Ajo më shpëtoi jetën, kurse unë...» «E ku ka gjynah, more burrë! Me lëkurën e saj i bëjmë një xhup djalit, që do ta kënaqë gjithë dimrit». I shogi u bind, futi zagarin në thes dhe shkoi te dhelpra. Dhelpra qëndronte larg. «Afrohu, moj dhelpër, se ta solla squkën me gjithë zogj», — i tha bariu. «Të falem nderit, o njeri. Zgjidhe thesin dhe léri aty në fushë. Unë i kap ato në çdo kohë që të dua». Njeriu ngeci. Ai filloi ta zgjidhte grykën e thesit. Doli

zagari dhe iu turr dhelprës. Mirëpo dhelpra iku dhe, kur doli në majë të një kodre, tha: «Paske qenë njeri i pabesë...»

— Kështu është puna e njeriut të lig, — e mbylli Ahmetja. — I ligu është më i keq sesa gjarpri.

Xheja pohoi me kokë. Edhe asaj po i vërtiteshin ca njerëz të ligj. Çfarë u kishte bërë që po i binin më qafë kot së koti?! «Sa përrallë e bukur!» — pshëreti Xheja dhe patjetër këtë përrallë ajo do t'ia tregonte edhe Selimit të saj. Ata takoheshin rregullisht të paktën një herë në javë. Si vend takimi kishin caktuar mullarin e bykut, në kopshtin plot me pemë të Xhejes. Hëna rrinte e i vështronte si me zili, tek flisnin me zë të ulët, si një çift gugeschësh. Xhejes i qeshte nuri. I hovte kraharori dhe gjaku i rridhte më me vrull, kur ajo rrinte vetëm me Selimin.

— A je e lumtur? — e pyeste ai herë pas here, i pustuar i téri nga zjarri i dashurisë.

Ajo ngrinte qepallat dhe e vështronte me ata sytë e saj gjithë lëng e të shndritshëm.

— Fol, se nesër do të të jap njëqind pikët e mia, — përpiquej të bënte ndonjë shaka të vogël Selimi, por e shih-te se nuk e udiste dot, prandaj vazhdonte me bisedat e tjera. — Sot kam punuar mirë, — hidhej te puna Selimi, se për punën, që s'ia përtonte, kishte ç'të tregonte. — Puno-va tok me vullnetarët. Hapëm kanal. Po na shqeu së qeshuri ai Sulë Metani. Dreqi vetë është ai.

— E di, — pohoi Xheja, e gjëzuar.

— Sa shpejt më ka kaluar dita sot, s'e ndjeva fare. Kisha shumë qejf të ishe edhe ti me ne.

— Jo, jo, se më duket sikur të gjithë na vështrojnë.

— Le të na vështrojnë, se mos na prishet punë.

— Po sikur ta marrin vesh ata të shtëpisë sime?

— Në mos sot, nesër do ta marrin!

Ajo s'dinte ç'përgjigje t'i jepte. Ata rrinin sa rrinin dhe vetëm kur ndaheshin, ai ia zinte dorën e ashpër, ia shtrëngonte në gjoks, pastaj ia puthte dhe ia shpinte në zemër. Bota e tërë i dukej e vetja. Ndihej njeriu më i lumtur. Dhe si rrinin disa çaste ashtu, ndaheshin, duke i uruar njëri-tjetrit natën e mirë. Mirëpo këto kohët e fundit,

Xheja dukej e mërzitur dhe rrinte pak si e hutuar. Ai, Nuri Loku, biri i Dervish Lokut, po i binte më qafë dhe po e bezdiste shumë. Ajo nuk donte që kjo qështje të përhapej dhe të merrte vesh i madh e i vogël. I vinte keq hem pér prindët, hem pér gjyshen, por i vinte keq më shumë pér Selimin. Me siguri ai do të tërbohej dhe dreqi e di, puna mund të arrinte deri në vrasje!

— Po c'kemi ndonjë të re? — e pyeti Selimi një mbrëmje, kur ata u takuan, si zakonisht, te mullari. Ajo rrudhi supet.

— Ke filluar të më fshihesh pak, — vijoi ai me një ton të rëndë.

— Unë?

— Po, po, ti.

Ajo vuri re se Selimin po e pushtonte zemërimi, si një flakë përvëluese.

— Në qoftë se s'të pëlqej unë, shko, zgjidh cilin të duash, sepse unë një bishtdredhur nuk marr pér grua! — Ato fjalë i ranë si bombë Xhejes. Ajo e kuatoi se ku e kishte fjalën.

— Unë s'kam q'ti bëj atij, ai më ka zënë rrugën nga dy herë.

— Po mua përse nuk më ke treguar?

— Kisha frikë.

— Nga se?

— Se mos ziheshit ju të dy.

— Dhe të më fshihesh?! — skërmitti dhëmbët ai gjithë inat. Ajo dëgjonte si e vrarë dhe me kokën të ulur poshtë. «Ndoshta duhej t'i kisha treguar», — mendonte me vete.

— Po yt atë e di këtë?

— Më duket sikur i ka rënë në vesh.

— C'ka ndër mend të bëjë?

— S'di gjë, mua nuk ma ka zënë këtë muhabet.

Atë natë Selim Qarri nuk ia përkëdheli dorën si herët e tjera e nuk i uroi natën e mirë. Iku si i xhindosur me mendjen top pér t'i dhënë një dru të shëndoshë atij dobiç dobiç, që kishte guxuar t'i ndërhynte në ato punë deli-

• kate. Ai e priti në një cep të udhës, po Nuri Loku nuk kaloi andej. Selim Qarri vendosi ta presë të nesërmen dhe u largua gjithë brengë, i zhytur në lloj-lloj mendimesh të turbullta...

17.

Sherif Arra po rrëmonte me shatë parcelën e vet. Po shkrifte dheun në rrënjet e kumbullave e të qershive, që i kishte mbjellë vitin e kaluar. Aty pranë kërcente një kec i vogël, me lara të bardha. Rrëmonte Sherifi dhe mundja i bridhte qark. Kohët e fundit ai kishte bërë ca vepime, që brenda për brenda e shqetësonin. Ishte egoist dhe i dhënë shumë pas interesave të ngushta personale. Si i tillë, e tërhiqnin mëritë dhe grindjet. Në fakt, edhe Sherifi ishte rritur i varfër. Kishte qenë edhe ai argat. Po kudo, te pasanikët ku kishte shërbyer, kishte thithur huqe të këqia, si koprracinë, të rënit barkas para interesit të ngushtë, egoizmin. Këto vese ia ushqeu edhe e shoqja, me të cilën ishte martuar një vit pas formimit të kooperativës. Ajo vinte nga një derë më e mirë sesa e Sherifit, ishte bijë e Reshit Fankut ajo, një fshatar, për të cilin thuhej se i kishte të dyqind mijë lekët të ndara mënjanë. Ai vetë, Rushiti, kishte bërë një jetë të varfër brenda për brenda në familje, ishte ushqyer me kursime të mëdha, së shpirtin e kishte pasur te paratë ai. E bija, e shoqja e Sherifit, i kishte ngjarë krejt, sikur ai ta kishte nxjerrë nga hundët. Edhe në pamje ajo i ngjiste shumë t'et, kurse me huqet ishte në vend Rushiti. Dorështrënguar, shpirt-vogël, që kishte maninë për të zhvatur sa më shumë dhe ku të mundej. I tillë ishte deri diku edhe i shoqi, Sherifi, dhe kështu ata kishin gjetur shoshoqin, si arra palën.

Në Parti Sherifi u pranua kur në kooperativën e Arrës lindi problemi i formimit të organizatave bazë në të gjitha fshatrat e këoperativës. Asaj nate dhjetori, Sherifin e propozoi një kushërim i tij. Dy të tjerë, të lidhur me lloj-lloj fijesh me fisin e Sherifit, e mbështetën këtë propozim dhe kështu Sherifi, dashur padashur, hyri në Parti. E vërteta është se ai ende nuk ishte i formuar dhe i përgatitur për të qenë në radhët e Partisë dhe, ndonëse brenda për brenda radhëve të saj ai u pastrua nga shumë të meta e dobësi, megjithatë, prapëseprapë te ai imbetën ca ferra, që Sherifi nuk i shkuli dot nga rrënjet me këmbëngulje e me guxim...

Rrëmonte Sherifi rrënjet e pemëve dhe mendja i bridhë qark. Ai e hiqte veten për shumë të zgjuar, për shumë të zotin dhe kishte qejf të dilte mbi të tjerët e t'i shkonte fjala për çdo gjë. Njëherë ai kishte këmbyer një dhi të tijën me një dele të majme të kooperativës. Dervish Loku, i cili atëherë kishte qenë bariu i bagëtive, kishte heshtur. Mirëpo aty-këtu ky veprim ishte marrë vesh, po askujt s'ia mbante ta bënte çështje, se askush nuk donte të ngatërhohej me këtë njeri, që ishte i zoti ta bënte të bardhën të zezë dhe të zezen të bardhë. Edhe me Islam Sulën, kryetarin e këshillit të bashkuar, Sherifi nuk para shkonte mirë, sidomos që asnjëherë nuk i kishte rënë në sy, se q'bluanë përbrenda. I pëlqente Sherifit të ishte vetë kryetar i këshillit të bashkuar dhe jo Islami. Ndjenja e egër për t'i zënë vendin Islam Sulës i ishte forcuar, kur rastësisht ai kishte parë në zyrën e byrosë së partisë se një nga kandidatët për kryetar të këshillit të bashkuar ishte edhe ai, Sherifi. Gjumi nuk e kishte zënë atë natë: Eh, q'punë e mirë dhe q'vend i rëndësishëm ishte ai i Islam Sulës! Të gjithë e nderonin, të gjithë e gmonin, e ftonin nëpër dárka e nëpër dasma, i qanin hallet. Sherifi e laktonte me gjithë zemër atë vend, i digjej xhani të shihëtë njerëzit që t'i vinin në zyrë, t'i luteshin e ky, Sherif Arra, të jepte urdhra dhe porosira poshtë e përpjetë, të caktonte arsimtarët nëpër shkollë, të kontrollonte fshatrat, madje, po ta donte, edhe vetë kryesinë e kooperativës...

«Këto rrënëjë duan më shumë pleh», — tha Sherifi me vete dhe vajti në haur e mori një kosh me pleh kafshësh. Mani që plehëroi kishte filluar të lëshonte sythe. Pranvera po hynte si vjedhurazi atë vit. Sherifin e pushtuan përsëri mendime, mendime të shumta. Ishte tip i shkathët ai, Nuk rrinte pa marrë vesh dhe pa ditur deri në hollësi qđo gjë që ndodhë me njerëzit. Madje ai dinte hollësira të vecanta edhe për shumë familje, dinte si shkonte filanca me filanin, kush merrej me allishverishe, kush përpinqej të bënte ndonjë fejesë të fshehtë, me para nën dorë. E Sherifi jo rrallë u hidhte thumba atyre, ua sillte rrotull e rrotull dhe ata thoshin me vete se ky Sherif Arra s'ka gjë që s'di e s'ka gjë që s'merr vesh dhe nga kjo i ruheshin shumë. Jo rastësish Sherifi u hoq atëherë sikur i kishte ardhur keq që Xhelal Vishnjën nuk e kishin dërguar në kurs për normist. E dinte Sherifi se Xhelali dhe e ëma, e tij, Xhevria, do të kundërvepronin, do të flisnin poshtë e përpjetë, do të ankokeshin kundër Pashones, po sidomos kundër Islam Sulës. Sherifi ishte nga të parët që u informua edhe për marrëdhëniet në mes dy të rinjve — Nuri Lokut dhe Xheje Brahimit. Atij iu bë qejfi që në mes të këtyre dy familjeve po fillonte grindja. Ishte i bindur Sherifi se i ati i Nuriut, Dervish Loku, nuk donte ta shihët me sy Islam Sulën jo vetëm sepse me familjen e tij gjysh stërgjyshi kishin qenë në hasmëri, por edhe sepse e quante fajtor që i hoqën të birin nga püna e shtetit. Kishte edhe një arsyet tjetër që Dervish Loku e urrente Islam Sulën: ca kohë më parë, Dervish Loku, kur ishte grindur me të vëllanë e vet për shkak të një vijë uji, Islam Sula i kishte dhënë të drejtë vëllait të tij dhe kishte nxjerrë fajtor atë, Dervish Lokun. Ja, pra përsë Dervish Loku organizoi veprimin e fshehtë, duke i futur dhitë me kast në haurin e Islam Sulës për ta paditur se gjoja ai ishte vjedhës.

Ai s'la vend pa vajtur dhe u ankua edhe në polici, edhe në prokurori kundër Islam Sulës. Sherif Arra, me marifet, kishte mbajtur anën e Dervish Lokut. Atë e kishte kushëri të së shoqes, po, nga ana tjetër, me Dervish

Lokun e lidhte edhe këmbimi i dhisë me delen e kooperativës. Do ta ndihmonte, pra, Sherifi me ç'të mundej Dervishin dhe të birin e tij, Nuriun. E dinte Sherifi se, po të të qepej pas Dervish Loku, ai plak shtrig, s'të shqitej më si një ferrë drize. «Ki kujdes, se të bëjnë gjëmën ata, — i kishte thënë Sherifi një ditë Dervish Lokut, kur ishin vetëm pér vetëm. Por edhe kishte shtuar: — Të drejtén tën-de mos e lër pa e kërkuar. Ke mjaft shokë që janë me ty, por që pér arsyet tē ndryshme, nuk dalin hapur. Unë, nga ana ime, me aq sa kam pasur mundësi, jam përpjekur të të ndihmoj. Dhe do të të ndihmoj përsëri, se ti je me të drejtén. Sidoqoftë, mua mos më përmend në asnjë vend. Hiç mos iu ndaj së drejtës sate! Gjynah tē sjellësh vërdallë një burrë plak hallexhi si til! Ne duhet t'i japim dorën njëri-tjetrit dhe jo t'i vëmë këmbën në fyt. Pashonia s'ka ç'të bëjë, e tërheqin nga hunda Islami me Bedri Gjuzin. Ata u bënë sebep që hoqën nga lista edhe Xhelal Vishnjën pér normist. Unë e di mirë së Islam Sula e bëri shkresën që Nuriu yt tē pushohet nga puna gjoja se i duhej kooperativës. Gjynah, gjynah! — dhe ai rrudhi buzët si shumë i dëshpëruar...

Si mbaroi së plehëruari pemët, Sherifi hodhi krahe-vë xhaketën, futi në qilar shatin, lau pak duart me ujin e lambikut prej teneqeje, që e kishte mbërthyer në dy gozhëtë në faqe të murit, dhe zbriti pér nga zyrat. Hyri në ambulancë. Doktor Kristoja po shikruante një recetë pér një punëtor të minierës.

— Mos jep pushime vend e pa vend ti, doktor, — i tha Sherifi si me shaka, duke zbuluar dhëmbët, disa të verdhë, të veshur më ar.

— Shko, more, tutje, tullac! — ia ktheu Kristoja dhe qeshi.

— Tullac mua mos më thuaj, sepse ti e di cilin shajmë ne tullac.

— Ja, pra, nga inati yt do t'i jap dy ditë pushim, — tha Kristoja dhe u zgjat me trupin e tij si të qullosoj nga dhjami, pér të marrë një recetë të re, në cep të tavolinës.

— Ç'e do pushimin ky! — pyeti si i habitur Sherifi.
— Nuk sheh se éshëtë sa një derr!

Punëtori i minierës veshi xhaketën dhe tha me zë të mbytur nga gripi:

— Ke të drejtë ti, ore Sherif Arra, ty po të pjell edhe pula, edhe gjeli.

— Lodhet i shkreti gjithë ditën e ditës! — ia priti infermier Sefa me fytyrën e tij të rruar taze. — Dy-tri shkresa në ditë, ndan rrogat e nëpunësve të kooperativës dhe kaq. Kjo éshëtë gjithë puna e Sherif Arrës.

— I kishe marrë një orë dore dikujt në Derdom ti, Sefedin, ë? — e hodhi bisedën gjetkë Sherifi, për ta mposhtur infermier Sefën.

— Kush të tha ty?

— Punë përmua se kush më tha! A e ndreqe apo mos ia ke shitur ndonjërit? — e thumboi përsëri Sherifi dhe ndjeu një gëzim të thellë, kur pa infermierin që filloj të hutohej.

— Aman, more zot! — ia priti doktor Kristoja si i habitur. — Si nuk mbete pa marrë vesh se ç'bëhet në këtë botë? — dhe ktheu duart mbrapsht, mu afër fytyrës së tij.

— Pse, ç'kujuat ju, bar hamë ne, fshatarët? — pyeti Sherifi dhe qeshi, duke i vështruar të gjithë me sytë e tij si të grifshës.

Pas pak ai doli nga ambulanca, ktheu djathtas, për nga mensa. Ishte kohë dreke dhe mensa gumëzhinte nga zëra njerëzish. Fémijët sapo kishin dalë nga shkolla dhe po prisnin të merrnin bukët. Xha Isufi ishte ulur në një karrige aty pranë ftoit, me pushkën në prehër. Xhevria po zbriste me nipçen e vogël për dore. Ajo ecte ngadalë, si e mbytur në mendime. Pas e ndiqte qeni i madh, gjithë lesh, i Sherif Arrës. Pak më tutje traktoristi Qerim Rapi po hahej me fjalë me agronom Dautin. Dukej që agronom Dauti nuk i firmoste ca urdhra pune Qerimit.

— A ta kam bërë punën, more vëlla i dashur! — fliste me zë të lartë Qerimi, me damarët e fytit si të fryrë.

— Nuk e di, akoma nuk e kam parë cilësinë e punës.

— Po ç'faj të kam unë? Pse nuk ke ardhur ta shohësh?

— Kam qenë i zënë.

— Pra, faji éshëtë yti dhe jo imi. Unë dua të shkoj në SMT, se sot éshëtë ditë rrugash.

Xhevria qëndroi një copë herë për të marrë vesh mi- rë përse po grindeshin ata të dy. Dëgjonte dhe afrohej ngadalë, si pa u vënë re.

Ekonomistja Liri po afishonte një lajmërim për mbledhjen e rinisë të të gjithë kooperativës, kurse përgjegjësi i kulturës, i ndihmuar nga dy arsimtare, po vendoste ca parulla nëpër faqet e mureve të ndërtesave kushtuar mbjelljeve të pranverës. «Të gjithë në këmbë për të realizuar dhe tejkaluar detyrat e aktivit të partisë!» — thoshte një ndër parullat.

— Mos bërtit kot këtu, më mes të rrugës, — iu drejtua Xhevria traktoristik Qerim Rrapi, duke e vështruar shtrembër me atë syrin e saj të çapëlyer.

Qerimi ktheu kokën nga ajo dhe ia priti i inatosur:

— Shko në punën tënde ti, nëna e Xhelalit, mos u ngatërro atje ku s'të takon!

— Po ti po i bie kot më qafë Dautit ! — tha Xhevria me zërin e saj të gjerrë. Qerim Rrapi shtrembëroi buzët si i habitur.

Sherif Arra po bisedonte pak më tej me Petritin.

— Nuk ke bërë hiç mirë që i ke bërtitur atij Nuri Lokut. Ti je vullnetar, ti mos u shkarkonis në punët e fshatit. — Sherifi i fliste me ton të butë, sikur po e këshillonte. Petriti po e dëgjonte qetë, pa e kundërshtuar. — Kështu t'i Petrit, — vazhdonte gjithnjë me tonin e butë Sherifi. — Këto po t'i them në formë shoqërore, se unë as që e çaj kokën ç'bën Nuri apo Xhëlali. Por ty, si i huaj që je, nuk të takon të futesh si qimja në qull, në punët e katundit.

Petriti e ndërpren. Nuk mundi ta duronte më gjatë atë gjuhën e Sherif Arrës ai.

— Ali Nuri, Loku e ka tepruar shumë me atë Xhejen — i tha dhe, tek foli, iu drodhën cepat e buzëve. — Kurse qëndrimi tënd mua nuk më pëlqen. Katundin e udhëheqim ne, komunistët. Veprimet tona duhet të përputhen me dëshirat e masave dhe, me sa di unë, masat e dënojnë qëndrimin e atij të riut.

— Edhe unë e dënoj, por fjalën e kam që ju, vullnetarët, të mos përziheni kot në ngatërresat e fshatit.

Atë çast Xhevria i bëri zë Sherifit që të shkonte tek ajo. Sherifi gjeti shkak për t'u larguar nga Petriti.

— Si i ke hallet, Xhevrie? — e pyeti ai.

— Hallet e mia! Ti i di se si i kam unë hallet!

— Mos u mërzit, punët e mira bëhen ngadalë-ngadalë.

— Mërzitu, po të duash, e q'fitove? Do të duroj. Ka duruar lëkura e lepurit gjashtë muaj në ujë e nuk u kalb, kurse njeriu është më i fortë dhe duron më shumë.

Sherifi buzëqeshi dhe pohoi me kokë.

— Hamiti im me Xhelalin kishin një fjalë me ty. Po deshe, duku sonte andej nga shtëpia jonë, — tha ajo me gojën që ia afroi te veshi.

Sherifi nuhati se diçka e re po ziente. Me siguri kjo zierje kishte të bënte me çështjen e Nuri Lokut ose të Xhelal Vishnjës. Sherifi nuk kishte qejf të ecte kuturu. Nuk shkelte në dërrasë të kalbur ai. Ruhej shumë, madje edhe në bisedën me Petritin sikur u nxitua një çikë. Sherifi u pendua që nuk diti të përdorte një gjuhë më të zgjedhur e një takt më të mirë.

— Po s'më doli ndonjë punë, edhe mund të vij, — iu përgjigj Xhevries ai.

Dielli çante retë e bardha dhe derdhë mbi malet, përtëj zallit, nëpër gryka e lugina rrezet e tij të ndritura, të zjarrita. Vullnetarët po zbrisnin poshtë, pér të vazhduar punën. Tërë fshati ishte në aksion, gra e burra.

— Pér te mollët, shoku Petrit? — pyeti Sherifi me një ton të përzemërt.

— Po, te mollët.

— Keni edhe shumë pér të mbjellë?

— Edhe nja katër a pesë hektarë.

— Eh, ç'mollë do të prodhojë Arra! — ia priti Sulë Metani me zë të ngritur. — Do të jenë mollë eksporti. Eti-ketën do t'uva vëmë: «Made in Arra» — dhe e qeshura e tij me gjithë shpirt çau ajrin e asaj dite të bukur.

— Kur të bëhen ato mollë mua më ka mbirë bari, — tha si me shaka Sherifi.

— S'prish punë, — ia priti Sulë Metani. — Ty të mbin bari, kurse mollët tonë do t'i hanë kalamajtë e tu. Përsëri në rregull, apo jo?

— Afrohu, afrohu, këtu ti, Sulë, — i bëri zë Sherifi. Sula u shkëput nga shokët.

— E di q'më ka thënë Xhevria për ty?

— Për mua?

— Po, më tha se për Sulën flasin mirë të gjitha gratë e vajzat.

— Me të vërtetë, Xhevrie?

Vëngroshja pohoi me kokë.

— Rrofsh, Xhevrie, më dhe një lajm të mirë, po unë nuk di se si t'ua hap zemrën atyre, — bëri shaka Sula.

— Thuaju si të duash, se ato e kuptojnë vetë, — ia priti Xhevria, dhe ajo goja e saj pa dhëmbë, e errët, u hap sa një kamare.

— I thashë njërsës, njëherë, në uzinë, — vazhdoi Sula me përzemërsi. — I thashë kështu: «Po t'i them të gjitha fjalët të mbledhura grumbull: Të dua!» Kurse ajo m'u përgjigj: «Edhe unë po të përgjigjem me fjalët grumbull: «Nuk të dua!» «Jo, jo grumbullin e kam zënë vetë!» — i thashë unë, — dhe Sula iku duke qeshur. Qeshën edhe Sherifi, edhe Xhevria.

— Ai i gjati kishte folur kundër Xhelalit tim, — foli Xhevria, tek ndiqte me sy vullnetarët që po shkonin në-për punë.

— Petriti?

— As emrin s'ia di, — murmuriti ajo si me mospërfilleje. — Ai duhet të jetë, se ai është më i gjati.

Sherifi po ndiqte me sy brigadier Mexhitin, që po i thoshte magazinierit të tërhiqte plehun kimik nga magazina e Kapërcyllit.

— Zgjidh çështjen e kafshëve, — e kundërshtonte magazinieri.

— Kam biseduar me Bedri Gjuzin unë, i thuaj Bedriut që të mobilizojë kafshët e fshatit. Nesër në mëngjes plehu të jetë te mollët, se më mbesin punëtorët pa punë, — i thoshte brigadieri.

Sherif Arra e la aty Xhevrien dhe shkoi nga zyrat e kryesisë së kooperativës. Diç kishte ndër mend t'i thoshte kryetarit. Po nuk e gjeti aty. Atëherë vajti në zyrën e tij. Nxori librin e pagave, e shpalosi dhe e la përsipër mbi tavolinë. Kështu bënte shpesh ai. E hapte librin dhe rrinte e vështronë firmat e nëpunësve një e nga një. E bënte këtë punë edhe për ta parë njerëzit se gjoja ai ishte i zë-në me shumë punë. E ndiente veten në qejf atë ditë. Xhevria i kishte dhënë të kuptonte se diç po kurdisnin përsëri në adresë të Islam Sulës.

Mbi një degë mani, ra një mullenjë e zezë me sqepin të verdhë. Sherifi e pa nga penxherja. «Sikur të kisha një çifte! — mendoi tek po kundronte atë zog të bukur. — Ta merrja nishan,» — dhe instinktivisht bëri sikur kishte armën në duar: «Bam» — bërtiti me zë dhe iu duk sikur vrap shpendin...

18.

Erdhi pranvera e bukur. Malet u veshën me blerim. Në qellin e kaltër vozitin re të bardha, shtëllunga-shtëllunga. Dielli shkëlqen. Toka filloi të marrë frysë lirisht. Vende-vende gjineshtra ka nxjerrë lule të verdha, që janë si gojë ujku dhe që përhapin një aromë të këndshme në të katër anët.

Në ajrin e freskët fluturojnë dallëndyshet krahëshpejta, fluturojnë flutura me lloj-lloj ngjyrash, laramane, të bardha, pikaloshe. Nëpër gështenja, që kanë filluar të zbardhin nga lulet, këndojnë mullënjet cicërojnë fugat dhe gardalinat bukuroshe. Natyra qesh e gjëzon. Në barin e njomë, të gjelbër, hidhen e kërcejnë pupthi karka-

lecë të vegjël, jo nga ata me ngjyrë të gjelbër e me këmbë të gjata e të shtrembra si flokë arapi, por një soj tjetër karkaleci, që është i vogël sa një zekth e që ka një ngjyrë si të zezë.

Në majën e një dushku të gjatë dëgjohet kënga e qyqes. Ky zog i bukur e i rrallë ia thotë për shtatë palë qejfe. Tek këndon «ku-ku-ku», ai lëkund bishtin e tij të gjatë dhe ngazëllehet nga pranvera. Sherif Arra, kur e dëgjoi për herë të parë, tha: — «Qyqe, o zog i bekuar, më tregoj edhe sa vjet kam për të jetuar?»

Shpendi këndoi tri herë.

— Do të jetuakam edhe disa vite, — tha si i kënaqur ai.

Cdo ditë fshati zgjohej plot hare. Kodrat e luginat e bleruara gumëzhinin nga kumborët e sqepve dhe zilkat e shumta të dhive. Njerëzit punonin me qejf. Dhe punët po u shkonin mbarë. Pak ditë më parë kishte përfunduar mbjellja e mollëve. Ishte plantacioni i parë i një pemishrativa qysh nga themelimi i saj. Ky plantacion u kishte dhënë një bukuri të rrallë gjithë kodrave e luginave. Morlët, mijëra e mijëra rënje, ishin mbjellë me sistem. Njerëzve u kënaqej syri. «Sa bukur!» — pëshpëriti Liman Driza, kur i pa. Si ai pëshpëriten edhe qindra të tjerë, gra e burra, madje edhe fëmijë. Në vatrat e tyre s'bisedohej për gjë tjetër veçse për kodrat e luginat që u kthyen në

Bilal Bregu kishte disa muaj që ishte bërë bari. I doli emri në aktivin e partisë, dhe organizata bazë vendosi që ai të shkonte bari. Bilali nuk ia përtonte kësaj pune, por kishte hallin se nuk e njihte mirë atë zanat..

— Ti je mësuar që të gjykosh të tjerët, — i kishte thënë Sherif Arra, i skuqur flakë në fytyrë. — Provoje vettë një herë se ç'do të thotë të jetosh mal më mal e pyll më pyll.

— Për vijën e Partisë unë s'kursej asgjë, or ti, shoku Sherif. Malet janë tonat. Dhe pyjet janë tonat. Unë nuk mërzitem fare. Sa për kritikat e mia, ti mos u bëj me-

rak se unë do të vazhdoj të kritikoj kudo që të jem, edhe në majë të malit, kuptove? — dhe qysh të nesërmen ai vajti dhe mori në dorëzim tu-fën e dhive. I kaloi një e nga një nëpër duar të gjitha dhitë, szeptë keçat. I therte në zemër tek i shihte ato të dobëta, ca të sëmura me zgjebë, ndonjëra me këmbën të vrarë. I shihte dhe ndiente dhembje në shpirt. Ishte pasuri e shtrenjtë e të gjithëve ajo tufë. I ati, Ali Bregu, i kishte thënë se bagëtia, po dite ta mbash, të mban. I kishte dhënë shumë këshilla Aliu të birit. Ishte lindur e ishte rritur vetë bari Aliu. Ai dinte kur nxirrej për kullotje bagëtia, në q'vende duhej dërguar, kur u duhej dhënë ujë e kur duhej të ruheshin nga vapa apo nga ujqit.

Bilal Bregu po e shpinte tufën për në malin e Derdomit. Rruga kalonte afér plantacionit të mollëve. Ai e dinte se dhitë janë të rrezikshme për pemët. Ato të shkëputen pa e vënë re dhe veç kur e këputin filizin, si ta presë diçkush me brisk. Bilali i bëri zë edhe rojes së kooperativës dhe tok me shokun tjetër bari bëri çmos që të mos dëmitohej as edhe një filiz molle. Brigadier Mexhiti e kishte ndjekur gjendjen me vëmendje të madhe dhe me shqetësim. Ai do t'i gjobiste pa mëshirë edhe barinjtë, edhe rojen e kooperativës, sikur të ndodhët edhe dëmi më i vogël. Mirëpo kur çdo gjë vajti në rregull, pshërëtiu dhe mendoi me vete me një buzëqeshje të ëmbël se Bilal Bregu ishte vërtet komunist i mirë. Brigadier Mexhiti iu kujtua Sherif Arra dhe mbledhja e fundit e organizatës. «Sa keq u shpreh Sherifi ndaj Bilalit dhe sa mirë iu përgjigj Bilali!» — tha me vëte ai. Mexhiti i kishte ardhur keq që nuk i ishte dhënë të ngrihej e të kritikonte Sherifin...

Tufa po ngjitej përpjetë. Kudo derdhej një bukuri e rrallë. Dëgjohej fishkëllima e Bilal Bregut, që përhapej grykave e luginave. Ai ecte dhe vështronë me kujdes rrëth e rrotull. Diku andej duhej të zgjidhët një vend të përshtatshëm për të ndërtuar një kasolle me thupra për bagëtinë. Natën bënte ftohtë, dhe bagëtia medoemos duhej të strehohej. Deri atëherë barinjtë e tjerë i kishin

mbajtur nëpër vatha të bëra ashtu fët e fët, pa mundime, sa për të thënë se diç kishin bërë. Ndryshe mendonte Bilal Bregu me shokun e vet. Që të dy kishin vendosur të ndërtonin kasolle dhe jo vathë. Ja tek ishte një shesh i gjerë dhe shumë i mirë. Bilali po e kundronte me vëmen-dje. Te këmbët e tij kalonin dhitë.

- Ta bëjmë këtu kasollen? — pyeti tjetri.
- Jo këtu, se s'ka ujë.
- Ku atëherë?

— Më lart. Di unë një vend shumë të bukur. Atje afër ka edhe ujë, — dhe Bilali bëri përpjetë. I ishin ngjitur go-xha Malit. Ai ndiente një kënaqësi të madhe atë ditë. Me atë shpirtin e tij romantik, ai kishte të thoshte e të men-donte shumë. Malet dhe kodrat përballë ishin tani më të vogla. Fshati dukej si një grumbull i vogël shtëpish. Naty-ra e bukur të mahnistë. Gjelbërimi të përkëdhelte sytë. Bilali e donte shumë natyrën. Ja, atje shquhej plantacio-ni i mollëve. Sa mirë! Ja q'mund të bëhej. Kodrat dhe luginat mund të transformoheshin. Bagëtia mund të bë-hej mbështetje e fortë e tyre. Ai e kishte shpirtin plot me ndjenja dhe mendime. Ndiente shumë Bilali, ndoshta si një poet i vërtetë. Asgjë nuk i shkiste pa e vénë re: dhe ngjyrat e ndryshme të gjetheve të pyllit, ku gjelbëronin disa më shumë e disa më pak, edhe hijet e bukura që kri-joheshin herë aty e herë atje, edhe depërtimi i rrezeve të diellit që binin mbi barin e njomë si shigjeta të arta e që ravizoheshin me lloj-lloj fijesh nëpër degët dhe gjethet e shumta, edhe férshëllima e lehtë e flladit pranveror që i përkëdhelte gjoksin e bëshëm, edhe ndonjë iriq që ecte ngadalë nëpër lëndinë, edhe zogjtë që harbonin e dashu-roheshin degë më degë. Bilali mori frymë thellë, me gjithë fuqinë e mushkërive, dhe tha me vete: «Bukuri! E bukur është jeta!»

Tutje njerëzit po punonin ca në Zall, ca në ato faqet e kodrave rreth të tria lagjeve të Arrës. Punët u venin mbarë atyre. Mbjellja e patateve kishte përfunduar. Në disa kodrina të buta po lulëzonte kamomili, kurse gruri ishte rritur nga dy pëllëmbë përmbi tokë. Dukej i mbarë

gruri i atij viti. Brigadier Mexhiti kishte caktuar Xhejen, Sabrien dhe vullnetarin Sulë Metani për spërkatjen e tij me herbicide: Sulë Metani spërkaشتë me pompë, gratë me dorë.

Vullnetarët e tjerë, së bashku me një pjesë të brigadës, po punonin për hapjen e kanalit. Ishte një punë e lodhshme dhe plot pengesa hapja e kanalit. Vende vende toka ishte gjithë shkëmbinj dhe gurë të mëdhenj. Për të ndihmuar që punët të shkonin mirë, erdhën tre minatorë të minierës dhe vendosën mina në ato vende me shkëmbinj. Deri larg, deri në Zall, madje deri te stalla e Bilal Bregut, atje në malin e Derdomit, dëgjoheshin minat. që pëlcisnin njëra pas tjetrës. Ishte tamam si në luftë. Luftë për të shkuar përpara. Në zemrat e njerëzve ishte përhapur flaka e një ndriçimi të madh, se e gjithë kjo punë edhe kjo luftë patjetër do të jepnin frytet e veta. Në mbrëmje, në sheshin përpara mensës dhe zyrave të kryesisë, kërciste muhabeti. Vinin aty kooperativistë e punëtorë të minierës, të cilët, përpara se të shkonin nëpër shtëpitë e tyre, rrinin një copë herë duke biseduar e duke dëgjuar muzikë nga radioja e vatrës së kulturës.

— A e di ç'tha një ditë sekretari i byrosë, — u thoshte kandidati i partisë Asllan Beri disa të rinxve. — Vetëm nga mollët që mbollëm, kooperativa do të marrë mbi treqind mijë lekë të reja të ardhura në vit.

Një i ri i shoqëroi fjalët e Asllanit me një fërshëlli-më të gjatë dhe sytë i shkëlqyen nga habia.

— Na tradhtove, or Sulë, — e ngacmoi Lindita, kur ai ia behu te sheshi ku kuvendönin njerëzit.

— Unë, përsë?

— Vajte në një punë të lehtë, u more me spërkatje.

— Punë të lehtë e quan ti spërkatjen? — ia ktheu me vrull Sulë Metani. — Eshtë helm ai, Linditë, dhe me helmin nuk bëhet shaka. Apo nuk u zbardha si gëlqerexhi!

— Lëri, lëri ato.

— Ka të drejtë Lindita, — u hodh kundër Sulës, përtatë ndezur më shumë, Eliaz Fuga.

— Po ti, Petrit, ç'thua?

— Edhe unë bashkohem me shumicën, — tha Petriti qetë-qetë.

Sula përdrohhi pak buzët, pastaj filloi të këndonte me zë të butë e të ëmbël, pa e prishur terezinë:

Kam shtëpinë me rrasa,
ububu se plasa.

Xha Isufi, me pushkën në sup, bënte çap e jak aty rrrotull, i kredhur në mendime.

— Marrim nja dy a tri shishe verë sonte? — pyeti befas Sulë Metani më sytë e vegjël që i lëviznin plot shkathësi.

— Shumë mirë, — ia pritën njëzëri vullnetarët e tjerë, kurse Petriti shtoi:

— Unë mendoj që sonte t'i blejë Sula, një natë tjetër unë e kështu me radhë, dakord?

— Aprovohet, — dhe Sula u nis drejt dyqanit të ushqimit.

— Bën qejf rinia! — pëshpëriti me vete xha Isufi dhe lëshoi një pshërëtimë të thellë. Eh, të kaluar të hidhur që kishte pasur edhe ai babush!

— Xheje, Nife, — thirri Lindita me zë të lartë. Ato u afruan. — Sonte ejani te ne, festojmë ditëlindjen e Sulës.

— Po si s'na tha gjë, ne bashkë punuam sot me të!

Sulë Metani ia behu me tri shishe verë në dorë, me dy kuti sardele, një kuti me mish lope dhe nja shtatë a tetë vezë që i nxori një e nga një nga xhepi, si prestidigjitor.

— Paske ditëlindjen ti sot, Sulë? — e pyeti Nifja me buzë në gaz.

— Po, — tha ai me fytyrë të çelur e gjithë hare. — Sa herë që unë blej verë, dijeni se kam ditëlindjen.

Ato u futën brenda. Dhoma ishte e pastër dhe dukej e verdhë nga drita jo e plotë elektrike. Nifja nxori me fshesë, aty afër derës, disa lëvozhga arrash. Petriti ha-

pi me një turjelë kutinë e sardeleve, kurse Elma Fuga solli radion.

— Po shishja e vajit ku është? — pyeti Liria me tigan në dorë.

— Ja tek e ke, afër komodinës.

Përveç Nifes dhe Xhejes erdhi edhe e reja e xha Isufit si dhe Xhelal Vishnja. Pas pak hyri edhe furrxhiu. Krisën muhabeti dhe shpotitë. Kripa e asaj mbrëmje ishte Sulë Metani. Bënte lloj-lloj shakash ai. Lindita qeshte me të madhe dhe zëri i përplasej në tavan.

— Pse nuk shkon me blegtori ti, Xhelal? — e pyeti Sula, duke e vështruar me sytë e tij të vegjël, sikur po kundronte një pikture të largët.

— Nuk shkoj sepse këtu në fshat kam radio, se këtu kam familjen, se atje në mal ka shumë telashe, grisesh nga rrobat dhe, po të vritet ose po të të çajë ujku ndonjë bagëti, të detyrojnë të paguash paret nga xhepi.

— Justifikime të kota, — ia ktheu me ton tepër serioz Sula.

— Ti, Xhelal, je mendjemadh dhe burokrat!

Lindita vuri duart në ije, duke qeshur me gjithë shpirt, dhe u shtri mbi krevat nga të gajasurit.

— Posi, burokrat!

— Ç'më je bërë kështu me këta flokë që të kanë mbuluar gjithë qafën.

— Nuk kemi berberë, ti e ri, shoku Sulë.

— Brena javës të qethesh, ndryshe, — dhe Sula nxori nga komodina e vet një palë gérshërë delesh. — Ndryshe të bëra xero me këto, — dhe hapte e mbyllte gérshëret e mëdha.

Nifja ishte ulur në mes të Linditës dhe të Xhejës dhe i kishte kthyer krahët dritäres.

— Tani vallëzim, — ia prit Sula dhe u ngrit. Bëri sikur rregulloi me dorë kravatën, tërroqi cepat e xhaketës dhe iu drejtua Linditës:

— Me leje, shoqe?

Lindita u ngrit. Sula hapi krahët. Lindita gjithashtu. Radioja përhapte muzikë. Filluan të kërcejnë.

- Si ju quajnë?
 — Lindita.
 — Sa emër i bukur! Nga jeni?
 — Nga Gjirokastra.
 — Sa mirë! Si nuk ju kam parë? Banojmë në një qytet. Në c'rrugë e keni shtëpinë?
 — Në rrugën «Bajram Curri».
 — Çudi, si s'ju paskam parë?
 — As unë ju:
 Heshtje. Tek vallëzonin, Linditës i lëviznin lehtë shpatullat dhe tërë trupi i saj pak i ngathët.
 — Keni mbaruar ndonjë fakultet? — theu heshtjen zëri i Sulë Metanit.
 — Po, Fakultetin e Drejtësisë.
 — Kurse unë të Medicinës. Jeni e fejuar?
 — Jo.
 — Sa mirë! A ju ngacmon njeri?
 — Është një djalë që më vjen rrotull.
 — Të shkruan letra?
 — Më ka shkruar, por unë nuk ia kam pranuar.
 — Shumë mirë ke bërë! Po të të ngacmojë përsëri, më thua j mua. E sheh ai se ç'i bëj unë, — dhe Sula tundi grushtin në ajër.
 Lindita s'duroi dot më, u shkëput nga ai dhe vajti u përplas drejt e në krevat, përmbysh, duke qeshur me lot.
 — Ju pëlqeu ky numër? — pyeti Sula me buzë në gaz dhe me sy që i shkëlqenin gjithë nur.
 — Plasën duartrokite.
 — Të lumtë, Sulë, na kënaqe, — tha Petriti.
 — Qenka dreq i madh ky Sula! — pëshpëriti furrxhiu me sytë e tij të mëdhenj e të hapur shumë.
 — Mbrëmje të tilla ju, rinia e fshatit, duhet të organizoni herë pas here, — i thoshte Petriti furrxhiut dhe Xhelal Vishnjës.
 — Po nuk vijnë, more shoku Petrit.
 — Ose vijnë vetëm djemtë, — tha furrxhiu.
 — Po t'i organizoni mirë, vijnë që ç'ke me të. Jeta bëhet e mërzitshme, kur nuk ka variacione. Njeriu ka ne-

vojë edhe të këndojet, edhe të dëgjojë një përrallë, edhe të këmbejë mendime për një libër apo për një film, edhe të flasë për gjendjen në Vietnam.

— Na kap një këngë, o Sulë, — i tha Nifja.

— Këngë? Me gjithë qejf, — dhe Sula filloj me zërin e vet melodioz:

«Malet me blerim mëbuluar
plot me bëkuri.»

Në derë zgjati kokën Sherif Arra. Sytë e tij sikur e fotografuan menjëherë gjithë ambientin dhe vështrimi iu ndal te shishet e boshatisura të verës.

— Po bëkeni qejf, ë? — pyeti si me kast.

Po vullnetarët s'ë ndërprenë këngën. Dhoma buçiste. Xha Isufi dëgjonte gjithë qejf atje në bërakën e tij të vogël.

— Ku je, o Sherif artisti! — ia priti Sulë Metani me zë të përzemërt.

— Edhe artist më bëre? — pyeti Sherifi dhe hyri brenda.

— Ti je numër i rrallë, — ia priti Sula.

Lindita kishte kthyer kokën mënjanë dhe po kafshonte gishtërinjtë e duarve përmëtë mos qeshur; pisk e kishte edhe Petriti, kurse Elmaz Fuga doli jashtë. Pas pak shpatullat e Linditës filluan të fryheshin e të shfryheshin me shpejtësi. Sherifi e kuptoi se ajo po qeshte.

— Po kjo bullica pse i zbardh dhëmbët ashtu tinëz?

— pyeti duke vështruar kurrizin e Linditës.

— Ka pirë shumë verë, — dhe Sula tregoi shishet e verës, në fund të të cilave kishte imbetur pak verë.

— Gjithë ato shishe Lindita i ka pirë?!

— Ajó bashkë me Lirinë, kurse ne, burrat, pimë raki, — vazhdonte të bënte shaka Sula, po në një mënyrë të tillë thuase po bisedonte seriozisht.

— C'paskeni për të hequr sonte me të! — dhe Sherifi shënoi me gisht Linditën. — Nuk është as doktor Kristoja, — shtoi ai duke kruar qafën.

— Ka pirë më shumë se dy litra verë, — vazhdonte shakatë Sula.

— Po Nifja me Xhejen? — pyeti me vrull Sherifi, duke i shikuar si me dyshim ato.

— Jo, këto nuk kanë pirë asnje gllënjkë.

— E pimë nga një gjysmë gote, — ia priti Nifja, duke buzëqeshur. — Përse nuk thua të vërtetën, Sulë?

Sherifi i hodhi një vështrim të mprehtë, pastaj pyeti si për të ndërruar bisedë:

— Ka njeri domino nga ju?

— Jo, kemi shah.

— Shah s'di unë.

— Ta mësojmë ne.

— Jo, jo, — tha Sherifi, — po të kishit domino, po e bënim një katërshe.

— Ne po ikim, — tha Nifja dhe u ngrit. U ngrit edhe Xheja, pastaj edhe furrxhiu. Lindita dhe Liria i shoqëruan.

Petriti e kishte mendjen gjetkë. Duhej të shkonte në uzinë. Do të bisedonte me shokët e tij që t'i jepnin një saldatriçe. Tubat e hekurt të kanalit vadtës kishin filluar të vinin. Ata do të vendoseshin në ato vende ku pjerrësia ishte e madhe dhe uji nuk kalonte dot. Ndërsa Sherifi thyente me grusht herë pas here nga një kokërr arrë, dëgjonte me kujdes bisedën e Sulë Metanit, që i thoshte Xhelal Vishnjës:

— Po të ngrihet edhe oficina, do të jetë gjë shumë e mirë. Aty do të rregullohen të gjitha veglat e punës.

— Ju do të largoheni, kush do të punojë në oficinë?

— Do të vijnë vullnetarë të tjerë nga klasa punëtore. Përveç kësaj, Petriti do të marrë ndonjë të rifshatar, për ta mësuar, apo jo, Petrit?

Petriti u shkëput nga mendimet e tij dhe pyeti:

— Ku e kishit fjalën?

— Do të përgatitësh ndonjë të ri për mekanik, apo jo?

— Patjetër.

— Më merr mua,, shoku Petrit, — iu lut Xhelali me një buzëqeshje të qiltër në fytyrë.

— Po të të caktojnë ty, me gjithë qejf.

Sherifi deshi të fliste për të birin, që në qershori mbaronte shkollën tetëvjeçare, por u druajt nga Xhelali.

— Po të përfundohet edhe kanali, punët e Arrës do të përmirësohen shumë; paga do të rritet dhejeta do të bëhet më e mirë. Gjithë ato lugina që sot janë të vdekura, mund të kthehen në tokë buke.

— Kthehen, kthehen, — tha si i menduar Sherifi.

— Por duhet punë e madhe, ne na mungojnë krahët e punës.

— Mungojnë, se ju, për shembull, keni zënë nga një qoshe të rehatshme:

— Léri shkatë këtu, — tha si i pakënaqur Sherifi. — Ja ta zemë se shkuakam edhe unë në brigadë, a mos u zgjidh problemi i krahëve të punës?

— Por si ti ka edhe të tjerë.

— Llogaritni edhe ata që do të vijnë pasi të shkëputen nga puna e shtetit, — ndërhyri Elmaz Fuga.

— Po, po, për të ardhur kanë! — i hoqi fjalët zvarrë Sherifi dhe nxori gjuhën jashtë, — Pastaj ai Mexhit Driza nuk po e drejton mirë brigadën, — shtoi pas pak si i pezmatuar Sherifi.

— Vetëm Mexhiti nuk ka ç'të bëjë, duhet ta ndihmojmë të gjithë.

— Plasëm me ndihma ne, por atij këshillat tonë i futen nga njëri vesh dhe i dalin nga tjetri.

— Llum i ka bërë punët Mexhiti, vec të bërtasë di ai, — ndërhyri Xhelal Vishnja dhë befas brofi në këmbë.

— Ti pusho! — e ngriti zërin Sula. — Për ty të gjithë kanë vërejtje.

— Kanë vërejtje, se unë kritikoj hapur e pa frikë.

— Është i rafinuar Petrøja, — ia priti Sefa. — Nuk ngatërrohet lehtë me njerëzit ai dhe bravo i qoftë!
— Ha larg pushka e kryetarit, — tha Sherifi dha i shkeli syrin Dautit.

— E kuptoj se ku e ke fjalën, — foli si i zbutur agronom Dauti.

Brenda ditës fjala mori dhenë. S'mbeti njeri pa e marrë vesh: Demir Krepit kishte ofenduar agronom Dautin. Disa thoshin se ia kishte bërë mirë, tek-tuk e shanin atë dhe merrnin anën e agronom Dautit. Pashones i erdhi rëndë që në këtë çështje ishte ngatërruar kunati i saj. Ajo nuk donte gjéra të tilla. Dhe, sapo e mori vesh, tha se faji ishte i Demirit.

— Besoni ti, Pashone, që Demiri im të sillet ashtu me agronom Dautin, sidomos me kryetar Petron? — e pyeti i shoqi me zë të pakënaqur:

— Epo, Dauti nuk ka përsë të shpifë kot së kотi për të!

— Mirë, — ia priti i shoqi, duke u përpjekur ta përbante zemërimin. — Unë qysh sonte do të shkoj tek ai dhe do ta sqaroj mirë këtë punë...

Të nesëmnen Islam Sula dhe Bedri Gjuzi po bisedonin me agronom Dautin dhe po i kërkonin disa hollësira rrëth ngjarjes. Aty ishte edhe brigadier Mexhit. Agronom Dauti tha qfarë kishte për të thënë, pastaj Bedri Gjuzi foli ngadalë, duke kontrolluar mirë qdo fjalë:

— Edhe unë baškohem me ty, shoku Daut. Qëndrimi i Demirit është shumë i gabuar. Ne do ta detyrojmë të bëjë autokritikë përpara teje.

— Autokritikën ai do ta bëjë pasi ta dëgjojmë edhe vetë atë, — korrigoi Islam Sula.

— Sigurisht që do ta dëgjojmë Demirin, — tha Bedri Gjuzi.

— Unë nuk pranoj asnjë autokritikë nga ai. Unë dua të merren masat më të rënda kundër tij dhe Mëxhitit i kam dhënë urdhër që të mos e pranojë në punë.

- Po s'kemi cilin të dërgojmë pér bari, more shoku Daut.
- Nuk dua të di cilin dërgon pér bari ti.
- Atëherë caktoje vetë personin, — tha si i fyter Mexhiti.
- Shko ti, — e ngriti zërin Dauti me hundën e kthyer si sqepi i një shpendi grabitqar.
- Unë shkoj, por... — s'e mbaroi frazën ai.
- Mos jep urdhra kot më kot ti, shoku Daut, — e këshilloi Bedri Gjuzi me gjakftohtesi. — Ti je kuadër dhe duhet të mendohesh thellë, përpara se të japësh urdhër.
- Ka disiplinë, shoku Bedri dhe shoku Islam, apo jo? Mexhiti nuk po më zbaton urdhrin, sepse nuk do që tē prishet me Pashonen.
- C'hyn Pashonia në këtë mes? — dhe Islami tundi kokën si me habi.
- Hyn që ç'ke me tē, sepse Demir Krepin ajo e ka kunat.
- Tani po i ngatërron gjërat dhe mua më duket se po i ngatërron me dashje, — u nxeh Islami.
- Mos u ngutni, — tha Bedri Gjuzi me atë gjakftohtesinë e tij tē zakonshme, sido që edhe ai ziente brenda pér brenda nga qëndrimi kokëfortë dhe egoist i agronom Dautit. — Punët t'i marrim shtruar dhe tē nisemi nga interesat e punës dhe jo nga interesat tona personale. Ti, shoku Daut, thua që Mexhiti tē braktisë brigadën dhe tē bëhet bari në vend tē Demir Krepit, kështu?
- Në rast se ky nuk cakton ndonjë bari tjetër!
- Po brigadën kush do ta drejtojë?
- Ajo s'më duhet mua...
- Aha, kështu nuk merremi vesh bashkë, shoku Daut, — e ngriti zërin Bedri Gjuzi. — Ti nuk pranon autokritikën e Demirit, pavarësisht se nuk e kemi dëgjuar akoma se ç'thotë ai pér ty; ndoshta edhe ai ka vërejtjet e tij karshi teje, po ne kemi shpresë se ai do tē na e dëgjojë fjalën që tē bëjë autokritikë, me qëllim që tē

ruajmë autoritetin tënd si një nga shokët kryesorë të sektorit dhe si specialist që të kemi. Por ti po ngul këmbë me inat: o si them unë, s'ka! Dhe arrin deri atje sa t'i thuash Mexhitit: «Shko ti bari në vend të Demir Krepit!» Mexhitin nuk e ka caktuar ti brigadier, por e ka propozuar organizata e partisë dhe e ka aprovuuar kryesia e kooperativës. Ti kështu jep urdhra të pabazuara dhe që nuk ka se si të zbatohen, prandaj të këshilloj që ta kontrollosh veten dhe të jesh më i thjeshtë e më gjakftohtë.

— Nuk kam nevojë për këshilla! — tha me sy të ulur përdhe agronom Dauti. Islami shpuri buzën në gaz dhe tundi kokën si i pakënaqur. Bedri Gjuzi u ngrit dhe pas tij u ngrit edhe Mexhiti.

— E prishim, Daut, — tha Islam Sula dhe fërkoi duart, si t'i kishte larë me ujë. — Edhe një herë të këshilloj që të thellohesh, se më duket që e ke marrë një çikë si me rysh.

— Unë dua të më zbatohen urdhrat se s'bën! Bedri Gjuzi s'foli. Ai u nis për në zyrat e kooperativës. Ikën edhe të tjerët.

Dauti tundi kokën si ai kali azgan që duan t'i vënë frerin në gojë dhe, si drodhi pas dyqanit, vajti të bisedonte me Pashonen, Ishte i bindur se tanë e kishte shtënë në dorë pothuajse gjithë fshatin. Dinte vetë ai se si e vërtiste punën. Autokritikë nuk do të pranonte as nga Demiri, as nga ndonjë person tjetër. Demiri nuk duhej të pranohej **në punë**, **derisa të merrej një masë e rëndë** ndaj tij. Pashonia duhej të **dinte** forcën e tij si kuadër e si agronom. Ai me qëllim u kishte thënë atyre: «Dua të më zbatohen urdhrat se s'bën». Këtu e kishte fjalën edhe për çështjen e Xhelal Vishnjës ai. Vërtet Xhelali nuk vajti për normist, por deri atëherë as Selim Qarri nuk kishte shkuar. Shokët e organizatës bazë e merrnin me mend se ai, Dauti, diç do të kishte kurdisur me ndonjë nga ata të SMT-së, por hollësira dhe gjëra të sakta nuk dinin.

Dauti nuk e gjeti në shtëpi Pashonen. U kthyesh për nga zyrat e kryesisë.

— Ore, Daut, — i tha doktor Kristoja, kur e takoi, — pse bën, more djalë, gjëra të tilla? Përse grindesh me njerëzit në vend që t'i shtrohesh punës si ne të tjerët?

— Nuk lejoj të më ofendojnë mua.

— Askush nuk lejon të ofendohet, por mos harro se kjo kooperativë po t'i ushqen fëmijët dhe ty, dhe mua, prandaj shtroju më mirë punës dhe tregohu më i thjeshtë e më i dashur me njerëzit.

— Di unë se si do të veproj, — tha Dauti dhe u largua gjithë xhind.

Por e vërteta nuk po dilte ashtu siç e shtronte çështjen agronom Dauti. U mblohdh brigada te lëmi, gra e burra, të rinj e të reja, një pesëdhjetë e kusur veta. Aty, përpëra tyre, me fjalë të thjeshta e të qarta. Demir Krepi tregoi me hollësi se si kryetar Petroja dhe agronom Dauti nuk e kishin gjetur të shtrirë mbi stivën e dushkut, siç kishte thënë Dauti, por kishte qenë agronom Dauti ai që i kishte thënë i pari «kapadai», «bajraktar» dhe ca fjalë të tjera që Demirit nuk i kujtoheshin mirë.

— Po ti, a i ke thënë «perandor»? — e pyeti Bedri Gjuzi si me qesëndi.

— I kam thënë, — pranoi me gjysmë zëri Demiri. — Nuk gënjej, i kam thënë, por duhet të dini se atë fjalë ia thashë kur më bëri «kapadai» e «bajraktar». Unë i shkreti kisha gdhire gjithë natën, se dy dhi më ishin sëmurur dhe kisha frikë se mos më ngordhnin, kurse ai s'la fjalë pa më thënë. Pastaj përsë shkojmë kaq larg ne? Pyesni kryetar Petron, po të doni, ai e di mirë çështjen.

— Pushoni, flisni me radhë!

U ngrit Petriti. Disa filluan të qeshnin. Ai u hodhi një vështrim të ashpër. Pllakosi heshtja.

— Edhe unë, — tha ai me një ton si të lodhur e si të mërzitur, — mendoj se po humbasim kohë dhe s'po

nxjerrim gjë në krye. Agronom Dauti duhej të ishte patjetër këtu. Demir Krepi mund të ketë kusuret e veta si njeri, por në rastin konkret mua më duket se faji më kryesor bie mbi agronom Dautin. Ai është kuadër, me arsim të lartë, dhe ai duhet, siç thanë edhe të tjerët, të jetë më i thjeshtë, më i urtë, më i dashur me njerëzit dhe më i lidhur me masat. Shoqja Pashone, nëpërmjet sekretarit të byrosë, duhet që mendimin e brigadës për agronom Dautin ta shpjerë medoemos deri në byronë e partisë...

— Jemi dakord me ty, — e ndërpree Selim Qarri me zë të kënaqur. — Të thirret Dauti, t'i jepet një dru i shëndoshë dhe t'i thuhet që me popullin të sillet mirë, të mos u bjerë kot më qafë njerëzve, se përndryshe...

— Përndryshe i japim kazmën në dorë, — e ndërpree një tjetër me zë të lartë.

— Kazmën s'ia jep dot, se ka goxha diplomë në xhep ai, — ia priti Xhevrie Vishnja.

— Di edhe ti ç'është diploma, o Xhevrie? — pyeti dikush.

Ajo hodhi sytë mbi gjindjen aty si e habitur. Syri i saj i çapëlyer, i turbullt si ujë kénete, kalonte sa te njëri te tjetri.

20.

Puna për hapjen e kanalit të madh Arrë — Selish-të — Bubrec vazhdonte me ngulm. Në ndihmë të Arrës erdhën edhe disa punëtorë nga Selishta e Bubreci, kurse disa të diela me radhë ndihmoi edhe një repart ushtarak që fushonte në afërsi të Kapërcyllit. Ushtarët punonin shumë mirë. Shumica ishin fshatarë dhe s'ishte nevoja t'u qëndroje në kokë për t'i udhëzuar.

Petrit Skënderi kishte afro një muaj që nuk ishte kthyer fare në shtëpi. Edhe të dielave ai qëndroi tok me ushtarët dhe me kooperativistët dhe me ta transportoi me krahë disa tuba të mëdhenj prej hekuri dhe i vendosi në ato vende ku do të bëhej saldimi i tyre.

Sulë Metani, Lindita Saliu, Liri Zeneli, Xheje Brahimë dhe disa të rinj e të reja ndodheshin në vendin më të vështirë të kanalit, kush me kazmë, kush me lopatë. Brigadier Mexhiti u kishte caktuar pa normë vendin e punës dhe kishte kërkuar që ajo zonë e vështirë të përfundonte sa më parë.

Elmaz Fuga po i thoshte një të riu nga Selishta:

— Përse, more djalë, e theve bishtin e kazmës?
— Se mos e theva me qëllim.

— Me qëllim apo pa qëllim, dëmi u bë njëlloj. Kjo është e kooperativës, pra është tëndja. Ti do të mbetesh pa punë dhe, po s'punove nuk paguhesh.

— Se mos marrim shumë pikë për ditë pune! — murmuriti tjetri.

— Dëgjo ti, djalë i mbarë, — dhe Elmazi i hodhi dorën në sup. — Po të sjell një shembull: ne jemi një grup njerëzish që kemi vendosur të hapim këtë kanal. Po të punojmë mirë, do të paguhemi më mirë. Vitin tjetër kanali do të vaditë tokat, prodhimi do të rritet, pra ti dhe unë paguhemi për aq sa i japim shoqërisë. Mirëpo, ti, more djalë i mbarë, më vjen në punë në orën tete, — i tërhoqi fjalët zvarrë Elmazi.

— Bëj gjysmë ore rrugë nga Selishta e këtu unë.

— Atëherë nisu më herët. Ti je i ri, gjithë shëndet, duhet të jesh shembull. Unë ty dhe ndonjë shokun tënd asnjëherë nuk ju kam parë të plotësoni tetëorëshin në punë. Tani theve edhe bishtin e kazmës! Jo, jo, kështu nuk përparon kooperativa...

Petriti e kishte ndjekur me vëmëndje bisedën e tyre dhe, g'është e vërteta, raste të qëndrimeve të pakujdeshme në punë e vrissnin në shpirt.

— Merre dhe rregulloje menjëherë kazmën që theve! — u zemërua Petriti me atë të riun nga Selishta, që

ishte treguar fare i shkujdesur, thuase s'kishte ndodhur asgjë.

— Si ta rregulloj?

— Merr sëpatën dhe bëj një bisht të ri, pak dru ka këtu? — dhe sytë iu zmadhuan nga zemërimi.

I riu nuk e zgjati. Nuk ia ktheu fjalën mbrapsht, se Petriti ishte shumë i sjellshëm dhe shumë i ndërgjegjshëm në punë.

Petriti po godiste me kazmë anët e një guri të madh dhe po përpinqej ta nxirrte nga toka. Njëra nga gratë, Nifja, iu afrua dhe me kazmën e vet u përpoq ta ndihmonte.

— Ashtu mbaje, — i tha Petriti dhe, si hodhi kazmën aty pranë, ra në gjunjë dhe zhyti duart në tokë, duke ngritur përpjetë gurin e madh. U sforcua aq shumë, sa u bë flakë në fytyrë dhe damarët e fytit dhe të ballit iu frynë jashtë mase.

— Edhe pak, — i tha Nifja, që mbante një pjesë të peshës së gurit me kazmën e saj.

Petriti derdhi tërë fuqinë e vet. Atëherë guri filloj të ngjitej përpejtë, derisa më në fund u shemb në qoshe të kanalit.

— Të lumtë krahu! — i tha ajo, duke e vështruar me admirim.

— Punën kryesore e bërë ti, — i tha Petriti, tek merrte frymë me mundim.

— Syri është friks, krahu është trim, — tha ajo duke buzëqeshur dhe iu zbuluan dhëmbët e mëdhenj e pak të rrallë.

Petriti shpuri buzën në gaz me hijeshi.

— Ti ua kalon edhe fshatarëve në punë, — vazhdoi ajo, duke e vështruar me respekt.

— Jo, jo, — kundërshtoi Petriti, — Është Asllani sa për dy si unë. Pastaj, pak punoni ju, gratë?

Ajo heshtte dhe tha:

— Punojmë, punojmë, shoku Petrit, ju po e shihni edhe vetë, bujqësia është e lodhshme.

Petriti pohoi përsëri me kokë, Ajo largoi nja dy gurë të tjera dhe tha:

— Gratë tuaja andej nga qyteti lodhen, s'do mend që lodhen, por qilizmë s'kanë për të bërë, barrë s'kanë për të mbajtur në kurriz dhe rrugë të largëta e me të përpjeta nuk kanë për të bërë.

Këto fjalë e prekën mu në shpirt Petritin. Ato ishin plotësisht të vërteta.

— Ashtu është, — foli ai. Por në qytet ka edhe shumë gra që punojnë shumë, sidomos gratë punëtore, Nëpër uzina dhe fabrika, qindra e mijëra gra punojnë me dy ose tri turne. A e di ç'do të thotë punë me turne? Marrim, për shembull, turnin e tretë. Puna fillon në mesnatë dhe mbaron në orën shtatë të mëngjesit. Ja tek e ke Linditën dhe Lirinë, në fabrikën e tyre ato punojnë me tri turne.

— Po për bujqësi sikur s'janë, — tha Nifja. — Lindita çka, lodhet e përpinqet, kurse Liria...

— Vijnë nga një punë krejt tjetër, — foli Petriti. — Po do të mësohen; ja, ju jeni mësueset e tyre më të mira.

Sulë Metani vazhdonte punën dhe herë pas here ngacmonte Linditën.

— Mbrëmë kam parë një èndërr të bukur, Lindita. A ta tregoj?

— Po s'pati lidhje me mua, tregoje, ndryshe mos e thuaj.

— Gjithmonë kështu ma pret iniciativën ti mua! — tha si i pakënaqur Sula. — Helbete, èndrrat kanë lidhje me njerëzit. Edhe ajo e mbrëmshmjë ka lidhje me ty...

E qeshura me zë të plotë e Linditës çau me vrull ajrin, aq sa një mullënjë u tremb dhe iku me të katra nga teli i elektrikut ku kishte qëndruar.

* * *

Të nesërmen në mëngjes, ata vazhduan të punonin po në atë front pune. Dielli shkëlqente. Sa bukur shkëllqen dielli në ato anë! Bari i gjelbër dhe i njomë ka

mbirë kudo. Kanë mbirë edhe lulet e deleve, edhe ca lule të tjera të verdha, që kanë një formë shumë të bukur e që janë plot me petale të shpeshta e të buta si kadipe.

— A keni nevojë t'ju ndihmojmë, oj Nife? — u dëgjuar zëri i Selim Qarrit. Pak më tutje punonte Xheja e tij.

— Jo, jo, s'kemi nevojë për asgjë, — iu përgjigj Nifa me zë të lartë.

— Ti flet për vete, apo edhe për shoqet?

— Flas për të gjitha.

Selimi heshtë. E pa veten ngushtë.

— Ta mblohdhën gocat, or Selim, — ia priti nga larg Elmaz Fuga me fytyrën të dërsitur.

— Për nder, janë brisk nga goja, — pohoi Selimi dhe vazhdoi: Oj Nife, hidhi, hëdhi një zë nënës sate të na fërgojë ndonjë pulë sot për drekë.

Ajri sa vjen e ngrohet më shumë, dielli shkëlqen me rreze gjithnjë e më të arta, grunjérat gjelbërojnë dhe tutje, në ca kodra me zabel, jehojnë këmborët e bagëtisë. — Sa pilkë doni? — u afrohet vajzave Selim Qarri, duke buzëqeshur tinëz dhe duke vështruar me ata sytë e tij pak të mëdhenj.

Sa të na japë brigadier Mexhiti. Sa të punojmë, aq do të marrim.

— Po ti pse i bie pragut, që të marrë vesh dera? — u hodh Sulë Metani me zërin e vet tingëllues e gjithë thumba.

— Çudi, — tundi kokën Liria, — Gati janë të fejuar dhe nuk i flasin njeri-tjetrit!

— Flasim, flasim ne, por jo në sytë e të tjerëve, — ia ktheu Selimi si me shaka.

— Hë, pra, foli, — e ngacmoi Lindita, duke e vështruar me vëmendje Selimin.

— E ç'ti them?

— Atë e di ti. Thuaji mirëmëngjes, po të duash, — tha Sulë Metani.

Krisën të qeshurat. Qeshi me gjithë shpirt edhe Xheja, edhe Selim Qarri.

— A ke nevojë të të jap ca pikë? — iu drejtua Selimi Xhejes.

— Jo, jo, unë normën time e kam tejkaluar, po pate nevojë, të jap unë pikë.

— Mirë, më jep tepricën e normës.

Selim Qarri ishte djalë i ciltër, i parrahus me jetën, tamam djalë fshati, punëtor e i ndershëm. Ishte shumë i emocionuar, prandaj edhe bisedën e bënte kodër më kodër, si i thonë fjalës. Ai hodhi vështrimin tutje, vajti e ndenji. mbi një sukë të vogël dhe befas filloj të këndoje me zë të ulët:

«O ju dallëndyshe, nga po shkoni,
se do t'ju lë një porosi...»

— Mori kot ky, — ia priti Nifja me një buzëqeshje të ëmbël në fytyrë.

— Nga halli e ka, — tha Sulë Metani. — Nuk sheh si është skuqur në fytyrë?

— Vapë, shoku Sulë, po fillon vapa, — dhe Selimi zbërtheu trikon prej leshi.

— Keni ca zakone të vjetra ju, — u hodh Lindita me hijen e një buzëqeshjeje në fytyrë. — Përse vajzat, sapo mbarojnë shkollën tetëvjecare, vënë shamira në kokë?

— Sepse u mërdhin koka, moj Lindita, — tha Selim Qarri.

— Jo, jo, nuk është pér këtë. Rinia duhet të jetë në ballë të luftës kundër këtyre gjërave të vjetra. A është e vërtetë se në Selishtë kohët e fundit ka pasur marte-së me ndërrresë? Po të jetë kështu, rinia e Selishtës dhe ne duhet të veprojmë: t'i kritikojmë shumë, të bëjmë ballafaqime e debate...

Lindita fliste me zë të lartë, Gjoksi i fryhej tek fliste dhe sytë i shndrisnin.

— Të lumtë, Lindita, — ia priti me zë të gëzuar Petriti.

— Jo, jo, unë Xhejes sime do t'i flas çdo ditë; ja, këtu keni pér të qënë, — përfitoi nga rasti Selim Qarri pér të thënë atë që e mbante të kyçur në zemër prej shumë kohësh...

21.

Në shtëpinë e Xhevrie Vishnjës thureshin plane të reja. Hamit Vishnja, Xhelali (natyrisht, Xhevria ishte kryesorja në këto punë) po e ndiznin më shumë gjakun e turbulluar të Nuri Lokut dhe të gjithë familjes së tij.

Ishte ditë e shtunë, mëngjes, kur ata të katër po pinin nga një kafë dhe po bisedonin shtruar për punët që kishin nëpër duar. Nuri Loku kishte afro një muaj që nuk dilte në brigadë. Kishte vendosur që bari të mos shkonte në asnje mënyrë. Njerëzit, madje edhe disa që i quante si të tijtë, e vështronin vëngër dhe rrallë edhe e qortonin.

— Tani ke dy rrugë, — i tha Hamit Vishnja me ato buzët e vogla, që i qëndronin si të qepura në atë ftyrën e tij të hequr. — Ose hiq dorë fare nga Xheja, ose sajo ndonjë rreng tjetër që të bëhet nami.

— Çfarë, për shembull?

— Pak rrengje ka? — ia priti Xhevria, duke shpënë buzët në gaz e duke përpëlitur atë syrin e saj të çapëlyer.

— Ka rrengje, ka sa të duash, — pohoi Hamiti. — Por kjo punë do guxim. Ty ta mban ta bësh?

Nuri Loku s'foli. Atij iu kujtua se si tri ditë më parë Selim Qarri i kishte dalë në rrugë dhe e kishte paralajmëruar se do ta gjente belaja, në qoftë se ai, Nuri Loku, do të vazhdonte t'i binte më qafë Xhejes...

Nuri Loku s'ia kishte treguar kurkujt kërcënimin që i kishte bërë Selim Qarri, prandaj ai dyzoi të përgjigjë menjëherë, se e dinte që Selimi do të vepronë me tërë tërbimin e tij.

— Unë të këshilloj të bësh një letër, — vazhdoi pas pak Hamit Vishnja, duke kafshuar lehtë me dhëmbët e tij pakëz të vardhë cepin e majtë të buzës së poshtme. — Në këtë letër të ankolesh për tri gjëra: e para të aku-zosh Bedri Gjuzin dhe Pashone Krepin përsë ata e mby-

llën çështjen e dy dhive të tua të vjedhura nga ai dhe të gjendura në haurin e tij? Ligjet janë për të gjithë një lloj. Të thuash se je i sigurt se edhe ndonjë nëpunës i prokurorisë mund të ketë ngrënë ryshfet nga Islam Sula, sepse ndryshe ajo çështje nuk mund të mbyllej. E dyta, të ankuzohet i ati i Xhejes, se ai ka vendosur të shësë vajzën për 50 mijë lekë te Selim Qarri. Në letër të thuash se Xheja të do ty, se ju dashuroheni qysh prej një viti e ca, por ajo ka gjetur belanë me të atin, që po e zhdëp me dru qdo natë. E treta, të ankohesh se Islam Sula të doli përpëra në udhë dhe, duke të kërcënuar me revole në dorë, të ka goditur me shuplakë në fytyrë...

— Kjo është e shkëlqyer! — gati sa s'u hodh përpjetë Xhelali, kurse Xhevria tha:

— A dëgjoni një fjalë nga unë plaka ju? — Po sikur të thotë se Islam Sula ka dashur t'i kapë motrën me zor?

— Rri ti! — foli si i palkënaqur Hamiti dhe, duke kthyer kokën nga Nuriu, vazhdoi: Këtë letër që të tha shë ta bësh me emrin tënd dhe me firmën tënde në dy kopje, shiko në zyrën e ndihmës juridike, e di ku është?

— E di!

— Atje ta bëjnë fët e fët në dy kopje, njëren drejt toja kryetarit të gjykatës së lartë, tjetrin kryeministri-së, — dhe Hamiti fshiu ballin më pëllëmbën e dorës. — Ke për të parë se si do ta fitosh davanë pas kësaj letre, — tha si i kënaqr.

Nuri Loku lëvizte kokën si i zhytur në mendime. E ndiente se po futej thellë e më thellë, drejt një pylli të panjohur, e të rrezikshëm.

— Mua mos më përmend, ndryshe ta ha fjalën, dëgjove? — iu drejtua Hamiti atij me atë fytyrën me profil si prej kali.

— Jo, jo, nuk të përmend, — pëshpëriti nëpër dhëmbë Nuriu dhe, si ndezën nga një cigare, doli që andej me mendjen të turbulluar, por edhe me një ndjenjë të thellë kënaqësie, se po vinte ora e hakmarrjes.

* * *

U poqën qershítë, në fillim ato të Zallit dhe pas një dhjetë ditësh edhe ato të të tri lagjeve të sipérme të Arrës. Janë qershi të bukura ato të Arrës, vijnë ca si të zeza, por janë kokërrmëdha, sheqer të ëmbla dhe gjënjë ta mbushin gjithë lëng.

Sherif Arra, sa herë shihte që qershítë kishin filluar të piqeshin, sajonte ndonjë punë ose gjente ndonjë sebep dhe zbriste i pari në Zall. Shkonte qershi më qershi dhe hipte ndonjë fëmijë, se vetë kishte nja dy vjet që s'hipte dot, ngaqë i merreshin mendtë. Ai kthehej në lagjen e sipérme me buzët të nxira dhe u shiste tangërllek doktor Kristos, infermier Sefës, furrëxhiut dhe nepunësve të tjerë se kishtë ngrënë disa kile qershi nga të Zallit.

— Egoist! — ia priste doktor Kristoja, — vetëm për vete mendon ti...

Por ja, nuk shkonte shumë kohë dhe piqeshin edhe qershítë e lagjeve të sipérme të Arrës. Fëmijët s'kishte zot t'i bënte zap. Ata u vinin rrotull qershive, si ato fushkak se hutohen pas atyre kokrrave të kuqe e joshëse, sa nuk e vënë re fare gjahtarë, që u vjen ngadalë e vjedhurazi për t'i hedhur në tokë, edhe kur sapo ndoshta kanë filluar të çukasin kokrrat e para të qershisë...

Brigadier Mexhiti zakonisht në këtë kohë merr masa përforcuese për sektorin e pemëve. Ai vendos në këtë zonë edhe «shtabin e brigadës», që njerëzit ta dinë se, përvèç rojeve, kanë të bëjnë personalisht edhe me të. Mirëpo një ditë — ishte ditë e enjte — ai së bashku me Asllan Berin, bujkun e zot dhe ustanë e Arrës, ai që u meremetonte shtëpitë dhe u zinte pikat e çati, ve, duhej të shkonin në Komitetin e Partisë. Atë ditë do të bëhej pranimi i tyre nga kandidat partie, në anëtar partie. Brigadier Mexhiti ishte ngritur që me natë dhe u kishte bërë një «inspektim», siç thoshte drejtori i shkolles 8-vjeçare, ngastrave që ishin mbjellë me qershi dhe

që ngriheshin të bukura në mes të kodrave ose në ndonjë fushë të pjerrët, ose edhe buzë luginave. Pastaj ai vajti e trokiti në derën e Pashone Krepit.

— Zgjuar je, Pashone? — pyeti me një fill zëri.

— Urdhëro, Mexhit!

— Na u bë vonë, duhet të nisemi.

Pashonia i hodhi një vështrim të kujdeshëm nga koka te këmbët dhe buzëqeshi me kënaqësi.

— Shkëlqeka sot, Mexhit, — tha ajo me sytë që i shndritën.

— O sot, o kurrë, shoqja sekretare.

— Ke të drejtë, shoku Mexhit, ke shumë të drejtë, — tha ajo me një ndjenjë të thellë kënaqësie.

A e di ti se sonte s'kam mbyllur sy gjithë natën e natës! Çfarë s'mendoja! Unë, Mexhit Driza, anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë! Unë, Mexhit Driza...

— Nuk ka nder më të madh.

— Hajde pra, se, sa të gjejmë ndonjë makinë, na duhet kohë.

— Erdha; — dhe pas pak Pashonia doli me një shportë në dorë nga ato të artizanatit. Edhe ajo ishte veshur me rrrobat më të mira.

— Kam merak qershítë, Pashone, — tha Mexhiti, duke ecur përmes një are të vogël, që dukej si një qilim i blertë, i ndarë nga një rrip i ngushtë toke ngjyrë kafe — udhëza nga ecnin njerëzit. Pashonia s'fiste. Ajo rregullonte herë pas here shaminë e re, tërë ngjyra e lule, që ia merrte filadi pranveror, dhe asaj i zbuloeshin ato kaçurrelat e leshrave, që vareshin mbi veshët e saj të vegjël:

— Kini mendjen sot, goca, — u thoshte Mexhiti disa të rejave që do të merreshin me vjeljen e qershive.

— Hajde, Mexhit, hajde, as dhëndër nuk ke qenë kështu si sot!

Brigadier Mexhiti bënte sikur s'e kishte mendjen aty, por një buzëqeshje e ëmbël i shkiste nëpër fytyrë. Ai ishte veshur me një kostum blu prej stofi të kualitetit të parë. Pak i gjatë, me trup të drejtë, me flokë rebelë, të

dendur, që i kishte ndarë me një vijë në mes, por vija nuk mbante gjatë, sepse leshrat e tij nuk shtroheshin, ai dukej atë ditë me të vërtetë dhëndër dhe kaluar dhëndrit.

Pas pak ia behu edhe shoku tjeter i tij, Asllan Beri. Ky nuk ishte në gjendje aq të mirë ekonomike sa brigadier Mexhiti. Kishte një tufë me kalamaj ai — katër djem dhe pesë vajza — dhe kështu nuk kishte përse të mendonte për kostume e më the të thashë. Por ishte treguar i zgjuar: kishte vajtur në shtëpinë e Bilal Bregut dhe i kishte marrë hua xhaketën e tij të re, se ajo e vetja nuk ia mbushte syrin për një ngjarje aq të shënuar, siç ishte ngjarja e asaj dite.

— Dalçi faqebardhë! — i uronin kooperativistët, dhe ata të dy, Mexhiti dhe Asllani, të shoqëruar nga Pashonia, falënderonin me dorë në zemër. Një flake e ngrohtë dhe e shkëlqyer ua ndriste bebet e syve. Gjatë shumë vjetëve ishin përpjekur me gjithë shpirt për t'ia arritur kësaj dite...

— Dëgjo, shoqja Pashone, kur të dilni nga Komiteti, drejt e në restorant, — i thoshin disa të rinj gazmorë.

— Dhe ku të jetë më i shtrenjti, — shtonë një tjetër.

— E kam vetë parasysh, — u thoshte Pashonia, edhe ajo shumë e gjëzuar dhe e emocionuar nga tërë ajo atmosferë përzemërsie.

S'mbeti fëmijë që nuk e mori vesh që brigadier Mexhiti ishte nisur për në qytet. Ata fluturonin nga gjëzimi, se pandehnin se do të bënин kokrrën e qejfit atë ditë. Mirëpo Mexhiti ua kishte zënë pritat me kohë. Në këmbë të vet kishte caktuar Xhemal Krepin, të shoqin e Pashones, që kalamajtë ia kishin frikën dhe i rrinin sus.

Kur dielli shkrepi mbi majat e maleve, dy skuadrat me gra e me vajza filluan vjeljen e qershive. Mëngjes i freskët, mëngjes që buçiste nga zëra të gjëzuar. Secila nga gratë ka qejf më shumë të hipë lart, në pemë, sesa të rrijë poshtë, e të mbajë koshat. Ato janë të shkathëta dhe u ngjiten qershive si ketra. Madje hipin aq lart

dhe u kacavirren degëve aq tē holla, sa thua se do tē rrë-zohen nga çasti nē çast.

Fëmijët rrinë poshtë, me kokën përpjetë.

— Na hidhni ndonjë degë, oj Rahime!

— Jo, jo, se dëmtohet qershia. Duam tē hamë edhe mot ne.

Xhemal Krepi ka hipur nē një qershi, që mund tē ketë mbi tre kuintalë kokrra. Është qershia më e madhe dhe më e mirë e lagjes së sipërme.

— M'u lodh qafa, or babë, — ankohej Mira e vogël me kokën që e mbante vazhdimisht përpjetë.

— Prit, se tē jap unë, kur tē zgres.

— Po ti pér vete po ha! E mbarove gjithë qershinë! e hollon zërin ajo si shprehje e një proteste tē fortë. Xhémali queshte me vete.

— Prite, pra, — dhe i hodi një degë tē vogël, me shumë kokrra tē kuqe. Mira përgatiti fustanin, por s'ishte në gjendje ta pritte degën, dhe kokrrat e qershive i plasën nē tokë.

— U çanë, or babë, — u ankua përsëri ajo, tek futi nē gojë disa kokrra njëra pas tjetës.

— Por ti nuk di tē presësh.

Ti nuk i hedh nē fustan.

— Unë aty i hedh, por ti nuk di t'i presësh qershitë.

— Hidh përsëri! — dhe, ngaqë e vështron te lart, iu mörën mendtë dhe u rrëzua.

— Jo, jo, se tē bëhen me dhe.

— A tē shkoj tē marr çarçafin e manave? — tha Mira dhe u ngrit sakaq.

— Dreq kalamani! — pëshpëriti Xhemali atje nē maje tē qershisë dhe u përpoq tē shihte Mirën përmes gje-theve tē dendura dhe morisë së kokrrave tē kuqe.

22.

Të hënën, në ora dyimbëdhjetë, kur dielli shkëlqente në kupën e kaltër të qillit, në Arrë mbërriti një «gaz 69». Fëmijët iu turrën pas makinës, duke thirrur me zë të lartë. Shoferi frenoi dhe nga makina zbriti një oficer i Policisë Popullore. Ishtë i gjatë dhe me trup të drejtë. Ai pyeti se ku ishin zyrat e këshillit të bashkuar dhe, kur fëmijët ia treguan, u nis ngadalë, duke vështruar me kujdes rrëth e rrrotull gjithë ambientin. Dukej që vinte për herë të parë në Arrë. Islam Sula i doli përpara dhe e priti me përzemërsi. U futën në zyrën e këshillit. Ishtë një zyrë ajo jo si në qytete, megjithatë njeriu e krijonte menjëherë përshtypjen se ndodhej në zyrë, Përballë, tavolina e kryetarit, ngjitur me të ishte një tavolinë tjeter që së bashku formonin gërmën T. Mbi tavolinë ndodhej një makinë shkrimi Oliveti.

— U lodhët? — e pyeti Islami dhe i zgjati paketën e cigareve «Partizani».

— Ju falem nderit, nuk e pi, — tha oficeri me një buzëqeshje të gjiltër, në fytyrën e tij të gjerë. Islami pandehu se oficeri nuk e dëgjoi. — U lodhët? — e përsëriti pyetjen Islami, sepse nuk dinte nga t'ia fillonte muhabetit. Nuk donte ta pyeste menjëherë për shkakun e ardhjes në Arrë.

— Jo, jo, jemi mësuar me udhëtime ne.

— Dëgjova zhurmën e makinës dhe poteren e kalamajve dhe dola të shoh.

— Shumë fëmijë m'u duk sikur paska ky fshati juaj!

— tha oficeri me buzëqeshje.

— C'punë tjeter kemi ne, katundarët? — ia priti Islami me zë të butë dhe me buzën në gaz. Edhe oficeri buzëqeshi përsëri pastaj tha:

— Unë kam ardhur nga dega e punëve të brendshme për të verifikuar me Partinë dhe me pushtetin një ankesë të një kooperativisti.

— Si quhet ai?

Oficeri hapi çantën, nxori një bllok të trashë dhe një dosje, lexoi diçka dhe tha: — E quajnë Nuri Loku.

— E për çfarë ankohet ai? — picërtroi sytë Islami.

— Ai ju akuzon ju se i keni vajtur në shtëpi natën dhe i keni marrë dy krerë dhi, të cilat ju janë gjetur në haur, ju akuzon gjithashtu se ti tok me djalin tënd i keni dalë në rrugë, e keni kërcënuar dhe e keni goditur me pëllëmbë. Ai ankohet edhe se i ati i Xheje Brahimit e rreh të bijën, se ka rënë në ujdi me Selim Qarrin për t'ia dhënë përgrua kundrejt një ryshfeti prej 5 mijë lekësh.

— Po tjetër ç'hotë? — pyeti Islam Sula dhe u përpooq që ta përbante shqetësimin që i shkaktuan akuzat që i bëheshin.

— Kaq, — tha oficeri, tek shfletonte bllokun me gish-térinjtë e dorës së djathët. — Tani, po të keni mundësi, lajmëroni sekretarin e organizatës bazë, kryetarin e kë-shillit të fshatit, Nuri Lokun dhe Xheje Brahimin. — Be-fas ai e ndërpree fjälén dhe shtoi duke ngritur pak një-rën vetull: — Jo, jo, Xheje Brahimin mos e lajmëroni tani.

Islam Sula ia kishte mbërthyer sytë bashkëbisedue-sit. Nuk e njihte, nuk dinte ç'njeri ishte, i urtë apo ner-voz, i shakasë e i muhabetit apo tepër serioz e gojëkyçur.

— E ka shënuar datën kur unë e paskam rrahur atë?

— pyeti me një ton, jo të zakontë Islam Sula.

— Po, e kâ shënuar: njëzet e dy prill ora 8 e darkës.

— Një gjë po më vjen për t'u çuditur, — tha si befas Islami, tek mendohej. — Si s'keni përtuar ju, goxha bu-rrë e goxha oficer, keni lënë punën dhe keni marrë mun-dimin deri këtu në Arrë për shpifjet e një rrugaci!

— Kjo është detyra jonë, — tha oficeri me zë të qetë,

— Meqenëse jemi vetëm për vetëm, — ia priti si me nxitim Islam Sula, — të lutem shumë shëno aty në bllokun tënd se unë natën e 22 prillit bashkë me djalin tim kam që-në për mik, kam ngrënë e kam pirë te Bedri Gjuzi, kurse ai thotë se në atë datë dhe në orën 8 të darkës, kur unë isha mysafir, e paskërkam rrahur!... Sa për të tjerat edhe ato dihen.

— Ashtu qoftë, — tha oficeri dhe hoqi kapelën nga koka. Ca pika djerse i shkëlqenin në ballin pa rrudha.

Islam Sula doli jashtë dhe dërgoi dy të rintjtë që të lajmëronin personat e kërkuar. Oficeri mbeti vetëm për disa minuta. Nga dritarja përballë dukeshin luginat që humnerat e Arrës, dukej Zalli me ujet e lumit që farfurinte nga rrezet e diellit, dukej mali i Derdomit, i gjelbër e i madhërishtëm. Tek kundronte panoramën, në zyrë hyri Sherif Arra. Ky i buzëqeshi oficerit të policisë, iu afrua me një farë vemendje të tepruar, i zgjati dorën dhe ia shtrëngoi fort, si të ishin miq të vjetër e që i kishte marrë malli.

— Islami ku qenka kështu? — pyeti duke përkëdhelur me dorë kokën e tij gjysmëtullace.

— Tani vjen.

— Ra një heshtje e shkurtër.

— Po ju përsë paskeni ardhur? — s'duroi pa e pyetur Sherifi.

— Natyrisht për punë, — tha shkoqur oficeri.

— E kuptoj, — ia shkrepri të qeshurit Sherifi, — sigurisht për punë, — dhe qeshi përsëri, — po ka punë, e punë, — shtoi pas pak si me konfidencë ai. — Kur vini ju të policisë, helbete nuk vini për të mirë.

— Nuk po të kuptoj, — tha oficeri dhe i hodhi një vështrim të kujdeshëm.

— Thonë se diçka e keqe duhet të ketë ndodhur! Apo jo? — dhe Sherifi lëpiu buzët e murme me gjuhën e tij të

— Përsëri nuk po të kuptoj, — ia priti si me ironi oficeri. — Thuajeni më qartë mendimin tuaj.

— Më qartë nuk di unë, tha duke qeshur, po edhe si i pakënaqur Sherifi. — Unë e kuptoj se punët tuaja janë një çikë si sekret hesapi, prandaj ju të hidhni degë më degë, — dhe qeshi përsëri, duke zbuluar dhëmbët e tij të veshur me ar.

— Tani hyre në temë, — ia priti oficeri me zërin e tij tingëllues dhe pushi i verdhë sipër vetullave iu drodh lehtë.

Jashtë u dëgjuan ca fjalë të ashpra, diçkush thirri një emër gruaje me zë të lartë; Islam Sula u kthyte në zyrë.

— I lajmërova, — tha ai, tek merrte frymë si me zhurmë.

— Cilët, o Islam? — pyeti me gjysmë zëri Sherif Arra dhe me sytë që i shndritën plot shqetësim.

— Na kanë akuzuar, o Sherif, na kanë akuzuar shumë rrëndë, — tha Islami me zë të ngritur, i bërë si plak në ftyrë.

— Për çështjen e dhive? — dhe i hodhi sytë vjedhurazi në drejtëm të oficerit.

— Posi, çështja e dhive do të hyjë në histori, po ka edhe gjëra të tjera, — tha Islam Sula.

— Derisa ai ju akuzon, diçka do të ketë, — ia priti si me shaka Sherifi, po në fakt, duke, e vështruar oficerin mu në ninëzat e syve, u përpoq t'i jepte të kuptonte se mbrenda atyre fjalëve kishte edhe diçka të vërtetë.

Pas pak, Pashone Krepi trokiti në derën gjysmë të hapur.

— Erdhe, Pashone? — tha Islami, — Njihu me këtë shokun e policisë. Kjo shoqja është sekretarja e organizatës bazë të partisë, Pashone Krepi.

Oficeri u ngrit në këmbë, e përshëndeti dhe i zgjati dorën me respekt.

— Tani ju, shok, na falni, — iu drejtua Sherifit ai. Sherifi doli pa fjalë. Ai nuk e kuptoi përsë e ndiente vreten ashtu të trondit, si të hutuar e si të mpirë në kokë. Vajti në furrë dhe pyeti furrtarin për shkakun e ardhjes së atij oficerit të policisë, pastaj hyri në mensem, doli që andej dhe vajti në zyrat e kooperativës, por asgjë s'mori vesh. Kjo e bëri tepër nervoz. Të ishte vetëm çështja e dhive vallë? Po ato të tjerat që tha Islam Sula? Sherifi e ndiente se diçka e rëndë duhej të kishte ngjarë. Se nëpër fshatra të kooperativave rrallë shihej ndonjë person me uniformën e policisë, kurse kësaj here kishte ardhur një oficer dhe jo një polic i thjeshtë! Diçka më e madhe sesa ajo e dhive duhej të kishte ndodhur! Ndonjë vjedhje e re? Ndonjë përdhunim? Ndonjë spiun? Ç'të ishte vallë? Sherifi merrte e jepte, e shpinte mendjen gjithandej, por nuk po i

binte më të. «Mos kushedi Islami na del ndonjë...? Jo, — tha përsëri me vete. — Po të ishte i tillë, ia vinin hekurat në vend.» Vajti në ambulancë... Doktor Kristoja sapo kishte vizituar një grua dhe po i jepte disa këshilla.

- Cili erdhi me atë gazin, Sherif? — pyeti Kristoja.
- Një oficer policie.
- Pse?
- S'di gjë.

— Si është e mundur të mos dish ti, Sherif?

— Besa, nuk e di, — foli si me naivitet Sherifi.

«E hëngri Islam Sula», — mendonte me vete Sherif Arra, tek vinte vërdallë aty, përparrë ambulancës.

Pak më vonë pa sekretarin e byrosë, Besnik Salën, që po vinte nga qyteti. Sherifi i doli përparrë dhe e vështroi me një ndjenjë të thellë gjëzimi, që i buronte nga brenda.

— Kush ka ardhur me këtë gaz? — pyeti Besniku dhe hoqi çantën e zezë nga sjetulla.

— Policia! — tha Sherifi sikur po tregonte një të fshehtë të madhe.

Besniku zuri të ekte drejt zyrës së vet. Sherifi e ndoqi pas.

Dicka ka bërë Islam Sula, shoku Besnik. Ai oficeri i policisë e ka marrë në pyetje.

- Islamin?
- Po, po, Islamin. Shko, po deshe, dhe sqaroje çësh-tjen.

— Po të jetë nevoja, më kërkojnë vetë ata, — dhe Besniku futi këçin në bravë dhe hapi derën. Kutërboi një si lloj ere myk apo diçka tjeter, krijuar nga mungesa e qarkullimit të ajrit. Besniku kishte disa ditë që s'kishte ardhur në zyrë. Kishte bërehur shumë, fshat më fshat, shtëpi më shtëpi për problemin e letrës anonime lidhur me shtimin e oborreve personale.

— Në derën e zyrës së tij trokiti dikush. Pa thënë aksoma» hyr», Besnik Sala dalloi trupin e një oficeri të gjatë me uniformën blu të Policisë Popullore.

— Me leje, shoku sekretar? — foli ai me fytyrë të gelur.

— Urdhëroni! — dhe Besniku u ngrit në këmbë. I zgjatën dorën njëri-tjetrit si shokë. Pastaj oficeri, i ulur në karrige, përballë sekretarit të byrosë, i shpjegoi me hollësi gjithçka rrëth ankesës së bërë nga Nuri Loku dhe i ati i tij, Dervish Loku...

Sherif Arra e pa oficerin kur hyri në zyrën e partisë. E pushtoi një gëzim i madh. Me siguri do të zbuloheshin faje të rënda. Ndoshta nuk ishte vetëm çështja e Nuri Lokut në këtë mes, me siguri policia duhej të kishte të dhëna të tjera të rëndësishme. Eh, sa bukur po shkonin punët! Sherifi ndjeu se kishte vepruar mirë. I pëlqeu qëndrimi që kishte mbajtur. Në dukje ai nuk ishte pajtuar as me vepri-met e Dervish dhe Nuri Lokut, as me të Hamit dhe Xhelal Vishnjës. Megjithatë, kishte njerëz (madje edhe vetë Islam Sula) që e dinin se Sherifi hidhte gurin e fshihte dorën. E dinin edhe të tjerë këtë që Sherif Arra ishte me Lokajt dhe vellezërit Vishnje, por s'kishin ç'ti bënin, nuk e akuzonin dot, se u mungonin faktet. Pashonia dy a tri herë kishte qenë gati duke ia përplasur në organizatën bazë, kishte qenë duke e akuzuar për njeri me dy faqe, por Besnik Sala e kishte këshilluar që të mos nxitohej. Patjetër e vërteta do të dilte në shesh një ditë.

Sherif Arra u nis për në shtëpi. S'i zinte vendi vend. Habitej përse ndiente një gëzim aq të papërmëbajtur nga ato që po ndodhnin. Habitej përse e paskërkësh urryer aq shumë ai Islam Sulën. E vërteta është se Islami, përveg të mirave, asnjë të keqe nuk i kishte bërë. E megjithatë, në shpirtin e Sherifit paskësh qenë ruajtur si një thëngjill i ndezur urrejtja për atë njeri! Pse vallë? Ai Sherifi nuk dinte ta shpjegonte me hollësi. Vëçse një gjë i dilte herë pas here përpëra syve: se do të ishte ai kryetari i pushtetit. Se, si pas tij, në fshat, njeri më me influencë e më të zotin se ai nuk mund të gjeje. Kështu i qe mëbushur mendja Sherifit. E këtë mendim nuk kishte dreq që t'ia shkulte nga koka.

Te kumbulla e Krepajve, ai vuri re Xhelal Vishnjën që po bisedonte me ekonomisten Liri.

— Eh, keni ndër mend të fejoheni bashkë? — u foli pa ditur qysh Sherifi.

— Plaq! — ia priti Liria, kurse Xhelali ia shkrepit të qeshurit me vrull, me duart në ije.

— Pse, them keq, a?

Liria zbriti poshtë si flutur, e skuqur pakëz në fytyrë. Xhelali iu afrua Sherifit dhe i shkeli syrin në drejtim të «gazit 69».

— Bravo ju goftë, e futët që e futët në klapë.

— Prit, prit ti, Sherif Arra, dardha e ka bishtin prapa, tha Xhelali, duke lëvizur gjuhën. — Eh, sa të palara do të dalin këtu!...

— Edhe një kokërr saqme do ai dhe ra përtokë.

Xhelali. — S'kemi përsë ta akuzojmë më, — shtrembëroi buzët

Më kanë thënë se një dajë i së shoqes paska qenë cilësuar si kùlak në vitin 1951.

— Ashtu?

— Qafsha kalamajtë, kështu më kanë thënë.

— Po, pse s'thua ti? — i qeshi nuri Xhelalit.

— Ja, pra, tek ta thashë.

— Tani ia qëndis vetë unë.

Mos harro të shohësh se në grindjen e vëllezërve Shima, në Derdom, më duket se Islami i ka ngrënë ryshfet njërit prej tyre, Aliut. Ti fute edhe këtë, ka se kush e sqaron çështjen; — dhe Sherifi u largua si ajo dhelpra që ruhet nga zagari. Donte të takonte të shoqen. Donte t'i thoshte se i erdhë fundi Islam Sulës. Nga grazhdi dëgjoi të lehurat e qenit të tij. «Bal, Bal, s'më njohe.» — dhe Sherifi ngjiti shkallët prej guri, ngadalë, duke u mbushur herë pas here me frymë, sikur të ishte plak nëntëdhjetëvjeçar. Gjunjët i dridheshin.

— Oj, grua, oj dreqe, — bërtiti ai me aq zë sa ta dëgjonte ajo. E shoqja zgjati kokën nga dritarja.

— Po duke sharë mbete ti, more burrë! — u ankua ajo dhe fytyra e madhe gjithë mish iu nder.

— Dil, dil këtu një çikë, bufe! E piu edhe Islami barin e minjve.

— Kush Islam? — pyeti ajo.

— Një Islam ka Arra, moj bufe! — u nxeh Sherifi

me paaftësinë e së shoqes, që nuk ishte në gjendje tia kuptonte mendimet pa i nxjerrë nga goja.

— Ka ardhur policia, një oficer i madh, po e pyet pér rrip e pér këpucë.

— Ashtu?

— Po, po, mori fund puna e tij.

Atë çast hynë në dhomë dy djemtë e Sherifit, që sapo ktheheshin nga shkolla. Sherifi i vështroi me vë-mendje dhe me një si brengë që i kishte zënë vend mu në kraharor. Donte t'u thoshte atyre dy vogëlushëve se «babì do t'ju veshë e do t'ju ushqejë më mirë se deri tani, se edhe ju do të gëzoni disa të mira që u takojnë fëmijëve të kryetarit, se mësuesit do t'ju vënë gjithmonë nota të mira dhe do t'ju nxjerrin në tabelën e të dalluarve...» — ai u shkëput nga këto ëndërrime dhe i kërkoi së shoqes t'i fërgonte një kokërr vezë me gjizë. Ish-te ulur aty afër oxhakut; mbi shilten e re, që zakonisht ua shtronte miqve. Tani kishte qejf të rrinte i-vetëm dhe të mendonte. E përfytyronte veten kryetar të këshillit të bashkuar. Nuk do të mbante më atë zyrë që kishte tani Islami. Do të merrete dhomën e ambulancës, se ajo ishte më e madhe dhe gjithë dritë. Do të shënonë edhe orarin e pritjeve të popullit, ashtu me gërmë të mëdha, siç e kishin shefat në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit. Mirëpo kishte çaste që nuk donte të mendonte gjatë mbi këtë pikë. Thoshte se fundi i fundit le të vendoste populli. Cilin të donte populli! Ai s'ishte keq edhe në vendin që kishte. Po prapë mendja, e shtyrë nga egoizmi, ambicia dhe karrierizmi, po atje e shpinte. Sa bulkur i përkëdhelte ëndrrat e tij Sherif Arra! Disave, që ua kishte inatin, do t'u vinte hakut. Tërë ata që i kishin folur mirë pér Islam Sulën do t'i sillte vërdallë dhe nuk do t'u mbaronte kurrë punë. Në kokë i lëviznin emrat e gjithë atyre që do të nxirritë nga puna e shtetit. Do të shkonte vetë nëpër ndërmarrje dhe do të ngulte këmbë se ata persona që do të thoshte ai të pezulloheshin menjëherë nga puna. Diku në një cep të trurit i dilte figura e Besnik Salës. Vështrimi i tij sikur ia prishte humora e Besnik Salës.

rin. «Do ta bëj për vete, do t'ia shtroj me darka e me dreka, që të më thotë: «Rrofsh, o Sherif Arra.» Pastaj dreqi-e di se si përfundon edhe ai! Ndoshta e transferojnë. Ishalla e gradojnë. Ministër le ta bëjnë, po të duan...

E shoqja i solli mezenë dhe pak raki. Ai kishte një faqore të vockël dyqindgramëshe, që ia kishte dhuruan një mik i tij. Ajo ishte racioni i tij i përditshëm.

— Kam vepruar kurdoherë bukur! — i bëri qejfin vetes Sherifi. Piu përséri. E shoqja u vinte rrötull punëve. Sherifi e vështroi me vëmendje. Kishte filluar t'i plakoj ajo. Disa vjet më parë, atij i gufonte zemra, kur vinte në shtëpi. Tani ajo s'ishte më e mëparshmjë. Edhe atëherë Sherifi i thoshte «bufë», por me një tingull tjetër, me një ton përkëdhelës që edhe asaj i vinte mirë, kurse tani këtë fjalë ia thoshte krejt ndryshe, me një lloj përbuzje të fshehtë. «E piu barin e minjve edhe Islam Sula», — pëshpëriti përséri me vete dhe ndjeu se gjaku i lëvrinte nëpër, damarët më shpejt më me vrull...

23.

Kanali Arrë — Selishtë — Bubrec ishte gati në përfundim. Tani mbetej vetëm vendosja e tubave. Në këtë punë të madhe që bëhej nga mëngjesi deri kur përhapej muzgu i mbrëmjes, deri atëherë kur kodrat dhe luginat bëheshin grumbuj hijesh, barrën kryesore e mbante Petrit Skënderi dhe vullnetarët e tjerë. Praktikisht Petriti kryente detyrën e brigadierit të brigadës së ndërtimit, e cila së shpejti do të fillonte hapjen e themë-

leve për ngritjen e spitalit dhe të maternitetit të ri të kooperativës «Çlirimi».

Për hapjen e kanalit po ndihmonte edhe qyteti. Komiteti Ekzekutiv i Rrethit dërgonte çdo muaj dhjetëra kuadro për të kryer punën fizike, mjekë, inxhinerë, gazetarë, artistë e nëpunës të sektorëve të ndryshëm. Bujqiste Arra gjithë ditën e ditës, gjëmonët jeta nëpër ato lugina, derisa binte nata, që i mblidhët njerëzit nëpër shtëpitë e tyre të qeta.

Sulë Metanin s'e zinte vendi vend nga gjëzimi. Ai punonte me mish e me shpirt dhe puna i jepte një kënaqësi të madhe. Tërë kooperativistët ishin përfshirë në një valë të madhe pune. Gruri i atij viti të kënaqte sytë. Ai po bëhej çdo ditë e më i verdhë, po merrte gjithnjë e më shumë ngjyrën e arit. Harabelët, me tufa, harbonin si të hazdisur në atë bollëk të madh ushqimi të këndshëm. Pikërisht ato ditë pune dhe vrulli përfundimin e kanalit, atëherë kur dielli shkëlqente dhe flladi pranveror të përkëdhelte, tamam në këtë kohë, lindën ca vështirësi të reja, të mëdha. Po punohej në një vend që quhej «Kepi i Xanit». Ai ndodhej në mes të Arrës e të Selishtës. Tamam aty ndodhej një nga humnerat më të mëdha. E tamam kjo humnerë duhej të kalohej me anë të tubave. Duheshin bërë disa trarë të gjatë e të trashë, të nguleshin në tokë e mbi ta të vendoseshin tubat e hekurit. Petrit Skënderi, Sulë Metani, Elmaz Fuga, Lindita Saliu, Liri Zeneli dhe shumë kooperativistë të tjera shkrinë gjithë energjitetë e tyre që puna të mos ndërpritej as edhe një çast. Me krahë, ata zunë të transportonin tubat e mëdhenj që peshonin mbi dhjetë kuintalë secili. Grahjet që u dilnin nga sforcimi i madh dëgjoheshin gati-gati deri në lagjen e sipërme të Arrës.

Djem petrita, — i kishte pagëzuar xha Isufi vullnetarët.

Prapa «Kepit të Xanit» ndodhej një pyll i bukur, me drurë dushku të dendur e të mëdhenj. Vullnetarëve u kishte pëlqyer pa masë ai vend. Pylli përhapte freski dhe vërvhellente pothuajse vazhdimisht. Petrit Skënderi

po saldonte bashkimin e dy tubave, Sulë Metani e ndihmonte kurse Elmaz Fuga me një dy kooperativistë po prisnin ërru për t'i përdorur si biga. Lindita me Lirinë hapnin kanal. Petriti, që kishte hipur mbi tub, me gjyzlykët e mëdhenj të saldimit për ta mbrojtur nga drita verbuese, dukej si ndonjë pilot. Saldonte dhe mendonte. Të dielën e kaluar ai nuk vajti në familje. Kur ishte takuar me të shoqen, ajo e kishte pritur si e pezmatuar. Kohët e fundit Petriti i kishte rralluar të vajturat në familje. Mirëpo e shoqja ishte sëmurur një ditë dhe e kishin shtruar urgjent në spital. Kiske ngrënë diçka të prishur dhe ishte helmuar. Dy net e dy ditë kiske vuajtur e kiske hequr shumë ajo.

— E martuar apo begare je ti? — e kiske pyetur një sanitare, tek i fuste serumin.

— E martuar jam, përsë?

— Po si nuk e pashë atë burrin tënd, moj korbë...

— E kam vullnetar në fshat.

— Shiko, se ato fshataret janë bërë shejtanka, — i kiske thënë sanitarja me shaka, por që asaj, Poliksenit të Petritit, i kishin mbetur gozhëdë në zemër ato fjalë. Dhe, kur Petriti erdhi në shtëpi pas dhjetë ditësh dhe e gjeti Poliksenin me pushim mjekësor, ajo i ndenji gjithë hundë e buzë, derisa e detyroi që t'i thoshte:

— Po mirë, fundi i fundit, paske ndenjur dhjetë ditë në spital, po pastaj? Mos e quan heroizëm ti këtë?

— Heroizmat t'i kemi lënë ty.

— Dëgjo, Poli...

— Na vajte në një fshat të humbur dhe po humbet edhe vetë atyre maleve e shkrepave.

— Shumë mirë bëmë, atje ishte nevoja të punonim.

— Po mos harro se ke familje, ke grua, ke djalin...

— E di.

— Shokët e tu ama vijnë çdo të diel...

— As ata s'kanë ardhur kohët e fundit; bile Sula e shtyu për një vjeshtë edhe një provim.

— Po unë Linditën e kam parë vazhdimisht këtu.

— Lëre atë, vajzë është ajo.

Ai fliste me një ton të butë dhe brendë përbrenda ndiente se ajo kishte të drejtë. I vinte keq, por nuk i shfaqej. Pastaj, me siguri, Poliksenin e shqetësonte edhe ana ekonomike. Petriti me të ardhurat nga kooperativa fare pak kishte mundësi të ndihmonte familjen. Por, me gjithëkëtë, ajo nuk i ishte ankuar asnjëherë. Asnjëherë nuk i kishte thënë të shoqit se mungonte kjo apo ajo. Këtë anë të mirë të karakterit të saj, Petriti e qmonte shumë. Dhe tani, tek saldonte, mendonte pikërisht mbi këtë çështje. I përfytyrohej Polikseni, djali, spitali, bis-sedat. Ai pshëretiu. «Gratë, gratë tona të mira!» — tha me vete dhe ngriti syzet mbi ballë, si pilot.

— E, o vëlla, ç'pate? — e pyeti Sulë Metani me atë zérin e vet karakteristik.

— Sikur na mori uria.

— Pylli na pret. Shih si fishkëllon. Si dridhen gjethet! Më duket sikur dëgjoj këngën e pyllit...

— Je me shpirt poeti ti, Sulë.

C'kanë poetët më shumë se ne? Dikur kam lexuar se të jesh poet, mjafton të kesh një shpirt të zjarrtë. Shpirtin e kam jo zjarr, por vullkan, për fjalë të nderit.

— Po me gruan si u ndave kësaj radhe? — S'mbeti pa e ngacmuar Petriti.

— Ti e di që unë me paratë që mora i bleva një copë për fustan dhe një palë sandale vajzës. Kur u ktheva për këtu, me zor i mora 25 lekë. I kam dhënë pesë të puthura, pesë lekë një e puthur më ka rënë! — dhe qeshi me gjithë shpirt. Qeshi edhe Petriti. Ndërkaq ata u nisen të hanin drekë. Atje, në pyll, po i prisnin edhe shokët e tjerë. Lindita sapo kishte përfunduar së ngrëni. Ishte shtrirë me krahun e djathtë si jastëk. Kënaqej me freskun dhe atë aromën e mirë të tokës gjithë bar të gjelbër.

— Hajde, aristokratja jonë, dhe një shezlong të mungon në këtë ambient përrallor, — ia priti me zë të lartë Sulë Metani.

— Çfarë? — pyeti ajo dhe u ngrit e mbështetur në bërryl.

— A u thonë shezlong atyre karrigeve që lëkunden si govatë në bregdet?

Lindita qeshi me të madhe. Liria po hante bukë. Elmaz Fuga zuri të përgjonte diçka me vëmëndje.

— Shihni, shihni, një lepur! — tha ai me zë të ulët, sikur kishte frikë se mos e trembte.

— Ku është? — pyeti Liria.

— Ja tek e keni, mu afër atij trungut të prerë.

— E panë. Lindita u mahnit! Lepuri, i strukur, herë pas here ngrinte kokën lart dhe currte veshët e gjatë. Aty pranë kaloi edhe një thëllëzë. Me ato puplat e bukura gjithë ngjyra, me ato këmbët e shpejta, ajo ecte dhe çukiste.

— Të kisha një çifte! — ofshani Elmaz Fuga me një psherëtimë të thellë.

— Nuk do të lejoja të shtije, — ia priti Sulë Metani.

— Pse?

— Këtu jemi si në një kopsht.

— Ka të drejtë Sula, — pohoi Liria.

Lindita u shtri përsëri. Mbrëmë ajo kishte qenë tok me Lirinë mikeshë në shtëpinë e Pashone Krepit. E shtrire aty në atë vend fantastik, asaj i kujtohesin bisedat me Pashonen. U kishte treguar Pashonia punëdoret e veta të bëra dikur, që kur kishte qënë vajzë. Lindita me Lirinë ishin habitur. Kishin parë lloj-lloj çorapesh të punuar me mjeshtëri nga Pashonia, pastaj ajo u nxori një xhamadan qëndisur me ar, pastaj një shami të bukur që e përshkonin tejendanë fije gjymyshi e temina të vogla që shndrisnin si flori.

— Këto i vishnim për bajram, — tha Pashonia me buzë në gaz e pak si e druajtur.

— Po pse nuk i vishni tanë për 1 Majin ose për 28,29 Nëntorin?

— Nuk shkojnë, janë veshje të vjetra.

— Çudi! — tha me gjysmë zëri Lindita. Përse të hiqen për fare apo të mbahen nëpër sepete si relike të kohëve të kaluara? Këto qenkan punime të shkëlqyera.

— Vlejnë vetëm si punë që i kanë bërë duart tonat. Ne, gratë e kësa zone, dimë të bëjmë qilima.

— Kaq të bukur si këto çorape?

— Edhe më të bukur.

— Po pse keni hequr dorë tanit?

— As unë s'e di, — rrudhi supet Pashonia.

— Këto çorape i dua për vete, — u hodh Mira e vogël dhe i tërhoqi me forcë, për t'i këputur nga tufa tjetër e çorapeve, që ishin lidhur me një fill leshi.

— Jo këto, se janë çorape burrash, — qeshi Pashonia.

— Ku i dalloni çorapet e burrave nga ato të grave? — pyeti plot kureshtje Liria.

— A e dini si e ka pasuar një herë kryetari i kooperativës me punën e çorapeve? — ia priti Pashonia me ftyrën e saj të ciltër.

— Jo, — pëshpëriti Lindita.

— Dëgjoni. Na vjen kryetari një natë i lagur dhe i bërë qull nga shiu. Ishte dimër. I bëra një zjarr të madh dhe e ndërrova me rrobat e Xhemalit. I dhashë edhe një palë çorape, tamam si këto. Të nesërmen ai ishte ngritur pa gdhirë dhe kishte ikuar. I kishte rastisur të flinte në Bubrec. Të zotët e shtëpisë kishin filluar të qeshnin nën buzë. Shih çorapet e kryetarit dhe qesh. Ato kishin qenë çorape grash!

— Po ku i dalloni ju? Mua më duken njëlloj, — e ndërpren Liria.

— Ja, te kjo lulja në mes. Të burrave e kanë lulën të plotë, kurse të grave e kanë gjysmë. Kishin qeshur të zotët e shtëpisë me kryetarin, derisa, më në fund, ia kishin thënë hapur: «Pashnderin, or kryetar, a mund të na tregosh se kush t'i ka dhënë këto çorape!... — Kryetari ia kishte treguar q' i kishte ndodhur një natë më parë. — Po thuaaj, mor burrë, ti ke veshur çorape grash, prandaj kalmajve dhe neve na vjen për të qeshur!» «Pashonia ma paska punuar!» — u kishte thënë kryetari dhe kishte qeshur edhe ai vetë...

Këto përfytyronte Lindita, tek rrinte e shtrirë në ato

hije tē dendura që pérhapte pylli. Nëpër barin e njomë duket aty-këtu ndonjë milingonë. Një brumbull i zi fluturon mbi kokën e Linditës, si helikopter. Brenda, më në thellësi tē pyllit, dëgjohen cicërima bilbilash e mullënjas, por kënga e qyqes mbizotëron mbi tē gjithë. Në tē rrallë, buçasin minat e një reparti ushtarak. Gjithë lugina ushton. Ushtima largohet e largohet dhe po nga larg vjen përsëri jehona e saj, që i ngjan bubullimës...

— Çohemi? — u dëgjua zëri i Petritit.

— Sikur s'na vjen mirë. Të lësh tërë këtë bukur! — murmuriti Sulë Metani me sytë e shndritshëm si fosfor.

Një zog qyqeje erdhi e ra fluturimthi mbi qarrin aty pranë. Sulë Metani pér herë tē parë shihte një qyqe aq afër. Ishte vërtet i bukur zogu i qyqes. Shpendi vështroi nga lart poshtë, pastaj filloj tē këndonte. Këndonte dhe lëvizte bishtin, që e kishte tē gjatë, e lëvizte një herë djathas e një herë majtas, si fshesë me korent.

— Çohemi, vëllezër, çohemi! — tha Elmaz Fuga dhe rregulloi rripin e pantallonave.

Njëri pas tjetrit u ngritën tē gjithë.

24.

Në pesëmbëdhjetëdhjetëshin e dytë tē korrikut, gruri priste draprin. Tërë fshati u ngrit në këmbë, me gra e me burra, me tē rinj e çiliminj. Organizata e partisë kishte bërrë një mbledhje tē posaqme dhe kishte marrë vendime që kjo fushatë tē përfundonte në kohën e duhur dhe gruri tē futej në depo pa asnjë firo. Ishin caktuar edhe pikat e lëmenjve, njëra në Zall, ku shkonte makina shirëse, tjetra në qëndër tē fshatit, ku shirja do tē bëhej me kuaj.

Aksioni ditën e parë filloi qysh me natë. Njerëzia u zgjuan në ora tre pas mesit të natës. I zgjoi çanga, që i ra me forcë dhe pa ndërprerje xha Isufi. Ditën e parë, për solidaritet dhe për kënaqësi, shkuat të korrnin grurë edhe vullnetarët. Ata ishin gjithë shend e verë. Kishin dëgjuar se si fushata e bukës së re kthehej në një festë të vërtetë dhe s'kishte kënaqësi më të madhe sesa të merrje pjesë në këtë betejë të bukur.

Me të rënë çanga, njerëzit e prishën gjumin e ëmbël, u zgjuan si në alarmet partizane. Nëpër shtëpitë u ndezën sakaq dritat elektrike. Thua se njerëzit s'kishin fjetur fare! Thua se ata kishin pritur alarmin që do të jepte çanga. Ishte ndezur edhe drita në dhomën e vullnetarëve, edhe ajo në dhomën, si kuti, të Linditës dhe të Lirisë. Të pestë, si një repart i vogël partizan, ishin gati për aksionin e madh.

— Shpejtësi, disiplinë, kualitet, — thoshte herë pas here Sulë Metani, thua se po lëshonte parulla luftarake në mes të një stadiumi, ku përgatitej ndonjë festival fiskultural. Petriti me Linditën kishin dalë te dera dhe po soditnin natyrën e asaj nate të bukur. Ishte një natë e rrallë dhe shumë e freskët. Qielli mbushur me yje. Hënë nuk kishte, ndaj malet ngjanin me ca grumbuj hijesh, hije të dendura e me forma gjigande. Fresku që zbriste dallgë-dallgë nga malet me pyje ishte si një dhuratë e veçantë, që mund ta shijonin vetëm njerëzit e kësaj zone, pilkërisht ata që ndodheshin zgjuar dhe që po niseshin për në aksion.

— S'ka të paguar ky fresh dhe ky ajër i pastër, — pëshpëriti Petriti, duke mbushur mushkëritë.

— I sheh njerëzit me fener nëpër duar? — tha Lindita, duke shënuar me gisht.

— Po vijnë. Sa bukur! — pëshpëriti me gjithë zemër Petriti, kur pa në pikat tē ndryshme shkëlqimin e dritave të fenerëve të kooperativistëve, që po zbrisnin drejt Zallit. Zalli ishte caktuar si fronti i parë i punës. Në Zall binte drapri i parë. Atje piqej në fillim gruri, pastaj buqit ngjiteshin përpjetë parcelë më parcelë. Befas u dëgjuat zëri i ngjirur i brigadier Mexhitit. Ai diç tha për vullnetarët, prandaj Sulë Metani ia priti me zë të lartë:

— Gati, gati jemi, shoku brigadier!

U nisën. Xheje Brahimi printe e para, me fenerin në dorë. Një grup tjetër e udhëhiqte e shoqja e Bedri Gjuzit, e cila rrallë dilte në punët e kooperativës, për shkak se vuante nga kolona vertebrale. Pashone Krepi kishte marrë hopa Mirën e vogël. Nuk kishte pasur ku ta linte, për shkak se të gjithë do të shkonin në punë. Vogëlushja, me kokën të varur te supi i s'ëmës, përpiquej të mos flinte, sido që gjumi në atë orë ia mbyllte qepallat.

*«Shkrep si zjarr porsi rrufeja
mbi armikun gjakatar...»*

filloi të këndonte befas Sulë Metani, në fillim me zë të ulët, po, kur pa se e ndoqi Lindita me Lirinë, ai e ngriti zérin.

Dhe në shkrepa nis beteja...

Kënga shpërndahej nëpër errësirën e natës, valë-valë, përkëdhelte zogjtë, që flinin nëpër drunjtë e pyllit, përshkonte zemrat e njerëzve, që nxitonin për në punë, bënte të ushtonin kodrat e luginat.

— Ju lumtë goja, moj Linditë! — u dëgjuia zëri i brigadier Mexhitit.

Ecim, ecim dhe marshojmë....

Kënga vazhdon. Lindita, Liria, Sula dhe pastaj Petriti me Elmaz Fugën, të ndjekur nga disa të rinj, që atë vit kishin mbaruar shkollën 8-vjeçare, këndojnë tok, si në kor, dhe, sa vjen, kënga i ndez gjithnjë e më shumë. Këndojnë me gjithë shpirt. Ata kanë mendime të ciltra, të bukurë. Mendojnë për punën, për jetën, për të afërmët, për grurin. Shikojnë këtë natë të shkëlqyer, këtë bukuri fantastike, këtë kolektiv të mirë dhe njerëzor.

— Nëma mua Mirën, shoqja Pashone, — i thotë Liria.

— Jo, jo, është udhë e keqe.

— Ta marr unë, — e ndërpret këngën Sulë Metani dhe zgjat krahun.

Po Mira, e zgjuar nga kënga, nuk do. Ajo shtrëngohet fort pas qafës të s'ëmës.

Arritën në Zall. Uji i lumi rrridhte qetë-qetë. Bujqit vendosën aty, te rrapet, shamitë dhe torbat të mbushura me ushqime. Nga anë të ndryshme vinin grupe-grupe edhe banorët e tjerë të Arrës.

— Deri në Derdom dëgjohej zëri i Linditës, — tha Islam Sula, i cili kishte ardhur edhe ai në aksionin e grurit.

— Ata s'paskan pasur nevojë për çangë, — shtoi di-kush.

Me grupin e fundit ia behu edhe sekretari i byrosë, Besnik Sala, që e lante rrugën me një elektrik dore.

— E dini sa më mallëngjeu kënga juaj? — i tha ai grupit të Petritit. — Më dukej se ishit vërtet një repart partizan që po marshonte për në beteja kundër armikut.

— Kënga është baras me pushkën, — tha i sigurt Sulë Metani.

— Tani, shokë, dy fjalë përpara se të filloni nga korrija, — ndërpreu bisedat zëri i ngjirur i brigadier Mexhilit.

— Do të fillojmë në këto parcelat këtu. Ato të tjerat atje, do t'i korrin banorët e Zallit. Në orën tetë do të hamë mëngjes. Ndahuni vetë, disa të korrin, disa të lidhin duaj. Na qoftë për hajër, pra, — dhe i pari mori draprin, u fut në parcelën me grurë dhe filloi të korrte. Të gjithë, pa fjalë, ndoqën shembullin e tij. Pashonia e la Mirën pranë një rrapi, e mbuloi me një çarçaf të vogël, të bardhë, por vogëlushja nuk pranonte të rrinte vetëm, ngaqë kishte frikë. Ajo i shkonte pas Pashones.

— A të thashë se do të më pengosh në punë? — i foli si me qortim eëma. — Rri aty e mos të ta dëgjoj më zërin! Ose, po deshe, eja korr edhe ti me ne, — shtoi ajo si me shaka.

— S'kam drapër, — murmuriti me ton ankues e me seriozitet Mira me gishtin që e rrotullonte te goja...

— Po Sherif Arra ku qenka? — u dëgjua zëri i Besnik Salës.

— Sherifi? S'begenis tē vijë ai. Rralléherë e shohim nëpër aksione, — ia priti një i ri.

— Pô e shoqja

— Do tē ketë dalë me ata tē Zallit, se mbrëmë ka qenë mikeshë në Zall, — tha Nifja.

Pashonia e bindi më në fund vogëlushen që tē rrinte vetëm. I premtoi se do t'i blinte hem karamele, hem bis-kota te dyqani i Canit.

— Gruri qenkerka i pastër, nuk paska egjér, — tha Pashonia, pasi korri duajt e parë.

— E kam spërkatur dy herë me granular unë, — tha si me mburrje brigadier Mexhiti.

— Po, po, është i bukur ky grurë, — pohoi edhe një tjetër.

— Pse s'thua se është më i miri? — ia priti përsëri brigadier Mexhiti. — Në parcelat e Zallit me siguri i përlamë 30 kuintalë për hektar. Frikën ua kam parcelave tē sipërmë unë.

— Jo, jo, mos u tremb, se edhe ato tē mira janë. Edhe atje gruri i ka kokrrat tē plota e tē mëdha, — foli Nifja, e sigurt.

Njerëzit korrnin me shpejtësi. Korrnin edhe vullnetarët. Shumë shpejt ata ia morën dorën kësaj pune dhe po-thuajse ecnin krahas shokëve e shoqeve fshatare.

— Lindita, kujdes, se mos tē del ndonjë larosh, — i thoshte Dija, një grua me moshë tē re, por që kishte lindur 11 fëmijë.

— C'është laroshi, moj Dije?

— Gjarpri, gjarpri, — i shpjegoi një vajzë asaj.

— Qyqja, edhe gjarpri tē më zërë! — tha Lindita me zë si tē trembur.

Dalngadalë po zbardhete. Mali i Derdomit po shquhej mirë. Filluan tē dalloreshin edhe drurët, edhe humnerat. Qielli po merrte një ngjyrë argjendi. Yjet ishin rralluar dhe ato që dukeshin po veniteshin gjithnjë e më shumë. Zogjtë e pyllit po zgjoheshin. Dëgjohej qukapiku me klithmat e tij tē çjerra, frushullonin krahe turtujsh, këcenin nga degët e dushkut në tokë avdosqit. Pylli po shpaloste

gjithë atë bukuri mahnitëse që mbante në gjirin e vet.

— Po ti? — pyeti Besnik Sala si i habitur kur pa Liman Drizën që po vinte çalë-çalë, i mbështetur në shkopin e vet, në drejtim të tyre.

— Ne e kemi filluar përpara jush, — tha Limani me zë të hareshëm. — Punë të mbarë! — shtoi ai.

— Mbarë paq!

— E kemi filluar në orën 2 të natës ne, — vazhdoi Limani me atë zërin e vet të plotë e të trashë.

— Na e paskeni kaluar.

— Jo, jo, s'është aty fjala. Ne të Zallit e kemi më të lehta, se, e para, s'kemi për të bërë udhë si ju dhe, e dyta, ne e njohim vendin aq mirë, sa s'kemi nevojë as pér fenerë.

— Ku je, or Liman Driza, — ia priti Petrit Skënderi me zë të lartë dhe plot nuanca gëzimi.

— Po ai kush është?

— Vullnetar.

— Ju lumtë krahu, or shokë. Ata janë pér të marrë shembull, shoku Besnik, ata që kanë lënë familjet e tyre dhe kanë ardhur pér të ndihmuar kooperativën tonë.

— Sa mirë punohet nëpër fresk, — u dëgjua zëri i një nuseje të re.

— Çalë-çalë, Liman Driza iu afrua të vëllait, Mexhitit, dhe diç bisedoi me të me zë të ulët, pastaj u largua. Dhe, kur dielli ishte ngjitur gati nja dy hostenë mbi malin e Derdomit dhe kur gjinkallat kishin filluar të zukatin, te Pashone Krepi vajti Dervish Loku.

— Kisha një fjalë me ty, Pashone, — i tha ai dhe u ul nën hijen e një qarri të madh.

Pashonia buzëqeshi. Ajo habitej me atë plak mbi të shtatëdhjetat, habitej ku i gjente tërë ato forca, pér të ardhur vërdallë zyrë më zyrë e lugine më lugine.

— Hë, xha Dervish, si i ke hallet? — iu afrua Pashonia dhe qëndroi në këmbë përballe të tij. Dervish Loku merrte frymë me zor nga lodhja. Ai fshiu ballin me një së peshqir të vjetër që e mbante në qafë, nxori ngadalë kutinë e duhanit dhe, tek zuri të dridhëte cigaren, foli ngadalë.

— Ti e di se nënën tënde, Pashone, unë jam gjak.

- E di, — buzëqeshi ajo.
 — Bulkën hem ma keni ngrënë, hem juam ngrënë.
 — Po.
 — Ty, shyyqyr zotit, të kemi sekretarë partie. Te ti do t'i qajmë hallet ne, apo jo?
 Pashonia s'foli. E dinte ajo se ku do të dilte Dervish Loku.
 — Ti e di se çmë ka bërë mua ai Islam Sula, — i têr-
 hoqi fjalët zvarrë.
 — Po ti vajte e u ankove në qeverinë e madhe, ti
 s'pate besim te ne, o xha Dervish.
 — Unë u ankova kur pashë se ju i vutë kapak punës.
 Ju i dolët krah Islamit, në vend që të më mbronit mua.
 — Po ne u bindëm se dhitë nuk i ka vjedhur Islam
 Sula. Kështu vendosën edhe ata shokët e prokurorisë edhe
 të policisë.
 — Po ti e di se iu gjendën brenda në haur, apo jo?
 — Iu gjendën, iu gjendën, po dikush tjetër e ka kur-
 disur këtë marifet.
 — Jo, Pashone, nuk është ashtu, po ti thuaj se pesh-
 ku i madh e ha të voglin.
 — Hiq dorë nga këto gjëra, xha Dervish. Ju po përfol-
 ni shokët, ju kërcënoni një vajzë, ju po shqetësoni qe-
 verinë me gjenjeshtra. Kështu dëmtohet uniteti i popullit.
 Gjykonit edhe vetë: e mbroni, apo e dëmtoni ju vijën e
 Partisë?
 — Ta duash ti sa çereku im Partinë, të hante macja
 petën ty, — i têrhoqi fjalët zvarrë ai.
 — Duhen vepra, xha Dervish, jo fjalë. Dërgo djalin
 në brigadë, jemi në kohë fushatë e mos u sorollatni sa
 andej-këtej. A nuk e sheh ti se sot kanë dalë në punë i
 madh e i vogël, pleq e plaka? Kurse ti vjen rrrotull dhe
 merresh me punë jo të pëlqyeshme.
- Plaku qeshi** me ironi dhe tundi kokën e tij vezake.
 Psherëtiu thellë dhe u ngrit.
- **Nejse,** — tha me ton të dëshpëruar. — E dija qysh
 kur u nisa se ti kështu do të më prisje. Po e drejta ime do
 të dalë në mos sot, nesër.

— Kur e dije, përse erdhe atëherë? Kot që bëre mundimin.

— Thashë të të dal edhe një herë borxhit. Jam plak njeri dhe s'dua të të hyj në gjynah.

— Unë të këshilloj të heqësh dorë nga këto gjëra. Këto këshilla në daç zbatoji, në daç hidhi në lumë. Kaq kisha unë, mbeç me shëndet, xha Dervish!

— E, moj Pashone, kurrë nuk e besoja se edhe ti do të bashkoheshe me Islam Sulën, — tha ai ngadalë, duke e vështruar Pashonen me sytë e tij të bardhë.

— Djalin dërgoje në brigadë, kështu e do e mira, mos e lërë të shkojë nëpër kafenetë, duke pirë birrë me lloj-lloj njerëzish.

— I bëftë mirë birra, me paratë e veta pi, — e ngriti zérin plaku.

— Po ku i merr këto para ai? Për të punuar nuk punon!

— Derisa të jem gjallë unë, ai me birrë e me ç't'i dojë zemra do të jetojë. A e njeh kokën time, apo s'e njeh! Unë do të shitem e do të lëçitem, derisa të më dalë e drejtë! O e kam futur në burg Islam Sulën, o më përlaftë mortja si jevg udhëve.

— Po shkoj, xha Dervish. Po na zë vapa dhe unë s'kam bërë as gjysmën e normës, — dhe u largua, duke përshëndetur me dorën në ajër. Tek ecte, ajo u binte me drapër lulëkuqeve.

— Ç'thoshte Dervish Loku? — e pyeti Besnik Sala.

— Më zuri koka, shoku Besnik. Është vdekje të dëgjosh pallavrat e tij. Plak më tuaf se ai unë s'kam njohur në jetën time.

— Është i tillë se ka nga ata që i krehin bishtin. Pse nuk e pyete, kush të nxit në këtë udhë?

— Se mos do të më tregonte gjë mua!

— Atëherë t'ia thoshe troç se ti po bëhesh lodër e të tjereve.

— Këtë ia kam thënë.

— Këtu jemi, të gjitha do të dalin një e nga një. Ata edhe korrrnin, edhe flisnin. Pak më larg tyre dë-

gjoheshin shakatë gjithë kripë të Sulë Metanit. Qeshte a s'qeshte ai me atë Nifen e hollë e sybardhë dhe me Dijen, që kishte lindur njëmbëdhjetë fëmijë!

— U shkri Sula me gratë, — tha Besniku dhe zgjati kokën për të parë. Pashonia s'pati kohë t'i përgjigjej, se pse po vinte Mira e vogël. Dëgjohej vetëm zëri i saj. Ajo vetë nuk dukej, ngaqë e mbulonte gruri...

25.

Ali Bregu vdiq papandehur. Kishte gdhirë mirë atë ditë, madje kishte shfaqur dëshirën që të merrte pjesë edhe ai në aksionin për korrjen e grurit të kooperativës. Kishte marrë draprin dhe ushqimin e mëngjesit dhe ishte nisur për në punë, por befas e kishte zënë një dhembje e fortë në zemër. Sytë i ishin errësuar. Kishte qëndruar një hop te gardhi dhe pastaj ngadalë e me vështirësi ishte kthyer në shtëpi. «Nëm pak kos», — i kishte thënë Lules dhe ishte mbështetur me kurrizin pas një jastëku të trashë, që zakonisht e përdorte për vete.

Lulja kishte vajtur në raft, por kos nuk kishte gjetur. Atëherë me nxitim i solli palk kos që e mori nga komshinjtë. «Na, pije! — i kishte thënë ajo. — Apo do të ta bëj përslesh?»

Aliu heshtte. Kishte vdekur. Me siguri i kishte pushuar zemra. Lulja kishte lëshuar kujën. Ishte kohë fushate dhe njerëzia ishin nëpër ara, po, me të marrë vesh se ç'kishte ndodhur, ata erdhën të pikëlluar e me dhembje të thellë në zemër.

— Po ishte mirë, si ndodhi kështu?

— As ne s'e morëm vesh. Kërkoi pak kos dhe, kur ia sollën, kishte dhënë shpirt.

— Lum si ai! Vdiq pa vuajtje.

— Po, po, me këmishën e javës.

— Të gjithë të asaj toke jemi! — ia priti një burrë me moshë të kaluar, që kishte një fytyrë të madhe dhe zeshkane.

S'mbeti njeri pa ardhur për ngushëllim. Shumë njerëzve u mbusheshin sytë me lot për xha Aliun e mirë. Kishte jetuar afro një shekull Ali Bregu dhe kishte lënë gjurmë të paharruara. I biri, Bilal Bregu, që e ndiente thellë dhembjen për të atin, përpiquej ta mban te veten. I shkathët dhe me mendjen top, ai priste dhe përcillte njerëzit që vinin për ngushëllim.

— Ta mbyllim të gjithë si e mbylli Ali Bregu, — thoshte më plaku, i ulur në qoshe pranë zjarrit, ku ziente kafe.

— Po, po, jetoi me nder dhe vdiq me faqe të bardhë.

— S'ka gjë më të madhe e më të bukur sesa të vdeshtë me faqe të bardhë. A e dini, burra, se njeriu edhe një ditë përpara se të mbyllë sytë ka mundësi të turpërohet?

— Ke të drejtë, ka raste të tilla...

Të vjetrit bisedonin në dhomën e pritjes, duke pirë duhan e kafe. Flisnin për jetën, për korrjet, për mollët që po rritheshin të bukura, për shiun që prisnin gështhenjat, për rininë, për festat e reja, për gjithçka.

Pasdite e varrosën. Varrin ia hapën mu pranë varrit të një partizani të panjohur. Shpesh Ali Bregu kishte folur për atë njeri, për atë partizan. Mbante mend se e kishin quajtur Sotir, dhe vetëm kaq. Asgjë më tepër. Dy net ishte strehuar te Ali Bregu ai deli djale, pastaj kishte vendosur të ikte. Kishte detyra të rëndësishme për të kryer ai. Askujt nuk i kishte folur për planet e tij. Mirëpo e kishin rrithuar befasisht forcat e Bazit të Canit në afërsi të Selishtës. Kishte qitura goxha pushkë partizani Sotir, derisa më në fund kishte mbetur i vrarë. Ali Bregu ishte kujdesur për të, e kishte marrë në krahë, e

kishte shpënë në Zall dhe e kishte varrosur. «Sikur futa në dhe tim bir sot», — i tha Lules ai me lot në sy. Kaq. Asnjë fjalë më shumë. Në çdo 5 Maj, në atë varr të vemuar, gjeje një trëndafil të kuq. E hidhte Ali Bregu.

— Sa bukur e paskan menduar! — thoshin njerëzit, kur shihnin se po e varroson pranë varrit të partizanit.

— C'neri i drejtë që ka qenë Aliu!

— Ka qenë edhe trim, edhe i besës. Ishte njeri i Partisë...

— Më kujtohet kur erdhën partizanët në Arrë. Me ta ishin edhe shumë djem të Derdomit, Selishtës, Bubrecit, Arrës. Partizan vajti edhe Aliu. Si hidhte valle ai?» Të rrojë Partia, vellezër, të rrojë Shqipëria!» — thërriste me gjithë shpirt dhe tundte pushkën.

Në varrim mori pjesë gjithë kryesia e kooperativës, e këshillit të bashkuar dhe e frontit. Madje kishin ardhur edhe nga shumë fshatra të tjera të largëta. Sherif Arra u përpoq që fjalimin e rastit ta mbante ai vetë. Ishte rast i volitshëm të dilte si një nga kryesorët në atë ceremoni ku merrnin pjesë shumica dërrmuese e kooperativistëve. Mirëpo Besnik Sala, Islam Sula, kryetar Petro Doraci dhe Bedri Gjuzi kishin menduar që përshëndetjen ta mbante sekretarja e organizatës bazë, Pashone Krepit.

— Po është grua, — tha Sherif Arra me bebet e syve që i lëviznin me shpejtësi si zhivë nga inati.

— C'ka të bëjë këtu grua apo burrë? — e kundërshtoi Petro Doraci.

— Ne s'e kemi zakon që të vdekurin ta përshëndesin gratë. Bile gratë as që marrin pjesë fare në varrim.

— Rri, or Sherif Arra, lëri këto zakone! — ia priti përsëri kryetar Petroja — Ti je edhe komunist!

Fjalimi që mbajti Pashonia u pëlqeu të gjithëve. Atë e kishin përgatitur me kujdes vetë Besnik Sala dhe Bedri Gjuzi si kryetar i këshillit popullor të fshatit dhe si njeri që e kishte njojur mirë Ali Bregun.

Pas varrimit, Besnik Sala dhe Petro Doraci po ngjiteshin sipër për në zyrat e kooperativës. Ajo e përpjeta si thikë i lodhi, sidomos Petron, që ishte burrë mbi pe-

sëdhjetat. Rrugës ata u ndalën disa herë për t'u mbushur me frymë. Ecnin dhe bisedonin halle pune.

— E vure re se si ishin shkulur gjithë fshatrat e kooperativës për varrimin e Ali Bregut? — thoshte Petroja.

— Mua më erdhi mirë, se nderonin kujtimin e një njeriu patriot, që e kemi dashur të gjithë, por, ama, kur u bën thirrje që të gjithë të dalin në punë ose në aksion, pjesëmarrja nuk është 100%.

— Ashtu është! — poħoi Besniku si i kredhur në mēndime. — Edhe mua më bëri përshtypje një gjë e tillë. Nuk është keq që çështje të tilla t'i ngrëmë në mbledhjet e organizatave bazë dhe në popull.

— Të hënën isha i deleguar në organizatën e Bubreçit, tha pas pak Petroja. — U lodhëm shumë. Vura re se ishin ndarë në dy tarafe. Secili taraf hidhej kundër tjetrit. Din Dushkun e kishin kritikuar Besimi dhe Shaqiri si njeri që kérkon privilegje për familjen e tij, se vëtë Dini nuk del rregullisht në punë gjoja si i sëmurë, se të atin e paska futur në punë të shtetit e të tjera e të tjerë.

— Po Dini ç'thoshte?

— Dini? Buzëqeshte sikur s'kishte ndodhur asgjë... Petroja ndjeu se u lodh.

— Ulemi pak këtu, nën këtë hije të bukur, — tha dhe hodhi mbi barin e njomë xhaketën prej doku gri. Besniku ndenji mbi bar. Ai ishte vetëm me këmishë, një këmishë me mëngë të shkurtra, Dikush kaloi pranë tyre dhe pa i përhëndetur fare, u tha:

— Dini gjë, shoku kryetar, për atë që kishte ndodhur në Arrë?

— Jo, çfarë ka ngjarë? — ia qepi sytë ai.

— Kanë rrëmbyer një vajzë, vajzën e Sadikut.

— Kush e mori?

— S'di gjë, — dhe tjetri iku.

— U qoftë për hajér! — tha me dialektin e vendave Petroja. Ky u ngrit, hodhi krahëve xhaketën. Besniku, duke i fryrë cigares për të shkundur hirin e duhanit, tha:

— Të mos harrojmë çështjen e bagëtive. Kam të dhëna se disa familje sikur e kanë shkelur statutin.

Petro Doraci diç mendoi me vete. Edhe ai kishte një dy të dhëna lidhur me atë që tha sekretari i byrosë.

26.

Fshati, që në pamjen e jashtme dukej i qetë, gumezhinte. Nëpër shtëpitë njerëzit **bisedonin për gjithëka**. Ata i dinin pothuajse të gjitha: që ishte myllur ankesa e Dervish Lokut, që të birin nuk do t'ia pranonin në punë, se së shpejti Selim Qarri do të fillonte kursin për normist, që agronom Dauti ishte porositur të bënte autokritikë përpara brigadës lidhur me ngjarjen me Demir Krepin. Po, i dinin të gjitha dhe, natyrisht, i komentonin ashtu si ua priste dhe si u vinte për mbarë.

Pas shirave të fundit që ranë, qelli u la dhe u bë i kthjellët. Një diell i bukur, i ngrohtë, shkëlqente me madhështi. Mëngjeseve ose mbrëmjeve, ahet, panjat, shkoza dhe dushku, secili në ngjyrën e vet, dukeshin si kur të ishin spërkatur me lëng trëndafili. Herë të verdha, herë të kuqërrrema, tamam si ca bugeta të mëdha në mes të pyllit, ato të magjepsnin. Gëzonte njeriu, gjëzonte toka, pyjet, madje gjëzonin edhe insektet.

Ato ditë agronom Dauti kishte filluar matjen e oborreve dhe numërimin e bagëtive personale. Si ndihmës kishte një djalë të ri dhe një anëtar të këshillit populor të fshatit. Kur vajtën te trualli i Sherif Arrës, ishtë ndaj të perënduar. Një erë e lehtë dhe e vakët lëvizte gjethet e pemëve dhe dukej sikur përplasej pas misërish-tave të njoma. Sherif Arra, që e kishte marrë vesh se do

të vinin ata, po i priste aty në një qoshe të oborrit, ulur mbi një arkë të vogël, të vjetër. Pinte duhan dhe mendonte. Për punët e veta ishte i shkathët e i zoti ai. Çdo gjë e bënte me kujdes e zgjuarsi. Edhe tani ai po bluanë për ato që do t'i thoshte agronom Dautit. Po brenda në shpirt ndiente diçka që e brente dhe e gërryente. Sherifi nuhaste se punët nuk po rridhnin në atë vah që ia donte zemra. Këto veprime që po bëheshin, duke përfshirë edhe matjen e oborreve personale dhe numërimin e bagëtive, nuk i ishin të rastit, por të paranduara e të peshuara mirë. Vetë Sherifi kishte rrëth dyzet metra truall të tepërt, dy dhi e një lopë mbi numrin e caktuar. Megjithatë; ai kishte në plan të manovronte. Dy dhitë i kishte bashkuar me ato të Xhelal Vishnjës. Për lopën kishte menduar të thoshte se ajo akoma nuk ishte lopë, por mëshqerrë nëntëmuajshe dhe se do ta ~~hiqte pas tre muaj, kur të bëhej motake~~. Me këto mendime e gjeti agronom Dauti.

— Erdhëm ne, or Sherif Arra, — tha anëtari i këshillit popullor me një ndjenjë mburrjeje.

— Mirë se të vini! — ia priti Sherifi. — Shtëpia ime është hapur ditë e natë për miqtë e dashamirët.

Anëtari i këshillit u ul pranë tij, në cep të arkës, kurse agronom Dauti qëndroi në këmbë përpara tyre.

— Po luajti gjë, matjen e bëjmë nesër, në mos jo, po fillojmë qysh tani, — tha ai djaloshi i ri që ia kishte ëndë të hynte në bisedë me burra të pjekur.

— Për këta të dy po, u jap raki sa të duan, kurse ty po të bëj ca petulla, po të nxjerr edhe një pjatë me musht që të kënaqesh, — dhe Sherifi qeshi me gjithë shpirt.

— Jo, jo, — tha agronom Dauti. — Këtë punë do ta lëmë për nesër. Sonte jemi vonë. Te Sherif Arra do të ~~bëjmë~~ një kontroll shumë të imët, — dhe shpuri buzën në gaz.

— Vetëm te unë apo te të gjithë?

— Te ti më shumë.

- Si mik që më keni, ë? — dhe Sherifi qeshi si me zor.
- Atëherë, — e mbylli bisedën agronom Dauti, — nesër në orën 8 të mëngjesit të na presësh këtu.
- Natën e mirë! — thanë gati me një zë anëtari i këshillit dhe djaloshi.
- Rrini, or çuna! — i ndoqi pas ata zëri i Sherif Arrës.
- Me petulla? — ia priti anëtari i këshillit. — Burri do mish e pilaf, or Sherif Arra, e jo petulla...
- Agronom Dauti zuri të ecte ngadalë nëpër oborrin e Sherifit.
- Ti e ke nga pesëdhjetë metra tepër, Sherif, ë?
- Unë? Kush të tha?
- Ka plaçka këtu? — dhe ai nxori të bardhën e syrit.
- Të kanë gënjer, kur të qaj kalamajtë! As pesë metra nuik kam tepër unë.
- Kështu më tha edhe një person tjetër nga Derdomi, po, kur i vura metrin, i gjeta 35 metra më shumë.
- Sherifi instinktivisht vështroi andej nga fshati Derdom. Ai ndodhej në bregun tjetër, prapa zallit me zhur të bardhë. Atje ngriheshin plot bukuri ngastrat e kooperativës, të cilat shikonin duke u ngjitur përpjetë dhe arrinin deri pranë grumbullit të shtëpive. Sipër shtëpive fillonte mali me shkëmbinj të thepisur.
- Kush qe ai nga Derdomi? — pyeti pa ditur qysh Sherif Arra.
- S'ka rëndësi personi. Ka rëndësi 35 metërsi, po ti ke edhe një lopë të tepërt, — dhe i shkeli syrin me kast. Sherifi u skuq, pastaj filloi të zverdhej ngadalë.
- Mos e ke fjalën për mëshqerrën?
- Ajo është bërë lopë prej kohësh, or Sherif Arra. Ç'kujtove ti, mos hamë bar ne?
- E thua më të vërtetë? — shqeu sytë Sherifi.
- Si bukën që ha, — dhe buzëqeshi përsëri.
- Të kanë gënjer. Mëshqerra ime është tetëmuaj-she.

- Ti ke filluar ta mijelësh qysh në maj.
- Jo, pér nder të familjes, të kanë gënjer! A hyjmë brenda dhe bisedojmë më shtruar?
- Jo, jo, s'onte jam ftuar te sekretarja e partisë.
- Ashtu?
- I thashë se do të vete. Tani s'kam se si të mos shkoj.
- Ja tekështë Pashonia, — bëri me gisht në drejtëtim të saj Sherifi. Ajo ishte kërrusur me shatin në dorë. Era e vakët që frynte ia përkëdhelte cullufet e flokëve, bërë kaçurrela-kaçurrela afër tëmthave, mu te veshët e vegjël.
- A ta lajmëroj që po rri te unë s'onte? — pyeti Sherifi, duke e vështruar në sy agronom Dautin.
- Jo, jo, i kam dhënë fjalën dhe nuk bën që të mos shkoj.
- Mirë atëherë, nesër pér drekë të pres medoemos. Dhe shiko!! — shtoi ai, duke iu afruar pranë dhe duke ulur zërin. — Shiko se po më nxore ndonjë ngatërrësë, do t'i prishim hesapet bashkë.
- Detyra detyrë, Sherif i dashur.
- Po edhe unë të kam mbrojtur ty, kur ka qënë rasti pér ta thënë një fjalë të mirë në adresën tënde.
- Ashtu? — Unë s'di të kem bërë gjëra të këqija, aq sa të më mbrojnë të tjerët — ia priti Dauti si i fyter.
- E di unë. Pse pak rrufe kanë shkrepur e do të shkrepin në kokën tënde?
- Agronom Dauti shtrembëroi buzët. Diç mendoi. Kishinte nevojë pér mbështetje ai Sherifi ishte nga ata që, po të donte, mund ta ndihmonte.
- Sidoqoftë, bisedojmë nesër, Sherif — foli me ton të butë.
- Mirë, por eja me të tjera mendime.
- Të shohim, — buzëqeshi Dauti. dhe zuri të ecte. Era lëvizte gjethet e një qershie të madhe. Në perëndim dielli skuqte në qiellin ngjyrë manushaqe.

* * *

Sherifi u bë si i tèrbuar. Sapo u nda nga agronom Dauti, vajti menjëherë të takonte Xhelal Vishnjën. Zemra e tij e trazuar ndiente një boshllék të madh. Kish-te rrezik që këto gjëra t'ia bënin problem në organizatën bazë të partisë dhe ai e dinte se puna mund të shkonte deri në përjashtim nga Partia. Sherifi dinte se edhe të tjerë kishin kush një dhi, kush disa metra tokë më shumë nga ç'përcaktohej në statutin e kooperativave bujqësore, mirëpo ai ishte anëtar partie. E ndiente thellë Sherif Arra se këtë faj nuk do t'ia falnin shokët e Partisë. Ai ecte i kredhur në mendime, duke kafshuar thoin e gishtit të madh. Ky zakon i kishte mbetur qysh nga koha kur ishte ushtar.

Xhelal Vishnjën e gjeti në oborrin e shtëpisë. Një natë e kthjellët, e freskët, m'bulonte gjithë fshatin. Nga larg dëgjohej angullima e një qeni. Disa drita elektrike, të verdha, të ndezura nëpër shtëpitë, vezullonin e xixëllonin në errësirë.

— Mos u mërzit, — e qetësoi Xhelali. — Ai ka bërë shaka me ty. Kam biseduar edhe unë me të, bile edhe Xhevria.

— Po ai dreq më tèrboi fare! — dhe Sherifi zbardhi dhëmbët.

Xhelali buzëqeshi. Sherifi nuk e pa buzëqeshjen e tij, se ishin në errësirë.

— Te Pashonia do të shkoj edhe unë sonte, — pëshpëriti Xhelali. — Kështu kemi rënë dakord me Dautin.

— Shumë bukur, — tha i kënaqur Sherifi. — Atëherë nèsër eja me Dautin. Ju pres të dyve. Bile, po pate mundësi, rregulloje që matjen ta bëni ju të dy. Ata dy të tjerët i degdisni në ndonjë vend tjetër.

— Mirë, mirë, — tha Xhelali dhe u nis për te Pashonia. Sherifi e shoqëroi deri afér shtëpisë së saj. Mëdje ai dëgjoi të trokiturën e derës dhe këtë dialog:

— Kush është?

— Hape, hape.

— Ti, Xhelal, je? — e njoju ai zérin e Pashones.
— Unë jam, unë, — dhe u hap dera. Sherifi u largua.

Ndérkohë Mira e vogël i doli përpara Xhelalit, e shpejtë si flutur. Sa shumë u gëzua ajo vogëlushe, kur pa Xhelal Vishnjën në shtëpi të saj! E pushtoi te këmbët, si ta përqafonte me mall.

— Shejtan kalamani! — i thoshte Xhelali dhe i përkëdhelte kokën me dorë.

— Erdhi xhaxhi Xhelali, xhaxhi Xhelali, — hidhej përpjetë Mira, duke rrahur shuplakat. Pashonia kënaqej tek e shihte të bijën aq të lumtur e të gëzuar.

— E shikon ti, Xhemal Krepi, sa shumë më do vajza tënde?? — hodhi me kast këto fjalë Xhelali.

— Ajo të do, se edhe prindët e saj të duan, — qeshi Xhemali.

— Kjo është e vërtetë, — pohoi agronom Dauti pa lëvizur nga vendi.

— Ashtu qoftë! — tha Xhelali dhe u ul në qoshen tjetër, përballë agronom Dautit. Xhemal Krepi me agrom Dautin sapo kishin filluar të pinin nga një gotë raki. Pashonia, i hodhi Xhelalit në prehër një peshqir dhe pas pak i solli legenin për të larë duart.

— Unë i lava vetë atje te dera, — bëri sikur e qortoi me shaka Dauti.

— Jo, mua më pëlqen kur më shtie, sekretarja e partisë, — tha duke u zgërdhirë Xhelali.

— Këtu s'jam sekretare, këtu jam zonjë shtëpie, — tha Pashonia me atë buzëqeshjen e saj të ciltër.

— Dale se i shtie unë, — u ngrit me vrull i shoqi i saj, Xhemal Krepi.

Xhelali lau duart dhe i fshiu ngadalë, me nge. Mira hidhej a s'hidhej nëpër dhomën me dérrasa. Ajo kishte flokë të verdhë, greth, ballë të gjerë, të dalë, ca sy pak të mëdhenj e si të bardhë, por shumë të shkathët. Gojën e kishte të vogël, të kuqe, që kur fliste, i lëvizte si një gonxhe trëndafili. Njeriu mund të bënte muhabet me të si me një të rritur.

ngritur zërin, por më një theks kundërshtimi, — nuk e lë të shkojë me dhi plakun unë, dashkeni të ma gremisni në ndonjë humnerë?

— Si të doni, — preu shkurt agronomi.

— Jo, jo, plakun nuk e çoj me dhi unë, — nguli këmbë ajo.

— Pusho, ti! sikur e qortoi xha Isufi të shoqen, ngaqë i erdhi si turp që puna kishte arritur sa ta mbronte e shoqja. Ajo shpuri buzën në gaz. Buzëqeshja sikur i ngriu një copë herë në cepat e buzëve dhe në faqet me rrudha, por që e tregonin më të re nga ç'ishte.

— Ah, more plaku im i shkretë! — tha ajo sikur po e vajtonte, — ç'paske për të tharë e për të ngrirë maleve, në shi e në dëborë!...

Xha Isufi buzëqeshte si i kredhur në mendime dhe tundte kokën hierë pas here. Tërë jetën maleve, nëpër shi i dëborë, e kishte kaluar kohën ai. Edhe tanë nuk u trembej maleve dhe dëborës, pavarësisht se i kishte mbushur të têtëdhjetë vjetët.

— Kaq shumë e dashkérke plakun ti, moj Isufe? — e pyeti Xhelal Vishnja, që deri atëherë nuk ishte futur në ato muhabete.

— Po e kam burrë, more Xhelal, për të unë kam lë-në shtëpinë time, kam lënë të dashurit e të dhimbsurit e mi, dhe si të mos e dua? — dhe i binte lehtë me bërryl te krahu xha Isufit, si për ta këshilluar që të mos zemërohej e të mos i thoshte ndonjë fjalë të papëlqyer në sy të tjerëve.

— Mendimi im personal është se xha Isufi duhet të zëvendësohet me një roje tjetër, — tha agronom Dauti me fjalë të shkoqura mirë e me një ton prej zyrtari.

— Keq që ju, o shoku agronom, nuk paskeni menduar fare për këtë qyqarin tim! — foli si e pikëlluar e shoqja e xha Isufit.

Xhemal Krepin e prekën këto fjalë, prandaj ndërhyri dhe tha:

— Sidoqoftë, mua ma merr mendja se asgjë nuk mund të bëhet pa e sistemuar në një punë të përshtatshme edhe xha Isufin. Ky është punonjës i vjetër i kooperativës dhe bille njeri i dalluar.

— Sigurisht, — pohoi edhe agronom Dauti dhe la të kuqntonte se s'para i pëlqente të vazhdonte më tej kjo bisëdë.

Mirën e kishte zënë gjumi duke luajtur me macen aty, mbi postiqen me lesh të dendur e të gjatë. Xhemali u ngrit, e mori në krahë dhe e hodhi mbi një krevat të gjerë, që e mibante përmiqqtë. Vogëlushja hapi sytë, bëri një gjest si përm t'u ngritur, por dora ledhatare e t'et e qetësoi dhe ajo fjeti përsëri...

Pashonia solli darkën në pjata të vecanta. Kishte bërë vezë të fërguara me gjizë, një tas të thellë me fasule, që skuqnin nga salca e qepët e tiganisura, dhe kos.

— Edhe hani, edhe pini nga pak, — u tha ajo dhe shkoi të sillte ca pjata të tjera bosh, lugë e pirunj përm të gjithë.

— Të lumtë, Pashone! — tha Xhelal Vishnja. — Si amvisë, s'ta kalon kush.

— As si sekretare, — plotësoi agronom Dauti me një ton, ku mund të dalloje edhe një fije romuzi të fshehtë.

— E kemi të mirë Pashonen, — tha xha Isufi me gjithë shpirt.

— Shumë të mirë! — plotësoi e shoqja e xha Isufit dhe të dy u ngritën menjëherë, si ta kishin bërë me fjalë.

Xhemal Krepi i përçollti miqtë dhe, kur u kthyte në vendin e vet, e pyeti agronom Dautin, duke i shkelur syrin me kast Pashones:

— Po ti, shoku Daut, përsë nuk vjen përm të jetuar me ne këtu në fshat? — buzëqeshte dhe e vështronët në sy atë.

Agronomi u zverdh, buzëqeshi, tundi kokën, pastaj tha: —

— Tani po e kuptoju se ma dashke të mirën ti, shoku Xhemal!

— Jo, jo, ta thashë me të vërtetë.

— Mirë është të vij, por ka edhe vështirësi përm ne.

— Të jetosh sic jetojmë edhe ne, — vazhdoi Xhemali.

— Edhe ne njerëz jemi, apo jo?

— Sigurisht, por ju, fshatarët, jeni të sistemuar, — në zërin e Dautit shquheshin nota zemërimi.

— Edhe ty tē sistemojmë. Tē japim shtëpi, tē japim dhe një parcelë tokë, po deshe.

— Nuk jetojnë dot qytetarët nëpër këto malet tonë! — i doli krah Xhelal Vishnja agronom Dautit.

— Mësohet, mësohet pér bukuri, — tha qetë-qetë Xhemali.

Pashonia, që i kishte ndjekur me kujdes këto fjalë, pyeti duke ecur nëpër dysheme, dërrasat e së cilës tundeshin dhe kërcisin:

— Po grua, ç'punë tē bën, shoku Daut?

— E kam ndihmësmjeke në spital.

— Shumë bukur! Ne kemi nevojë pér ndihmësmjeke.,

— ia priti e gëzuar Pashonia.

Dauti ziente përbrenda.

— E sheh si tē djeg, sapo tē preken telat e interesit personal? — ia priti Xhemal Krepi.

Po Dauti ka mbaruar goxha universitet, si mund tē vijë dhe tē jetojë me ne përgjithmonë? — tha me buzë tē varura si mëlçi Xhelal Vishnja.

— Unë, pér hesapin tim, nuk shoh asnje pengesë. Edhe fëmijët e tij mund tē jetojnë pér bukuri në fshat. Shkollë kemi, dyqane po, bukë e qumësht sa tē duash, ajër tē pastër, edhe gjueti, po tē ketë qejf. Tē vrasë në dac derra, në dac thëllëza.

— Jua kemi lënë juve tē gjitha, — tha Dauti me duart që i lëvizte *sikur* po shtynte diçka që nuk e donte. Sytë e tij tē futur ca si thellë dukeshin si tē lodhur.

— Partia do ta çmonte këtë dhe gazetat do tē shkruanin pér ty, — foli Pashonia, duke e përtypur shtruar kafshatën e bukës me ata dhëmbët e rregullt e tē bardhë si thelpinj lajthie.

— Gazetat shkruajnë pér masat dhe jo pér ne, kuadrot, — tha Dauti si i mërzitur e si i vrenjtur, ndonëse përpiquej tē buzëqeshte me zor.

Xhemal Krepi dëgjonte duke ngritur e duke ulur sytë herë pas here. Ai habitej se përsë këta njerëz, si ky agronom Daut, flisnin si me përgjim pér punën dhe jetën në fshat! Si komunist dhe si njeri që e shihte me besim

të ardhmen, ai nuk mund ta kuptonte përse këta njerëz
të kishin mendime të tillë!

— Që ta merrni vesh ju, — tha Dauti me seriozitet e si
me vrull, — unë fshatit i kam falur pjesën më të mirë të
rinisë sime.

— Hallall të qoftë! — e ndërpreu i kënaqur Xhelal Vi-
shnja.

— Por që t'i dënoj gruan dhe fëmijët e mi të bëhen
fshatarë në një kohë kur jetojnë për bukuri në qytet, kjo
do të ishte një aventurë për mua dhe një dënim i rëndë
për ta...

— E ke gabim, shoku Daut. Sipas teje, ne qenkemi
të dënuar që jetuakemi në fshat, — e qortoi Pashonia, pa
e ngritur zérin.

— I lëmë këto muhabete tanë? — i ra shkurt Xhelal
Vishnja, sepse e pa se agronom Dauti po ndizej e s'po
përmbahej më.

Xhemal Krepi buzëqeshi, kurse agronom Dauti mi-
ratoi me kokë. Në shpirtin e tij filloi të zgjohej frika dhe
dyshimi se mos këta; Xhemali dhe Pashonia, diç dinin
rrëth këtyre çështjeve. Kjo do të ishte vërtet vdekje për
të! Ai hoddhi sytë nga dritarja. Errësirë dhe asgjë tjetër.
Vetëm një dritë elektrike dukej diku thellë errësirës dhe
njigjante si një fener në mes të detit. Ky dyshim dhe kjo
frikë se mos Xhemali dhe Pashonia dinin ndonjë gjë që
mund ta sillnin familjarisht në fshat e torturuan agronom
Dautin edhe kur ra për të fjetur. Atë e vendosën në kre-
vatin mbi të cilin deri atëherë kishte fjetur vogëlushja
Mirë. Vendi ishte ende i ngrohtë nga trupi i saj i njomë.
Agronom Dautin s'e zinte gjumi. Rrotullohej herë majtas,
herë djathtas. I bëhej sikur dëgjonte ciatje minjsh sipër,
në hatllat. Jashtë frynte erë, që përplasej në xhamat e
dritares. Pashonia akoma s'kishte rënë për të fjetur. Siç
dukej, po lantë enët atje, në kthinën tjetër. Lodhet, — tha
me vete Dauti, — Grua e fortë kjo! — shtoi përsëri dhe,
kur e krahasoi me Vjollcën e tij, ndjeu se në mes të Pa-
shonisë, dhe asaj kishte një hendek-të madh, që i ndante.
— Më mirë të kisha qëndruar te Sherif Arra, — murmuriti
dhe u përpinq ta zinte gjumi...

* * *

— Oj Pashone! Oj Pashone! — e zgjoi herët, pa zbardhur, agronom Dautin zëri i një gruaje. Pas pak ai dëgjoi napat e Pashones. «Sa pak paska fjetur!» — mendoi dhe iu kujtua përsëri biseda e mbrëmshme pér fshatin.

— Shih, shih si i shkon macja prapa Mirës, — thoshte ajo gruaja, që kishte ardhur pér të kërkuar pak zjarr.

«Pra edhe Mira qenkerka zgjuar! — mendoi përsëri agronom Dauti, — kurse Iliri im ngrihet në ora shtatë. E megjithatë, Mira është njëqind herë më e fortë se ai...»

Ai ndenji edhe pak në krevat, duke e shpënë mendjen në shumë gjëra, në takime me njerëz, në ngjarje të herëshme e të vonshme, te xha Isufi, te e shoqja, te darka që hëngri mbrëmë, te bisedat pér fshatin, dhe u ndal te rroga që do të merrte të nesërmen.

U ngrit. Nga dritarja dukej hëna e venitur, si një portret femre e piktuar me ngjyrë të verdhë. Nga mallet, era sa vente e shtohej. Ndoshata do të binte shi. Ai ndjeu se i shkuan mornica nëpër trup. Bënte pak ftohtë. Nata është zakonisht e ftohtë në këto anë. Ai eci ashtu nëpër errësirë dhe gjeti, me duar, gelësin e elektrikut. Sakaq dhoma shndriti. Ai ferkoi sytë, ngaqë ia vrapa drita. Xhemal Krepi vazhdonte të flinte aty pranë vatrës. Dauti u vesh dhe zuri të ecte me majat e gishtërinjve pér të mos u zgjuar Xhemali. Në çastin kur po rrotullonte gelësinë e derës pér të ikur, nga kthina tjetër hyri Pashonia me xhevzen e kafesë në dorë.

— Po ti? — u habit ai.

— Të solla kafenë. Si u gdhive?

— Të falem nderit, Pashone. Kaq pak orë gjumë bën zakonisht ti?

— Si të ndodhë, — tha ajo pa u mburrur. Ai zuri të rrufiste kafenë. — Njerëz të mirë, — thoshte me vete. E ndiente se ishte larg shpirtit të tyre.

— Të të sjell pak qumësht?

— Jo, jo, Pashone. Zakonisht mëngjesin e ha pas orës nëntë.

— Kam edhe kos, po të duash.

— Të falem nderit. Unë po shkoj. Së shpejti do të zbardhë. Do të bëj ca veprime në zyrë. Pastaj do të fillojmë nga matja e tokave.

— Po tonën kur e ke në plan?

— Sot.

Ai hapi derën dhe, pa dalë mirë akoma, tha:

— Ditën e mirë, Pashone.

— Mirardhsh, shoku Daut!

Atij iu kujtua përsëri biseda e mbrëmshme dhe vritste mendjen se ç'e shtyu Xhemal Krepin që të fliste në atë mënyrë, Zbardhi. Andej nga lindja malet dukeshin si një sfond përrallor. Agronom Dauti iu afrova zyrave të kooperativës, por ndërroi mendim. Më mirë të shkonte te Sherif Arra, sesa të futej brenda në zyrë. Sherifi me siguri do të ishte zgjuar tani. Ai bëri prapa, kapërceu një gardh e i ra përmes një luadhi. Luadhi, që ishte kositur jo shumë kohë më parë, në një pjesë, dukej si një kokë e qethur me gërshtë. Vende-vende kishin mbetur tufa me bar, me një ngjyrë të gjelbër e të zbehtë, të venitur. Tutje shiheshin gjerdhe, kopshtie të vogla të anëtarëve, rrëthuar me hunj, të mbjella me lloj-lloj zarzavatesh.

Qeni i Sherif Arrës. me të lehura të shpejta e të forta, lajmëroi të zotin e shtëpisë se dikush po hynte në oborrin e tij. Sherifi zgjati kokën te dritarja, si breshkë. I gufoi kraharori, kur njoihu agronom Dautin. U ngrit, hapi derën me vrull dhe i bërtiti qenit. Kafsha heshti.

— Nuk të ha, jo, — foli Sherifi, tek zbriste nëpër shkallët prej druri.

— E kush i zë besë atij? Qen është ai, — tha Dauti dhe hyri brenda. Si u ul në qoshen e djathtë të vatrës, tha: — Më duket se edhe në këtë dhomë qenka pirë raki mbrëmë!

— Hundë të fortë paske! — ia priti si i habitur Sherif Arra.

— Është e vërtetë, apo jo?

— E vërtetë, — dhe i shkau një buzëqeshje.

— Kush ishte?

— Sefte erdhi Besniku, pastaj Islam Sula.

— Mirë Besniku, po Islami ç'donte?

— Edhe unë u habita; ndoshta ka pasur frikë se mos

kushedi Besniku mund tē mē tregonté ndonjë sekret mua.
— Tamam, i ke rëñë nē tē.

— Ose ndoshta erdhi pér t'i bërë qejfin Besnikut, se helbete, kohét e fundit Islamit sikur kanë filluar t'i dri-dhen leqet e këmbëve. Ankesat kundér tij, sido që ranë poshtë, nē një ményrë ose nē një tjeter, e kanë bërë një farë pune, apo jo?

— Patjetër. — tha me ton tē sigurt agronom Dauti.

Besniku, kur akoma s'kishte ardhur Islami, mē tregoi se e kishin thirrur nē Komitetin e Partisë pér çështjen e djalit të Dervish Lokut.

— Vërtet thua? — gati u hodh pérpjete agronom Dauti.

— Po, po, e kishin thirrur dhe, me ç'kuptova unë, ia kishin bërë tetë me dy.

— Po si tē tha konkretisht?

— Hollësira nuk më tregoi, sepse erdhi Islami, por e kuptova se e kishte pisk.

Agronom Dauti u krohdh nē mendime...

Ja si kishte ndodhur. Komiteti i partisë kishte lajmëruar me telefon se Besnik Sala duhej tē paraqitej medomës nē orën dymbëdhjetë tē asaj ditë te sekretari i Komitetit. Ishte ditë e shtunë. Besniku ishte duke biseduar pér problemin e gështenjave, pér kontratat e pér disa probleme tē tjera, kur i dhanë lajmërimin se e kérkonin urgjent. Ai shikoi orën e dore. Ishte tetë e tridhjetë minutë. Du-hej tē nisej mënjenjherë. Koha s'priste. «Pérse më kérkojnë vallë?» — Ai mëndoi se mos ndoshta kishte lënë pa kryer ndonjë porosi, por jo, s'iу kujtua asgjë.

Gazi i kryesisë së kooperativës nuk ndodhej aty. Besnikut do t'i takonte tē udhëtonte me ndonjë kamion tē rastit. U nis. Vjeshta po hyntë më téré bukurinë e saj. Në ato anë, nëpér ato gryka e lugina, vjeshta është stina më e bukur por edhe më e lodhshmja. Në vjeshtë fillon e pri-tet dushku dhe e bëjnë bigë, në formë mullari pér tē ush-qyer gjënë e gjallë gjatë dëmrit. Burrat hipin nëpér dru-rët e gjatë dhe godasin më sépatë degët e dushkut, kurse gratë dhe fëmijët i mbledhin dhe i bëjnë kapicë. Është e vështirë dhe e lodhshme kjo pune. Është dhe e rrëzikshme. Në Arrë dhe në fshatrat e tjera tē kooperativës ka pasur

raste kur njeriut i ka shkarë këmba ose i është thyer dega e dushkut dhe ka rënë poshtë, madje thellë në humnerë, ku është dërrmuar ose ka gjetur edhe ydekjen. Sidomos pisk e kanë ato familje ku s'ka asnje mashkull në shtëpi. Atëherë këtë punë janë të detyruar ta bëjnë gratë, mirëpo nuk është gjë e lehtë të ngjitet një grua majë dushkut dhe të godasë vazhdimisht me sopatë, me njérën dorë, se pse me tjetrën është e detyruar të mbahet pér të mos u gremisur në tokë.

Tek ngjitej pér të dalë në Kapercyll, Besnik Sula ec-te duke marrë frymë me vrull nga lodhja. Era lëvizte gjetet e gëshitenjave. Në të djathtë përhapej aroma e këndshme e gjinashtrës. Nga larg vinte jehona e një kënge. Në pér ngastrat e tokave, gratë, varg njëra pas tjetrës, me bluza ngjyra-ngjyra, përkulnin belin, ulnin e ngrinin shatat, që binin njëra pas tjetrës mbi tokën e ashpér nga thatesira. Pas korrjes së grurit, filloj puna pér mbjelljen e hamullores. Misër, sa më shumë misër! Besnikut iu bë zemra mal, kur i pa gratë që po punonin aq mirë. «Sikur të arrijmë të marrim 38 kv pér ha! — pëshpëriti me vete dhe shpejt e shpejt u përhoq të bënte me mendje një farë llogarie: — Do të merrnim aq shumë misër, sa nuk do të na mjaftonin depot...»

Udhës e zuri një shi i hollë, që i përplasej në fytyrë. Por pas pak shiu pushoi dhe një diell i bukur doli sapo ajo copë re e zezë u largua dhe u ndal mbi majën e maleve.

Në Kapercyll, shofer Kola, që e pa Besnikun tek po ngjitej, vendosi ta priste pér ta shpënë në qytet. E njihnin dhe e donin të gjithë Besnik Salën. «Shoku sekretar» ose shoku Besnik e thërrisin tē gjithë. Besniku hipi në skodën e Kolës, i shtrëngoi dorën atij dhe makina u nis. Menjëherë Kola filloj nga pyetjet dhe bisedat. Besniku i përgjigjej «po» ose «jo» dhe vështronë udhën plot me kthesa tē fortë. Ai përfytyroi sekretarin e Komitetit të Partisë, sic qe, tē gjallë, bugko, me ata sytë e tij zhbirues, si pér tē cilëve nxinin një palë vetulla tē trasha.

Pas një ore Besniku ec-te nëpër rrugët e qytetit me hap më tē shpejtë se zakonisht. Kishte ardhur në kohë,

madje pati mundësi edhe për t'u dhënë një lustër këpu-
cëve.

— Në orën 12 fiiks trokiti në zyrën e sekretarit.

— Hyr! — u dëgjua një zë nga brenda. Besniku i më-
shoi dorezës dhe hyri. Sekretari u ngrit, zgjati dorën dhe
e ftoi të ulej aty pranë tavolinës në formën e gjermës T.
Besniku qëndroi për një çast në këmbë.

— Uluni! — përsëriti sekretari. Besniku tërroqi ka-
rrigen dhe ndenji. — Ç'kemi andej nga Arra? — dhe se-
kretari e vështroi në sy.

Besniku nuk u përgjigj në çast. Ai e ndiente veten
pak të shqetësuar. Nuk dinte përse e kishin thirrur. Tek
i zgjati paketën e cigareve, sekretari e pyeti përsëri:

— Si po shkon puna për zbatimin e vendimeve të
aktivit?

— Ç'ka, jo keq, — sa mezi u dëgjua zëri i Besnikut.

— Domethënë jo dhe aq mirë.

— Kemi plot telashe. E vërtet është se duhet të pu-
nojmë më mirë. Në grurë, për shembull, realizuam de-
tyrën, por nuk realizuam zotimet.

— Po me misrin?

— Do të dalim më mirë.

— Kam përshtypjen se pak kohë dhe pak kujdes i
kushtonit punës me njerëzit. Mos harroni porositë e Parti-
së, se puna me njeriun, puna e gjallë, është kyçi i fitores.

Besniku e vështronët në sy pa folur.

— Tek lexoja letrën e një të riu nga Arra, po men-
doja pikërisht lidhur me punën që duhet bërë me njeri-
un, — vazhdoi sekretari dhe filloj të kërkonte diçka në
një dosje. — Ja, — pëshpëriti me vete dhe hoqi nga dosja
një letër, ku dukej një shkrim i keq. — E njeh ti Nuri Lo-
kun?

— Si urdhëron, e njoh.

— Ç'njeri është ai?

Me fjalë të prera, Besniku i tregoi gjithçka që dinte
rreth tij. Sekretari e ndoqi me vëmendje.

— A nuk është ky një qëndrim pak ekstremist? — e
pyeti në fund ai, kur Besniku kishte përfunduar të dhë-
nat rreth tij.

— Ekstremist?! — dhe Besnikut i shpëtoi një buzë-qeshje e lehtë.

— Po, po, ekstremist, — e ngriti zërin sekretari. — Përse ky djalë u dashka dërguar për dënim në një fshat tjetër? Çfarë të këqijash ka bërë konkretisht ky njeri? Gjithë faji qenkarë se paskërkë akuzuar Islam Sulën! Po këtë ai e ka bërë hapur, nëpërmjet organeve kompetente. Nga kjo pikëpamje ai s'ka përse të dënohet.

— Ka dyshime rrëth tij, shoku sekretar.

— Keni prova?

— Sikur të kishim, puna ndryshonte.

— Derisa s'keni, unë mendoj se nuk duhet ta trajtoni në këtë mënyrë. Ai ka të drejtë që ankohet edhe kundër teje, shoku Besnik.

Besniku vuri re se fjalët e fundit sekretari i tha si i mërzitur.

— Prandaj kini kujdes për gjëra të tillë, — dhe sekretari u ngrit në këmbë. Vazhdoi duke ecur nëpër zyrë:

— Siç ju thashë, duhet të keni kujdes të madh. Kryesorja për ju është puna me njeriun, për të krijuar tek ai bindje të thella politike dhe ideologjike mbi drejtësinë e vijës së Partisë.

— Edhe këtu kemi disa rezultate të mira, por që nambetet për të bërë më shumë, kjo është plotësisht e drejtë. Mirëpo në rastin konkret, ai djali ka manifestuar edhe xheste rrugaçerie me një vajzë shumë të mirë.

Sekretari ia priti me vrull:

— Përse xhanëm, e ndaluar është, sipas jush, që një i ri t'i shfaqë dashurinë një vajze?

— Jo, askush nuk e thotë këtë, — mblodhi supet Besniku.

— Po atëherë, ku qëndron rrugaçllëku i tij? Në rast se ajo vajza nuk e do, atëherë t'ia shpjegoni dhe të bindni djalin. Por, në qoftë se ajo e do dhe s'vepron dot, se mund t'i jenë bërë presione në forma të ndryshme, atëherë ju mbani përgjegjësi ndaj këtij djali.

— Unë!? — pyeti Besniku dhe instinktivisht fërkoi mjekrën me dorë.

— Po, po, ti dhe gjithë byroja e partisë! Keni arritur

— Dëri atje sa të përgatitet terreni për ta përjashtuar nga organizata e rinisë.

— Sepse shumica e të rinjve janë zemëruar shumë nga sjelljet e tij.

— Unë shoh se t' zemëruar je edhe ti.

— Dëri dikur po Ju e dini, shoku sekretar, se në çështjet morale fshatari jnë eshtë shumë i ndjeshëm.

— I ndjeshëm, i ndjeshëm, po mos harro se ne po luftojmë që fshataati të përqafojë thellë normat e moralit komunist. Ju, sipas mendimit tim, nuk keni bërë mirë që një të riu, i cili guxoi t'i shfaqte dashurinë një vajze, i krijuat një atmosferë të tillë mbytëse, sa ai u detyrua t'i drejtohen me letër Komitetit të Partisë. Ju nuk duhet t'i acaroni artificialisht gjérat. Ky veprim nuk i shërben unitetit. Ai eshtë një djalë i ri, ka botën e tij shpirtërore, por eshtë yni. Edhe në rast se ka ndonjë të metë, ju duhet ta edukoni...

Besniku, tek dëgjonte fjalët e sekretarit të Komitetit, zuri të vriste mendjen për ato që i thoshte ai.

— Ndoshta keni të drejtë ju, — e ndërprenë në fund Besniku. — Unë do të thellohem në këtë çështje. Po që vdiqëm me gjëra të tilla! Pesëqind çekanë na rrabin në kokë, jo gruri, jo misri, jo tokat e reja, jo pemët, jo aktivitetet kulturore. Hajde tani të merrem edhe me letrat e njerëzve!

— Gjithë puna aty eshtë, shoku Besnik, te njeriu. Të gjitha këto bëhen për njeriun. — tha me ton të qetë sekretari. — Po dite t'i futesh në shpirt njeriut, po dite t'ia njohësh hallet dhë brengat, atëherë do ta kesh fare të lehtë të punosh me të e t'a bësh përvete.

— Mirë, — tha përsëri pas pak Besniku. — Po e bisedoj edhe me shokët e tjerë çështjen e tij; ne do ta shohim problemin në dritën e këtyre porosive që na dhe. Sepse as ne nuk duam që t'i ashpërsojmë këtë kontradiktat.

— Unë jam dakord me këtë konkluzion, — tha sekretari dhe shkëmbjen nga një cigare. Ata vazhduan të bisedonin edhe për disa probleme të tjera me karakter organizativ.

27.

Toka, e shkrifët dhe e kuqërremtë, po lahej nga shirat e vjeshtës. Rrëketë e përrrenjeve malorë zbrisnin po-shtë grykave dhe luginave me potere.

Sude Çela zgjidhi nga gjoksi litarët dhe hodhi në oborr barrën e dushkut. Ajo grua, që tre muaj më parë ishte si molla në degë, tani kishte filluar të venitej e të fishkej. Atë e kritikuan për humbje të vigjilencës. Pas një muaji e përjashtuan nga Partia. Kjo e kishte dërrmuar fare shpirtërisht.

Tek po shtynte me këmbë degët e dushkut, asaj i zutri syri një njeri, që iu duk si i huaj. Kur ai sesi ktheu fytyrën në profil, për shkak se preu majtas, Sudja e njohu. Ishte Zeqir Trushi. Sudes i rrahu zemra me vrull. Ja djalli që i kishte nxirë jetën, që e kishte bërë fatkeqe;

Ajo kishte qenë kandidate partie, por e kishin përjashtuar, për shkak se nuk ishte treguar vigjilente në një rast, kur Zeqir Trushi kishte bërë ca veprime të rrezikshme në shtëpinë ku ajo ishte nuse.

Ajo e mori me mend se ai djall po shkonte në shtëpinë e Mersin Bories. Madje e dinte ajo edhe shkakun e asaj vizite: kishte dëgjuar se tek ajo familje do të bëhej, një fejesë me ndërresë dhe një djalë synet. «Duhet të lajmëroj», — vendosi aty për aty dhe, si rregulloi ç'kishite për të rregulluar, u nis pothuajse me vrap. Preu për shkurt nëpër pyllin me gështenja, me gjethë të rëna e të buta, që shtypeshin si sfungjer, ndërsa nën to ishte foka e lagët, e freskët, e butë.

Sudja eci si veriu me hap të shpejtë, derisa arriti te shtëpia e Pashone Krepit.

— Po ti? — e pyeti Pashonia si e habitur dhe e përaqfoi me ato duart e saj të ashpra.

Sude Çela buzëqeshi.

— Futemi brenda më mirë, — tha dhe hyri vetë e para.

Mira e vogël po pinte një tas me dhallë. E pinte duke rrudhur buzët.

Në mes të Sudës dhe të Pashones u zhvillua ky dialog me zë të ulët, thuase kishin frikë se mos i dëgjonte njeri:

— Zeqir Trushi erdhi përsëri sonte.

— Te ju?

— Jo, te Mersin Boria.

— Si do ta ketë hallin?

— Do të bëjë synet nipi e Mersinit dhe, me sa di unë, është dhënë fjala për fejesë me ndërrim.

Pashonia picërrroi syrin e majtë.

— Ç'të bëjmë? — pyeti ajo tek kafshonte lehtë me dhëmbë buzën e poshtme. Sudja nuk foli. Po vështrimi i saj i guximshëm dhe i sinqertë sikur i thoshte: — Flakën t'i vëmë.

— Si thua, Sude? — pyeti ajo përsëri si e menduar. — Prit, se e gjeta, — tha përsëri Pashonia. — Po e bisedoj me vullnetarët dhe me Sherif Arrën, — dhe Pashonia dolë me nxitim. Sudja filloi të fliste me Mirën, e cila, mbasi mbaroi dhallin, filloi të luante me arra në dhomë.

— Nëma mua këtë, — i tha Sudja me shaka dhe mori në dorë një kokërr arrë.

— Jo, e kam për kaqol.

— S'kam gjale unë se për çfarë e ke. Kështu i pret mysafirët ti?

— Këto nuk janë arra që hahen, janë për të luajtur. Arra për të ngrënë ka aty te sepeti. Ka edhe palë...

Ndërkaq u hap dera. Pashonia hyri si furtuna. Dukej e gjuar.

— Bisedova, — tha ajo me vrull dhe, ngaqë i vinte si për të qeshur, i fshehu buzët me duar.

— Ç'të thanë vullnetarët? — e pyeti Sudja.

— Të shkojmë e ta demaskojmë.

— Shumë bukur, — ia priti Sudja, e gjuar, dhe dolën bashkë.

Vullnetarët po prisnin te mensa. Sulë Metani po sqaronte Sherif Arrën rreth ngjarjes.

— S'ma merr mendja që të jetë kështu siç thua ti! — tha më në fund Sherifi.

— Të betohem që Zeqir Trushi ose ka filluar nga synetllëku, ose po mpreh briskun, — i thoshte Sula me një ton të papërmbajtur, sepse donte që ai njeri keqbërës të zihej sa më parë me presh në duar.

— Jo, jo unë nuk jam i mendimit që të veprohet kështu siç thua ti, — i tha Sherifi Pashones, kur ajo erdhi bashkë me Sudan dhe me dy të rinj të tjerë.

— Nuk je dakord? — e pyeti Petrit Skënderi pak si i

— Eja, eja dhe ti me ne, — i tha Pashonia Sherifit dhe e zuri për krahu, si për ta marrë me vete.

— Unë të vij me ju? A nuk e kuptioni se po shkelni ligjet? Pashone, mos u ngut...

— Si, të lejojmë kriminelët që të thyejnë normat e shoqërisë sonë! Ne po shkojmë, o ti, Sherif Arra. E mira është të vish edhe ti me ne, se je komunist, — tha Pashonia dhe priu e para.

— Jo, jo, — kundërshtoi Sherifi, duke bërë një hap prapa. — E dini se si do të vija unë? Po të mblidhet organizata bazë, po ta diskutojmë e po ta vendosim të gjithë, ndryshe unë...

— Kur të mblidhet organizata, Zeqir Trushi i ka kryer punët e tij, — tha Sulë Metani, si për ta mbyllur këtë bisedë. — Ti, or vëlla, dashkérke shumë ceremonira diplomatike, kurse ne po zbatojmë ligjet e revolucionit.

— Dhe vijën e masave, — plotësoi si me mburrje El-maz Fuga. — A e sheh? Ne kemi me vete edhe të rinj të tjerë...

Sherifi mbeti si i vrarë, pa qenë në gjendje ta zgjaste më. I pa ata tek u nisën.

Gjysmë ore më vonë mbërritën. Sapo kishte filluar të errej.

— Thirre babën një çikë, — i tha Pashonia një vajze që po tërhiqte një sqap aty te gardhi që rrethonte shtëpinë e Mersin Borisë. Vajza la sqapin dhe iku me vrap.

Pas pak doli një grua. Ishte e reja e Mersinit.

— Po ju hyni brenda! — u tha me gjysmë zëri dhe si me frikë.

— Le tē vijë Mersini një herë, pastaj shohim e bëjmë, ia kthcu Pashonia, duke zbatuar kështu vendimin që kishin marrë, gjatë udhës. Gruaja u largua si hije dhe si e rrahuar.

Sulë Metani diç fliste e bënte shakara me zë tē ulët me Linditën dhe Lirinë. Lindita ia plasi tē qeshurës me zë tē lartë.

— Filloj Lindita, — tha Pashonia pa e prishur gjakun.

— Mbani qetësi! — u dëgjuar zëri i Petritit.

— Veç kur tē na vërsulet Zeqir Aga me hanxhar në dorë, — vazhdonte shakatë e tij Sulë Metani.

Befas kërciti një derë, u dëgjuan hapa që zbrisnin nëpër ca shkallë tē drunjta. Dikush u afrua.

— Po tē jeni miq, bujrum, mirë se keni ardhur! — njohu Pashonia zérin e trashë tē Mersin Borisë. — Ti, Pashone, qenke?

— Po, unë. Na fal se po tē bezdisim pak.

— Po këta tē tjerët? — pyeti ai dhe u zgjati dorën me radhë. — Po ju qenkeni shumë! As me shtresë e mbulesë nuk jua dalkam dot! — tha si me tē qeshur.

— Ke njeri sonte në shtëpi, Mersin? — e pyeti me ton tē butë Pashonia.

— Shtëpi pa njerëz nuk ka, — ia ktheu me humor Mersini.

— Ndoshta brenda ke edhe miq tē tjerë, — përfitoi nga rasti pér tē hyrë drejt në thelbin e çështjes Pashonia.

— Ajo s'dihet. Çdo mik ka vendin e vet. Ju paçi fagen e bardhë, bujrum! — dhe bëri sikur po i udhëhiqte pér në shtëpi.

— Prit, prit, Mersin! — foli Petriti shtruar. — Puna është gjetkë. Ne jemi tē informuar se te ti sonte ka ardhur Zeqir Trushi. Është e vërtetë?

— Po pastaj?

— Është e vërtetë apo jo?

— E zémë se është, — ia priti me zemërim ai.

— Jo e zémë, — ndërhyri Pashonia. — Ti atë e ke brenda.

— Na u përgjigj drejt, — e ngriti zérin Petriti.

— Drejt? Nuk kam njeri tē huaj nē shtëpi, — i mëshoi zërit ai.

— Mos e thuaj atë fjalë, or Mersin Boria, se je burrë i vjetër, — u dëgjua zëri i Sude Çelës, që shprehte habi dhe dëshpërim.

— Po ajo që foli kushështë? S'po e dalloj.

— Unë jam Sudja, unë e pashë me sytë e mi Zeqirin që hyri nē shtëpinë tuaj.

Mersini s'foli një copë herë. Pastaj murmuriti:

— Ti paske spiunuar?!

— Po, unë lajmërova.

— Aferim tē qoftë! — ia priti Mersini gjithë nakar.

— Të dhanë ndonjë bakshish?

— Asaj mos i bëj presion, dëgjove? — iu vërsul meton tē ashpër Sulë Metani.

— Nejse, — sikur u zbut Mersini. — Po ç'doni nga unë, se s'po e kuptoj.

— Nxirre jashtë atë qen, — i tha Pashonia.

— C'thuha, moj Pashone! Eshë turp! — e holloi zërin Mërsini dhe shpuri dorën te faqja. — A nxirret miku jashtë?

— Ai s'është mik, por armik, — tha me zë tē lartë Petriti.

— Armik? Pse?

— Sepse ka ardhur që tē bëjë punë tē këqija, reakcionare, prandaj nxirre jashtë.

— Ashtu? — shprehu një habi tē thellë Mersini me sytë tē fryrë si tē bretkosës. Ndenji pakëz aty nē këmbë, sikur tē ishte përpëra një xhenazeje, pastaj, pa thënë gjysmë fjalë, u kthye mbrapsht dhe zuri tē ecte duke u mbajtur nē parmakët e shkallëve.

S'shkoi shumë kohë, ai u kthye vetë i dytë.

— C'ka bërë vaki? — pyeti Zeqir Trushi me zërin që i dridhëj nga ankthi.

— Ti sillesh këtyre anëve si djalli, — e ngriti zërin e tij kumbues Petrit Skënderi. — Na trego, arrite ta kryesh krimin apo jo?

— C'krim, more djalë, more zotëri?

— S'jam zotëri unë.

— Më fal, zotëri, shok.

— As shoku yt nuk është ky! — ia priti Sulë Metani me zë të lartë. — Ti je matrapaz, maskara...

— Je dallkauk, reaksionar, — u hodh Elmaz Fuga dhe e tërroqi me forcë nga krahu.

— Mosni, mosni, mosni për hatër të zotit! — Lëshoi një thirrje mëshire Zeqiri.

— Fol, e bëre synet nipin e Mersinit apo jo? — e kërcënoi Petriti.

— Jo, jo, për allah, jo!

— Qërrahu këtej e mos të ta shohim më bojën, — u dëgjua zëri i ashpër i Pashone Krepit. — Shtrig, shpirt-
qen!

— Të humbtë varri, të humbtë! — ia priti një njeri tjetër.

— Zhduku, se ndryshe... — tha Lindita.

Zeqir Trushi ua mbathë këmbëve. S'e pa rrugën nga shkoi.

— Dhe ti, Mersin Boria, s'ke bërë hiç mirë që u je futur allishverishevë me atë matrapaz dhe parazit njëri, — i tha Petriti.

— Keni të drejtë, — me zor u dëgjua zëri i penduar i Mersinit.

— Të drejtë, të drejtë, po ti u mundove të na e hedhësh deri në çastin e fundit, — s'u përbajt dot Petriti.

— Burri në shtëpi të vet bie ngushtë. Mos i paça kalamajtë, më mirë të kisha vdekur sonte...

— Nejse, këto gjëra do t'i bisedojmë kur të bëjmë mbledhjen me të gjithë popullin. Aty do të japë llogari edhe Zeqir Trushi; se atë njeri ne nuk e lëmë me kaq, edhe ti që ke pranuar të merresh me punë të tilla, — e mylli këtë çështje Pashonia.

— Doni t'jua them troç, or vëllezër? Kurrë s'ma merrte mendja se do të merrej vesh kjo punë...

— Është qeveri e fortë kjo, fle me një sy, — ia priti Sulë Metani. Petrit Skënderi qeshi nën buzë, kurse Lindita s'u përbajt dot, dhe e qeshura e saj u përhap me vrull nëpër errësirën e natës.

Sido që Mersin Boria bëri çmos që t'i mbante maz kar edhe për një kafe, ata nuk pranuan. U larguan. Nata po bëhej gjithnjë më e errët.

— Kafenë do ta pini tek unë, — u tha Sude Çela, kur ata iu afruan shtëpisë së saj.

— Te ti me gjithë qejf, — foli në emër të të gjithëve Pashone Krepi dhe hynë brenda gjithë gëzim njëri pas tjetrit.

28.

Kamioni i kooperativës uturinte në rrugën drejt Kapërcyllit. Mbi të kishin hipur tridhjetë e ca kooperativistë, gra e burra. Po shkonin tek «Uji i Ftohtë», në aksion, për hapjen e tokave të reja. «Uji i Ftohtë» ndodhet në Derdom, nja tre çerek ore larg Arrës. Arriotët zakonisht s'para shkojnë me qejf atje, sepse e para, është larg, e dyta, po të të zëré ndonjë shi ose po të fillojë murlani, të grin të ftohtët dhe e keqja është se s'ke ku fut as kokën. Qiell dhe pyje dhe asgjë tjetër.

Brigadier Mexhit i rrinte mbi kamion, në këmbë, i zënë krah për krah me Sulë Metanin, dhe bënte lloj-lloj shakash me të e me Lindita Salun. Pastaj ia nisi këngës. Lindita shquhej për zérin e saj melodioz. Pashone Krepit më shumë i pëlqente të dëgjonte sesa të këndonte. Koha ishte e bukur. Qielli shkëlgente si xham.

Punëtorët zbritën nga kamioni dhe u nisën varg njëri pas tjetrit nëpër udhët e ngushta të pyllit. Toka e butë, ngaqë ishte mbushur me gjethë të verdha, të kalbura, lëshonte një aromë të këndshme. Sulë Metani, ndonëse mërdhinte, ngaqë bënte pak ftohtë, u mahnit me bukurinë e atij pylli. Pyll i virgjër. Një ngjyrë si

kafe e çelur shtrihej ánekënd dhe sipër, qiel i kaltër. Ajri i pastër dhe i lehtë ua mbushte më shumë mushkëritë.

Kur mbërritën tek «Uji i Ftohtë», ata panë se derdomasit kishin bërë goxha punë. Puna për hapjen e tokave të reja kishte mobilizuar forca të mëdha. Në një shesh të gjerë ishin shtrirë kushedi sa trupa të trashë qarri dhe dushku. Kur i pa ashtu të shtrirë tërë ata trupa drurësh, Sulë Metanit iu duk sikur kishte përpara një shesh ku sapo kishte përfunduar një betejë e madhe.

— Nga do të fillojmë ne, o shoku Mexhit? — pyeti Elmaz Fuga dhe shkopsiti kopësat e xhupit blu.

— Ju burrat do të prisni dru me sëpatë dhe do të largoni trungjet. Kurse gratë të presin degët e dushkut.

Pashone Krepi nxori sëpatën e saj dhe filloi të priste degët e një dushku. Ajo i priste pa vështirësi dhe kjo punë i pëlqente. Tek qethë si me gëershërë degët e dushkut, ajo solli ndër mend Sherif Arrën. Në mëngjes, te Pashonia kishte vajtur ai anëtari i këshillit popullor të fshatit që maste tokat me agronom Dautin dhe i kishte shfaqur dyshimin se në mes të Sherif Arrës dhe të agronom Dautit duhej të ishte bërë ndonjë dallavere. Si fakt ai kishte sjellë atë që oborri i Sherif Arrës ishte matur pa pjesëmarrjen e d y ndihmësve të agronom Dautit.

— S'ma merr mendja, — kishte pëshpëritur Pashonia si nëpër buzë.

— Kaq di, kaq thashë, — kishte folur tjetri edhe ai si nëpër buzë.

— Jo, ti bëre mirë që më the. Po prapë s'ma merr mendja! Sherifi është komunist!

— E di, po mua më brente këtu në shpirt dhe s'mund të rrija pa e thënë.

— Jo, jo, ti bëre shumë mirë. Organizata e partisë e sqaron vetë këtë çështje...

Përfytyrimi i Pashones qe aq i gjallë, sa iu duk sikuri e kishte mu aty përpara Sherif Arrën, me nofullat e gjera, me ballin e madh, me kokën gjysmëtullace dhe me sytë e shkathët që i ngjanin si dy vrima.

Pashonen sikur e zgjoi nga gjumi e qeshura me gjithë shpirët, e Mexhittit. Diç i thoshte ai Sulë Metani shakaxhi.

Nga Arra erdhën përsëri forca të tjera. Ndër ta ishin edhe Islam Sula, Besnik Sala, Sherif Arra e të tjerë:

— Punë e mbarë, shokë!

— Mbarë paç, shoku sekretar!

— Po këtu qenka bërë kërdia! — tha Sherif Arra me dorën si strehë te balli dhe me zërin të holluar enkas, duke parë si me keqardhje tërë ato trungje e ata trupa drurësh të përbysur me forcë.

— Hiqe atë xhaketë dhe eja këtu! — ia priti Sulë Metani, duke vështruar Sherifin me sytë e tij të qeshur.

— Shyqyr që të pamë një herë në aksion, — shtoi ai.

— Ku kam fuqi të shtyj gjithë atë trung unë, more Sulë!

— Së bashku, së bashku, ja kështu, — dhe të tre vullnetarët me palla druri filluan të lëviznin trungun e trashë të qarrit. Te ata shkoi edhe Besnik Sala. Ai shtriu duart përpëra dhe zuri të shtynte trungun me tërë forcat e tij, sa u skuq e u bë flakë në fytyrë.

Puna po ecte mbarë. Vërtet ishte e rëndë ajo punë, por kënaqësia ishte e madhe. Eh, ç'tokë buke që do të bëhej ajo! Gjithë ato gjethë që kishin rënë vite e vite me radhë, që kishin krijuar shtresa të tëra, që ishin kalbur e bërë si humus, shërbenin si pleh i rrallë dhe me siguri gruri ose misri që do të korrej do të ishte me bollëk.

— Forca, or burra! — bërtiste me zërin e tij të ngjirur brigadier Mexhiti, tek sforcohej me të gjitha fuqitë e tij, në çastin kur kishte futur si pykë pallën poshtë trungut.

— O burra! — i përgjigjeshin zëra të tjerë gjithash tu të acaruar jashtë mase.

— Me thonj e me dhëmbë po e ndërtojmë këtë jetë, — mendoi Petrit Skënderi, tek vuri re damarët jeshilë, të fryrë të brigadier Mexhittit.

— Pas dy orësh, bënë pushim:

— Tani kush të dojë, le të hajë bukë. — tha Mexhi-

ti me gjoksin që i fryhej dhe i shfryhej me shpejtësi nga lodhja.

— Uluni, uluni në këtë qilim të bukur, — i tha Sulë Metani, Besnik Salës. Ai u ul vetë i pari dhe preku me dorë gjethet e rëna të buta, poshtë të cilave ishte toka. Besniku nxori një gazetë nga xhepi, e shtroi mbi gjethet e kalbura dhe u shtrua këmbëkryq. Te ata vajti edhe Pashonia, pastaj edhe Nifja e hollë dhe e gjatë si purtekë, por çuditërisht e zonja dhe e fortë për punë. Erdhi edhe Sherif Arra, i cili ndenji mbi një trung, si mbi kalë.

— Po unë që s'kam marrë bukë me vete? — pyeti ai duke buzëqeshur e duke i vështruar të tjerët me sytë e hapur shumë.

— Përse s'more? — u dëgjua zëri i hollë i Mexhitit.

— Harrova. Na hutoi ai dreq shoferi me atë borien e makinës që i binte vazhdimisht.

— Eja hamë bashkë, — i tha Petriti. Sherifi zbriti nga trungu dhe vajti e u ul në mes të Sulës dhe të Petritit. — Mua më ra më mirë se juve, — u tha nja dy bashkëfshatarëve Sherifi. — Kanë ushqime të mira këta vullnetarët.

— Do sallam? — pyeti Sula, — duke rrëmuar me duar në qesen e tij prej najloni.

— Si jo! Sallami të kënaq, — dhe Sherifi qeshi me zë.

— Gjithnjë harron të marrësh bukë me vete ti, Sherif, — e thumboi Nifja, që i pëlqenin shumë shakatë. Krisën të qeshurat.

— Hidh, hidh këtu një kokërr vezë dhe nja dy korrë qepë, — i tha Sherifi, pakëz i skuqur, duke i zgjatur dorën. Ajo i hodhi në prehër vezën dhe qepët.

— Ja kështu! — i mëshoi zërit Sherifi, i kënaqur.

— Më të lumtë ty! — ia priti Lindita.

— Eh, moj Lindita ime, dymbëdhjetë veta kanë ndarë një kokërr lajthi! — tha Sherifi si për të mbyllur bisedën. Ai zuri të hante ngadalë e i qetë. E përtyppte shtruar kafshatën e bukës, dhe Sula s'ia ndante sytë. Dikush nga vajzat qeshi përsëri.

— Hani bukë e mos hingëllini si pela, — bëri sikur i qortoi Nifja me buzën në gaz.

— E kanë nga të ftohtët, — ia priti Sulë Metani. — Edhe mua me zor më lëvizin nofullat.

— Pse, i ke dhëmbët ti?! e ngacmoi enkas Nifja.

— Këtë Nifen dua ta regjistrojmë për në grupin e estradës, — tha Sula, duke iu drejtuar Elmaz Fugës.

— Pse estradaxhi je ti? — vazhdonte thumbat e saj Nifja, duke u mbillaçit.

— Të vuri përpëra Nifja, or Sulë, — ia priti duke u përtypur Besnik Sala.

— S'ka gjë më të mirë, — tha Sula me dorën në zemër dhe vazhdoi fillin e bisedës: — Unë, shoqja Nife, jam si biçim regjisori amator. Unë zgjedh ata njerëz që kanë talent. Ti, për shëmbull, më dukesh një talent i vërtetë...

— Shihni, shihni një mi, — ua ndërpreu bisedën atyre një djalë i ri që foli me zë të lartë. Ai u ngrit me vrull dhe e ndoqi miun pas. Miu vraponte nëpër tokën e shtruar me gjethe. Ai vazhdonte ta ndiqte me potere. Nja dy herë e qëlloi me plisa dheu. Miu i madh sa një këlysh lepuri u fut në rrënjet e një qarri të trashë.

— Ka shumë minj këtej, — tha Sherif Arra dhe u ngrit duke fshirë thërrimet e bukës që i kishin mbetur anës buzëve dhe te mjejkra e parruar mirë.

— Ashtu? — pyeti si e habitur Lindita.

— Po, po, — tha rëndë-rëndë Sherifi dhe u nis drejt atij djalit që ndoqi miun. U ngrit edhe Sulë Metani dhe instinktivisht vajti drejt qarrit të trashë. Mi të tillë, aq të madh, ai nuk kishte parë kurrë në jetën e tij.

— Këtu u fut, ë? — pyeti Sula djalin që e shihte për herë të parë. Dukej që ai ishte Derdomas.

— Këtu, — tha djaloshi duke lëvizur një shkop në zgavrën e thellë të qarrit.

— Do të jetë trembur nga dinamiti, — tha Sula.

— Hapu, hapu një çikë — foli Sherif Arra dhe tërroqi lehtë nga krahu djalin. Sherifi ra në gjunjë dhe zhyti dorën në rrënjet e qarrit, pikërisht në një vrimë të madhe që dukej si gojë e ngërdheshur. Befas i shndri-

tën sytë, Buzëqeshi. Diçka i kishte prekur dorën. Ishte njeri me përvojë ai. Nxori një grusht me gështenja dhe nja dy kokrra arra. — Shihni! — thirri më zë, të lartë. — Gështenja dhe arra! — dhe zhyti përsëri dorën në gropën e thellë. Ai nxori përsëri gështenja, gjethë dhe ca arra, të kalbura. — E shihni? — bërtiste përsëri si me habi Sherifi. — Këtu mund të ketë një kuinal gështenja dhe arra. Kjo është si biçim depo e minjve.

— I fortë është ky Sherif Arra! — tha Petriti me buzë në gaz. Pashonia e vështroi më vëmendje. Iu kujtua denoncimi i fshatarit për çështjen e oborrit personal. Ajo nuk kishte biseduar me njeri. Në fillim këtë denoncim do t'ia tregonte vetëm sekretarit të byrosë së partisë dhe pastaj do të informonte organizatën bazë.

— Çudi e madhe! — pëshpëriti Sulë Metani si i habitur, kur shihte se grushti i Sherif Arrës vazhdonte të nxirrte gështenja dhe arra.

Pas paik filloj puna. Pashone Krepi godiste me sépatën e saj të shkurtër degët e një dushku të shtrirë përdhe, si ta kishte vrarë dikush më pushkë; Sherif Arra vajti te brigadieri i Derdomit dhe ju lut atij t'i jepte një kapsulë dinamiti.

— Përsë e do? —

— E dua të vras peshq, në Žall, te pellgu i Kadriut, — i tha me zë të ulët, por me dëshirë tepër të madhe. Brigadieri buzëqeshi dhe ia zgjati kapsulen fshehurazi. Sherifi e mori tinëz dhe e futi në xhep. Ndjeu një gëzim të thellë. Vërtet, mund të vriste shumë peshq më atë kapsulë ai...

Mali i Dërdomit zuri të buçiste nga era. Natën uléri-má e saj e zgjatur ngjante si një rënkim i thellë, i mbytur. Bilal Brëgu nuk flinte. Një kope ujqish ishte parë ato ditë dhe kjo e kishte tronditur deri diku. Shoku tjetër përballej tij gërhiste në gjumë. Bilali nuk ia shihte dot ftyrën nga errësira. Tute, në stallë, dëgjohej zhurma që bënin herë pas here dhitë, dëgjoheshin tinguj këmbore ose një fërkim në thuprat e stallës; një llamarinë përplasej diku, sipër në çati. Rrallë tek angullintë njëri nga të tre qentë, Bali, qeni më i dashur i Bilal Bregut. Bilali përpiquej të kapte edhe zhurmën më të vogël. Ishte dhënë i téri pas asaj tufe. I donte shumë ato kafshë të urta. Madje disave u kishte vënë edhe emra. Njérën e thërriste Shegë, një tjetër Dallëndyshe, një të tretë Drita.

Era e asaj nate ishte e rrëzikshme. I ati, Ali Bregu, ndjesë pastë, e kishte porositur që në netët me erë e me tufan tē kishte kujdes, se ujqirit, kur janë në kope, bëjnë kërdinë. E, pra, ato ditë kopeja me ujq ishte parë jo larg stallës, mu të «Kepi i Pëllumbit.»

Bilali kishte vëndosur tē mos flinte. Nuk mund tē flinte, edhe sikur tē donte. Gjumi i ishte larguar, dhe sytë i rrinin hapur nga meraku. Rrintë i shtrirë mbi krevat, i pažhveshur. Vetëm çizmet kishte hequr dhe ato i mbante aty pranë, për t'i pasur gati në çdo rast. Mendja i shkontë qark, herë te gruaja, herë te djali, herë te numri i ditëve tē punës që kishte bërë e herë te baxhoja, që nuk kujdësej aq sa duhej për tē marrë qumështin. Mendonte Bilali, po përsëri, sapo dëgjonte ndonjë zhurmë që vinte andej nga stalla, harronte gjithëcta dhe shqetësimi i përqëndrohej vetëm te bagëtia. Shokët ishin tē kënaqur me punën e tij. Tufa kishte filluar tē viinte gradualisht në rregull. Qumështi ishte shtuar, dhe shëndeti i kafshëve po përmirësohej. Po Bilali nuk kënaqej më kaq. Ose do tē bënte që tufa e tij tē arrinte rekord qumështi, peshe, dhe pjellshmërie, o s'ka! Ja, një

zhurmë më e madhe! Ç'të ishte vallë? Bilali u ngrit përgjysmë. Mbajti vesh. Nxori nga xhepi i jelekut prej leshi të ashpër çakmakun e tij. Ndezi fenerin. Kasollja ndriti. Shoku i tij tha si nëpër gjumë: «Fike, se më vra ve sytë.» «Fli, fli,» — i tha Bilali dhe u ngrit në këmbë. Do të shkonte në stallë. Do ta shihte me sy gjendjen e dhive ai. Do të kontrollonte edhe një herë derën. Po sikur era ose ndonjë keqdashës të kishin bërë ndonjë të pabërë dhe dera të ishte hapur? Veshi çizmet dhe doli duke mbajtur me njérën dorë pushkën, me tjetrën fenerin. Në fytyrë iu përplas era e ftohtë dhe e fortë. Ai ndjeu se po binte edhe një shi i hollë. Jo, ishte një si shtrat breshri shumë i imët. Tek i binin në fytyrë ato cikla të vogla, ai ndiente sikur po i binim ca si saçma të ndara në grimca-grimca. Bali angulliu me zë të ulët dhe erdhi dhe iu ferkua te këmbët Bilalit. Ky ia përkëdheli kokën dhe hapi derën. Ajo ishte në rregull. Një afsh i rëndë plehu dhish ia pakësoi frymëmarrjen Bilalit. Dhitë rrinj shtrirë pranë e pranë, ca me kokën të ulur poshtë, ca të tjera me vështrimin në një pikë të vetme, sikur të kishin ngrirë. Brenda në stallë bënte më ngrohtë. Ai vajti mu në mes të stallës dhe, duke ngritur fenerin lart, për të parë më mirë, i vështronte me kujdes ato kafshë të urta që dremisnin. «Eh, si dukesh? — i foli Bilali një cjapi. Të dhemb? Jo, e ke më mirë plagën.» Cjapi ishte vrarë para dy ditësh.

Bilali doli, tërhoqi derën pas dhe e mylli me reze, me kujdes. Era frynte e fortë. Bali lëvizi bishtin aty në një si lloj grazhdi që kishte sajuar Bilali dhe shoku i tij. Feneri gati u shua, po Bilali i ktheu kurrizin erës. Aty afër kasolles mori nja dy drurë dhe i hodhi mbi fundin e një fuqie që ata të dy e përdornin si mangall. Me majaën e drurit, shpupuriti zjarrin dhe hirin e dendur, pastaj hodhi drutë sipër.

- Po ti ç'burburon? — e pyeti shoku tjetër dhe u kthye në krahun e majtë.
- Kontrollova stallën.
- Fli, fli, se është shumë shpejt, — tha tjetri.
- Më ha meraku nga ujqit.

- Pse, dëgjove gjë?
- S'të lë era të dëgjosh.

Shoku tjetër s'foli më. Bilali ndenji mbi krevat dhe zuri të dridhte një cigare. Pastaj do të bënte një kafe. I mbante me vete kutitë e sheqerit e të kafesë. I pëlqente ta pinte një kafe mëngjes për mëngjes. Po qejfin më të madh ai e kishte atëherë, kur i bënte surprizë ndonjërit që i shkonte te stalla. E gostiste me kafe në një kohë kur vizitorit as që i shkonte ndër mend se mund të gjendej një gjë e tillë në zemër të malit Derdom...

30.

Pashone Krepi po pastronte stallën nga bajgat, kur e lajmëruan se po e priste Besnik Sala në zyrën e tij. Asaj i vajti mendja se do ta kishte thirrur për raportin e organizatës bazë, ku do të analizonin rezultatet e deri- atëhershme për zbatimin e vendimeve të aktivitit të parti-së. Por nuk ishte e sigurt. «Ndoshta më ka thirrur për ndonjë çështje tjetër,» — mendoi ajo.

Pashonia bëri si bëri, i nxori nja dy a tre kosha të tjerë me pleh jashtë në oborr, pastaj u nis për në zyrën e partisë. Te furra ajo pa plakun Mal Çalin dhe iu kujtua se emri i tij figuronte në raport si shembull i keq. Ishte njeri tuaf ky! Duke përfituar që e kishte shtëpinë veç dhe larg të tjerëve, i lëshonte dhitë e tij kù të mundte. Të gjithëve ua kishte sjellë mu në majë të hundës, por Mali ishte mësuar dhe as që e çante kokën nga fjalët që dëgjonte poshtë e përpjetë. Mirëpo kohët e fundit e kishin gjabitur. Tym ishte bërë Mali, por asnjërit nuk i kishte ardhur keq. E kishte mbushur kupën

aq sa s'mbante më. «Ndoshta më ka thirrur për këtë», — mendoi Pashonia dhe preu majtas më ata hapat e saj, të shkurtër, por të shpejtë si pulë mülliri.

— Ka mundësi, shoku Besnik? — hapi derën ajo pa trókitur.

— Urdhëro, shoqja Pashone, ty po të presim! — dëhe Besniku lëvizi nga karrigia. Aty në të djathhtë të tij ishte ulur Sherif Arra, dyllë i verdhë në fytyrë. Pashonia e kuptoi menjëherë shkakun e këtij takimi. Ajo i buzëqeshi çiltër Sherifit, po ky uli sytë me një pamje të vrenjtur.

— Ç'kemi, Sherif? — e pyeti përsëri ajo dhe nuk ia dha dorën, ngaqë i kishte akoma të ndotura me mbeturina bajgash.

— Ç'të kemi! Duan të më ngatérrojnë kot së kot! — tha si duke shfryrë ai dhe instinktivisht lëvizi nga karrigia, por ndenji përsëri.

— Mirë, mirë, — foli Besnik Sala me një farë nën-teksti. — Do t'i sqarojmë çështjet.

— T'i sqarojmë pos! — tha me rrëmbim Sherifi dhe befas nga i verdhë, u skuq në fytyrë.

Nga këto fjalë, Pashonia kuptoi se ata të dy e kishin acuar muhabetin.

— Tani, shoqja Pashone, çështja qëndron kështu, — tha shkoqur Besniku. — Shoku Sherif, ndërsa unë po haja drekë në mensë, zuri të më thoshte ca gjëra në adresë të Bilal Bregut. Atëherë u detyrova ta thërrisja këtu në zyrë dhe të bisedoja shtruar me këtë shok. Në fund i fola edhe për atë informacionin që të ka ardhur ty, si sekretare organizate, lidhur me atë që thuhet se mund të jetë bërë ndonjë dallavere ndërmjet shokut Sherif dhe agronom Dautit. Mirëpo shoku Sherif u hodh përpjetë dhe, nga zemërimi, filloi të binte edhe në gabime të tjera. Tani po të pyes ty, shoqja Pashone, në prani të Sherifit, a është e vërtete se të kanë ardhur e të kanë informuar se oborri personal i Sherif Arrës është matur vetëm nga agronom Dauti, pa pjesëmarrjen e dy ndihmësve të tij, pra pa komisionin që krijoj push-teti për oboret dhe bagëtinë personale?

— Po, — pohoi Pashonia, duke parë në sy herë Besnikun, herë Sherifin, të cilit i dridheshin cepat e buzëve.

— E dëgjove, shoku Sherif?

— Janë shpifje!

— Si? Mos do të thuash se ka qenë komplet komisioni te ti.

— Unë nuk di komisione. Unë di se oborri është matur në rregull.

— Jo, rregulli është shkelur, — tha si i indinjuar Besniku.

— C'më duhet mua se e paska shkelur agronom Dauti? Atij i kërkoni llogari dhe jö mua.

— Jo, më përpara ty, pastaj edhe atij. Ti je komunist. Në rast se është e vërtetë, ti mban përgjegjësi të rëndë pér këtë. Në një kohë kur luftojmë pér të forcuar rregullat, ti i shkel ato dhe na akuzon se po shpifim.

— Po; po shpifje janë, — i hapi sytë shumë Sherifi.

— Mjaft! — u ngrit në këmbë Besniku dhë, ndonëse e kuptoi se s'po bëntë mirë që po rrëmbehej, prapë nuk që i zoti ta përbante veten. — E qartë, — vazhdoi ai, — sqarimet do t'i japësh në organizatën bazë.

— Sherif, — ndërhyri Pashonia. — Të këshilloj që gjërat t'i marrësh më shtruar.

— Por jo dhë këshfu, Pashone! — tha Sherifi me zërin që iu drodh nga mallëngjimi. — Unë po i tregoja Besnikut se Bilal Bregun e kanë parë me një kusi me qumësh që po e shpinte në shtëpi. Kurse ky m'u vërsul e s'la fjalë pa më thënë.

— Pse t'u vërsula? Thuaje psë! Unë të pyeta cili e ka parë. Kurse ti nuk më tregoje personin. Atëherë të thashë se ti po merrësh më thashethème, të thashë se Bilalin e këmi shok të mirë, të ndërgjegjshëm, që po na e përmirëson gjendjen në blegtori. Ne nuk lejojmë që të ndjohosen shokët.

— Po, përmua pse besuake që paskam bëre dallavëre më agronom Dautin?

Besniku ngeci. Pyetja kishte qenë e goditur. Ishte si një lëvizje e fortë në shah.

— Nuk e kam besuar dhe as dua ta besoj, — foli me ton të butë Besniku.

— Ti, shoku Sherif, — ndërhyri përsëri Pashonia, — nuk ke bërë mirë që nuk i ke treguar shokut Besnik emrin e personit që të ka thënë për Bilal Bregun. Përse nuk e thua xhanëm?

— Sepse jam betuar. Ai ma tha në formë miqësie, — murmuriti Sherifi.

— Po ti je komunist, more Sherif, ti je i detyruar t'ia thuash medoemos Partisë. Kaq gjë nuk e kuption ti?

— Jo, nuk e kuptoju, — i ngrysi vetullat ai. Në shpirtin e tij kishte filluar të zgjohet frika se mos kishë rënë në një batak ku e kishte të zorshme të dilte pa u ndotur.

— Atëherë, pra, unë kam të drejtë të akuzoj se merresh me thashetheme, — e ngriti zérin përsëri Besniku. — Kështu si e shtron çështjen ti, unë kam të drejtë të besoj se ty nuk të ka thënë njeri për Bilal Bregun...

— Domethënë, e paskam shpifur unë nga koka ime! — e ndërpreu Sherifi, duke folur me ngut.

— Derisa nuk thua emrin, unë kam të drejtë të arrij në këtë konkluzion.

— E ke gabim, — tha Sherifi dhe fërkoi mjekrën me qime të parruara prej dy a tri ditësh, ca qime të rralla, të verdha, po të ashpra si të iriqit. E ndiente se e kishë pisk. Nuk kishte c'ëmër të thoshte. Pastaj foli përsëri me ngut:

— Kam një pyetje, shoku Besnik.

— Urdhëro, fol!

— Po sikur të të kishte ardhur ndonjë letër anoni-
me për Bilal Bregun, si do të kishe vepruar?

— Kjo është një çështje tjetër!

— Jo, jo, m'u përgjigj, si do të kishe vepruar? — i mëshoi zërit Sherifi.

— Do të kisha mbledhur fshatin dhe do ta kisha le-
xuar përpara të gjithëve. Dhe unë i pari do të kisha folur fjalët më të mira për Bilal Bregun. Dhe do të ki-

sha thënë se personi i letrës anonime duhet të jetë një provokator.

— Mirë atëherë, ajo që të thashë unë për Bilalin, zëre se ishte një letër anonime, — tha Sherifi dhe u përpooq të buzëqeshte, por në atë buzëqeshje kishte diçka të shtënë, të shpëlarë.

— Ç'janë këto gjëra që thua, more shoku Sherif! — ia priti si i lodhur dhe si i mërzitur Besniku. — A e kupton ti se po vë në diskutim karakterin tënd si njeri dhe si komunist!

— Si komunist unë jam në rregull. Të dhashë një lajm, ti, po deshe merre, po deshe hidhe në kosh, por unë s'ta tregoj emrin e tij, i kam dhënë fjalën, jam shqiptar unë, e mbaj besën.

— Ti nuk bën mirë që e kthen sa andej-këtej, ia priti Pashonia, duke kthyer dorën herë nga pëllëmba, herë nga kurizi.

— Jo, Pashone, jo, nuk di ta kthej unë, — foli Sherifi dhe u ngrit në këmbë. — Ka mundësi të shkoj tanë?

— Posi, mund të shkosh, — i tha Besniku.

— Ditën e mirë!

— Ditën e mirë! — iu përgjigjën gati me një zë Besniku dhe Pashonia.

Sherifi doli dhe tërroqi derën pas, me vrull. Ai ndiente një turbullirë të madhe në kokë. Ajri i ftohtë dhe pak i brishtë i përplasej në fytyrën e skuqur dhe në ballin pa flokë. Një damar jeshil i ishte fryrë si karrem i hollë dhe i arrinte deri afér syrit të majtë. Sherifi nuk dinte nga të shkonte.

Veteriner Afrim Qosja po bënte shaka me ekonomisten Liri, po Sherifi nuk u foli. I mërzitur e i vrenjturn, ai e cte duke u përpjekur të sillte ndër mend gjithë bisedën që kishte bërë me Besnikun. Befas qëndroi në vend. I lindi një mendim që i pëlqeu. U kthye përsëri nga kishte ardhur. Iu afrua zyrës së partisë. Dëgjoi zërin e Pashones. Hapi derën me vrull. Besniku dhe Pashonia kthyen kokën nga ai. E vështruan si me habi.

— Harrova të bëja edhe një pyetje tjetër, shoku sekretar, — dhe Sherifi u përpooq të buzëqeshte.

— Ç'farë? — dhe në ballë Besnikut iu formuan rrudha.

— Po ti, a ke mundësi të më tregosh mua emrin e personit që më paska akuzuar për dallavere me agro-nom Dautin?

— Do ta dëgjosh në organizatën bazë.

— Jo, jo, dua të ma thuash tanë.

— Thuaje, Pashone.

— Është Shaqir Tarja, — tha Pashonia si nëpër buzë.

Sherif Arra shtrëmbëroi fytyrën dhe ia priti sikur u lehtësuat nga një barrë e rëndë:

— Si? Kush? Ama ai?! Po ai ka inate të vjetra me mua...

— Sidoqoftë, ankesa e tij qëndron vetëm për faktin se këtu kemi të bëjmë me një shkelje të vendimit që thotë se në komision bëjnë pjesë tre persona. Shaqiri është anëtar i komisionit edhe anëtar i këshillit populor të fshatit.

— Ç'faj i ka agronom Dauti ose unë atij që vjen në orën 10? Ne pritëm sa pritëm dhe, kur e pamë se ndoshta nuk kishte ndër mend të vinte fare, filluam ta matnim vetë.

Besniku nuk foli. Nuk dinte si qëndronte e vërteta. Sherifi ndjeu se kishte bërë mirë që ishte kthyer. Vuri re se si Pashonia, si Besniku sikur po lëkundeshin nga miendiimi i tyre. Kërkoi leje për të ikur dhe doli. Tani e ndientë veteri më të qetësuar. Edhe mëndimet i kishte më të qarta e më të guximshme. Duhej të takonte sa më parë agronom Dautin. Duhej, të bisedonte medoemos me të. T'i tregonte ç'i kishte ngjarë, ç'përgjigje u kishte dhënë, në mënyrë që edhe Dauti të thoshte po ato gjëra. Kështu e kishte më të lehtë ta kalonte këtë telash që i rëndonte në zemër si një makth i zi. Ekte dhe bisedonte më vete. «Po sikur të vendoset që të matet përsëri oborri im?»

„Ai kaloi përpara merisës, pyeti nja dy fëmijë a e kishin parë agronom Dautin dhe, kui ata i thënë jo, pyeti përsëri duke u përkulur që të bëhej baras me ta:

— Po Xhelal Vishnjën?

— Jo, — tha njëri.

— E pashë unë me lopën e tij pér dore, — tha fëmija tjetër me zë të lartë.

— Në ç'vend?

— Afér shtëpisë së tij.

Sherifi s'e zgjati. S'duhej humbur kohë. Duhej të zinte të gjitha shtitjet. Gjithë e keqja mund t'i vinte në rast se do të matej përséri oborri i tij. «Po, kjo s'duhet të ndodhë, — mendonte ai. — Unë jam komunist, ata duhet të më besojnë. Po në qoftë se vendoset të matet? — kjo, pyetje e godiste si çekan në kokë dhe e torturonte. I dukej sikur tëmthat i mbusheshin me sumbullë djerse, sido që bënte ftohtë. — «C'duhet të them në rast se e matin pér të dytën herë? Fundi i fundit, përse nuk sajova një emër të rremë e t'i thosha se ai që më foli pér Bilal Bregun është nga Shënkoll? Se mos do të shkronin deri atje pér të vërtetuar në se është i vërtetë apo jo ky emër! Kështu duhej të kisha vepruar. Dhe me sigruri puna nuk do të kishte arritur deri këtu. Ptu! Ta hajë dreqi, ta hajë!» —, dhe pështyu anash gjithë mllef.

Nga larg ai pa Petrit Skënderin që po saldonte tubat e kanalit vaditës. Petriti ishte lidhur me litar dhe i kthehej tubit poshtë, të barku, pér ta salduar. Në ajër shkrepëtinin qindra e mijëra shkëndija të zjarcta, me një ngjyrë të fortë drite, që të verbonin sytë.

Sherifi mendonte i shqetësuar pér ato që mund t'i ndodhnin më vonë. Sa vinte, ky shqetësim po kthehej në frikë. Ai përpinqej të sillte ndër mend përséri gjithë bisedën që bëri me Besnikun, por nuk i mbante mend të gjitha. Madje tani nuk arrinte të përfytyronte as Besnikun. «Si është Besniku? — pyeste veten, por përséri nuk mundi ta riprodhonte dot. Kjo e bëri tepër nervoz. I shpejtoi hapat. Ja tek e gjeti edhe Xhelal Vishnjën. Ai po bënte një kërrabë prej thane me brisk.

— Ke ndër mend të vrasësh mullenja? — e pyeti Sherifi, kur i vajti pranë.

— E dua pér nipin, — ktheu kokën nga ai Xhelali.

— Kam dy javë që i kam dhënë fjalën.

- Lëre nipin, se mua po më pjell belaja, — tha Sherifi me nofulla të shtrënguara:
- Pse? — dhe Xhelali u pre në fytyrë.
 - Tani po vij nga zyra e partisë. Kam bërë goxha fjalë me Besnikun.
 - Si e kishte hallin shoku sekretar?
 - Nejse, — u pendua Sherifi, që po tregonte gjëra që s'duheshin thënë rrugëve. — E keqja është se ai makasjara Shaqir Tarja më paska spiunuar.
 - Ashtu? Për çfarë?
 - Për punën e oborrit tim.
 - I poshtri! — ia priti Xhelali me gojën që i mbeti hapur si kamare.
 - Vërtet i poshtër paska qenë!
 - Po q'mund të ndodhë? — pyeti pas pak Xhelali.
 - Ndoshta mund të japid urdhër për ta matur përsëri.
 - Po pastaj?
 - Po pastaj! Ma bëjnë problem në parti, ore!
 - E ç'do të të thonë?
 - Ouu, nuk i di këto gjëra ti, Xhelal, këto i di unë, ti më ndihmo si të dal nga ky qorrakat.
- Xhelali rrudhi supet dhe shtrembëroi buzët, i zhystur në mendime.
- Gjithë puna qëndron te agronom Dauti, — tha sëndër ethe Sherifi. — Po nguli këmbë ai, po tha se gjithçka është zhvilluar në rregull, çështja mund të mbyllët me kaq, përndryshe...
 - Çfarë përndryshe? Mos dyshon te Dauti ti?
 - Ah, more Xhelal vëllai! — tundi kokën Sherifi si ai demi që duan ta futin në kular.
 - Sa për atë, mos u bëj merak fare. Në fund të fundit, Dauti ka interes të ruajë edhe...
- Një mullenjë erdhi fluturimthi dhe ra aty, në një ferrë pranë tyre.
- E sheh? — ia bëri Xhelali me dorë. — Të kisha një llastikë, e lija në vend!
 - Mua po më del tym nga koka, kurse ti... — ai s'e

mbaroi të gjithë frazën dhe heshti si i vrarë e si i dërrmuar.

— Po pse, edhe me këto punë u marrka organizata e partisë? — sesi u kujtua të pyeste Xhelali, duke këqyrur Sherifin me vëmendje.

— Kur duan, merren, kur nuk duan, nuk merren. Po ti thua se Dauti do të më dalë burrë, ë?

— Qind për qind.

Sherifi i hodhi dorën në sup me dashuri.

— Rrofsh! — i tha si i përgjëruar. Xhelalit i erdhi mirë që po rritej në sytë e Sherifit, prandaj vijoi:

— Mua më ke gati për çdo nevojë.

— E di, të falem nderit shumë. Ti je djale flori.

— «Pronto», — përdori një fjalë italisht Xhelali dhe qeshi.

Ngadalë. si një copë rre e murme, po vinte e ëma e Xhelalit, Xhevria. Në të djathtë ishte e bija, Bakushja, që flitej se katër a pesë ditë më parë e kishte ndarë i shoqi për shkak se ajo kishte mbajtur marrëdhënie të fshehta me të birin e baxhaxhiut. Sherifi e kundroi nga larg dhe ndjeu se gjaku i lëvizi më me vrull. Bakushja ishte e re dhe e bukur. Nuk kishte lindur fëmi-jë. Thuhej se fajtor për këtë ishte i shoqi.

— Ti Sherif shejtani qenke? — e pyeti Xhevria me dorën si strehë për ta parë më mirë.

— Kanë filluar të të lënë sytë, oj Xhevrie! Si je ti, Bakushe? — Dhe Sherifi i zgjati dorën dhe ia shtrëngoi më shumë nga ç'duhej.

— Mirë shyqyr, po ti, Sherif? — foli ajo dhe u skuq në fytyrë. Sherifi ia lëshoi dorën, se i erdhi zor nga Xhelali, megjithëse kishte shumë qejf t'ia mbante më gjata.

— Sherifi është për bukur, — u hodh e foli Xhevria me fytyrën gjithë rrudha. — Nuk sheh si është kuq-kuq!

— Fshiji sytë, — qeshi Sherifi, pastaj iu drejtua përsëri Bakushes. — Kur paske ardhur?

— Kam nja tri-katër ditë.

— Do të rrish ndopak?

— Do ta mbaj derisa të mërzitet, — tha Xhevria dhe

zuri tē ecte. Bakushja buzëqeshi dhe ndoqi pas t'ämën.

— Shumë bukur, Bakushja na e zbukuron lagjen, — ia priti me kast Sherifi, dhe sytë e tij tē ndezur i ranë rrotull fytyrës me tipare tē bukura tē asaj nuseje tē re.

— Nuk e meritonte Bakushen ai mistrec, — bëri sikur i qau hallin Xhelalit ai dhe vazhdonte ta vështronë Bakushen nga pas, tek ecte ngadalë me atë trupin e saj tē gjatë e tē drejtë. Xhelali ngriti qepallat dhe s'foli.

— Nejse, — shtrembüroi buzët Sherifi, si për t'i thënpërsëri në bisedën që e kishte lënë përgjysmë.

— Po s'më la në baltë agronom Dauti mua, ata s'ka-
— Nuk tē lë, jo!

— E kush i njeh, more Xhelal? Jabanxhinj janë këta, tē lënë bishtin në dorë dhe kërcasin e ikin.

— Jo jo! — tha pas pak Xhelali si me vendosmëri. — Dauti nuk është nga ata.

Sherifit i shkëlqueu fytyra dhe mori frymë thellë, si i çliruar nga një ankth i madh. Pastaj tha me një ton joshës:

— Tani më duket se ka ardhur koha përfletërrufe-në e rakisë. Apo jo, Xhelal?

— Duhet tē bisedoj me Nuri Lokun.

— Shkoji në shtëpi, ja tek e ke, dhjetë minuta dava.

— Do t'i shkoj sonte.

— Kështu pra, — tha si i kënaqur Sherifi, se, helbete, fletërrufeja që do tē akuzonte Islam Sulën se kishte zier katër fuçi raki dhe se nuk kishte paguar as taksën e kazarant tē shtetit, do tē hapte punë në fshat.

— Po, po, do t'i shkoj sonte, — përsëriti Xhelali dhe filloj tē mprihëtë me brisk pjesë tē kërrabës.

— Kurse unë po shkoj tē gjej agronom Dautin.

— Dhe sa më parë bile.

— Ika, — dhe u nis nëpër rrugën e ngushtë, hapur përmes një are, ku sapo kishte kaluar Xhevria dhe Bakushja. Ai pa përsëri Petrit Skënderin kaluar mbi tubin që po saldonte. «I fortë ky Petriti, — mendoi Sherifi dhe vazhdoi udhën për në qendër tē fshatit.

Xha Isufi, i cili akoma vazhdonit ta mbante detyrën e rojes, po pinte ujë te çezmja. Qeni i Sherifit vinte vërdallë aty pari dhe, kur ndjeu erën e të zot, filloj tundte bishtin e trashë, si bisht dhëlprë. Sherifi futi kokën në derë të mensës, po nuk hyri brenda, se aty nuk ndodhej agronom Dauti Ekonomistja Liri i tha se agroñomi kishte vajtur gjér në Derdom.

Sherifi diç njëmi nëpër dhëmbë. U nxi në fytyrë. E kishte të domosdoshme që ta takonte sa më parë agronom Dautin. Mirëpo ai kishte vajtur në Derdom! Me mendime të shumta, që i buçisnin në kokë, me një frikë të quditshme, që sa vente ë po i shtohej, vendosi të shkontë në shtëpi. Ishte i shqetësuar jo vetëm për oborrin, por edhe për bagëtinë e tepërt që kishte. As Besniku, as Pashonia nuk ia kishin përmendur çështjen e bagëtisë. Por ai mendonte se mund t'ia kishin bërë me kaft. Murid të kishte hile nga ana e tyre. Ndoshita kishin në plan që ta zinin me prësh në duar jo vetëm për oborrin, por edhe për bagëtinë!...

E shoqja ishte duke nderur ca ndërresa, që sapo i kishte larë. Ajo grua e bëshme, me mëngë të përveshura deri sipër bërryleve, s'donte t'ia dinte fare nga të ftohtët. Krahët e saj tërë tule ishin skuqur e ishin bërë si këmbë rose. Sherifi e pa dhe u köllit énkas.

— Po q'u bërë gjithë ditën, more burré! — u dëgjuazëri i saj përkëdhelës.

— Ai i hodhi një vështrim domethiënës dhë'sfoli.

— Po ky këshfu? — murmuriti e shoqja nëpër buzë, po Sherifi, me ato nerva të tendosura, s'e dëgjoi.

— E pati dhe puna jonë, — lëshoi një i si rënkim Sherifi. E shoqja ktheu kokën nga ai, me duar në ajër, që mbanin pezull një palë të mbathura fëmijësh, borë të bardha.

— Si? — pyeti ajo, kur pa se Sherifi lëshoi ato fjalë dhë'spo e shkoqiste më gjatë çështjen.

— Në dogji Shaqir! — u mëshoi fjalëve ai.

— Shaqir Tarja? — dhë ajo uli duart dhe filloj t'i shtrydhët përsëri të mbathurat, pa ditur se ç'bente.

— Po, ai qen bir qeni! — rënkoj Sherifi.

— E ç'ka thënë?

— Se kam bërë allishverishe me agronom Dautin për punën e oborrit.

— Qelbësira! — u shëmtua në fytyrë ajo dhe mori frymë thellë.

— Më dogji i poshtri! — psherëtiu ai me kokën të varur pak poshtë dhe me fulqitë të shtrënguara nga zemërimi.

— E si i bëhet hallit?

— E di unë se si e do ai! — dhe Sherifi u bë si plak në fytyrë. — Të marrësh atë që kam varur aty brenda në mur dhe t'i shkosh e t'ia numërosh mu në lule të ballit; tang, tang; tang, a do më? t'i thuash! — dhe Sherifi bëri një gjest tamam sikur të kishte vrarë një njeri.

— Larg qoftë! — u lláhtar ish shoqja. — S'ka gjë, ne me bukë, ai me gurë. Por buka e ka mundur gurin. E kam pritur dhe përcjellë si vëlla qenin, — i tërhoqi fjalët zvarrë ajo dhe diç u përpoq të sillte ndër mend.

U dëgjua e pallura e lopës. Sherifi vështroi nga hauri. Duhej degdisur gjékundi mëshqerra. Nuk dihej se çmund të ndodhët nesër ose pasnesër. Ai hyri brenda në shtëpi, deshi, të hante pak bukë, por u pendua. Doli dhe u shkoqi një dy kallinj misri pulave që u mblo-dhën grigjë. Dhe, kur u err, nxori nga burgu lopën, që ai e quante mëshqerrë, dhe u nis për ta shpënë në Selishtë, te nipi i tij. Dinte një rrugë qorre Sherifi që s'para e shkelte njeri, sidomos natën. Atë rrugë bëri ai, që të mos e shihnin. Tek i shkonte ndër mend të gjitha, por sidomos kur mendonte se mund t'ia shtronin në organizatë, ai mallkonte veten dhe ishte gati që ta dorëzonte gjithë oborrin, madje edhe gjithë gjënë e gjallë, mjafton që të mos dënohej, të mos e cilësonin si njeri që kishte shkelur vijën e Partisë. Po përsëri, interesit i ngushtë personal, ajo ndjenja që të kishte sa më shumë, e verbonte dhe e bënte të arrinte në zërfundim se, fundi i fundit, nuk kishte bërë kushedi se çfarë, se nuk ishte ndonjë krim që të mbajë një lopë ose disa metra më tepër nga ç'lejonte statut!

Në Selishtë, Sherifi i rregulloi punët ashtu si i ki-

shëtë parashikuar dhe ashtu siç ia donte zemra, pastaj u kthye si veriu për në Arrë. Nuk pranoi të rrintë te nipi qoftë edhe për një kafe. E hante meraku se mos ndoshta ishte kthyer agronom Dauti, të cilin ai donte ta takonte sa më parë.

Kur mbërriti në Arrë, vuri re se dhoma e vullnetarëve kishte dritë. Ndoshta agronom Dauti mund të ndodhej aty! Nga penxherja ai pa Sulë Metanin që po studjonte. Sherifi i ra xhamit me majën, e gishtit tregues. Sula ktheu kokën.

— Kush është? — pyeti dhe u ngrit e hapi derën.

— Po, ti pse s'fle? — dhe Sherifi hyri brenda.

— Po studjoj.

— Cudi, gjithë bota fle, kurse ti me libra përparrë!

— Për dhjetë ditë na fillojnë provimet, Sherif i dashur. Është shkollë kjo, dhe jo fjalë.

Rri, ore, mos e lodh kot së koti trurin, se po punëtor do të mbetesh edhe kur të kesh mbaruar shkollën.

— Nuk ka rëndësi kjo, Sherif. Rëndësi ka fakti që unë kualifikohem, di më shumë, i jap më shumë shoqërisë.

Ata bisedonin me zë të ulët, se aty pranë flinin Petriti dhe Elmaz Fuga. Sherifi e shihte Sulë Metanin si me habi, dhe me një farë mosbesimi për ato që thoshte Sula.

— Agronom Dautin, e ke parë sonte? — pyeti pas pak ai.

— Jo. Ne u kthyem vonë nga kanali. Petriti ka vrarë gjurin.

— Shëndet e ka, — qeshi nën buzë Sherifi. — Sa herë na vritten gjunjët dhe këmbët ne, fshatarëve! dhe u ngrit. — Po iki, — tha, — natën e mirë!

— Natën e mirë, Sherif! — dhe Sula e përcolli deri te dera.

«E ku kam gjumë unë i shkreti! — tha me vete ai.

— Sidogoftë, një të keqe e largova nga shtëpia, — mendoi përsëri. E kishte fjalën për lopën që shpuri në Selishë...

31.

Nuri Loku, tanimë i rahatuar me punë dhe i qetë shpirtërisht, po mëremetonte një kotec, sepse dhelpra po ua shfaroste një e nga një pulat. Nja dy herë, ai dhe i ati, e kishin parë me sy dhelprën, kur kishte përfshirë nga qafa një gjel race me pupla të kuqe dhe lafshë të madhe, dhe të dy ata, atë e bir, s'kishin pasur q't'i bënin. Dhelpra s'e kishte prishur fare terezinë as nga të bërtiturat e plakut, as edhe nga një gur i Nuriut, që vajti pranë. Të dy kishin mbetur të hutuar e shumë të dëshpëruar, me sytë të hapur nga habia dhe inati.

— Na e përlau, pér allah! — kishte mëmurritur placu dhe i kishte rënë kofshës me pëllëmbën e dorës.

Mirëpo ata tanë do të kishin kotec dhe dhelpra s'do të kishte mundësi të hante pulat e tyre. Nuriu po e thurte bukur kotecin, me thupra thane. Le të vinte pas skëtaj dhelpra! Nuriu dhe i ati ishin betuar disa herë se ose do të gjenin një çark pér ta zënë të gjallë, o kota që jetonin! Mirëpo akoma nuk e kishin gjetur atë mjet, që me siguri do t'u fuste në dorë dhelprën dinake, pastaj ah, dinin ata se si do të hakmerreshin kundër saj...

Tek shkonte një e nga një thuprat, Nuriu dëgjoi dhe njohu zërin e Xhelat Vishnjës.

— Eja, se jam këtu, — tha me zë të lartë Nuriu, që s'deshi ta linte punën përgjysmë, sido që po errësohej Xhelali ia behu në qast.

— E mbarove? — e pyeti duke vështruar kotecin.

— Aty afër fundit jam.

— Po si shumë të madhi e ke bërë.

— Epo... — s'e mbároi fjalén Nuriu, duke shikuar me kënaqësi veprën e tij. — Po c'kemi? — pyeti përséri ai dhe e pa në sy Xhelalin. Kohët e fundit ata të dy ishin ftohur me njeri-tjetrin, sido që jo fare hapur. Dalja në brigadë e Nuriut nuk i kishte pëlqyer Xhelalit, as Hamitit, as Xhevries. Po Nuriu bëri ashtu siç i tha sekretari i byrosë, Besnik Sala, dhe çdo ditë që kalonte, ai e shihte qartë e

më qartë se sa bukur kishte vepruar, duke u radhitur përsëri në mes të shokëve dhe të shoqeve të brigadës.

— C'të kemi? — u dëgjua zëri i Xhelalit. — Ke shumë të fala nga Sherif Arra.

— Të fala paç! C'thoshte Sherifi? — pyeti përsëri, kur pa se Xhelali nuk po hapej.

— Prandaj erdha që ta pleqëronim bashkë një çikë, — foli ngadalë e si i kredhur në mendime Xhelali.

— Për çfarë? — sytë e Nuriut sikur u varën në ftyrën e tjetrit.

— Ai, Islam Sula, kërkon ta ngatërhojë.

— Për çfarë?

— Hollësira s'më tha, — ia priti Xhelali, se nuk deshi që t'ia tregonte të gjitha, nga frika se mos Nuriu trembëj dhe tërhiqej. — Unë erdha për atë çështjen e fletërrufesë.

Nuri Loku heshti. Rifilloi përsëri punën e ndërprerë. Shufra e hollë dhe e gjatë sikur nuk u vendos me atë saktësinë e të tjerave, prandaj e hoqi dhe e vuri përsëri, më me kujdes.

— Pse bën sikur s'dëgjon? — e pyeti Xhelali dhe i ra lehtë te gjuri me majën e këpucës së tij.

— I re në të, Xhelal.

— C'më kujtove ti mua? — dhe Xhelali picërrroi syrin e majtë. — Por po ta them qysh tani, se ti po bën gabim që e lë tjetrin në baltë.

— Në baltë? S'kam marrë ndonjë angazhim përpara Sherif Arrës unë që po e lë në baltë!

— Po përpara të tjerëve?

— Kujt të tjerëve? — dhe Nuriu u ngrit instinktivisht në këmbë.

— Ja, përpara meje, — dhe Xhelali me gishtin tragues i ra gjoksit të vet.

Nuriu nuk foli, mohoi me kokë.

— Kështu ti, Nuri Loku, tani që u rregullove, tani «O Mete për vete».

Nuriu vazhdonte të dëgjonte si i fyter.

— Pse, kështu është mirë? — vazhdoi ta sulmonte Xhelali, se e dinte që ai thyhej shpejt.

- Unë... — dhe Nuriu mblodhi supet.
- S'të dalin fjalët, se s'ke ç'të thuash! Të dha Besnik Sala një kockë dhe ti u shtrive si qen për ta lëpirë. Dole menjëherë në punë.
- S'kisha ç'të bëja, s'mund të vazhdoja më.
- Po ç'fitove? Ti në punë ishe. Apo fitove atë që u bëre zhële përpara gjithë botës.
- E di si është puna, Xhelal? — foli Nuriu me zërin të zbutur dhe me një ton sikur donte të shfajësohej.
- Ik, more, se paske qenë kalama fare! — dhe Xhelali bëri një xhest me dorë si i mërzitur dhe i zemëruar pa masë.
- Prit të ta them! — vijoi po me atë ton Nuriu. — Unë nuk mundesha më. U lodha e u mërzita pa punë, më kupton? Veç kësaj, Besniku u soll shumë mirë me mua.
- Dhe të lësh shokun në baltë?
- Po unë nuk e kam shok Sherifin.
- Si, si? Po ti ke kushërirë të shqoen e tij!
- Po, por nuk e kam shok, po të them.
- Po mua?
- Ty po, të kam.
- Po ti edhe mua po më pret në besë.
- Jo, Xhelal, jo, mos i ngatërron! — e ngriti zërin Xhelali. — A nuk kemi biseduar bashkë që t'i vëmë një fletërrufe Islam Sulës?
- Po, kemi biseduar.
- Hajt, pra, t'ia vëmë. Nuriu heshti. Nuk donte. Nuk donte t'a prishte përsëri qetësinë që kishte rifiuar.
- Një rrugë e dy punë, — e joshi Xhelali. — Sherifit i plotësojmë dëshirën, kurse Islamin e ngatërrojmë përsëri.
- Nuk mundem! — kundërshtoi Nuriu dhe u prish në fytyrë nga që përfytyroi tërë ato gjëra që do të ndodhnin pas fletërrufesë.
- Mendohu mirë!
- Jam menduar, nuk mundem, — tha me ton të vendosur.

- Po Sherifi di edhe gjëra që ty të djegin.
- Që më djegin? — Nuriu hapi sytë shumë.
- Po, po, bile që të përvëlojnë fare.

Nuriu u mundua të buzëqeshë me zor. Ku kërkon të dilte Xhelali me këto fjalë? Për herë të parë fytyra e shokut iu duk e shëmtuar, mizore.

— Ta lëmë këtë muhabet, Xhelal, — tha duke e mposhtur me zor zemërimin dhe u ul përsëri. Mori një thupër, e vërtiti nëpër duar, pastaj foli me zë të pakë-naqur: — Nuk e kisha besuar se nga goja jote do të dëgjoja fjalë të tillë! Të kam qmuar për shok të mirë.

— Po tani të dola i keq, ë? — u ngërdhesh Xhelali. Nuriu nuk deshi t'ia thoshte hapur këtë mendim që tanimë e kishte plotësisht të formuar, prandaj tha:

— Ditka gjëra që më djegin! Cilat qenkan këto gjëra?

— I di vetë ti, nuk është nevoja të t'i numëroj unë. Pa ditur qysh, Nuri Loku u ngrit përsëri në këmbë me vrull dhe tha:

— Mos e ke fjalën për ato që kanë të bëjnë me Xhejen?

— Edhe ato, por edhe të tjera.

— Edhe të tjera?

— I harrove dhitë ti?

— Dhitë? — u prish në fytyrë Nuriu.

— Po, po, dhitë. Ishim bashkë, apo jo.

Nuriu u drodh. E ndjeu veten me të vërtetë ngushtë.

— Për dhitë... — murmuriti dhe ankthi iu shtua e, duke mos e përbajtur dot veten, e zuri nga jaka Xhelalin: — Horr, po më kërcënon? — i tha sikur po e përpinte të gjallë.

— T'i thashë, se ndoshta i kishte harruar, — u përgjigji i qetë Xhelali dhe me dorën e djathtë uli duart e Nuriut, të cilat rrëshqitën ngadalë nëpër gjoksin e tij, derisa më në fund u varën poshtë.

— Nuk i kam harruar, — tha me përcëmim Nuriu. — Gjithë jetën nuk do t'i harroj.

— Shumë bukur, tani po më pëlqen.

— Por as ti nuk duhet t'i harrosh.

— Sigurisht, as unë, — u ngërdhesh Xhelali. Nuriu ia qepi sytë. Ajo sytyra e tij e zgjatur dhe e ngërdheshur po i pështirësohej shumë e më shumë.

— Kisha gjë tjeter pér të më thënë? — e pyeti Nuriu.

— Uli, uli nervat një çikë, — e zbuti pakëz zërin Xhelali. — Mos u nxito, dardha e ka bishtin prapa.

— Unë kaq kisha, — tha Nuriu dhe u ul përsëri pér të vazduar punën pér thurjen e kotecit.

— Domethënë hoqe dorë nga fletërrufeja.

— Po! — tha pa e ngritur kokën Nuriu.

— Edhe sikur të të bjerë keq?

— Edhe sikur të digjem dhe të përvëlohem.

Xhelali pështyu anash, përmes dhëmbëve.

— Mirë, — tha si në mëdyshje. Nuriu vazhdonte të shkonte *thuprat rrotull* kotecit me duart që i dridheshin.

— Unë them që ke kohë të mendohesh, — vijoi Xhelali, pasi hodhi hapin e parë pér t'u larguar.

Nuriu ngriti qepallat dhe s'foli. Ziente nga inati

— Është mirë të mendohesh, — theksoi përsëri në formë këshille Xhelali dhe ktheu kokën nga ai. Nuriu vazhdonte punën si me mospërfillje.

— Kështu, — vijoi Xhelali dhe gati-gati u largua. Po befas qëndroi në vend. Iu afrua përsëri. Nuriu i kishte kthyer kurrizin dhe po godiste me sépatë një dru gardhi që ishte shtrembëruar. Ai nuk donte të bisedonte më. Tani prania e Xhelalit e bezdiste shumë. Xhelali e ndjeu se ishte e kotë të qëndronte më gjatë aty. Por nuk donte të largohej në atë mënyrë, që Nuriu të kuptonte se ishin prishur një herë e përgjithmonë.

— Kështu pra, ë? — i foli përsëri me ton të butë ai.

— Fundi i fundit, bëj si të të pëlqejë. Megjithatë, unë bëra detyrën time.

— Të falem nderit! — ia ktheu Nuriu si me kast dhe u largua gjoja se kishte punë. Për herë të parë i shkrepitë kokë mendimi se do të ishte mirë që vetë ai të shkonte e të bisedonte hapur me Pashone Krepin ose, fundi i fundit, edhe me Besnik Salën...

32.

Agronom Dauti u kthyeshin nga Derdomi aty nga ora dhjetë para dite. Ishte i lódhur dhe lodhjen ia kishte shtuar më shumë kapota prej leshi ngjyrë kafe. Në Derdom kishte bërë një mbledhje me gjithë anëtarët e brigadës për luftën kundër lagështirës dhe gërryerjes së tokës. Këto nuk ishin probleme që shtrohieshin për herë të parë. Jo! Për të parandaluar gërryerjen, kishte porosi të vëçantë edhe nga aktivi i partisë, megjithëse puna nuk po ec-te me ritmin që kërkohej. Petró Doraci dhe Bësnik Sala e kishin porositur Dautin që të shkonte të shihte me sak-tësi sa drurë ishin mbjellë nëpër pikat të ndryshme, që do të shërbentin si pengesë që të mos shkiste tokë. Agronom Dauti kishte vënë re se ishin marrë ca masa, ishin vënë ca prita, por në disa zona humnerat, dhe luginat ishin zgjeruar për shkak të rrëshqitjes së tokës. Ai e kuptonte se duhej bërë shumë më tepër, por punët vinin valë-valë, si ato dallgët e detit, njëra zinte tjetrën, dhe kështu përpara tij krijohej një lëmsh i ngatëruar, sa ai nuk dinte nga t'ia fillonte. Tek ecte i menduar, i kujto-hej kryetari i kooperativës dhe sekretari i byrosë dhe në kokë po formulonte si do të raportonte për ato probleme. Shpesh Besnik 'Sala i pëqente, sidomos ajo thjeshtësia dhe gjiltërsia e tij, por, kur sillte në mendje aktivin e partisë, kritikat e forta, pastaj detyrimin për të bërë autokritikë përpara njëqind e kusur burrave dhe grave, djemve dhe vajzave të reja të Arrës, atëherë gati-gati flokët i ngriheshin përpjete nga inati...

Kur kaloi lumin me ujë të turbullt nga shirat e fundit që kishin rënë, ai deshi të qëndronte për një kafe në shtëpinë e Drizajve, por ndërroi mendim. U nis drejt për në Arrë. E prisni punë të shumta atë.

— Po q'u bëre, more vëlla? — i tha Sherifi si me padurim, tek i doli përpara agronom Dautit.

— Lëre, lëre, se u këputa fare.

— E kam pisk, foli Sherifi, duke e vështruar me ngulm në bebe të syrit.

- Nga kush? — rrudhi ballin Dauti.
— Më është qepur ai Besnik Sala. Seç dreqin ka me muua!

Agronom Dauti s'po kuptonte ku e kishte fjalën Sherifi, po që diçka kishte ngjarë, kjo ishte fare e qartë pér të. Ai vështroi djathtas e majtas, pastaj bëri një dy hapa prapa, që të dilte pas një muri gjysmë të shembur.

- Tani fol, — i tha.
— Ka dalë puna e oborrit. Ai Shaqir Tarja, ai qen e bir qeni, na ka spiunuar.

Agronom Dauti u zverdh. Befas e pushtoi një frikë e madhe.

- Po pastaj? — pyeti me ton sikur nuk e shqetësonte asgjë.

— Gjithë puna është në dorën tënde. Po the ti se toka është matur në rregull, besoj që do ta mbyllin. Unë u kam thënë se Shaqir Tarja, me atë djalin tjetër, erdhën vonë dhe ne u detyruam ta matnim vetë.

- Ke bërë shumë gabim! — u prish në fytyrë agronom Dauti. — Në asnje mënyrë të mos ishe shprehur ashtu!

- E pse?
— Sepse unë do ta mohoj, më kupton?
— Çfarë të mohosh?
— Që të kam matur tokën.
— Je në vete?! Po unë këshfu dal haptazi gënjeshtar! — dhe Sherifit iu drodhën bugjt.
— Skam se ëbëj! Prandaj të thashë se paske bërgabim trashanik. Bobo! — dhe Dauti i ra ballit me dorë.
— Më like, or Daut! — dhe fytyra e Sherifit u ndër dhe u zgjat.
— Skam ç'të të bëj, unë nuk mund të lë fëmijët e mi rrugëve pér ty!

— Po e vërteta si qëndron, ashtu siç thém unë, apo siç thua ti? — pyeti si i xhindosur Sherif Arra.

- Ashtu siç thua ti, po unë jam i detyruar ta mohoj, se ndryshe më pret gjyqi.

- Po tregoj unë se! — e kërcënoi Sherifi, duke holuar zërin me qëllim.
- Kurse unë mohoj, — u mëshoi fjalëve ai.
- Kush besohet, unë apo ti?
- Atë provoje vetë, — foli me ironi Dauti, sepse e pa që Sherifi ishte i vendosur në mendimin e tij.
- Mirë, mirë, — tha pas pak Sherifi dhe tundi kokën, duke vështruar në tokë.
- Po ta përsërit, ti je nxituar, Sherif.
- S'pata nga t'ia mbaja.
- Bile je trembur.
- Sherifi heshti. Ishte e vërtetë që ishte trembur.
- Mohoje edhe ti, s'ke rrugë tjetër, — e këshilloi Dauti pas asaj heshtjeje trishtuese që pllakosi.
- Po dal gënjeshtar, more shoku Daut!...
- Epo unë, pra, s'kam se si të të ndihmoj ndryshe!
- Nuk e di ti se mua mund të më përjashtojnë nga partia pér këto punë? — dhe sytë e tij i ranë rrotull ftyrës së Dautit si sytë e një varfanjaku.
- Atë e di ti, — ia priti me indiferentizëm agronom Dauti. — Ti je anëtar partie dhe jo unë. Ta kishe menduar thellë atë punë.
- Cilën? — pyeti Sherifi, se e pati mendjen gjetkë.
- Dauti nuk foli. Ishte bërë tepër nervoz. Madje as që donte të bisëdonte më pér këto gjëra.
- Po edhe ti mos kujto se del pa u lagur, — i tërhoqi fjalët zvarrë Sherifi dhe sytë i shndritën çuditërisht.
- Mua shumië-shumë mund të më heqin ndonjë vëretje. *Pastaj ua tregoj gjithë të vërteten.*
- Cilën të vërteten?
- Që më je iutur si dreqi për t'a mbajtur tokë dhe bagëti të tepërt. Unë do të them se m'u dhimbs dhe e bëra këtë gabim.*
- Na këtu, — dhe Sherifi futi gishtin e madh midis dy gishtërinjve të tjerë. — Po në thënca unë se më ka ngrënë njëzet mijë lekë ryshfet?
- Dautit iu errën sytë. «C'fshatar dimak!» — mendoi me vete dhe pér pak që duke ia mbërthyer duart në fyt. Me

gjithatë, e përbajti veten. Sherif Arra kishte nxjerrë në shesh gjithë ligësinë e vët.

— Ky është kulmi i poshtërsisë! — thirri agronom Dauti si i tërbuar.

Sherifi e shikoi me qepalla të ngritura dhe në atë vështrim kishte diçka tepër agresive.

— Mirë, Sherif Arra, të lumtë, ma ke hedhur shumë bukur, të përgëzoj, — dhe i rrahu supin disa herë me radhë, i bërë dyllë në fytvrë nga inati.

— Të thashë, kam nevojë të domosdoshme të më ndihmosh, — foli me ton më të qetë Sherifi, ngaqë e pa se po e moshtte.

Ranjë heshtje e zymtë. Dauti i tha:

— Unë ndihmën nuk ta kam kursyer asnjëherë, po ti mos më vër mua kushte të tillë. Në fund të fundit, ndërgjegjja jote e di, mirë që unë nuk të kam ngrënë ryshfet. Bile, në dac ta dish ti, unë e urrej ryshfetin.

— Po edhe ndërgjegjja jote e di që tokën ma, ke matur, — ia ktheu Sherifi, duke e lëvizur majën e gjuhës si të breshkës.

— Ashtu është, — pohoi agronom Dauti. — Unë e kam hallin...

— Ti ke hallin tënd, kurse unë kam timin, — e ndërpren Sherifi, i skuqur prush në fytvrë.

Agronom Dauti po përpinqej të fitonte kohë. Duhej ndërruar udhë, duhej të mashtrohej ky makth që i kishte hipur befas mbi zverk dhe po i merrte frymën.

— Unë të kuptoj ty, Sherif, të kuptoj fare mirë, — foli si i penduar Dauti. — Tani gjithë puna është që të ndërtojmë një taktkë, më kupton? Një taktkë të tillë që sic thotë populli, mishi të piqet dhe helli të mos digjet.

— Tamam, — ia priti i kënaqur Sherifi. — Që të shpëtojmë hem unë, hem ti; — dhe buzëqeshi.

— Ç'hall i madh! — murmuriti si i menduar Dauti.

— Sa i lig qenka treguar ai Shaqiri! —
— Sa t'i bëjmë bisht këtij halli ne, pa pastaj ia tregoj unë atij, ia vë unë çarkun atje ku të mos ia presë mendja kurre! — tha i vendosur Sherifi dhe skërmitti dhëmbët.

— Qiraxhiu pa rënë te hanxhiu eshtë e pamundur, — tha me të qeshur Dauti. — Edhe Sherifi, — i tashmë Qeshi edhe Sherifi. Tanimë përtë dy po krijohet pështypjë sikur po merreshin vesh.

— Ta mëndojmë mirë këtë punë, shoku Sherif, — i tha në fund Dauti. — Unë do të bëj çmos të të ndihmoj.

— Rrofsh! — dhe Sherifi ia shtrëngoi krahun në shenjë dashurie.

— Fshatar maskara! — tha me vete Dauti, kur u nda prej tij, — dhe pështyu tanash me përbuzje...

— Nëse nuk e ka qetësi, — i tashmë Sherifi, — më dëgjohem që këtë gjithë është e vërtetë.

— Më dëgjohem që këtë gjithë është e vërtetë, — i tashmë Sherifi, — më dëgjohem që këtë gjithë është e vërtetë.

— Më dëgjohem që këtë gjithë është e vërtetë, — i tashmë Sherifi, — më dëgjohem që këtë gjithë është e vërtetë.

— Më dëgjohem që këtë gjithë është e vërtetë, — i tashmë Sherifi, — më dëgjohem që këtë gjithë është e vërtetë.

33.

Sherif Arra, disa ditë me radhë, e ndjeu veten të trishtuar dhe shpesh gjumi riuk e zinte. Ai përpëlitez në shtrat, pranë së shoqes duke shfryrë në të rrallë gjithë brengë. Kishte pësuar një disfatë tepër të madhe dhe ndoshta të pandreqshme.

Një mëngjes, kur ende nuk kishte zbardhur, ai, me shfryrjet e tij gjithë zhurmë, ia nxori gjumin edhe së shoqes. Ajo, më atë fytyrën e saj të madhe dhe me flokët e hallakatur mbi jastëk, vishtë e pakënaqur, se donite të flinte akoma. Mirëpo Sherifi kishte nevojë të bisedonte me dikë.

— Më zgjoi një endërr e keqe, — i thoshte asaj me zë të ulët.

— Lërmë tani, se dua të fle?

— Si tħua ti, Nazmie, ç'do të më bëjnë mua?

— Unë them se do ta kenë imbyllur, kaluan kaq ditë, — tha ajo dhe u kthyë në krahun tjetër. Sido që Sherifi kishte mendime të tjera, prapëseprapë i pëlqyen këto fjalë, sepse sikur e qetësan.

— Të gjithë më lanë në baltë! — vazhdoi ai, i dësh-përuar. — Hem Xhelali, hem ai kushërimi yt, ai mistrecë mistreci, hem ai pusht Dauti. Tani e shoh se kam bëre gabim qoftë për tokën, qoftë për bagëtinë. Ç'm'u desh mua të shkel ligjet dhe rregullat e qeverisë!

— Gabim, — pohoi edhe e shoqja dhe kjo fjalë i theri mu në zemër Sherifit.

— Tani po më thua gabim? — bërtiti me sy të zgur-dulluar Sherifi.

— Mos thirr, se po tremb kalamajtë! — u kthye nga ai Nazmia. — Të kisha thënë që të mos ngatërroheshe as me Islam Sulën, as edhe me të tjerë?

— Po ti e di pse u ngatërrova me ta!

— Se i kishe zili.

— T'ia fut duart në fyt! — u nxeh Sherifi dhe bëri një lëvizje si për t'u ngritur nga shtrati.

— S'kemi gjë në vijë kështu! — tha me ton të pa-kënaqur Nazmia. — S'është punë kjo, gam-gum, ditë-na-të. Shko, more burrë, e tregojua hapur të vërtetën, ata s'do të të varin...

— Bukur po më mëson! — e holloi zërin Sherifi më ngërdheshje. — Ta pësoj si breshka te nallbani, ë?

— Po edhe kështu si bën ti, nuk bën. Ta them hapur, e ke tépuar; — dhe ajo i ktheu kurrizin.

— Me ty?

— Edhe me mua, edhe me veten. Je burrë, burri nuk futet në brimë të gjilpërës, — dhe rrudhi buzët.

Sido që këto fjalë ishin tepër të rënda, Sherifi u qu-dit se si nuk i bërtiti Nazmies, as e shau, përkundrazi, heshti si një qen i rrahuar.

— Ti e di hallin tim. — tha çiltër, pas një copë here ai. Ti bën mirë që më kritikon, se, sa më don ti mua, as-kush nuk më do.

— Mblidhe veten dhe qëndro si burrë, pra! Pesë qind rrengje i sajuat Islam Sulës, po unë asnjeherë nuk e pashë të zyntë e të dëshpëruar.

— Eshtë skile ai.

— Po edhe burrë.

— Bën vaki që eshtë edhe më burrë se unë! Po të

kesh halle tē mëdha, siç kam unë, dhe tē dëgjosh gruan pa gdhirë tē tē quajë frikacak, kjo është pér tē vënë duart në kokë...

— Unë nuk tē thashë se je frikacak, por tē këshillova ta përbledhësh veten një çikë.

I nxehur e i tërbuar, Sherifi zbriti nga krevati. Kishte veshur një palë benevrekë tē gjatë e tē trashë, ngjyrë hiri, Ai hyri në kthinën tjetër dhe përplasi derën me forcë. U kthyte pas një pesë minutave. Ishte si i penduar.

— Me gjithë mend e thua që Islam Sula apo ndonjë tjetër, në katundin tonë mund tē hahet me mua pér punë gishti?! — dhe e përkëdheli me dorë te qafa. Ajo s'lëvizi.

— Do një kafe?

— Jo, dua gjumë.

Sherifi ishte penduar shumë. Herë-herë i vinte ta godiste veten me grushët. «Sa hajvan jam treguar! — mendonte. — E pse? Pér tē ushqyer dreqin që më ka hyrë në bark!» Dhe i vinte përsëri ta godiste kokën, me grusht. Dhe ndenji ashtu, në krevat një copë herë me grushtet, te tëmthat, i humbur në mendime tē thella.

Atë ditë, në ambulance, doktor Kristoja, tek po mje-konte dorën pak tē vrarë tē Pashone Krepit (ia kishte zë-në një disk) i tha Sherifit:

— More Sherif, c'dreqin ke që më je bërë si një plak tetëdhjetëvjeçar? Ose do tē lësh duhanin, ose ndryshe do t'i them sekretares që ta shtrojë në organizatën bazë.

Sherifit i dogjën shumë këto fjalë. Pashonia do tē kujtohej pér shkakun, e vërtetë tē dobësisë së tij fizike. Po Pashonia as që e mendoi fare një gjë tē tillë. Ajo bu-zëqeshi dhe ndoqi me sy lëvizjet e duarve tē mjekut që po i lidhët fashon e bardhë.

— Çudi e madhe me ju, doktor! — tha Sherifi. — Dini tē lidhni kaq bukur, tamam sikur tē ishit grua.

— Të tëra duhet t'i bëjë një mjek, — tha Kristoja. — Ja, pér shembull, sot infirmier Sefa nuk ka ardhur. Kështu që edhe mjekimet, bile edhe injeksionet, jam i detyruar t'i bëj vetë.

— Në dëfë'u duk Petrit Skënderi. Fytyra i shkëlqente nga një gëzim i brendshëm.

— E mbarove mbledhjen? — e pyeti Pashonia.

— Po. Dhë me sukses, — tha Petriti me një buzë qeshje të embël.

— Ç'mbledhje? — pyeti doktor Kristoja, tek po lante duart me sapun te lavamani.

— Ishë il deleguar në organizatën e rinisë, — folt Petriti. — Shtruam çështjen e katër vullnetarëve për në hekurudhë.

— Pati rezistencë? — pyeti Kristoja.

— More, po ndodhi e kufidërt! — ia priti Petriti me zë të hareshëm. — Gati të gjithë shfaqën dëshirën të shkojnë.

— Kush e kush mbeti për të vajtur? — pyeti Pashonia me një ndjenjë të thellë kënaqësie.

— Dy djem e dy vajza, — u përgjigj Petriti dhe nxori nga xhepi një bllok të vogël. — Mbetën perfundimisht këta: Shpëtim Demiri, Aishe Fani, Liri Su'a dhe Nuri Lökü. — Ai i lëxoi emirat sikur po bënte apelin.

— Edhe Nuri Lökü? — pyeti si i habitur dhe njëko hësisht i zemëruar Sherif Arra.

— Ka bërë një diskutim të shkëlqyer, — ia priti Petriti.

— Shumë bukur — tha Pashonia dhe i erdhë mirë që ai djalë po ecte gjithnjë e më shumë drejt së mires. Lumtë! ia priti edhe doktor Kristoja, tek po fshinte duart me peshqirin ngjyrë blu.

Jashtë, në oborr, dëgjoheshin zëra njerëzish.

— Unë ika — tha Petriti! — Kam edhe gjysmë orë kohë, — shtoi pasi pa orën e tij të dorës.

— Prit, se dalim bashkë, — i tha Pashonia. Me ta vajti edhe Sherifi. Donte të zhbironte ndonjë gjë ai, të merrtë vesh së si do të bëhej ajo çështja që po e brente në shpirt; siç bëni tenja rrobën e leshtë. Ishte matur disa herë që të bisedonte me Pashonën, po përsëri ishte tërhequ, ngaqë mendonte së ndoshta ata mund ta kishin mbyllur, kurse pyetja e tij mund ta rihapte përsëri.

— Dje bisedova me drejtorin e SMT-së, erdhë me

gaz dhe pa punimet pér kanalin, — i thoshte Petriti Pashones. Në përgjithësi ai mbeti i kënaqur. Unë i ngrita problemin e motopompës që do ta vendosim në rezervuar. Më dha fjalën që po.

Pashonia dëgjonte me vëmendje dhe me respekt dhe zemra i bëhej mal. «Me njerëz të tillë, të ciltër e të pallodhur, ke qejf të punosh, — mendonte ajo. — Këta ngritën oficinën ku tani mund të ndrezen shumë vegla pune, këta riparuan dy makina shkoqëse misri, këta i vunë gjoksin punës pér hapjen e kanalit dhe duke vajtur ndërmarrje më ndërmarrje, pa kërkuar asnjë ditë pune nga kooperativa, bënë si bënë, rregulluan mjetet e nevojshme pér saldim, të cilat do t'i mbeten pérherë kooperativës. Ç'shokë të mirë këta vullnetarët....»

Nja pesë minuta, Sherif Arra dëgjoi shpjegimet e disa hollësi të tjera rreth kanalit, që Petrit Skënderi ia thoshte Pashones me pasion. Tek fliste Petriti, ai fshatari i gjabitur erdhë t'i lutej Pashones që të ndërhynë në këshillin e fshatit dhe këshilli në gjykatë që t'i zbrisnin gjobën, se nuk kishte të paguante.

— Jo, xha Mali, — i tha me të butë Pashonia, — Vendimi i gjyqit është i prerë, paratë duhet t'i paguash.

— Po, unë nuk kam, — kundërshtoi Mali me atë fytyrën e tij të verdhë, si meit, dhe me ca dhëmbë të krimbur.

— Njerëzve u bie bretku në punë, — ndërhyni me vrull Petriti, — kurse ti lëshon bagëtinë në mallin e kooperativës. Je apo s'je në të ti, xhaxho? Mendon apo s'mendon ti pér të ardhmen e fëmijëve të tu?

— Si, ore, s'mendoj, pér kë punoj unë? Pér ata fëmijë? — dhe lëpiu buzët e murme me gjuhën e tij tërë krisa.

— Epo, po punove pér ta, mblidh mendjen, pra! Në qoftë se t' gjithë fshatarët veprojnë siç ke vepruar zotrote, këtu, në Shqipëri, rikthehet kapitalizmi! Ti e di se ç'do të thotë kapitalizëm, se e ke provuar në kurrizin tënd.

— Pse, unë e kthekam kapitalizmin?

— Shko tani e paguaj paratë! — e këshilloi Petriti,

— dhe jeto me djersën tënde. Kështu t'i mësosh edhe fëmijët e tu, edhe nipat e mbesat, dëgjove? — Dhe i rrahu lehtë shpatullën e djathitë. Fshatari ndenji pak si i shushatur dhe u largua pa bërë zë. Tek ecte me hapin e tij të çrregullt, tundte kokën.

— C'mirë që ia bëre! — tha si i kënaqur Sherif Arra, duke vështruar pas kurrizin e drejtë të fshatarit, si të një burri të mbajtur mirë, megjithëse ishte afér të shtatëdhjetave.

— Ditën e mirë, pra! — dhe Petriti i zgjati dorën në fillim Pashones, pastaj Sherifit.

Pashonia dhe Sherifi po shkonin në drejtim të zyrave të kryesisë. Ecën sa ecën dhe Sherifi, me zemrën që i dridhej, ngaqë e brente ankthi, më në fund mori kurajë dhe pyeti:

— Po mbledhjen e organizatës kur do ta bëjmë, oj Pashone?

— Javën e parë të muajit që vjen. Është muaj me shumë të mira ky, vijoi ajo. — Kemi festat e mëdha përpëra, 25 vjetorin e Çlirimt. Atëherë inaugurojmë edhe Kanalin vaditës, plotësojmë edhe planin e hapjes së tokave të reja dhe shumë e shumë gjëra të tjera të bukura. Shefi i llogarisë më tha se si nëntëmuajor plani është realizuar qind për qind dhe, po ta myllim gjithë vitin kështu, dita e punës del të paktën 12 lekë.

— Këto do të diskutojmë në mbledhjen e ardhshme? — i ra terthorazi Sherifi për të mësuar rendin e ditës, se atje e kishte hallin ai.

— Oh, jo, mbledhjen e kemi për dy pranime të reja.

— Bukur, bukur — ia priti Sherifi dhe ndjeu se buzët iu drodhën befas. — Vetëm për pranime? — vazhdoi më tej ai.

— Po, kryesisht për pranime. Komiteti na ka kritikuar për këtë çështje.

Sherifit gati i ngriu hapi. Pra, nuk do t'u shtruaka çështja e tij! Mori frymë thellë dhe s'kuptoi përse iu errën sytë. Pashonia hyri në zyrën e kryetarit të kooperativës dhe mori në telefon Komitetin e Partisë së Rre-

thit. Sytë e saj shkëlqenin. Ishte shumë e emocionuar. Gjoksi i hovte nga gjëzimi. Atë çast erdhi me vrap Mira e saj e vogël.

— Mami! — thirri ajo me zë të lartë dhe merrte frymë me vrull, ngaqë kishte vrapuar. — Eja më blej karamele, se e hapi dyqanin Cani!

Pashonia buzëqeshi, e mori për dore dhe e shpuri në dyqan...

34.

Fundi marsi. Qysh prej tri ditësh ka filluar një dëborë që s'ka të pushuar. Ajo bie qetë-qetë, me flokë të mëdhenj, si petale lule molle. Bardhesia, që të verbon sytë, ka mbuluar gjithçka, malet, pyjet, honet, luginat. Kafshët e egra janë strukur nëpër folëtë e veta dhe s'levizin. S'kanë nga të venë, s'kanë q'të kullosin.

Andej tutje, prapa përenjve dhe luginave, përtet pyjeve të bardha, vijnë herë pas here zhurma të ndryshme, që u ngjajnë fërshëllimave, rënkimeve, grahimeve.

Pas pak filloj stuhia. Borë dhe stuhi. Ulërijnë grykat, lëdhet e gropat, malet e luginat. Stalla me thupra, ku strehohet tufa e Bilal Bregut, është ngarkuar me dëborë dhe, nga pesha, ajo ka filluar të lëshojë bark. Aty brenda, tok me bagëtinë, është edhe Bilal Bregu me shokun e vet, Dyl Pëllumbin. Dylit i digjet gjithë trupi nga temperatura e lartë. Ai ka marrë një të ftohur të rëndë, pér shkak se dy net më parë mërdhiu shumë, ngaqë tok me Bilalin vajtën e sollën në stalle me stërmundime të mëdha degët e fundit të një bigë dushku.

Në fundin e një fuqie metalike, të prerë e të bërë

enkas si mangall, Bilal Bregu trazon hirin e dendur dhe i frys, zjarrit, që tē ngrohë shokun e tij tē sëmurë. Era, brisk e ftohtë, futet nëpër tē çarat e stallës, vërtitet nëpër qoshe, ndalet aty te krevati i Dyl Pëllumbit, tē cilit i shkojnë mornica tē akullta nëpër trupin e bëshëm, leshator. Ndihet në ajër tymi i ashpër i bajgave tē thata, që digjen bashkë me drutë.

— Nga hyn kjo erë e mallkuar? — pyet si me rënkim Dyli dhe lëviz këmbët pér tē rregulluar më mirë batanien dalëboje, që i ka shkarë pak mënjanë.

— Nga s'futet ajo! — përgjigjet Bilal Bregu, duke vështruar me inat tē çarat, plasat dhe derën që s'puthitë mirë, e nga ku vërvshonte me fërshëllimë era e ftohtë.

Bilai Bregu është ulur këmbëkryq mbi shtratin e tij prej suste që kishte lëshuar bark. Ai mendon pér gruan, pér fëmijën, pér nënën. Ky dimër i egër e kjo dëborë e madhe që vërvshuan papandehur duan zjarr me bollëk. Dru ka pylli sa tē duash, por Bilali nuk dinte nëse e shoqja dhe eëma kishin vajtur me kohë pér tē prerë apo jo.

Bagëtia ka uri, Bilali i shikon dhitë në sy dhe i duket sikur i luten t'u japë ushqim. Thellë në shpirt e vret vështrimi i dhive dhe i cjepte Bilal Bregun! Sytë e tyre, si xham, tē lëngshëm, nuk shqiten nga sytë e tij. Atij i duket sikur nga çasti në çast ato do tē flasin, do ta qortojnë. Në stallë s'ka mbetur asnjë fije bar, asnjë gjethë dushku. Pisk e ka Bilal Bregu dhe shoku i vet, Dyl Pëllumbi. Ndihma s'po u vinte akoma nga kooperativa.

— Paska qenë tuaf njeri ai Mexhit Driza! — tha Bilal Bregu, tek rrinte mbi sustën, poshtë së cilës ishte dyshëku i fortë, i mbushur me bar.

— Dreqi e di se ç'mund tē ketë ndodhur, — tha Dyl Pëllumbi. — Ndoshëta nuk dinë gjë fare se si e kemi hallin ne.

— Po zjarri që ndezëm në mëngjes?

— Me sa duket, nuk e kanë parë.

— Mundet, — pohoi me gjysmë zëri Bilali. — Sa tē çelë pak koha, do tē ndez përsëri tri zjarre.

— Pó mërdhij shunië, — tha Dyli. — E di sì dridhem?

— Të tē hedh edhe një bataniye tjeter?

— Hidhma!

Bilali hoqi një bataniye nga të vetat dhe ia hodhi Dylit. Herë-herë atij i vinte të shkonte tek ato bigat e tjera me dushk, që ishin larg rrëth një orë. Po sa dushk mund të sillte Bilali me dy krahët e tij? Veç kësaj, bora rritej e trashej shumë e më shumë. Bigat e tjera me dushk që ndodheshin afër stallës ishin mbaruar. Bilali dhe Dyli nuk kishin menduar se mu në breg të pranverës, kur dushku dhe pánja kishin shpérthyer sythe, do të rikthehej një dimër i tillë, i egër e i pamëshirshëm. Drequo punë!...

Pas gjysmë ore, bagëtia filloj të lëvizte. Bilali e kuptoi se diçka i trembi. Sakaq dy qentë e stanit, Bali dhe Murri, zunë të lehnin me tèrbim.

— Ujjit! — tha Bilali, u ngrit me vrull dhe përlau pushkën. U dëgjua një kacafytje e tmerrshme kafshësh të tèrbuara. Bilali hapi derën me vrull dhe, përmes erës akull të stohtë, që iu përplas me vrull në fytyrë, dalloj mbi dëborën e bardhë, si ca kërcunj të murmë, ujqi që po' shqyenin Balin dhe Murrim. Bilali i qëlloi me pushkë tri herë. Një ujk u shkëput nga tufa dhe imbeti i vrarë mbi dëborën e bardhë. Të tjerët ikën me linkth. Kishin qenë nga pesë a gjashtë ujqi.

Murri kishte ngordhur qysh në qastet e parë, kurse Bali, ah Bali, ai qen trim e besnik, aq i zgjuar dhe i dashur, me të parë Bilalin, duke kultur e duke rënkuar me dhembje të thellë, u zvarrit nëpër dëborë dhe vajti e qëndroi mu te këmbët e të zot. Një curril gjaku ngjyrë vishnje i vërvshonte nga qafa dhe i derdhei mbi dëborën e bardhë, duke formuar një njollë të zezë, të deformuar. Trupi i kafshës, si u drodh disa herë me radhë, u shtri sa gjatë — gjérë dhe s'lëvizi më. Bilalit gati i rrodhën lot. Era ia ngrinte kindat e kapotës dhe, ashtu i rrëthuar nga tèrë ajo bardhësi, ai dukej si një lapidar prej bronzi. Pastaj, duke shtypur me këmbë dëborën e butë si sfungjer, vajti te ujku i vrarë. Egërsira, me qime ngjyrë hiri, kishte ngordhur nga një plumb që e ki-

shte goditur mu në shpatull dhe kishte rënë mbi dëborë me kokën të kthyer anash. Me atë gjoksin me qime të buta si push, ai dukej sikur dremiste mbi atë peizash të bukur. Syri i djathhtë (se i majti nuk i dukej) i ishte shqyer shumë dhe i shkëlqente plot tmerr. Bilali i ra me shkelm dhe e rrrotulloi praptazi, me këmbë përpjetë, Pastaj e tërhoqi zvarrë dhe e la aty pranë stallës, që të mos e mbulonte dëbora. Ai hyri brenda. Era e athët e plehut të dhive iu bë si lëmsh në grykë. Shoku i tij, Dyl Pëllumbi, gërhinte në gjumë. Ai s'kishte marrë vesh gjë prej gjëje se ç'kishte ndodhur pak më parë. Bilali nuk e zgjoi. U ul përséri mbi sustë me pushkën pranë. «Sikur të kisha vrarë tre ujq, — mendonte ai. — Mirë do të ishte edhe për kooperativën, edhe për mua. Tre ujq s'janë pak. Kush nuk do ta merrë vesh! Sa shumë do të gëzohej Gjylja!» Ai e përfytyroi të gjallë të shoqen, me atë fyttyren e bukur, të plotë, të pastër, me faqe si pjeshkë e ardhur mirë, me sy të qeshur dhe të ngrohtë. E kishte marrë malli shumë për të! Kishte njëzet e ca ditë që nuk e kishte parë, që nuk ia kishte dëgjuar zërin, që nuk e kishte përkëdhelur. Ç'fjalë të bukura, ç'poezi e vërtetë derdhej nga shpirti i Bilalit, kur ai rrinte me të, në një krevat, dhe i fliste me afshin e zemrës! E ndiente se ai nuk ia kishte zili askujt, ishte njeriu më i lumtur në botë...

E shkëputi nga vegimet e kollitura e Dylit, një e kollur e thatë, si krisma e kazmës, kur bie në një tokë me taban prej shkëmbi. Bilali iu përfytyrua përséri ujku i vrarë dhe pastaj pa ditur qysh sesi i vajti mendja te kuotizioni i Partisë. Ishte shumë i rregullt Bilal Bre-gu me të gjitha çështjet. Më 22 të çdo muaji ai paguan-te kuotën. Mirépo kësaj here kishin kaluar dy ditë. Passhonia, para nja dhjetë ditësh, i kishte thënë me gojën e saj se do ta lajmëronte për datën e mbledhjes së organizatës bazë. Por ai ende nuk ishte lajmëruar. Përse valle? «Sigurisht që do ta kenë shtyrë për më vonë», — mendonte Bilali. Ishte i shqetësuar. Gjithmonë ishte i shqetësuar për problemet e Partisë ai, dhe s'ka lumturi më të madhe për komunistin sesa të jetojë i shqetësuar

për problemet e Partisë! I varfri Bilal, nuk dinte si qëndronte e vërteta, nuk dinte ç'kishte ngjarë! Ai nuk dinte se personi që ishtë ngarkuar për ta lajmëruar ishte sëmurur papritur dhe s'kishte pasur mundësi të shkonte në stanet. Më kot priste, pra, Bilal Bregu aty, në stallë, ulur mbi sustën e krevatit, duke thithur erën e athët të plëhut, të pérzier me erën e rëndë të cjepve, që rrinin shtrirë me këmbët ngjyrë kafe përpara dhe me brirët e përdredhur e me mjekrat që u vareshin poshtë, si shtellunga leshi. Rinte aty i kredhur në mendime e i shqetësuar për shokun e sëmürë e për bagëtinë që s'kishte ç'të hante, vriste mendjen herë për një çështje e herë për një tjetër, por Bilal Bregu, nuk dinte se aty në fshat, në Arrë, mbledhja e organizatës së partisë kishte mbi një orë që kishte filluar. Qysh në fillim, Pashone Krepikishte pyetur si e habitur përsë atë ditë mungonte Bilal Bregu, por dikush kishte thënë se, me siguri, do ta kishte penguar dëbora. Sidoqoftë, mbledhja kishte filluar dhe Bilalit i ishte vërië mungesë e paarsyeshme. Pika e parë e rendit të ditës — pranimi i dy të rinjve (një djallë e një vajzë) ishin shembullorë në të gjitha drejtimet. Megjithatë, atyre u dhanë shumë porosi. Pashonia, që kishte folur mirë për të dy, kur erdhi puna për të dhënë mendim për atë të riun, i kishte vënë në dukje edhe një të metë: të mos manifestonte asnjë shenjë fanatizmi ndaj së motrës, kur rastiste që ajo vonohej në mbledhjen e kryesisë së frontit, ku e kishin zgjedhur si sekretare.

Pas pikës së parë, shokët e organizatës menduan se mbledhja mbaroi me aq. Por ndodhi diçka e quditshme. Kur Pashonia pyeti nëse kishte njeri për të shtuar ndonjë çështje tjetër, befas u dëgjua zëri i Sherif Arrës, që doili si me dallgë, ngaqë gjoksi i fryhej e i shfryhej me shpejtësi.

— Me leje, Pashone? — dhe ai ia qepi sytë asaj, ata sy që e kishin humbur qetësinë dhe i shkëlqenin si xham. Gjatë shumë ditësh ai dridhej përpara Pashones dhe shokëve të tjerë. Rruga e shtrembër që kishte ndjekur, thashethemet në adresë të njërit apo të tjetrit, oborri dhe bagëtia e tepërt, mungesa e sinqueritetit ndaj Besnik

Salës, dëshira e egër për ta parë veten në karrigen e kryetarit të këshillit të bashkuar, egoizmi dhe rendja pas interesit të ngushtë personal, të gjitha këto ia kishin shtypur zemrën dhe kohët e fundit e kishin bërë të ndiente frikë e ankth. Nga kjo frikë e nga ky ankth, ai kishte ndryshuar shumë. Kjo dukej edhe në sytë e tij, që e kishin humbur shkëlqimin e dikurshëm. Në ta dalloje shqetësim e pasiguri. Por çasti për të mos mbetur deri në fund i pasinqertë kishte ardhur. Thellë në ndërgjegjen e tij ishte zhvilluar një luftë e madhe dhe ai kishte ndjerë një nevojë të domosdoshme për t'i thënë Partisë se kishte bërë faj (dhe atij i dilnin përpara syve tërë ato që kishte bërë në kundërshtim me normat e Partisë). Gjatë gjithë kohës së mbledhjes, ai ishte dridhur nga padurimi për të folur. I bëhej sikur diçka përvëluese ia digjte shojet e këmbëve. Dhe, kur tha «me leje, Pashone», rrëqethje të ftohta ia pëershruan gjithë trupin. Për një çast mbeti si i shtangur. Ai ishte një nga ata që s'e humbisnin toruan edhe në situata shumë të vështira, madje ishte i zoti t'i kapërcente të gjitha vështirësitë, mirëpo kësaj here e humbi fare. Në kokë kishte një përshtjellim të shkaktuar nga lufta e brendshme shpirtërore, që e kishte torturuar shumë kohët e fundit. Ai ndiente se kishte vepruar kështu nga mungesa e burrërisë dhe tani i vinte turp përpara shokëve. Por vendimi që kishte marrë për të folur hapur ishte i prerë.

— Kam disa net që gjumi s'më zë dhe motori i kokës më është çakërdisur, — vijoi ai dhe shpuri gishtin tregues te tëmthat. Sulë Metani qeshi, kurse të tjerët vazhduan ta shihnin me ngulm. Fytyrën ai e kishte të verdhë e të prishur, me të gjitha shenjat e një emocioni të thellë e të jashtëzakonshëm. Duke parë shikimin e habitur të shokëve, për pak qe duke u ulur, se iu duk sikur një lëmsh iu mbështoll në grykë dhe s'po e linte të vazhdonte më tej. Por ai kishte vendosur të fliste me çdo kusht. I erdhi mirë, kur nga vështrimet e shokëve ndjeu se ata po e ndihmonin që ai të fliste hapur e pa druajtje, gjë që do ta qlloronte përfundimisht nga çdo brengë. Por ndiente gjithashtu se bashkë me dëshirën për të folur,

kishte edhe turp, që e bënte të ngecëtë e të mos vazhdon-
te dot rrjedhshëm.

— Dhe kjo për fajin tim, — i mëshoi zërit ai. — Ti,
shoku Islam, të ma bësh hallall se të kam shkelur në
kallo. Edhe me ligjet e shtetit jam treguar njëri i keq
unë... — dhe heshti një hop. Petrit Skënderi, që e kishte
pranë Sherif Arrën, vuri re se ai i kishte mbërthyer du-
art mbi tryezë, thuase donte ta shqyente e ta bënte co-
pë-copë.

Pashëne Krepi ndiente gjëzim që Sherifi po i hapej
organizatës bazë. Ajo ishte në dijeni për këto gjëra. Një
orë më parë Nuri Loku kishte vajtur te ajo dhe gati me
lot në sy ia kishte treguar fije për pe të gjitha. Po, po,
të gjitha.

— Dó të thoni ju, përsë i shkela ligjet, përsë i hyra
në hak Islam Sulës dhe ndonjë shoku tjeter? As unë nuk
di se si shkava, — dhe mori frjmë thellë. Tani Sherifi
ishte disi i qetësuar. Ndohëse me vonesë, atij i mjaftonte
që u tregua i singertë, i mjaftonte pikërisht ky hap i
parë për ta qetësuar dhe për ta siguruar e bindur thellë
se ndodhjej pranë njerëzve që e donin. Ndjeu se e gjithë
tronuditja e kohëve të fundit po zhdukej nën ndjenjën e
fuqishme të atyre fjalëve që tha. Dicëka zuri të ndriçonte
në sytë e tij të turbullt. Mirëpo në çastin kur ai u bë ga-
ti për të vazhduar, për t'i thënë të gjitha e me hollësi,
befas u hap derë me vrull. U duk trupi i bëshëm i xha
Isufit, me pushikën në sup, tyta e së cilës u përplas me
kulmin e derës, dhe xha Isufi për pak u rrëzua, por u
mbajt në mur dhë tha me zë të lartë:

— Barinjtë duan ndihmë, janë ndezur zjarre!

— Do të kenë mbetur pa ushqim! — tha brigadier
Mexhiti me sytë të hapur shumë...

Islam Sula u ngrit me vrull dhe tha:

— Propozoj që të pezullohet mbledhja dhe, kështu
siç jemi, të nisemi drejt për të stanet.

— Menjëherë, — ia pritën katër-pesë zëra së bash-
ku.

— Mirë, pra, kush është dakord të pezullohet mble-

dhja? — pyeti Pashonia. — Ngrini dorën! — shtoi ajo. Votuan të gjithë pa përjashtim.

— Mbledhja shtyhet, — tha ajo dhe u nis të dalë. Jashtë binte borë dhe frynte erë.

— Islami ç'u bë? — pyeti ajo.

— Shkoi të marrë pushkën.

— Ti, xha Isuf, bjeri çangës, por fort! — e porositi Pashonia.

— Kujtova se po më thua që t'ia kërcas kësaj, — tha plaku, duke i rënë faqes së pushkës me pëllëmbën e dorës.

— Aha, s'lejohet! — buzëqeshi Pashonia dhe u nis drejt udhës që të shpinte në mal. Priu brigadier Mexhiti. Ai e dinte mirë udhën, sido që ishte mbuluar nga një shtresë e trashë dëbore. Pas tij ecte Pashonia, pas saj Sherif Arra. Ai vazhdonte ta kishte kokën të turbullt dhe vështrimin si të errët. Tani i kishte ikur ajo ngjyrë e verdhë, si të ishte i sëmurë nga verdhëza, tani faqet i kishte të skuqura nga një afsh i zjarrtë, i brendshëm. Sido që kishte folur dhe do t'u fliste përsëri shokëve, ai prapëseprapë, thellë, në tërë qenien e tij, e ndiente mirë kuptimin e katastrofës që kishte ndodhur me të. Vettëm tani, gjatë udhës, po e ndiente se sa shumë e kishte tronditit ajo mbledhje. Ai prekte duart e tij të ngrira, të ftohta, si të ishim sende pa jetë. Por çfarë do të ndodhë? Kjo pyetje kishte kohë që e torturonte. Ai vazhdonte të ecte pas Pashones në ményrë mekanike. Bora kërciste nën këmbët e tij. Këmbë pas këmbe, hapoj ai korridori i ngushtë rrëthuar anash me «mur» të vogël prej dëbore. Ngado përhapej një shkëlqim verbues. Diku, në qellin e zënë nga re të holla, dielli dukej si një njollë e verdhë. Plepat, dushku, panja dhe drizat e dendura, dëllinjat dhe frashëri, të ngarkuara me dëborë, farfurinin dhe ndrisnin si argjend i bardhë.

— Shikoni, gjurmë ujqish, — qëndroi befas Mexhiti. Pashonia përkuli trupin për të parë. Edhe Sherifi zgjati kokën. Këmbët e ujqve kishin formuar gjurmë që u përngjisnin gërvishtjeve mbi një çarçaf të bardhë. Dukej që s'kishte shumë kohë që kishin kaluar andej, sepse

gjurmët kishin filluar të mbusheshin përsëri nga dëbora që binte.

Ata zunë të ecnin përsëri më me shpejtësi, me hapa më të mëdhenj, që ngjisheshin mbi dëborën e trashë, drejt një të përpjete jashtëzakonisht të vështirë. Sherifi ndiente një dëshirë të madhe për të bërë diçka që shokët t'ia çmonin. Ai ishte gati t'i dilte përpara, ballë për ballë, tufës së ujqve dhe të përleshej.

Mbërritën në majë të kodrës. Aty ishte një udhëkryq. Po të merrje djathatas, udha për te stanet shkurtonte shumë. Por ishte tepër e ngushtë dhe ajo bëhej e rrezikshme nga dëbora që e kishte mbuluar. Mexhit dyzoi për një çast dhe u duk se po shkonte majtas.

— Djathatas, Mexhit, djathatas! — foli me ton të vendosur Sherifi dhe doli para të gjithëve me nxitim. Bëri përpara dy hapa, por, kur hodhi të tretën, ndjeu se befas i shkanë këmbët dhe u rrökullis në humnerën e thellë, si të ishte një deng prej leshi. S'u dëgjua asnë zhurmë, me përjashtim të një thirrjeje të befasishme që lëshoi Sherifi në çastin kur rrëshqiti poshtë.

— Sherifi, shokë, Sherifi! — bërtiti Pashonia me potere dhe u sul përpara me vrull.

— Ku vete ti, moj, je në vete? — e zuri Petrit Skënderi nga krahu.

— Atje në greminë mund të zbritet vetëm andej, — tha Islam Sula, duke bërë me dorë në drejtim të një kodre tjetër.

— Eja nisemi bashkë! — tha Petriti. — Ju të tjerët për te stanet, — dhe, i zënë dora-dorës me Islam Sulën, u nisë andej nga e shpuri ai.

E gjetën Sherifin pothuajse pa ndjenja, të mbledhur kruspull, si një shpend i vrarë. Kokën e kishte mbi ca degë të prera, poshtë të cilave rridhëtë uji si kristal i një përrroi të vogël malor. Njëri krah i kishte mbetur poshtë trupit, kurse tjetri, me pëllëmbën e dorës së mbledhur grusht, ku shtrëngonte dhë të lagur, bërë si baltë, i kishte ngelur i varur mbi ca rrënje të forta si shufra hekuri.

— Me kujdes, se qenka dërrmuar i shkreti! — tha Is-

lami dhe, si i vuri dorën poshtë laqes, i ngriti kokën, pastaj gjysmën e trupit. E ndihmoi edhe Petriti dhe e vendosën me kurriz të mbështetur në një si shkëmb. Nga cepat e búzëve i rriddhe shkumë përzier me gjak. Një plagë i ishte hapur mu te cepi i kokës, nga ku i kullonte gjaku pika-pika në qafë e i përhapej te shpatullat. Erdhi në vete për një çast, hapi sytë, të lagur nga dëbora dhe uji i përroit, dhe vështroi si i habitur:

— Ti, Islam, qenke?! Po ky, Petriti? — dhe ndjeu, në kundërshtim me vullnetin e tij, t'i shkisnin pika loti nga sytë, lot pendimi, faji dhe respekti për këta dy njerëz, ndaj të cilëve, sidomos ndaj Islamit, ishte sjellë keq por tani i kishte pranë në çastin më të vështirë të jetës së tij.

— Si e ndien vetën? — e pyeti Islami dhe i fshiu me mëngën e xhaketës gjakun që i shkiste në tëmtha Sherifit për herë të parë në jetën e tij, ky zë i Islamit, aq i butë dhe aq i ngrohtë, iu duk sikur i buronte nga vëtë zemra e tij.

— Ah, më mirë të kisha vdekur!... — murmuriti dhe përsëri i rrodhën pika loti që i shkanë si rruaza nga të dyja anët e faqeve.

— Lëri fjalët tani, çohu të dalim nga kjo humnerë!

— E ç'ju duhem më unë? — dhe Sherifi u fishk në fytyrë dhe vari kokën poshtë, i pafuqishëm për të lëvizur.

— Ti je shoku ynë, mbaje veten! — dhe Islami e mbante në krahët e tij me dashuri.

— Këtu, këtu kape, — tha Petriti dhe filluan ta nxirrin.

— Ta çojmë te Drizajt, — tha Islami dhe emori mbi kurriz.

Luginat dhe gropat, faget e kodrave, arat e lëndinat, malet dhe pyjet kishin një pamje fantastike. Nga degët e dendurantë drurëve, era shkundte dëborën që binte togje-togje. Dhe, kur dielli grisi një copë re të hollë, si copë mëndafshi, dhe kur derdhi rrezet e tij të ndritura, gjithçka mori një pamje që s'përshkruhet dot.

Binte dëborë përzier me rreze drite, që farfurinin si shufra të arta.

Nga larg u duk kolona e komunistëve të ngarkuar me dushk. Nga ana tjetër e fshatit po vinte një grup të rinjsh, që po vraponin për te stanet. Ishin ngritur të gjithë në këmbë.

«Sa bukur!» — tha me vete Petrit Skënderi dhe mori frymë thellë, me të gjithë forcën e mushkërive...

FUND